

Vebi BEXHETI
Hamit XHAVERI
Mustafa IBRAHIMI

**STUDIME ETNOLINGUISTIKE, FOLKLORIKE
DHE SOCIOLINGUISTIKE PËR KULTURËN
SHQIPTARE NË MAQEDONI**

CIP - Katalogizacija vo publikacija Nacionalna i
univerzitetska biblioteka "Sv. Kliment Ohridski", Shkup

811.18'282.4(497.4)'373.46:636

811.18'27

398(=18:497.7)

BEXHETI, Vebi

Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolin-
guistike për kulturën shqiptare në Maqedoni / Vebi
Bexheti, Hamit Xhaferi, Mustafa Ibrahim. - Shkup 2008.
- f. 245: 23 cm

ISBN 978-9989-173-19-6

1. Xhaferi , Hamit (autor) 2. Ibrahim, Mustafa (autor)

a) Gjuha shqipe - dialektet - Maqedonia - leksiku bleg-
toral

b) Gjuha shqipe - sociolinguistika

COBISS.MK-ID 74675978



Projekt i Qendrës për Hulumtime Shkencore të
Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe
Komunikimit - UEJL - Tetovë



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

Vebi BEXHETI
Hamit XHAFERI
Mustafa IBRAHIMI

STUDIME ETNOLINGUISTIKE, FOLKLORIKE
DHE SOCIOLINGUISTIKE PËR KULTURËN
SHQIPTARE NË MAQEDONI

Tetovë
2008

Prof.dr. Vebi Bexheti

**HULUMTIME ETNOLINGUISTIKE NË
VEPRIMTARINË BLEGTORALE
TË MALËSISË SË TETOVËS**

PËRMBAJTJA

HULUMTIME ETNOLINGUISTIKE NË VEPRIMTARINË BLEGTORALE TË MALËSISË SË TETOVËS	6
--	---

<i>Aspekte të përgjithshme.....</i>	<i>6</i>
<i>Lëshuarja e deshve dhe të pjellat.....</i>	<i>12</i>
<i>Udhëtimi i bagëtisë për në bjeshkë.....</i>	<i>16</i>
<i>Stani dhe organizimi i jetës në bjeshkë.....</i>	<i>18</i>
<i>Ruajtja dhe kullotja e dheneve</i>	<i>22</i>
<i>Mjelja e dheneve dhe bulmeti.....</i>	<i>25</i>
<i>Emërtimet e dheneve.....</i>	<i>29</i>
<i>Të qethurit e dheneve.....</i>	<i>32</i>
<i>Kripja e dheneve</i>	<i>36</i>
<i>Sëmundjet e ndryshme dhe shërimi i bagëtive.....</i>	<i>37</i>
<i>Veshja e barinjve</i>	<i>38</i>
<i>Frazeologjizma që kanë të bëjnë me kafshët.....</i>	<i>42</i>
<i>Disa toponime që kanë të bëjnë me blegtorinë.....</i>	<i>45</i>
<i>Dyndja nga bjeshka.....</i>	<i>49</i>

Prof.dr. Vebi Bexheti

HULUMTIME ETNOLINGUISTIKE NË VEPRIMTARINË BLEGTORALE TË MALËSISË SË TETOVËS

Aspekte të përgjithshme

Ashtu si të gjitha gjuhët, edhe gjuha shqipe si dukuri shoqërore qëllim kryesor e ka komunikimin, pra marrëveshjen midis njerëzve. Gjuha si aktivitet më i lashtë shenjëzues, u fut thellë në botën shpirtërore dhe shoqërore dhe u bë pjesë e pandashme e jetës dhe e veprimtarive të njeriut (shih te Anton Berisha, Shumësia kuptimore, Prishtinë, 1990, f. 9). Është shumë e natyrshme që gjuha të zhvillohet edhe të ecë me kohën dhe të arriturat e teknikës dhe të teknologjisë që i sjell ajo. Këto zhvillime më tepër janë të fushës leksikore, prandaj fjalorët e gjuhëve, dita ditës e rrisin fondin e vet. Meqë gjuha vazhdimisht lëvrohet, hulumtohet dhe studiohet, është normale që fjalori i një gjuhe të pasurohet edhe me fjalë të vjetra të veprimtarive të ndryshme të njeriut. Tërësia e këtyre mjeteve gjuhësore, për të shënuar realitete jetësore të natyrshme edhe të jetës së shqiptarëve, përbëjnë pasuri gjuhësore edhe në veprimtarinë më të lashtë të tyre, siç është edhe blegtoria e bujqësia.

Në këtë studim nuk kemi për qëllim të thellohemi në probleme të thella të shkencës së gjuhësisë por krahas veprimtarisë që e kemi lëndë trajtimi, do ndalemi edhe në gjuhën shqipe dhe përdorimin e saj në fushë të veprimtarisë blegtorale, në rrethin e Tetovës, me theks të posaçëm në Malësinë e Sharrit dhe të Malit të Thatë. Ashtu si bujqësia, edhe blegtoria si zeje ndër më të vjetrat ndër shqiptarë, në vete përmbajnë një pasuri të pashtershme gjuhësore që deri më tani janë studiuar shumë pak. Veprimtaria blegtorale që është jetike për shqiptarët dhe për shumë popuj tjerë, u zhvillua kryesisht në vise malore, sepse atje më lehtë krijoheshin kushte të përshtatshme për këtë degë ekonomike. Jeta larg qyteteve dhe vendbanimeve të mëdha fushore krijonte kushte më të mira për një jetesë jo edhe aq të lehtë. Bjeshka dhe kullotat, jeta në stane gjatë ditëve të verës,

krahas punës dhe mundimeve, këtyre banorëve u mundësonte edhe kënaqësi. Klima shumë e përshtatshme dhe kullosat e atyre viseve malore për disa muaj vere i bënë të lumtur këta banorë që dinin ta organizojnë këtë mënyrë jetese. Dimrat e gjatë dhe me shumë borë, blegtorët e kësaj pjese të popullatës shqiptare, i detyronte të bënin jetë nomade, që me bagëtitë e tyre në vjeshtë ta lënin vendlindjen dhe të niseshin për në vende me klimë më të butë, ku do të kalonin dimrin, prej nga, pranvera do t'i kthente përsëri.



Në botën shqiptare është e njohur gojëdhëna për plakën e cila mezi priti të vijë prilli, për të dalë në stan. Kjo gojëdhënë që për plakën dhe bagëtinë e saj, u shndërrua edhe në legjendë, është prezent në shumë vendbanime, të viseve shqiptare veriore. Edhe sot, kur kah fillimi i pranverës bën mot i keq që shpeshherë shoqërohet me borë, erë shi e fërfallëzë, thuhet se është “koha e plakave” ose “plakat” (Në botën sllave kjo kohë njihet si “Babi”, që ndërlidhet me plakën e vetmuar e cila me bagëtinë e saj nuk e priti kohën e përshtatshme për të dalë në bjeshkë por meqë bënte mot i mirë dhe po shkrihej bora, doli në stan kah fundi i Marsit. Ky veprim i ngutshëm i plakës si duket e ofendoi Marsin, muajin i

cili në bjeshkë llogaritet dimër i vërtetë. I nënçmuar nga një plakë që nuk e respektoi fuqinë e tij, kërkoi tri ditë hua nga Prilli për ta zgjatur jetën e vet dhe ta mbysë plakën me gjithë dhentë. Kështu iu drejtua Marsi vëllait të vet Prillit: *“Ore Mars bre vlla, mi jep nja tre ditë uha, ta mbejti plakën me kit xhi ka.* Në këtë rast, prilli ia dha këto ditë marsit dhe ky e mbyti plakën, ndërsa dhentë ia shndërroi në gurë, i ngriu ato.

Legjenda e shndërrimit në gurë është shumë e njohur në botën shqiptare.

Nga legjenda e plakës në bjeshkët e f. Veshallë mbeti edhe toponimi “Te kroi i Plakës”. Ky toponim është ndër më të vjetrit dhe si duket i vetmi në Bjeshkët e Sharrit . Ky emërtim është një dëshmi e gjallë e lashtësisë së këtyre banorëve në ato vise, bashkë me zanatin e tyre, gjithashtu të vjetër, blegtorinë. Në të folmen e Veshallës, emri “krua” i këtij toponimi na del në



gjitha format rasore: *“Dhentë shkuën te kroi i Plakës”, “Në krue të plakës”, “Pi kroit te plakës”, “E pash kroin e plakës”* etj. Uji i këtij burimi del nga një e çarë e gurit, prandaj më të vjetrit këtë sintagmë e quanin edhe *“Te pshaurrën plaka”*. Kjo legjendë nga e cila u ndërtua edhe toponimi në fjalë, është njëherit edhe dëshmi për lashtësinë e jetës së shqiptarit blegtorë dhe lidhjes së tij me bagëtinë, për të cilën shpesh edhe viktimizohej. “Kroi i Plakës” asocon në blegtorinë e këtyre anëve, me tërë mundimet, që kjo veprimtari e vështirë u jepte banorëve të kësaj malësie

Për “kroin”, siç e dimë, u shkruan shumë poezi në letërsinë shqipe. Në këngët popullore , “kroi” u këndua edhe më shpesh.

Poezia “*Kroi i fshatit tonë*” e Lasgushit mund të themi se është poezia kryevepër që bën fjalë për dashurinë e të rinjve e që lidhet me kroin. Takimi i Rinës dhe Milosaut ndodhi te kroi i fshatit, ndërsa kënga “*Mora shtamat për me shku në krue,*” është ndër këngët më të bukura popullore që flet për dashurinë dhe kroin.



Se sa ishin të lidhura me jetën e shqiptarit bagëtia dhe bujqësia, e dëshmon edhe fakti se Naimi, veprën më të bukur ia kushtoi pikërisht kësaj veprimtarie. Nga Stambolli i largët atij i ra ndër mend atdheu i tij, që nuk u karakterizua me diçka tjetër, bie fjala me detin e bukur apo me qytetet e lashta, por me jetën e thjeshtë të banorëve të staneve dhe bujqve të cilëve krahas vështirësive, jeta e qetë larg qyteteve u falte edhe shumë kënaqësi. Kjo jetë apo mbijetesë do thoja, organizohej në bazë të raporteve që njerëzit kishin ndërtuar me kafshët, pa të cilat as që mund të organizohet jeta e këtillë. Ata, ashtu siç komuniknin mes veti, në gjuhën e pastër, pa ndikime të huaja, komuniknin edhe me kafshët që i konsideronin si pjesë të familjes. Blegërima e një deleje, pëllitja e një lope, hingëllima e një kali, lehja e një qeni etj., shumë, lehtë identifikoheshin nga i zoti. Bariu i mirë, në një tufë të madhe dhensh, e njihte se cili qengj ishte i asaj ose i kësaj deleje, vetëm në bazë të blegërimës. Edhe kafshët e njohin të zotin e tyre gjithashtu sipas zërit. Në këto raporte të lidhjes së tyre bazohej edhe komunikimi. Pa emërtimin që bazohej në ngjyrë

dhe në karakteristika tjera të shumta, do të kishte shumë pengesa për punën dhe raportet ndërmjet faktorit njeri dhe një kafshe të caktuar shtëpiake.

Gjuha shqipe në këto segmente të komunikimit na del shumë e pasur. Blegtorët dhe jo vetëm ata, me kohë e kishin ndërtuar gjuhën e kësaj veprimtarie jetike për këtë popullatë. Ky komunikim i ka edhe karakteristikat e veta në fushë të leksikut të frazeologjisë, të toponimisë dhe të gjuhës në përgjithësi, si mjet komunikimi. Shqiptarët e këtyre malësive, si edhe shumë shqiptarë të shtrirjeve tjera gjeografike, dikur jetesën e siguronin me blegtori dhe me një bujqësi të dobët si rezultat i tokës jopjellore.



Bjeshkët e Sharrit që shtriheshin nga Maja e Lubotenit deri në ate të Korabit, llogariten si më të përshtatshme për bagëti. Kullosat e bollshme, burimet e shumta dhe klima e përshtatshme për muajt e verës, krijonin kushte të mrekullueshme për ruajtjen e dhenve dhe të kafshëve tjera që ishin pjesë e jetës së shqiptarëve. Mali i Thatë, që nga Sharri e ndanë Fusha e Pollogut, është një terren i thatë pa ujë, pa pyje dhe me tokë gurishte, gjë që dëshmohet edhe nga vetë toponimi. Bagëtia pinë ujë nëpër bunarët që akumulojnë ujë nga të reshurat dhe nga thellësia e tokës. Me gjithë këto karakteristika, edhe këto bjeshka janë për ruajtjen e bagëtisë dhe bulmetin që prodhohej atje.

Për këtë veprimtari sa të vështirë aq edhe të dashur, këngëtari popullor i krijoi lirikat ndër më të bukurat. Kënga e Fushës (rrafshnaltës) së Korabit llogaritet ndër më të mirat e këtij lloji të lirikës popullore. Në shumë këngë tjera kjo temë u këndua dhe këndohet edhe sot. Motivi i dashurisë që ndërlihet me ate të blegtorisë janë dëshmi e gjallë për të treguar se njeriu dhe dashuria janë në raporte të njëjta edhe kur është fjala për bariun dhe dashnoren e tij që mezi e pret të kthehet nga bjeshka. Ashtu si sot, kur më tepër këndohet për djalit e shkolluar, dikur këndohej edhe për bariun dhe pengesat për t'u takuar me te, sepse ai me bagëtinë e vet dhe me kambanat e dhenve do të zbulohet se gjendet aty afër, prandaj në vargjet e shënuara në një fshat që shtrihet në rrëzë të Malit të Thatë e hasim këtë dialog mes djalit bari dhe dashnores që ka droje se kambanat do t'i dëgjojë nëna: *dil ku dole pares,/ dil ku dole pares,/ të bajm llaf kadales,/ të bajm llaf kadales,/ zi çato kumbanat be gjal,/ mos na ndeje nana,/ ene nana neve na ka pa,/ nana mu e taj be gjal,/ neve s'na ka nga/.*



Gjuha e fushës së kësaj veprimtarie është e pasur me plotë fjalë të pastra e të vjetra shqipe, disa nga të cilat sot në të folmet e kësaj popullate nuk përdoren. Ky leksik i pasur, në vete përmban shumë fjalë e shprehje që dalin me forma gramatikore që i përgjigjen edhe gjuhës së sotme. Këtë e ilustrojmë me disa shembuj: Dhentë i ka zënë vapa. (përdoret pothuajse në tërë fshatrat e Sharrit). Kjo, do të thotë se dhentë po mrizojnë nga i

nxehti duke u afruar njëra me tjetrën, me krye ulur për tokë. *Dhentë i melim me menxhes* (Veshallë, Bozovcë). Në të folmet e këtyre fshatrave në vend të fjalës **“mëngjes”**, përdoret ajo turke **“sabah”**. Në këto vendbanime jashtë këtij konteksti nuk përdoret fjala vapë. Përveç këtyre fjalëve nguruese karakteristike janë edhe format e ndryshme gramatikore që përdoren të pa cenuara *“E pash ni taufë dhensh”*, *“Sot i lshuem deshtë nër dhen”*, *“Ma majr tamël dhensh se tomel lopësh”*. *“Kjo e lefme çensh osht , n’ogjertojë”* etj. (f. Veshallë).

Meqë delja është edhe sinonim i blegtorisë e me siguri fjala “blegtori” ka të bëjë me blegërimën e saj, në këtë pjesë të studimit do ndalemi më tepër te kjo kafshë shumë e rëndësishme, nga e cila kemi shume dobi. Të gjitha këto përfitime bëhen nëpërmjet ceremonisë specifike dhe riteve të ndryshme që në vete përmbajnë edhe pasuri të shumta gjuhësore ne leksik, frazeologjizma, terminologji, toponimi etj.

Lëshuarja e deshve dhe të pjellat

Periudha kohore kur pjellin dhentë quhet **“të pjellat”** (t’pellat), kur qethen dhentë thuhet **“t’çethmet”** (i kemi të qethurat), Për kohën kur deshtë i përziejnë me dhentë që të mbarsen ato, thuhet **“i lshuem”** deshtë, ndërsa për dhentë e mbarsura thuhet se **“kanë marrë dash ose janë ndërzyer”** (Në fshatrat e Malit të Thatë). Kur dhenve u vjen koha e mbarsjes përdoret fjalia: **“Dhentë kërkajnë dash”** (në të gjitha fshatrat).



Përzierja e deshve me dhentë në kohën kur ato “kërkojnë dash, është një rit karakteristikë edhe me elemente pagane. Kjo ceremoni bëhet vonë në mbrëmje. Deshtë që gjatë tërë verës kanë kullotur ndaras nga dhentë, këtë natë takohen me to, dhe kështu fillon mbarsja e tyre. Nga kjo kohë llogaritej edhe fillimi i “të pjellave” që duhet të jetë pas pesë muajve.

Barinjtë dëshirojnë që dhentë e tyre të mbarsen në një kohë më të shkurtër dhe kështu edhe “të pjellat” të mbarojnë më shpejt. Varësisht se për sa kohë do të kryhej procesi i mbarësimit, llogaritej edhe tufa si më e mirë. Për tu kryer ky proces më shpejt, në tërë fshatrat ku ishte bërë hulumtimi, na kanë rrëfyer se dhentë duhej të kripeshin më shpesh, dy



deri katër herë në javë. Në Gurgunicën e Malit të Thatë, dhenve u jepnin edhe sheqer që konsiderohej si stimulim për dash.

Koha e “dashit” (kështu quhej koha kur lëshoheshin deshtë ndër dhen) është e caktuar më 10 shtator. Natën e këtij ceremoniali përreth grigjës ndizeshin zjarre. Zjarri si element pagan, ndoshta ka edhe ndonjë domethënie tjetër, por në bisedë me njerëz të moshuar e me përvojë të madhe në këtë zana, mësojmë se zjarri simbolizon “nxehjen” e dhenve dhe nevojën e zjarrtë për dash. Mësojmë gjithashtu se në momentin e këtij takimi të dy gjinive, në secilin dash hipte nga një vajzë që simbolizonte dëshirën që dhentë të pjellin sa më shumë qengja femra, sepse ato e shumojnë tufën dhe e ruajnë në vazhdimësi llojin e dhenve. Sipas llogaritjes së kohës së planifikuar, “të pjellat” duhet të fillojnë kah data 10 shkurt. Delja zakonisht pjell një qengi, por shpesh ndodh që të pjellë edhe dy e më rrallë edhe tre. Kur përnjëherë lindin dy qengja nga një dele, thuhet se delja ka bërë dynak (në fshatrat e Malit të Thatë) ose dinak (në fshatrat e Malësisë së Sharrit). Ky variant përdoret edhe për dy fëmijët e lindur nga një nënë. Gjatë periudhës së të pjellave, barinjtë ose edhe anëtarët tjerë të familjes, kujdesen për qengjat e porsalindur, sepse meqë kjo është periudhë dimri, qengji mund edhe të ngordhë. Delja para lindjes, quhet “*xhebe*” ashtu siç quhet edhe lopa, dhia, pela etj. Pas pjelljes, delja, lopa e dhia por jo edhe pela

e meca etj. (bushtra) quhet plle, emër që sigurisht vjen nga e folja “pjell”. Nga kjo folje, vjen edhe emri pellak (në fshatrat e Sharrit), pjellak (Gurguricë e Sallarevë dhe fshatra tjerë të Malit të Thatë) Delja polli dje, Dhentë kanë pellë (pjellë) herët. “*Dhentë do pellin (pjellin) mrena di javëve*”. Nga këta shembuj vërejmë se përdoret drejt folja “pjellë” e sidomos kur është në kohën e kryer të thjeshtë: polli, pollën.



Nga bashkëbiseduesit e mi që e njohin mirë zanatin e blegtorisë, mësojmë edhe për veprime tjera që ndërmerren në kohën e të pjellave. Nëse qengji i porsalindur mund të ngordhë, deles, pra nënës ia ofrojnë një qengj tjetër, zakonisht nga binekët (dinakët) e një deleje tjetër ose qengjin që ka mbetur pa nënë. Këtë qengj nuk e pranon lehtë delja, prandaj në të shumtën e rasteve lëkurën e qengjit të ngordhur, pasi e rrjepin, e venë në trupin e qengjit që duhet t'i jepet deles që ka mbetur pa qengj. Delja i merr erë lëkurës maskë dhe e pranon si qengjin e saj. Shpeshherë këtë lëkurë e lyejnë me miell dhe kripë, që ta lëpijë delja e ta birësojë atë. Nëse edhe në këtë rast delja refuzon ta pranojë si të vetin, e futin bashkë me qengjin në një vend të rrethuar, me sipërfaqe të vogël dhe pas një kohë izolimi, delja e pranon atë si të vetin. Kjo bëhet për dy arsye, që delja të thithet, e mos të bjerë në “*gji të*

madh” (*n’xhi t’madh*) e më pastaj të *“thahet”* (mos të ketë tamël) Nëse delja nuk thithet nga qengji ose nuk milet, ajo e prish Tamblin dhe për një kohë të shkurtër e humb ate, dhe arsyeja tjetër qëndron në mbajtjen në jetë të qengjit *“jetim”*.

Kur jemi te qengjat e posa lindur, po përmendim edhe një mjeshtri që ka të bëjë me qengjin që ngordhë sapo ka lindur, por që ka thithur nga nëna e vetë. Ky qengj pasi ngordhë, operohet dhe i nxirret lukthi me Tamblin e thithur (kullostër). Lukthi i nxjerrë varet diku që të thahet. Tamblin e lukthit të gjingjit e përziejnë me ujë dhe me te e zënë djathin, ashtu siç e zënë kosin nga Tamblin. (Tamblin i fusin pak kos). Kjo përzierje që bëhet maja e djathit quhet *“trantë”*. Shpeshherë delja e pjell qengjin të ngordhur. Për këtë *“abortim”* thuhet se delja *“ka shty”* (shtaj). Sipas njerëzve me përvojë në këtë fushë, kjo ngjan nga shkaku se dhentë kanë hëngër ndonjë kullosë të keqe, siç është *“kërçani”*: Dhentë i ka zënë *“kërçani”*: Nama: *“të zantë kërçani”* i drejtohet edhe njeriut. Rastet kur dhentë shtyjnë, spjegohet edhe me *“marrje m’sysh”* ose nuk përjashtohet edhe për ndonjë magji që ka mundur ta bëjë dikush për qëllime xhelozie.

Kur jemi te *“të pjellat”* po përmendim edhe fenomenin e *“marrjes së dashit”* para kohe dhe pjelljes së deles ende duke qenë qengj. Kjo nënë e re quhet *“llashkë”*: *“Sivjet më pollën shaum dhen llashka”*. *“Shqerrat e llashkave janë shoum të vojl”*. Ka edhe raste kur delja nuk pjell fare, edhe pse është mbarsur. Kjo quhet *“shterpa e madhe”* (në fshatrat e Sharrit) ose *“shterpa e dashit”* (në fshatrat e M. të Thatë). Kjo *shterpë* quhet edhe *“shtejra”* dhe *“shtira”* (Gurgunicë). Kjo pra, shtiret se do pjell, por asnjëherë nuk pjell. Meqë nuk pjell asnjëherë, ishte shumë e majme që në të shumtën e rasteve e luan edhe rolin e oqicit, dmth. e udhëheqë tufën, dhe mban këmborë, ndërsa kur e qethin, (qethtari më i mirë gjithmonë ka dëshirë ta qethe shterpën e



madhe) e zbukurojnë me shumë tufa, toufa ose tufka. Duke qenë më e majmja por edhe pse nuk pjell, e mbetet gjithmonë shterpë, ajo është “kurban” më i shpeshtë që mund ta mbushë kusinë dhe sofrën.

Kur është fjala për tufë të madhe, ta zëmë deri 1000 dele, ekspertët për të pjellat i marrin të gjitha masat që ky proces të mbarojë sa më mirë. Në bazë të gjinjve, këta ekspertë i ndajnë nga tufa e madhe dhentë që do pjellin më shpejtë, për t’u kujdesur më mirë. (I krehin dhentë për xhini). Kur pjellin të gjitha, ato bashkë me qengjat e vet, ndahen në tufë të vogël, sepse në tufë aq të madhe delja dhe qengji gjinden me shumë vështirësi. Pas ndarjes, këto tufë më të vogla quhen “sllon”, numri i të cilave arrin deri më 300 dele, por pa i numëruar qengjat. Bariu i parë, ai kryesori quhet “bylikbash”, domethënë i parë i bylikut, (kjo fjalë si duket ka prejardhje turke dhe vjen nga bylik, byjyk – i madh) ose ai që e udhëheq tufën e madhe, ndërsa ndihmësi i tij quhet “jamak” (këtë fjalë e hasim në të gjitha vendbanimet shqiptare të këtyre malësive).

Udhëtimi i bagëtisë për në bjeshkë

Ata që kishin pak dhen nuk bënë jetë nomade, por e kalonin dimrin në shtëpi edhe pse me vështirësi e pritnin pranverën. Barinjtë që kishin më tepër dhen, dimrin e kalonin në vende më të përshtatshme me pak ose pa borë. Pasi dilte pranvera, ata merrnin rrugën e gjatë që ndonjëherë zgjaste edhe 20 ditë. Karvani i gjatë me lopë, kuaj, dhen dhe qej, ndonjëherë rrugën e bënte më ngadalë, sidomos atëherë kur bjeshkët me vështirësi çliroheshin nga bora. Ata e planifikonin kohën për dalje në bjeshkë me qëllim që atje të krijohen kushtet për të vazhduar jetën e staneve. Plani i udhëtimit përgatitej me kohë. Dihej se në cilin vend kur do të arrijnë për të kaluar natën. Në vendin që ishte i caktuar me kohë, më parë mbërrinin ata njerëz me kuaj, për të prerë dru, për ta ndezur zjarrin dhe mundësisht për të zënë ndonjë shteg që dhentë mos të bëjnë dëme në arat e mbjella. Pasi i shkarkonin kuajt, mushkat ose gomarët, të ngarkuar me fereqha, gëzofa, enë të ndryshme dhe miell ose bukë, e formonin pikën e bujtjes që quhej “konak”. Varësisht se prej nga bëhej udhëtimi, varej edhe numri i konaqeve dhe renditja e tyre nga “këshllari” ose “këshllori” siç quhet në M. të Thatë, vendi ku me bagëti kalohej dimri, deri në cakun e fundit. Puna e parë që bëhej me të arritur të këtij ekipi të logjistikës, ishte ndezja e zjarrit dhe mbushja e ujit (zakonisht konaqet caktoheshin në vende ku kishte ujë dhe dru). Ai që

kujdeset për përgatitjen e ushqimit quhet “Odaxhi”. Ushqimi më i zakonshëm për këto kushte ishte “bakërdari” ose siç quhej ndryshe “kaçamaku”, që përgatitej më lehtë. Odaxhiu pasi ndizte zjarrin, mbi te e “ngrehte kollovarkën” (tre drunj të hollë e të gjatë të lidhur me një pikë ku varej zinxhiri). Këta drunj mbështeteshin me tre pika përreth zjarrit dhe në tokë e formonin një trekëndësh. Në kusinë e varur në zinxhirë, të mbushur me ujë sipas masës, futej mielli prej misri, dhe ashtu në formë koni notonte në ujë që duhej të zihej dy orë. Pasi kalon kjo kohë ë nevojshme “Bakërdari” përzihej me një shkop dhe kështu hahej, shpeshherë duke e bërë përshesh me kos ose me tamël. Odaxhiu me ndihmësit e vet e kishte obligim të përkujdesej edhe për ushqimin e qenve, që bëhej më shpejt dhe pa ndonjë kujdes të madh (bakërdari i çenve, xhella e çenve, buka e çenve etj.). Në këtë “konak” të improvizuar mbërrijnë dhentë me barinjte e lodhur dhe shpeshherë të lagur nga shiu. Në ato kushte i terin teshat, hanë bukë për të bërë “një sy gjumë”, që të nesërmen të nisin “marshutën” deri në stan, ku do ta kalojnë verën. Këtë rrugë, e bënin edhe barinjte e Malësisë së Prizrenit sidomos ata të rajonit të Opojës që po ashtu e kalonin Malin Sharr.

Stanet ku do të kalohej vera ishin në tërë bjeshkët e Sharrit, në ato të Mavrovës, duke përfshirë edhe Malin e Thatë. Përveç bjeshkëve, në shumë raste, stanet ndërtoheshin edhe nëpër ara, që atë vit nuk ishin të mbjella. Barinjte me bagëtinë duhet të mbërrinin në bjeshkë, pasi të ishin përgatitur dhe rinovuar vathë, **tërllat** (lloj vathe në formë gjysmë rrethi që qëndronte në mënyrë të pjerrtë, e që ishte e mbuluar me duj thekri), shtrunga, (vathe ne forme rrethi, me një ose më shumë dyer të vogla për të kaluar dhentë një nga një, për t’i mjelë), stani dhe kolibja. Ky udhëtim nga nisja deri në stan është gjithashtu ngjarje e rëndësishme me plot ceremoni që mund të llogaritet si veçori me interes për këtë veprimtari që e kemi objekt studimi, bashkë me gjuhën e përdorur.



Stani dhe organizimi i jetës në bjeshkë

Emri “stan” në kuptimin e të jetuarit të barinjve dhe të familjes së tyre, sidomos gjatë ditëve të verës, nga shqiptarët përmendet që nga lashtësia e veprimtarisë së blegtorisë. Ky term asnjëherë nuk përdoret për të emërtuar shtëpinë ose edhe banesën në një pallat, ashtu siç nuk përmendet edhe nga sllavët, me kuptimin që e përmendëm më lart. Nga kjo del se kjo fjalë është shqipe dhe si e tillë në fjalorin e gjuhës shqipe e ka këtë kuptim: vend me vathë e me kasolle për bagëtinë, për barinjtë e për bulmetin, i ngitur në mal ose vëri. Stan veror (dimëror), stan në mal (në bjeshkë), stanet e kooperativës. Barinjtë e stanit, bulmeti i stanit. Qen stani, qen i madh për të ruajtur bagëtitë. Ngritën një stan. i çuan bagëtitë në stan.



Emri stan është i lidhur ngushtë me bagëtinë. Në stan dilnin ata që kishin dhen dhe bagëti tjera. Dikur fshatarët e shumë fshatrave të malësisë, ata familje që dilnin në stan i konsideronin si më të pasurit, përkundër familjeve të varfra, që nuk kishin me çka të dalin në stan. Në mungesë të zanateve tjera, familja shqiptare e këtyre anëve, jetën mund ta siguronte vetëm me bagëti, sepse vetëm bagëtia, sidomos dhentë, i mundësonin një gjë të këtillë. Nga kjo rrjedh edhe frazeologjia: *“Nauk dom çesën*

n'ston". (thuhet për diçka që nuk ka vlerë, që nuk është e rëndësishme) Në fshatrat e Sharrit, në të shumtën e rasteve, në stan dilej me tërë familjen, d.m.th., bëhej shpërngulja nga fshati, por meqë punët e bujqësisë lidheshin me shtëpinë, sidomos kur bëheshin "lëmët" dhe mbushej hambari me drithëra, e "mashnat" me kashtë dhe bar, disa nga anëtarët e familjes banonin në shtëpi ose zbrisnin në mëngjes nga stani, për t'u kthyer sërish në mbrëmje. Kishte raste kur një pjesë e familjes dilte në stan, ndërsa pjesa tjetër jetonte në katund. Në disa vendbanime, në stan jetonin vetëm burrat. Ata e ruanin bagëtinë dhe e bënë bulmetin. Kjo dukuri është më e theksuar në Malin e Thatë, sepse atje nuk kishte kushte për jetë të mirë verore. Edhe në fshatrat e fushës, sidomos atyre të rrëzës së maleve, në stan dilnin vetëm burrat.

Stanet zakonisht ndërtohen në bjeshkë, por ka raste kur ata mund të ngrihen edhe nëpër ara të pambjella. Edhe nëse dilet në bjeshkë, stanet i bëjnë afër arave, për t'i plehëruar më lehtë ato. Në disa vendbanime stanet janë të tipit të katundit, afër njëri i tjetrit, e kjo bëhet për shkaqe sigurie, sidomos për t'u mbrojtur nga egërsirat. Madhësia e objektit të stanit, varej nga numri i anëtarëve të familjes dhe nga numri i bagëtive. Meqë bulmeti përgatitej brenda në stan, në një pjesë të tij ku ishin renditur edhe enë të ndryshme, pjesa tjetër shërbente për qëndrim ditor ose për të fjetur. Stanet më të mëdhenj, bëheshin në katër anët me mur guri dhe me dy dyer përballë njëra tjetrës, nga të cilat njëra ishte kryesorja ndërsa tjetra lidhej me vathën, sidomos me shtrungën ku milëshin dhentë. Çatia ndërtohej me drunj dhe mbulohej me kashtën e duajve të theknit. Renditja e duajve ose "**kashtimi**" siç thuhej zakonisht, ishte një punë jo edhe aq e lehtë. Nga dy anët e murit renditeshin drunjte që quhen **kepra** (çepra), që takoheshin njëri me tjetrin në kulmin e stanit. Mbi keprat vertikale shtroheshin **pallëzinat**, drunj më të hollë që lidheshin me keprat me litar që bëheshin nga duajt e thektrit, ose shpeshherë edhe gozhdoheshin. Fjala pallëzinë (pallzajnë) vjen nga – pullaz, pra drunj për pullaz, pullazina. (Këtë fjalë me këtë domethënie e hasim te Gjergj Fishta, te "Gomari i Baba Tasit".) Pasi mbi pallëzinat e renditura shtrohej kashta e duajve, përsëri vihej pallëzina tjetër mbi to dhe kështu mbulohej çatia e stanit. Edhe për këtë punë duhej mjeshtri e madhe. Ashtu siç ishin me emër qethtarët e mirë, ishin po ashtu të njohur edhe ata që "kashtonin" mirë. Nëse kjo punë improvizohet nga njerëz jokompetentë, kjo çati mund të lëshonte edhe shiun. Në pjesën që nuk mbyllet me kashtën e duajve, në atë vertikale në formë trekëndëshi, hyn drita dhe po nga ajo pjesë del edhe tymi. Një hapësirë që mbetet mes

fundit të çatisë dhe murit, quhet **“zda”**. Në këtë vend vihen shumë gjëra që nuk mund t'i mbërrijnë fëmijët, ndërsa në dollapin e formuar në mur që quhet “vendi i çerepëve”, **palohe**n njëri pas tjetrit çerepët dhe **saçat**, që shërbejnë për të pjekë bukë dhe gjëra tjera. Ky tip stani, i ndërtuar me mur prej guri, është i qëndrueshëm dhe mund të jetë funksional shumë vite.

Stanet më të vegjël janë të ndërtuar me gardh (gjardh) në vend të murit. Në dy anët e gardhit kashtohet po ashtu me duaj thekri. Në vjeshtë e vonshme, kur thahet kullosa, dhentë dhe lopët e hanë kashtën dhe mbetet vetëm gardhi, që përbëhet nga hunjtë dhe thuprat, prandaj para se të dilet në stan, ky gardh duhet të kashtohet sërish. Nëse familja është shumë e madhe, përreth stanit ndërtoheshin kolibet, që ishin shumë të vogla dhe shërbenin vetëm për të fjetur. Kolibet e kanë formën e stanit me gardh. Një tip tjetër e ka formën e konit, që ndërtohen vetëm me “pallëzina”, të cilat janë të ngulura në tokë në formë rrethi, majat e të cilave takohen në një pikë, në pjesën e epërme, e që mbulohen po ashtu me kashtë.



Në stanet ku dilej në mënyrë kolektive, jeta ishte shumë e organizuar, kishte punë për të gjithë, nga fëmijët e deri te më të moshuarit. Që nga mëngjesi i hershëm e deri në mbrëmje vonë, secili merrej me punën që mund ta bënte më së miri. Fëmijët zakonisht i ngisnin dhentë për t'i mjelë e më të mëdhenjtë i milnin. Disa fëmijë tjerë i ruanin vjetët, e disa i ruanin dhentë topalle. Fëmijët gjithashtu luanin me qentë dhe këlyshët. Gratë

bënin bulmetin e disa shkonin në arë për të korrur ose për punë tjera bujqësore. Këtë organizim të punës kolektive në stane e vërejtë edhe Naimi: Bariu plak me krabë në dorë, dhe urdhëron të rinjtë,/ E ata gjithë punojnë, ngritur më brez pëqinjtë,/ *Ca bëjnë vathën e shtrungën, ca ngrehin tendën e stanë,/ Kush sjell gjeth, karthi e shkarpa, sicilido ndih më një anë,/ Kush qeth shelekna, kush mjel dhitë, kush mjel dhentë,/ Njëri merr ushqen klyshna, tjatri përgëzon qentë.* (Naim Frashëri, vepra 1, Prishtinë, 1978, fq.149).



Nëse tufa e dhenve është shumë e madhe, ato kohë pas kohe duheshin të numërohen. Edhe numërimi i dhenve është ceremoni në vete. Në mungesë të lapsit dhe letrës, numërimi bëhej me anë të çeteles (Fjala çetele që është shënuar edhe në fjalorin e gjuhës shqipe, e ka kuptimin e një shkopi më të shkurtër ose të një cope druri të lëmuar që përdorej si mjet për të mbajtur llogaritë midis blerësit dhe shitësit, duke ndarë në dy pjesë të njëjta, në të cilat gdhendeshin dhëmbëza për numërim). Ai që e bënte numërimin e dhenve një nga një, duke e prekur në shpinë secilën, kur arrinte në numrin 50, thërriste me zë të lartë fjalën “tala”, në atë moment, ky që e kishte “çetelen”, e gdhendte një dhëmb dhe kështu në çdo 50 dele, e përsëriste të njëjtën gjë, e nëse p.sh. në atë çetele, ai që bënte dhëmbëzimin, arrinte deri më 20 dhëmbë, tufa duhej të kishte 1000 copë dele. Në këtë rast “çetelja” nuk shërbente edhe

për identifikim, por vetëm për numrin. Pasi mbaronte numërimi i dhenve, atë shkop e ngulin diku në kashtën e stanit ose të kolibes dhe kështu e ruanin dosjen e numrit të deleve. Ky ishte numërimi më i saktë, por që ishte e pamundur të bëhej çdo ditë. Bariu shpeshherë përafërsisht e bënte verifikimin e tërësisë së tufës. Bie fjala, nëse në tufën prej 500 deleve kishte 30 të zeza, ai i numëronte vetëm të zezat dhe nëse ato ishin të gjitha, supozohej se tufa duhet të jetë e tëra. E njëjta gjë ku po ashtu përafërsisht mund të supozojmë se dhentë janë të gjitha, numëroheshin dhentë me kambanë, ose deshtë, nëse ishin bashkë me dhentë.

Ruajtja dhe kullotja e dhenve

Dikur, të kullosh dhen, ose t'i ruajsh ato, donte të thotë të jesh specialist për atë punë dhe të jesh trashëgues i ndonjë familjeje që si profesion e ka pasur zanatin e blegtorisë. Ai që i ruante duhej të ishte me përvojë të madhe vetëm në këtë profesion të ngushtë të veprimtarisë blegtorale. Bariu i shtjerrave, sidomos ai i shtjerrave meshkuj, duhej të ishte mjeshtër i vërtetë për të zgjedhur bjeshkën më të mirë. Bariu i dhenve plejja duhej të ishte i aftë për të mjelë dhe për ndërtimin e meremetimin e vathëve të ndryshëm.

Bariu duhej ta merrte ushqimin me vete sepse tërë ditën është në terren. Buka me gjizë ose djathë që futej në kupën prej druri, futeshin në “Janxhik” (janxhejk). Barinjtë e bjeshkëve që kishin burime të shumta, nuk kishin nevojë që me vete të merrnin edhe ujë. Ata të rajoneve më të thata, ujin e bartnin me “Matare” (një enë prej metali me grykë të vogël që përdorej edhe në ushtri). Ky problem i mungesës së ujit në terrenet e Malit të



Thatë, i detyronte barinjtë të ndërtojnë gropa akumulimi për ujë nga shiu, ku do të pinin dhentë, apo edhe do të përdorej edhe për nevojat e përditshme në punët e bulmetit dhe për pastrimin e enëve dhe të njerëzve. Terrenet me kullota, zakonisht janë mbi nivelin e pyjeve, në lartësinë ku ka kullota dhe dëllinja të cilat vazhdimisht digjeshin nga barinjtë, për të hapur sipërfaqe të reja për kullota. Në lartësitë më të mëdha edhe dëllinjat janë më rrallë. Bukuritë e bjeshkëve me shumë kullota, dëllinja, kaçuba, brigje e lumenj, ia tërheqin vëmendjen edhe Naimit, prandaj te “Bagëti e Buqësia” i hasim edhe këto vargje: Përhapur bagëtia nëpër sheshe, *nëpër brinja,/ Në lejthi e nëpër dushnaja, ndër murriza, në dëllinja.* (Naim Frashëri, Vepra 1, Tiranë 2007, fq.72)

Kur në mëngjes dhentë ndahen nga vatha dhe drejtohen kah bjeshka, thuhet “I lëshova dhentë”. Nëse tufa është e madhe, bariu kryesor ose “bylykbashi” ecën para dhenve, ndërsa “jamaki” (ndihmësi) vjen pas dhenve. Kur dhentë kullosin në një vend të caktuar dhe nuk lëvizin përpara,



por janë në pozita të ndryshme nga njëra tjetra, thuhet se janë “kalavitur” (kalavajt), ndërsa kur ecin duke kullotur dhe formojnë gjysmë rreth, thuhet se ato kullosin me “mallë”. “I mallova dhentë shpatit”. “Dhentë vinë me mallë”. etj. Në këto momente, kur dhentë kullotin, bariu i bie fyellit (fajllit, në të folmen e Sharrit). Nga barinjtë më të vjetër mësuam se melodia e fyellit i kënaq dhentë, kur e dëgjojnë atë, e shtojnë edhe tamblin. Ishin të njohur barinjtë që i binin fyellit. Dikur, barinjtë u binin edhe “fijeve” (Shumësi i fyellit, me dallim se këto dy fyej ishin shumë më të gjata. Në shumë vende, “fijet” quhen edhe “kavall”).

Nëse dhentë nga i nxehti nuk kullosin, por rrinë afër njëra tjetrës me kokë ulur, pra mrizojnë, thuhet se i ka zënë vapa. Në fshatra të Malit të thatë, për këtë rast e përdorin edhe foljen “mrizojnë”. Kur dhentë janë “në vapë” dhe duhet të trazohen, për të kullotur, përdoret shprehja “qujs”. Më këtë fjalë bariu i drejtohej zakonisht oqiçit ose ndonjë deleje me këmborë, që i udhëheq dhentë. Kur bariu ec para dhenve, ai i ndjell ato që t’i shkojnë prapa (I nejlja dhent, I nejlja çent.)

Qeni si shoku më besnik i bariut dhe i familjes, është pjesë e pandashme e këtij zanati, që luan rolin kryesor në këtë veprimtari. Me lehjen e tij gati tërë natën, ai i bën me dije egërsirës, ujkut ose ariut se ai është aty dhe krenohet për detyrën që e ka.



Qentë e Sharrit, racës më të mirë të qenve, edhe gjatë ditës janë në krye të detyrës. Në raste kur ndonjë dele sëmuret dhe mbetet në kullota edhe natën, në pamundësi ta ndjekë tufën, qeni besnik dhe i mirëfilltë për t'i ruajtur dhentë, delen nuk e le të vetmuar, që si e tillë mund të jetë kafshatë e lehtë e ndonjë egërsire. Bariu kur e konstaton se qeni në mbrëmje nuk është me dhentë në stan, e di se çka mund të ketë ndodhur. Nëpërmjet lehjes së qenit, e zbulon vendin ku qëndron delja e sëmure, apo edhe e ngordhur. Ndodhë shpeshherë, kur bariu e len tufën vetë, “shkretë”, (“I kam lanë dhentë shkretë”. D.m.th., pa njeri) qeni e bën punën e tij dhe e kryen detyrën për mrekulli. Nëse në një stan ka disa tufë dhensh, e secila bariun e vet, edhe qentë e kanë punën e ndarë, secili shkon me bariun dhe tufën e vet. Nëse bën mot i lig, bie shi me erë të ftohtë, për momentin barinjtë e ndërrojnë vendin e fjetjes, duke i strehuar ato afër ndonjë pylli. Kjo ndodhë sidomos kur dhentë sapo janë qethur.

Sipas llojit të tufës, emërtohen edhe barinjtë: çobani i pllajave, çobani i shterpave, çobani i shqerrave ose shuligjari, fjalë që lidhej me emrin sheleknë që e përmend edhe Naimi. Bariu me vete e mban një lloj shkopi të gjatë, që zakonisht duhej të ishte i drurit të thënës. Në pjesën e epërme, ku shkopi është më i hollë, vihet “Kërliku”, që po ashtu është nga druri, që shërben për t'i zënë dhentë, duke i kapur për bërrylin e këmbës së mbrapme të

deles. Kapja me dorë e deles për këmbë, nuk është punë e lehtë, sepse me të ofruar njeriu, delja ikë.

Thupra e thënës, siç i thonë këtij shkopi të gjatë e të hollë, me kërlëk në majë, e lehtëson kapjen e deles nga këmba. Kërlëkun nuk mund ta gdhendte secili. Ata që ishin mjeshtër të vërtete të gdhendjes së drurit, për t'i dhënë formën e kërlëkut, me majën e thikës duke gdhendur,



bënin figura të ndryshme, e sidomos gjarprin si element mitologjik. Në vjeshtë, para se ta lëshonin dhentë bjeshkën, barinjte e hidhnin shkopin e kërlëkut në vathë ku flinin dhentë. Kur në mëngjes e gjenin shkopin, në bazë të asaj së sa ai është i përlyer me pleh (bajga), konstatojnë se do të ketë apo jo dimër të fortë. Nëse kjo “thupër kërlëku” do ishte më e përlyer, do të thotë se dhentë nga i ftohti janë afruar më tepër me njëra tjetrën, gjë që paralajmëronte dimër i gjatë e me shumë borë.

Këngëtari ynë popullor thuri këngë edhe për kërlëkun: *Me ni dorë janxhajkin,/ me ni dorë kërlëkin,/ nejlle Hasan Aga bilikin.*

Krahas foljes “kullot”, në gjuhën baritore përdoret edhe folja “ruaj”, që do të thotë se krahas kullotjes, dhentë duhet të ruhen, si nga egërsirat, ashtu edhe nga vjedhës të ndryshëm, që në të kaluarën, jo shumë të largët, vjedhja e dhenve, madje edhe e tërë tufës, ishte një realitet. Banda të ndryshme të armatosur i sulmonin barinjte dhe ua merrnin dhentë. Në këto raste shpeshherë kishte edhe viktima në njerëz.

Mjelja e dhenve dhe bulmeti

Dhentë që kanë udhëtuar bashkë me shtjerrat, me të arritur në stane, i ndajnë dhe kështu fillon koha e të mjelave. Dhentë pleja, meqë duhet të milen, flenë afër stanit dhe kullotnin të ndara nga qengjat e tyre. Nëse ishte fjala për ndonjë tufë të madhe, mbi një mijë copë dele, atëherë kjo tufë ndahet në dy pjesë më të vogla, për t'u mjelë më mirë. Dhentë dikur i milnin tri herë në ditë: në mëngjes, (me menxhes – disa fshatra të Sharrit), në drekë dhe në mbrëmje (me prome – në fshatin Veshallë). Në

shumë të folme të vendbanimeve të Sharrit thuhet: Dhentë milen. I kam mel dhentë. *A do vejsh për t'melmen? E mola lopën.*

Në fshatin Kalishtë të Gostivarit e hasim edhe formën: E njela delen. I kimi njelë dhentë.

Në Gurgunicë të Malit të Thatë thuhet: I mjelëm dhentë. Do t'i mjelim dhentë. Ka raste kur dhentë pleja pasi të milen në mbrëmje, (para se të errët) e vazhdojnë të kullotmen deri në vendin ku e kalojnë



natën, në argaç ose si i thonë në shumë vende, argaç, që në mëngjes herët të nisin po ashtu duke kullotur për të arritur në stan që të milen në shtrungë. Kur milesnin edhe në drekë, dhentë nuk vinin deri te shtrunga e stanit, por milesnin në vathën e improvizuar diku në bjeshkë, ndërsa Tamblin e mbanin nëpër gjima (gjygjima) të futur në ujë të ftohtë, që të mos priset nga i nxehti. Në bjeshkën e fshatit Veshallë ekziston toponimi “Te shtroungia” (Te shtrunga). Aty ishin të ndërtuara vathët, (shtrungat) dhe të gjithë i milnin dhentë për drekë. E mjelmja e drekës u ndërpre herët, sepse për këtë kohë në terrenet ku dhentë ishin duke kullotur përveç bariut, ishte e pamundur të mbërrinin edhe njerëz tjerë që t'i mjelnin dhentë më shpejt. Tufët më të mëdha me dhentë pleja as që janë mjelë ndonjëherë në drekë. Shtrunga kishte një ose më tepër dyer të vogla në dy anët e të cilave rrinin ulur mjelësit. Ata mes dy këmbësh e shtrëngonin enën prej druri, që po ashtu quhej shtrungë (në Gurgunicë Shtrungi). Derisa mjelësit e mjelnin një dele, ata i takonin gjunjë me njëri tjetrin, për ta zënë shtegun që t’ua pamundësojnë daljen e dhenve tjera pa u mjelë. E njëjta metodë e punës përdoret edhe në dyert tjera të vogla të shtrungës. Zakonisht për tufën deri 400 delesh, shtrunga ka 2 deri 3 dyer, që do të thotë se këtë tufë shumë shpejt mund ta mjelin edhe vetëm katër mjelës të mirë. Në mesin e njerëzve që mjelin mund të ketë edhe gra, nëse është fjala për të mjelmen e stanit, që banorë i ka tërë familjen. Mjelësit, para se të ulen në vendin e vet, i veshin benevrekët për tu mbrojtur nga plehu dhe balta që krijohet në shtrungë, sidomos nëse bie shi. Nëse vatha është e thatë, edhe Tambli është më i pastër.

Djathi dhe bulmetet tjera që dalin nga Tambli i verës së thatë, është shumë më i bardhë dhe më i pastër. Edhe e mjelmja e dhenve është një rit i rëndësishëm në veprimtarinë blegtorale . Në enën ku millet, shpesh herë vinin lule nga më të ndryshmet. Kjo bëhej për ta ruajtur Tamblin nga syri i keq. Në rastin kur në atë enë duken lulet, njeriut që merr mësysh, vëmendjen ia tërheqin



lulet. Tambli përpunohet nga ai që është përgjegjës për këtë punë. Në rastin kur në stan jeton e tërë familja, përpunimin e tëmblit e bëjnë zakonisht gratë. Tambli zihet në kusinë e varur në zinxhir. Ngjanë që Tambli i zier nuk zihet mire kos (kosi bëhet shumë i holl dhe i vjen era e keq).

Ky tamël nuk hidhet por bëhet gjizë. Me siguri edhe ky fenomen lidhet me magjinë dhe syrin e keq. Në këtë rast duhet marrë masa për ta larguar magjinë dhe marrjen msyshë, e kjo bëhet nëpërmjet kryqit. Kur kusia që zakonisht duhet të jetë prej bakri, e mbushur plot me tamël, vihet në zjarr, mbi te, në formë kryqi vihen dy krënde, si garanci se nuk do të priset Tambli e kosi. Kjo gjë bëhej deri vonë e ndoshta edhe sot, pavarësisht se është fjala për familje myslimane ose të krishterë. Që të mbrohet Tambli nga këto magji, që mund t'i kishte bërë ndonjë grua e huaj nga xhelozia se dhentë kanë shumë tamël, të mjelmen e parë e derdhin nëpër fqinj dhe duke bërë kështu mirë me të varfrit, do të ruhet bulmeti nga syri i keq. Pasi të zihet kosi, futet në fti pët t'u

tundur (në disa fshatra i thonë muti). Nga kosi i tundur del tëlyeni dhe dhalli (dhallët - në fshatrat e Malit të Thatë). Dhallti zihet dhe përfitohet gjiza e dhallit. Një sasi e kosit ruhet për ta ngrënë, ashtu siç ruhet edhe dhalli për ta pirë. Kur dhalli bëhet gjizë, lëngu që ka mbetur është hirra. Nëse nga Tambli duhet të bëjmë djathë, atëherë, atë e ziejmë shumë pak dhe e zëmë kos duke i qitur “t’rrantin” që më parë e tretnin në ujë ose tamël. Djathi bëhet në disa mënyra, prandaj kemi edhe disa lloje djathërash, por ai që më tepër përdoret është djathi i bardhë. Është i njohur për tregun edhe djathi i fortë (djathi i baçit dhe kashkavalli). Kajmaku është një prodhim tjetër që përfitohet nga Tambli. Edhe ai tundet dhe bëhet tëlyen. Tambli, para se të zihet, duhet kulluar nëpër shumë “musalla” që ndryshe quhen edhe kulluesa (kllausa). Se sa është i pastër Tambli, varet se në sa musalla është kulluar ai. Naimi në veprën e vet “Bagëti e bujqësia” i përmend këto lloje të bulmetrave: *stopani i bërë i zi, sterrë, shikon bulmetin e bekuar, tund, bën gjalpë, djathë, gjizë edhe punon pa përtuar* (Naim Frashëri, Vepra 1, Prishtinë 1978, q. 151).

Familjet që kishin më shumë dhenë plejja, një pjesë të bulmetit e shitnin në qytet, ndërsa pjesën tjetër e ruanin për nevojat familjare. Në vjeshtë, kur bëhej dyndja (dundja), ata bashkë me tërë inventarin e stanit dhe teshat, e bartnin me kuaj, gomarë ose mushka, edhe bulmetin që duhej ta harxhonin me kujdes, deri në verën e ardhshme. Familjet që merreshin me blegtori, krahas dhenve i milnin edhe lopët e dikur edhe dhitë. Në periudhat kur dhenve ua lenin të mjelmen, ata, për nevojat familjare, e përdornin Tamblin e lopëve. Meqë dhentë pas një kohe e ndalnin Tamblin në masë të madhe, atëherë ndërpritet e mjelmja e mëngjesit. Ka fillimi i muajit shtator ndërpritej edhe e mjelmja e mbrëmjes. Derisa dhentë plejja kishin trajtim të posaçëm, pra milesnin, dhentë shterpa (lopa shterpë, delja shterpë, ara shterpë) nuk milesnin dhe nuk kishte arsye pse të vinë deri te stani, por flinin diku më lartë, në bjeshkë. Këtë e konstatoi edhe Naimi kur thotë: Shterpari s’i qaset stanit, po nër pyje bij’ e ngrihet. (N.Frashëri, Vepra 1, Prishtinë 1980, fq. 50.).

Emërtimet e dhenve

Dhentë emërtohen në bazë të moshës, pamjes, llojit të leshit dhe gjinisë. Kur përmendet emri “dhen” nënkuptohet edhe delja edhe dashi edhe qengji. Një tufë dhensh. Ai nuk shkon me dhen. Pa dhen, nuk dilet në stan. Në bazë të moshës dhentë klasifikohen në qengja, ruza, llashka, shterpa, plle, plleja ,dhe maria, dhentë plaka që ndahen nga tufa në bazë të dhëmbëve dhe theren për “pastërmë”, ose shiten në thertore. Sipas pamjes, dhentë emërtohen me këto emra: Ragusë - dele me brirë, Çupë - dele me vesh të shkurtër, Kaleshë - dele e bardhë me buzët, veshët dhe sytë e zinj, Sorkë - dele me pika të zeza nga fytyra, Syskë - dele ose dash me pika të zeza rreth syve. Emërtimin “syskë” e hasim gjithashtu te Naimi: Dashi syskë e me këmborë, q’ e ka manar, po të vjen pas. (Naim Frashëri, Vepra 1, Prishtinë, 1978, fq. 146).

Sipas llojit dhe ngjyrës së leshit na dalin këto emërtime: Bellkë - dele e bardhë, Sharkë - dele laramane, Delja e zezë - dele e zezë, që ndonjëherë emërtohet edhe si arapkë, Rudë - dele me lesh më të butë dhe më të shkurtër (është e



njohur kënga popullore: O moj dele, delja rudë), Bukanka - dele me lesh të ashpër dhe të bardhë, Merino - dele e racës merino. Është i njohur aksioni për merinizimin e dhenve, kah vitet 60 të shek XX. Fshatarët, duke dashur ta ruajnë racën e vet të trashëguar me shekuj, tentuan ta refuzojnë këtë racë të panjohur par ta, dhe të imponuar nga pushteti, por që nuk patën sukses, edhe pse ata në atë kohë i fshihnin dhentë, duke paraqitur më pak për t’i dërguar në kooperativën që bënte mbarsjen artificiale me spermën e deshve merino, të sjellë nga Bullgaria dhe Australia. Leshi i deles merino ishte shumë më i gjatë, me fije më të holla, më i dendur dhe kaçurel, që përdorej në industrinë e tekstileve për prodhimin e stofnave më cilësor. Delja vllahinkë - zakonisht është

e zezë me lesh shumë të gjatë dhe të ashpër, racë kjo që e kultivojnë dhe e ruajnë vllahët.

Nëse tufa e shterpave është shumë e madhe, atëherë shtjerrat janë të ndarë, e nëse është më e vogël bashkë me to kullosin edhe shtjerat, edhe deshtë. (Deshtë në një kohë të caktuar ndahen edhe nga shterpat, që të bashkohen sërish, kur ishte “koha e dashit”). Madje nëse bëhet fjalë për ndonjë tufë shumë të madhe, edhe shtjerrat ndahen në meshkuj dhe femra.



Kjo bëhet me qëllim që qengjat meshkuj të kenë komoditet më të madh, të kenë kushte më të mira për kullotje, bile ka raste kur ata edhe i ushqejnë. E tërë kjo bëhet për shkak se këta në vjeshtë do të shiten dhe duhet të shtojnë më tepër në peshë për të pasur përfitime më të mëdha. Bariu që i ruante shtjerat, duhej të kishte përvojë dhe të ishte njëfarë specialisti. Në fshatin Veshallë dhe Bozovcë ai quhej “shuligjar” ndërsa vendi ku kullotnin shqerrat quhej “shuligjarnejk”. Kur këtyre dy emrave ua shtojmë edhe toponimin “Sheliçe”, bjeshkë që sipas shumë personave, barinj të vjetër, ishte e dedikuar për shtjerrat, na përkujtojnë fjalën “sheleknë” të Naimit, me të cilën e emërtonte qengjin që kishte mbushur një vjet: Kush përvjel, kush qeth sheleknë, kush mjel dhitë, kush mjel dhentë (N.Frashëri, Vepra 1, Prishtinë 1978,

fq 149). Nga qengjat meshkuj, zgjidheshin disa nga më të mirët që do të ruheshin (nuk shiteshin), për desh të ardhshëm. Qengji i gjinisë mashkullore që ruhet për ta vazhduar sojin (*damosllekun*), quhet “varg” (varg), që do të thotë se me to do të bëhet vargënimi, trashëgimia e tufës. Shtjerat femra që ruhen për t’u bërë dhen, quhen “kinxhe” (*Unë i rruaj kinxhet. Sa kinxhe kemi sivjet?*).

Shterpat janë kinxhet e vitit të kaluar që ndryshe quhen “*rrunza*” (rrauza – në të folmen e fshatrave të Sharrit dhe rruza – fshatrat e Malit të Thatë). Në atë tufë bëjnë pjesë edhe shterpat e mëdha siç quheshin ndryshe “shterpat e dashit” ose shterpat që nuk pjellin asnjëherë. Edhe krijuesi popullor në vargjet e veta lirike, e përmend bariun, një djalë të ri që i rruan shterpat: *Hasan Aga bilikin me shterpa,/ e ka mush janxhejkin me petlla,/ janxhejki me petlla i kullojte,/ caucën e kataunit shom e dojte.* (Këngë e shënuar në fshatin Veshallë të Tetovës.

Deshtë (shumësi i dashit) janë meshkujt që e kanë kaluar moshën e qengjit. Dashi që ka kaluar moshën njëvjeçare në të folmet e malësisë së Sharrit quhet “vetuan”, ndërsa në ata të Malit të thatë “**vjetun**”, domethënë dash njëvjeçar. Kur dashi mbush dy vjet dhe me të janë mbarsur për herë të parë dhentë, ai quhet “**pellak**”, në të folmet e Sharrit dhe “pjellak” në ato të Malit të Thatë, që do të thotë se dhentë e mbarsura me të, kanë pjellë. Kur dashi bën tre vjet quhet “**pellaki i dit**” (në malësinë e Sharrit), ose pjellaku i dytë (në Malin e Thatë) dhe kështu me radhë deri te pjellaku i pestë. Dashi me brirë të përdredhur e jo të hapur që shpeshherë ia dëmtonin fytyrën dhe në këtë rast detyroheshin t’ia presin me sharrë, quhej Dashi **kërrut** (kërruot). Dashi që kishte edhe katër brirë, quhej **Kaçor** (kjo fjalë është shënuar në të folmen e Malit të Thatë). Dashi Shut është ai që nuk ka brirë.

Ogiçi (ogjiçi vetëm në disa fshatra të Sharrit dhe **agiçi**, në fshatrat e Malit të Thatë) zakonisht është laraman ose i zi, rrallë herë mund të jetë edhe i bardhë. Ky dallon nga dashi i zakonshëm jo vetëm nga ngjyra, por edhe se ai tredhet dhe bëhet i paaftë dhe i painteresuar për delen dhe e udhëheq tufën, shkon pas bariut, dhe me kambanën më të madhe se të gjitha kambanat tjera, bëhet simbol i tufës dhe prijës i saj. Shpesh ai edhe fle afër bariut në “**argaç**”. Nëse tufa mund të trazohet, pa udhëheqjen e tij, ai mbetet aty, nuk largohet nga bariu. Ogiçi dallon edhe për diçka tjetër, ai nuk qethet asnjëherë i tëri por vetëm përvilet, d.m.th qethet vetëm nga bishti, nga barku dhe më rrallë edhe nga qafa. Leshi i tij, meqë nuk qethet, e merr ngjyrën e kafe dhe bashkë me lëkurën e rrjepur, në rast të therjes së tij, bëhet **postaj** (*postaqi*) shumë e preferuar që zakonisht u shtrohej mysafirëve. Ogiçi mund të jetë edhe pa brirë (shut), por edhe nëse ka brirë, nga

momenti kur ai tredhet, brirët nuk i rriten (*nuk çon brina*). Bujarinë dhe krenarinë e oqiçit kështu e përshkruan Naimi: *Oqiçi ikën përpara, i bie tufës në ballë,/ me zemër të çelur shumë, vete si trimi me pallë* (N.Frashëri, Vepra 1, Prishtinë, 1978, fq.147).

Të qethurit e dhenve

Një rit shumë i rëndësishëm me një varg ceremonish në fushën e veprimtarisë blegtorale, është edhe qethja e dhenve. Dhentë dikur qetheshin dy herë, në pranverë dhe në vjeshtë. Leshi i pranverës ishte më cilësor, meqë nga vjeshta deri kur dilej në stan, është koha e gjatë, dhe leshi i qethjes pranverore ose verore ishte më i rritur prandaj edhe quhej **“leshi i gjatë”**. Pasi përpunohej leshi, dhe bëhej gati për në vek, (diku edhe razboj), leshi i gjatë vajtjes së zhgunit, **kashnikut**, bëhej **“timën”**, kurse leshi i qethjes së vjeshtës, ai i shkurti bëhej **“indi”**. Ishte zakon që qethja e parë të bëhej kur dilej në stan. Për këtë ditë, që konsiderohej si festë e vërtetë, përveç qethtarëve thirreshin edhe shumë mysafirë të tjerë nga fshati. Kjo ceremoni nuk kishte të bëjë fare me fenë, por gjithmonë në këtë rast, thirrej edhe hoxha.

Qethtarët më në zë, vinin për të ndihmuar dhe për punën që bënin, nuk ishte adet të paguhen.

Ata vinin me gërshërët e veta të gjata. Gërshërët e shkurtra ishin për qethtarët amatorë, ose për të rinjtë që donin të mësohen.



Këto lloje gërshërësh ishin të ngjitura me njëra tjetrën dhe me to punohej me një dorë. Ishin shumë më të shkurtra se ato të gjatat dhe më të gjëra. Me këto qethnin vllëhtë dhe sipas zhurmës që e bënin gjatë prerjes së leshit quheshin edhe **“shtrakë”**. Për qethtarët e mirë që kishin bërë emër në këtë zanat, ishte ofendim të qethnin me këto lloj gërshërësh. Gërshërët e gjata, janë të ndara nga njëra tjetra (kama e gërshërës) dhe ngjiteshin me njëra tjetrën kur fillonte procesi i punës. Vendi ku bëhej e qethura duhej të

ishte i pastër, jashtë vathës, ku zakonisht kishte kullosë. Pasi në fillim dhentë të qetheshin nga barku, deles me një **gjalm** (sixhim) i lidheshin këmbët dhe kështu vazhdohej me qethjen në tërë trupin. Me gërshërët e shkurttra, dikush qethte edhe pa ia lidhur deles këmbët (pa e penguar). Stili i të qethurës ishte me **“lugje”** (lugje – në shumë fshatra të malësisë së Sharrit, ose me **shabak**, në fshatra të Malit të Thatë) dhe **rrumbëll**, kur këto lugje nuk dukeshin mirë. Dhentë më të mira, sidomos shterpat e mëdha, gjatë qethjes zbukuroheshin me tufa (në Veshallë – tafa, ose **tufka** - në Gurgurnicë) dhe me pika. (pasi delja është qethur me dy gishta, me atë të madhin dhe tregues tërhiqej leshi dhe pritej. Këto zbukurime bëheshin që dhentë mos të merreshin mësysh, sepse syri i keq duke i shikuar zbukurimet nuk e shikonte delen që shpesh herë mund të ishte **“viktimë e syrit të keq”**. Është me rëndësi edhe mprehja e gërshërëve. Edhe për këtë punë kishte njeri specialist, qethtar veteran, që e ka lënë atë zanat. Mprehja bëhej me anë të një gurori special që quhej **“grih”** (griha).

Për të qethmen e parë dhentë nuk lahen, sepse në këtë kohë ato janë shumë të dobëta fizikisht, sidomos pleajat të cilat po të lahen në lumë ose liqe, nga i ftohti e sterrin Tamblin. Të gjitha zbukurimet me anë të qethjes bëheshin më tepër në të qethmen e dytë, në kohën kur dhenve *pleja* u ndërpritej pjesërisht ose e tërë e *mjelmja*. Në këtë kohë, pra në qethjen e dytë, dhentë laheshin me qëllim që të



lahet leshi i tyre, ende pa u qethur. Ka kohë që qethja e dytë nuk po praktikohet. Në këtë kohë qethen vetëm shtjerat, sepse ato as që janë qethur ndonjëherë më parë. Larja e dhenve ishte një episod i rëndësishëm që i paraprinte të qethmes. Atë ditë gëzoheshin edhe fëmijët, të cilët nëse larja bëhej në njërin nga liqejtë e Sharrit, siç ishte edhe Liqeni i Karanikollës që nga banorët e Veshallës quhet **“Jezeri”**, ndërsa nga ata të Bozovcës **“Xholi i pafun”**, i hipnin oqiçit dhe ashtu qëndronin në shpinën e tij deri në bregun tjetër të liqenit. Meqë uji ishte shumë i ftohtë barinjte me një litarë (tërkuzë) e kufizonin sipërfaqen e liqenit, duke e lidhur atë në dy pikat e bregut. Nëse delja duke notuar largohet nga terreni kufizuar për këtë qëllim, has në litar dhe

kthehet prapa. Ishte zakon që dhentë e lara mos të flenë atë natë në vendin e zakonshëm, aty ku kishte pleh, por në një vend të pastër, diku aty afër.

Ditën e të qethmes, puna është organizuar sipas planit të paraparë. Derisa qetharët e bëjnë punën me vet, më të moshuarit dhe mysafirët ashtu të ulur diku afër vendit ku qethet, bëjnë muhabet për tema të ndryshme me theks të veçantë për të qethura dhe për punë të tjera që kanë të bëjnë me blektorinë. Edhe të rinjtë edhe fëmijët janë të ngarkuar me punën që mund ta kryejnë. Disa sosh e mbledhin leshin e disa të tjerë bëjnë shërbim sipas kërkesës së qethtarëve. Leshi i një të qethure që merr formën e një **postaje** (postaqie) pa lëkurë e që kapej nëpër skaje duke u mbledhur quhet “bashkë”, domethënë leshi bashkohet, fjalë kjo që në të folmen e përditshme të shumë vendbanimeve nuk përdoret. (Në fjalorin e gjuhës shqipe të botimit të Toenës, Tiranë 2002, e ka të njëjtin shpjegim: *gjithë leshi që merret nga qethja e një deleje, pa u prishur.*)

Dhentë e viseve shqiptare zakonisht janë të bardha, kjo më siguri ndodh kështu edhe për atë se leshi duhej të jetë i bardhë për shkaqe më praktike dhe tradicionale, por edhe me peshë etnokulturore.

Shqiptarët e preferonin ngjyrën e bardhë të veshjes, duke nisur nga plisi që në këto anë quhet edhe **ksulë, qeleshë, qeçe, kajuke** etj, e deri te pjesët tjera të veshjes siç janë: **xhamadani, mintani, tirçit** dhe në veshje tjera, ku ngjyra e bardhë është e kombinuar me ngjyra tjera. Në fshatin Bozovcë, të Malësisë së Sharrit, jo rastësisht, takëmit të veshjes: tirq, xhamadan, këmishë pëlhure dhe **ksulë (plis)**, i thonë edhe **“petkat e bardha”**. Nëse dhentë do ishin më tepër të zeza, do të ishte e pamundur të bëhen teshat e bardha, e nëse sipas nevojës, duam edhe tesha të zeza, kjo realizohet me anë të ngjyrosjes, ndërsa teshat ngjyrë kafeje si në të zezë, nuk kanë nevojë të ngjyhen sepse bëheshin me leshin e dhentë të zeza.



Dhentë e zeza i ruajnë më tepër vllahët (Arumunët që me bagëtitë e tyre, me kohë janë ngulitur në shumë vende të Ballkanit. Ata merreshin kryesisht me blegtori). Pikërisht nga shkakku se ata më tepër i preferojnë veshjet (të leshta) me ngjyrë kafeje, dhentë e tyre dallojnë për nga ngjyra, por edhe për nga ashpërsia e fijos së leshit. Leshi i tyre është më i gjatë edhe më i ashpër, por i përshtatshëm për veshjen e traditës së tyre. Këto dhen, nga blegtorët shqiptarë quhen **“vllahinka”**. Ato qethen vetëm me gërshtë të shkurtra. Leshi i qethur në formë bashkash, që në brendi u futej ndonjë pjesë leshi i prerë më i shkurtër e që ka mbetur jashtë kompletit të bashkës, futej nëpër thasë të mëdhenj që në këto anë quhen **“harar”**. Nëse dhentë janë larë, leshi i qethur nuk lahet. Leshi i qethur nga dhentë e palara lahet, thahet, përpuset dhe bëhet gati për në qytet ku me makinë speciale do të përpunohet (vritet) dhe në formë shtëllungash do të kthehet në familje për tjerje dhe faza tjera të përpunimit. Kishte rastin kur gjatë qethjes, pritej lëkura e deles. Më të rinjtë i merrnin **gacat (gjacat)** dhe duke i shtypur i bënë pluhur, i cili shërbente për ti lyer delet që janë prerë nga qethtarët jo profesionist, të cilët bashkë me leshin prisnin edhe ndonjë copë lëkure. Kur në ndonjë rast bëhej prerja me përmasa më të mëdha, intervenimi bëhej me anë të qepjes. Këtë punë e bënë njerëzit me përvojë të madhe për këso raste.

Derisa jashtë stanit vazhdonte kjo punë, gratë e përgatisnin drekën. “Buka” e të qethmes nuk ishte e zakonshme. Atë ditë krahas përgatitjes së mishit të ndonjë “shterpe të madhe” ose edhe të disa qengjave të rinj (**sugjar**), gatuhej edhe pitja speciale, e t’holluar shumë mirë dhe me plotë gjalpë (tëlyen) që quhej **“Peta e mirë”** (*peta e majr*). Për këtë drekë zihej edhe kosi special nga Tamblit i trashë që zihej shumë ngadalë, derisa t’i avullohej uji.

Pasi dhentë qetheshin, ato i futnin në shtrungë për t’i nxjerrë një nga një nga dyert e vogla që t’i shënojnë me katran. Një mjet prej metali që paraqiste një figurë sipas dëshirës, e që kishte edhe një bisht prej druri, futej në katranin e shkrirë e të nxehtë, në një legen, e pasi lyhej me katranin e gjendjes së lëngët, ngjitej në anën e djathtë të deles, ashtu siç vihet vula në ndonjë dokument. Kjo shenjë që paraqiste një figurë quhej **“damka”**, ashtu siç quhej edhe **“vula”** që e ngjiste katranin. Deles më të mirë, për t’u ruajtur nga syri i keq, i viheshin më shumë “damka”. Kjo shenjë kishte për qëllim identifikimin. Nëse një ose më shumë dele përziheshin në një tufë tjetër, pronari shumë shpejt e njihnte se është e tij. Këto “damka” sidomos të familjeve me në zë për blegtori, njiheshin në një rreth shumë më të gjerë.

Kripja e dhenve

Një ceremoni e veçantë me elemente të mitologjisë së kultit të blegtorisë ishte “kripja e dhenve”. Kështu si të gjitha kafshët, edhe dhentë kanë nevojë për kripë. Gjatë periudhës kur dhentë ushqehen, pra dimrit, u jepej kripë nëpërmjet ushqimit. Kur bagëtia janë në bjeshkë, ato duhet të kripjen. Zakonisht kripa derdhet nëpër rrasa guri që quhen **“gjollë” (xhollë)**. Në të shumtën e rasteve, një bari i kishte xhollet e veta, sepse shpesh ngjante të përcillej ndonjë sëmundje. Naimi nuk e la pa e përmendur edhe kripjen e dhenve dhe gjollët, vendin prej nga ato e lëpinin kripën: Marrën vrapin e nxitojnë, derdhen në gjollë për kripë (Naim Frashëri, Vepra 1, Prishtinë 1978 fq. 149). Kripja e dhenve dhe e kafshëve tjera ishte një mit që ka të bëjë edhe me kultin e bimësisë. Kripa e dhenve zakonisht ishte me kokrra më të mëdha (më e trashë), prandaj më parë shtypej gurë më gurë dhe përzihej me lloje të ndryshme bimësh. Ishte traditë që ditën e “Shën Gjergjit” të kripjen dhentë me kripën e përzier me një lloj bime fletëgjërë që quhet **“Qepë arushe”** (çep araushe), apo me një lloj tjetër bime që ishte shumë e hollë e që quhej “Preshi i gjarprit”.



Një lloj tjetër bari që po ashtu u jepej me krip dhenve ditën e Shën Gjergjit ishte një bimë që quhej **“Bari përfolës”**. Ky kult i bimësisë, që e shton pjellësinë, më së tepërmi, lidhej me festën e Shën Gjergjit. Këtë ditë në shumë krahina u jepnin kripë bagëtisë dhe bashkë me kripën u shtinin edhe barëra të ndryshme që i

shkulnin të njomë dhe i thanin ato ditë në zjarr (M. Tirta, Mitologjia ndër shqiptarë, Tiranë, 2004, fq. 289).

Kur kripa e përzier me barna, jo vetëm për Shën Gjergj, por edhe ditëve tjera gjatë verës e vjeshtës, hidhej në gjollë, dhentë e ndienin erën nga larg dhe vraponin drejt kripës. Nëse ata nuk e ndjenin erën, dhe kullotnin, bariu i thërriste me shprehjen “Qe”, e dhentë e kuptonin këtë thirrje dhe mblidheshin të gjollet me vrap. Kjo kripje bëhej të hënën e të enjten, dy ditët në të cilat fillohen shumë punë, e që janë simbol i barrësimit dhe sukseseve në punë. Në kohën kur afrohej “koha e dashit” kripja e dhenve, bëhej edhe më shpesh.

Sëmundjet e ndryshme dhe shërimi i bagëtive

Ashtu si çdo gjë e gjallë, edhe bagëtia sëmurej. Në këto raste kur ndonjë dele ngordhte (cofte), në familje thuhej se “**ka dalë ni dele**”, sigurisht me kuptimin se është ndarë nga tufa, ka dalë nga ajo familje e nëse delen e hante ujku, asnjëherë kësaj egërsire nuk i përmendej emri, por e identifikonin me “**gojë farkumi**” (*gojë forkuari*); dmth. ai me gojë të farkuar, të gozhduar. Ujku që në këto anë i thonë edhe **uki ouki** dhe **ujku** (Gurgurnicë), hyn në vathë, dhe me dhëmbë therë me dhjetëra dele, duke u kënaqur vetëm me gjakun që ua pi. Ndodhë kur disa dele sosh edhe pse të plagosura në fyt mbeten gjallë. Shpejt merren masa për shpëtimin e tyre, duke ia përvëlur plagën me ujë valë dhe me dhjam.

Nëse dhentë sëmureshin edhe mezi e ndiqnin tufën, bariu ekspert, nëse kishte nevojë për pastrimin e gjakut të keq, “i lëshonte gjak”, me prerjen e veshit ose me shpuarjen e një grope që gjendet mbi sy. Shpeshherë këto sëmundje vinin nga kullosat e këqija siç ishte: **kërçani, shtara**, nga e cila shkumoheshin dhe shumë barna tjera që barinjtë me eksperiencë i njohin dhe nuk i lejonin të kullosnin aty. Në bjeshkët (*beshket, gjeshkët, bjeshkët*) me terrene të pjerrëta dhe me shumë gurë, ngjante shpesh që guri ta mbysë ndonjë dele ose qengj. Nëse bariu e konstaton se është plagosur rëndë, e therë (e pret në fyt që t’i dalë gjaku) kur ende ishte e gjallë se vetëm ashtu mund t’i hahet mishi. Nëse ngordh, dhe nuk theret për së gjalli, i hiqet koka, rrjepet (dikur lëkura kushtonte shumë) dhe mishi u jepet qenve. Ka raste kur deles guri ia theu këmbën. Edhe për këto raste intervenohet shumë shpejtë. Këmbe e thyer mbështillet me lesh në dy anë vihet nga një shkop i gdhendur si dërrasë dhe me një gjalmë, ose pjesë litari shtrëngohet. Pas disa ditësh, e lidhura lirohet pak, sepse në ato momente ngjitet ashti i këmbës. Një sëmundje e shekullit do të

thoja për dhentë ishte “**shkepsa**”, sëmundje kjo që për herë të parë në viset tona është paraqitur para dyzet vjetëve. Me gjuhën e popullit kjo quhet “**shkepsa**” sepse sëmuret thundra e deles dhe ajo **shkepon** (çalon). Për këtë sëmundje të pashërueshme, krejtësisht, përdoren disa barna. Pasi thundrën e presin dhe e pastrojnë nga gjaku e qelbi, e lyejnë me lëngun e gurkalit, dhe e lidhin që të mos ketë kontakt me plehun ose baltën. Nëse dikush ka shumë dhen, një tufë më e vogël mund të bëhet me “topallet” të cilat kanë trajtim të veçantë për shërim dhe nuk mund të shkojnë larg për të kullotur, por kullosin aty afër stanit. Përveç këtyre sëmundjeve tradicionale të dhenve, kohëve të fundit si sëmundje që ngjitet edhe te njeriu dhe len pasoja të rënda, është “**Brucelloza**”. Për këtë sëmundje të rrezikshme edhe për shëndetin e njeriut po merren masa nga vet shteti nëpërmjet vaksinimit të tyre, por si duket ende nuk ka shërim të plotë. Si sëmundje tjera njihen edhe “zgjebja” që zakonisht i kap dhentë e dobëta fizikisht. Nga kjo sëmundje dhenve u bie leshi dhe si ilaç për këto raste përdoret një lëng “**vitalina**”. **Mërlivja** ishte një sëmundje tjetër, si pasojë e së cilës dhentë ndahen nga tufa dhe nuk e ndjekin atë. Ka edhe shumë sëmundje tjera të dhenve dhe të kafshëve tjera që trajtohen nga shërbimet veterinarë që nuk janë temë trajtimi i këtij punimi.

Veshja e barinjve

Ashtu si vetë jeta, me specifikat e veta, edhe veshja e këtyre banorëve të bjeshkëve e të staneve dallon dukshëm nga të tjerët. Kushtet për jetesë, puna e tyre në natyrë që shpeshherë ishte shumë e egër, qëndrimi i tyre pothuaj natë e ditë jashtë shtëpisë e stanit, dhe rruga e gjatë në këmbë për të bërë jetë nomade, ishin faktorët kryesorë që këto banorë të dallojnë nga të tjerët, edhe në veshje. Kjo veshje, që përbëhet kryesisht nga leshi i dhenve, pjesërisht ishte e ngjashme edhe me banorët tjerë që jetojnë në fshatrat e malësisë, e që



në një farë mënyre janë të lidhur me jetën blegtorale. Kësula e bardhë e leshtë që na del edhe me disa emra të tjerë e që është elementi më i veçantë identifikues kombëtar, gjithsesi edhe këtë shtresë të popullatës shqiptare e karakterizon identitetin tonë. Ky

element etnografik që është i përbërë vetëm nga leshi i bardhë i dhenve, me siguri edhe zanafillën e ka te barinjtë dhe tek shqiptarët tjerë, që merreshin më zejen e blegtorisë. Kësula e bardhë (plisi), prodhohej nëpër qytetet shqiptare. Kësula (plisat) e Prizrenit, Tetovës, Gjakovës etj., përveç rolit identifikues kombëtar, varësisht nga forma, ishte edhe shenjë përcaktuese krahinore nëpër trojet shqiptare. Barinjtë e malësive, që po i trajtojmë, rreth kësulës e mbanin edhe **“sherveten”**, një lloj shamie, zakonisht me ngjyrë kafeje që shërbente edhe për mbrojtjen e veshëve nga i ftohti. Jo rastësisht “shervetja” është me ngjyrë të errët dhe dallon nga një lloj tjetër shamie që quhet “çevre”, që është me ngjyrë të çelë dhe e qëndisur e që mbahet në rastet solemne. Lurka është një pjesë shumë e rëndësishme e veshjes së malësorëve, e theksuar më tepër te barinjtë. Edhe kjo veshje përdoret me disa emërtime.

Në vendbanimet e Malësisë së Sharrit më i njohur është emri “Lurkë”, por aty këtu përdoret edhe **“koparone”**, ndërsa në fshatrat e Malit të Thatë njihet me emrin **“xhulije”**. Më parë ishte i njohur edhe emri **“Kapsejize”** (në Bozovcë). Fjalori i shqipes së sotme këtë emër e sqaron kështu: **Lurkë - a-at**

Jakne (d.m.th. veshje e epërme burrash me jakë ka shpina. 2. Dele me lesh të gjatë e të ashpër (pa shumë sqarim për kuptimin e dytë se në cilën krahinë “jakuçe” i thonë deles me lesh të ashpër e të gjatë.

Lurka është nga Zhguni (kashnejk) i leshtë. me mëngë të shkurtra, për qëllime praktike, për lehtësim në punë sepse zhguni i trashë i leshtë mund të jetë pengesë e madhe për lëvizjen e krahëve. Në pjesën e prapme ka një copë të lëshuar që mbulon shpinën e që luan rol të dyfishtë: kur nuk ka të reshura, si e shtrirë mbi pjesën tjetër të lurkës, e mban shpinën nxehtë, e kur bie shi e borë, ajo mbërthehet me



kopsa dhe pasi merr formën e konit vihet në kokë. Kur bie shi i furishëm, bariu e hedh lurkën krahëve, ulet pak dhe ashtu me jakën në kokë mbrohet nga lagia. Naimi këto momente i paraqet kështu: *Bariu vë gunën më kokë z'eshkën me herë të parë, Ndes shkarpat...* (N. Frashëri, Vepra 1, Prishtinë 1978, fq. 150) Lurka nuk mbërthehet në pjesën e parë, po ashtu për shkaqe praktike gjatë punës. Në dy anët e përparme, ka pjesë të kthyera që kah fundi janë të qepura, që shërbejnë zakonisht për ta mbajtur fyellin, për të cilin nuk ka nevojë për dy xhepa të atillë, por me siguri kjo bëhej për shkaqe estetike për ta ruajtur simetrinë. Në dy anët e përparme ka dy xhepa, që përveç tjerash, shërbejnë edhe për ta afruar njërën anë të lurkës me tjetrën, sepse siç thamë kjo veshje nuk mbërthehet fare në pjesën e përparme. Lurka, që zakonisht ka ngjyrë të zezë e në shumë pak vendbanime të tjera edhe ngjyrë kafeje, mbahet edhe në raste solemniteti. Mitani, vishet nën lurkë, është gjithashtu nga zhguni i leshtë por më i hollë se ai i lurkës. Në fjalorin e gjuhës shqipe shpjegohet si jelek me mëngë, ndërsa në të folmet shqipe të këtyre krahinave jelek quhet vetëm ai pa mëngë. Mitani mund të jetë edhe i bardhë por edhe i zi. I bardhi vishet në raste solemne. Në pjesën e përparme zakonisht mbërthehet me kopsa ose me mbërthyesja (**mërthejza**). Përveç pantallonave (dikur tirqve), barinjte i përdorin edhe benevrekët ose shallvaret që ndonjë herë, sidomos kur bën mot i lig, i veshin mbi pantallona. Për t'i mbrojtur pantallonat, burrat i veshin edhe kur mjelin ose kur qethin, ndërsa gratë shpeshherë i mbanin në vend të dimive. Benevrekët ndryshe quhen edhe "**kokole**". Përveç çorapëve, që janë gjithashtu të thurur nga peri i leshit, vlen të përmenden edhe "rrogzinat" që në Gurgunicë të Malit të thatë quhen edhe "**Amxhanik**". Në fjalorin e gjuhës shqipe, si duket kjo pjesë e veshjes që ekskluzivisht përdoret te barinjte shpjegohet gabimisht. **Rogezinat** janë krejt diçka tjetër, nga ajo që shkruhet në këtë fjalor, e jo lloj tirqish të shkurtër prej shajaku apo rripa prej shajaku të trashë me të cilat bëhet xhubleta, e jo siç shkruhet në këtë fjalor. Rrogzinat janë dy pjesë që përdoren për mbështjelljen e këmbëve që janë të dedikuara vetëm për opinga (**openga**). Këto janë shirita nga material i leshtë më të hollë se shajaku, të vejtur në **vekun** me "dy liç" që nuk përpunohen pas vejtjes, domethënë; nuk vriten në punëtorinë ku përpunohej zhguni apo shajaku, që përdorej për pjesë tjera të veshjes së burrit. që i përmendëm më parë.

Rrogzina është e gjerë përafërsisht sa edhe brezi dhe e gjatë deri një metër. Mbahen zakonisht të zeza dhe zëvendësojnë çorapët. Këmba mbështillet me rrogzina nga maja e gishtave e duke shkuar në formë spirale deri nën gjunjë. Kjo mbështjellje këmbësh që për ata që se dinë qëllimin është bile edhe qesharake, e ka kuptimin e vet dhe është shumë praktike sidomos kur bën mot me shi. Pasi është mbështjellë këmba, futet në opingë dhe shtrëngohet me gjalma (**xhalma**, **norta** ose **ndorta**). Kur gjatë udhëtimit në terren



ALBANIAN SHEPHERD.

të lagur pjesa e poshtme e rrogzinës laget, atëherë ajo hiqet (shkatillohet) dhe mbështillet përsëri, por kah ana e kundërt. Pjesa e poshtme që ishte e lagur mbështjell pjesën e epërme deri nën gjunjë e që për një kohë duke ecur do të thahet përsëri. Gjatë rrugëtimit të barinjve në rrugën e largët, rrogzinat ndërrohen kështu disa herë, duke e ruajtur këmbën nga lagia dhe i ftohti.

Ferexheja është pjesë shumë e rëndësishme e veshjes së barinjve. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, jepet shpjegim i njëanshëm: Ferexhe, rrobë e zezë me të cilën gratë myslimane mbulonin fytyrën dhe trupin kur dilnin nga shtëpia, pa e përmendur fare rolin dhe rëndësinë e saj në jetën e njerëzve që merreshin me blegtori. Ferexheja, pra ka kuptim më të gjerë se ai që përmendet në fjalor. Kjo pjesë e veshjes që në këto malësi përdoret vetëm nga burrat, përbëhet gjithashtu nga shajaku i leshtë. Ferexheja më tepër përdoret si e bardhë dhe ka rol të dyfishtë përdorimi: si veshje që zakonisht mbahet krahëve, është me mangë të shkurtra, e gjatë dhe me një pjesë shtesë nga shpina, si ajo e lurkës, me një dallim se pjesa e shpinës ose jaka është e qepur në formë koni dhe si e tillë nuk ka nevojë të mbërthehet për t'u fituar kjo formë që do shërbente për mbrojtje nga shiu ose bora. Ferexheja mbahet krahëve se njëra mëngë, zakonisht ajo e djathta është e mbushur me ndonjë pjesë shajaku ose me lesh, që përdoret si nënkresë, (jastëk) kur ferexheja luan edhe rolin e teshës për fjetje. Barinjtë, Ferexhenë e mbajnë krahëve kur bie shi sepse uji i shiut nuk depërton në trup, edhe pse ajo peshon

shumë kur është e lagur. Kur Ferexheja përdoret si mbulesë dhe njëherit edhe si shtresë si pjesë e saj e pandashme është edhe Gëzofi, (gjozofi, gzofo, por edhe kozhufo – (Gurguricë) që futet në Ferexhe dhe ashtu, komplet e formojnë “shtratin” e bariut – i cili kur fle njëren pjesë të këtij “kompleti” e mban nën trupin që luan rolin e dyshekut ndërsa pjesën tjetër e shfrytëzon si mbulesë.

Frazeologjizma që kanë të bëjnë me kafshët

Meqë jeta e njeriut ishte shumë e lidhur me kafshët, ruajtja e të cilave kërkonte aq sakrificë për këto raporte reciproke, përveç fushës së leksikologjisë dhe shprehjeve të ndryshme gjuhësore u krijuan edhe shumë frazeologji që përveç kuptimit të drejtpërdrejtë, gjithsesi e kishin edhe atë të tërthortë, që është edhe vlera esenciale e frazeologjizmave. Me këtë rast ne do të përqendrohemi vetëm në disa sosh. Këto frazeologjizma që kanë shtrirje të gjerë, janë pothuajse të njëjta por dallojnë në aspektin dialektor. Ne po i shënojmë vetëm ato që i kemi hasur në të folmet e fshatit Veshallë.

1. **Kinxhi mejr thejth di nona** – njeriu i mirë, i sjellshëm, që i respekton të tjerët, është i respektuar dhe i shpërblyer nga të gjithë ato.

2. **Fle si kinxh** – e ka marrë gjumi, bën gjumë të rehatshëm.

3. **Asht zbardh si dele** – është thinjur (ngjyra e bardhë identifikohet me delen, ndër shqiptarë, të pakta ishin dhentë e zeza.

4. **Ashtu i butë si dele** – është i qetë, i sjellshëm, nuk i bën keq askuj.

5. **Asht bo si dash** – është rritur, është bërë shumë i fuqishëm.

6. **Ai asht dash e dele** - mashkull homoseksual ose heteroseksual (i takon dy gjinive)

7. **Si delja mas ukit** – shkon pas të keqes, e thërret e keqja.

8. **Pa dhen nauk dilet në stan** – pa kushte dhe para nuk arrihet asgjë, pa diçka që është elementare për një punë, vështirë se do jeshë i suksesshëm.

9. **Si dhoja nër dhen** – i pashoqërueshëm, i vetmuar, njeri që nuk respektohet dhe që nuk respekton, që dallon në shumëçka nga ata që e rrethojnë.

10. **Nauk dëm çese n’stan** – diçka që s’ka vlerë, nuk ka dobi prej diçkaje (nuk e ka vlerën e dhenve që të qesin në stan).

11. **Ai stan ç'at maksauëll (bulmet) ka** – prej tij mos prit më shumë, e keqja prodhon vetëm të keqe, ashtu siç është, i ka edhe punët.

12. **Dhoja zgebët, bishtin termo** – nuk vlen fare por mbahet se është dikushi, i nënçmon të tjerët, nuk e ka hallin, për ta ngritur veten aq lartë.

13. **Si lopa mas viçit** – që nuk i shkepet fare, e ndjek gjithmonë.

14. **Ma shoum pi gjurrës se pi murrës** – diçka që falsifikohet, e që tentohet të gënjejë dikë (ashtu siç mund të falsifikohet edhe Tambli i lopës (i Murrës) kur i qitet ujë i gurrës.

15. **I përziu dhentë e dhojtë** – i ngatërroi fjalët, i përziu punët, bën muhabet që nuk dëgjohet, nuk është i qartë.

16. **I vejn era cap** – erë e keqe, pa larë, njeri pis me erë si të cjamin

17. **Ni mekër cap** – njeri i keq me mjekër si të cjamin, pa autoritet, burrë që nuk i ndihmon as mjekra.

18. **I kimi nejt si lopës pa viç** – e kemi respektuar tepër, nuk e kemi hidhëruar asnjëherë.

19.

20. **E ka bo çafën si bik** – është shumë i shëndoshë.

21. **Si n'bri t'dhojs** – në vend të keq, ka jetuar në vend të papërshtatshëm, në kushte shumë të këqija

22. **Si stani pa çen** – si shtëpia pa të zot, si diçka e shkretë ku mund të hyjë të dalë kush të dojë.



23. **Çenit xhi lefën mos ju tout** – Ai që kërcënohet vetëm me fjalë, nuk është i rrezikshëm.

24. **Ai osht çen xhi e ha t'zotin** – i pabesë, njeri i paparashikueshëm, i rrezikshëm që befason në çdo moment.

25. **Nouk osht çen xhi i be ukit** – ai që nuk vlen gjë, më kot flet dhe lëvdërohet, është frikacak.

26. **Bon jetë si t'çenit** – jeton në kushte shumë të vështira, pa shtëpi e pa ushqim

27. **Burrit e kalit nouk u dihet vdekja** – janë në lëvizje, në punë dhe në rrugë. Janë gjithmonë në terren, nuk janë parazit që të presin nga të tjerët. Prej tyre presin e tërë familja.

28. **T'kërkoj me komë kali** – të kërkoj kudo shumë larg, edhe atje ku njeriu nuk mund të mbërrijë, atje ku mund të shkohet vetëm me kalë.



29. **Cejli kalë zihet, e fshoëjn lomën** – Ai që është i butë, i drejtë dhe nuk di intriga, pëson, i paguan të gjitha, e bën edhe punën e atij që ikë, të atij që bën sherr.

30. **Si shishja n'gjrive t'kalit** – I sigurtë, ashtu si shishja e llampës së vajgurit që dikur lidhej me fijet e jelave të kalit që të mos thehet.

31. **I gjan mozi pelës** – ka të ngjarë që të jetë ashtu edhe pse ai nuk e pranon.

32. **Si mozi para pelës** – dikush që nuk e respekton më të vjetrin, që mendon se di çdo gjë e që flet e përzihet atje ku s'e ka vendin.

33. **Prejt magjar se do dole barë** – ai që prët më kot, që humb kohë për diçka që s'bëhet asnjëherë, për diçka që nuk realizohet.

34. **Si magjari para kolve** – kur dikush del atje ku se ka vendin, do të bëhet i pari pa e merituar atë.

35. Biri samarit t'i mteket magjarit

- t'ia bëjsh me dije në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në mënyrë të tërthortë.

36. **Mushka nouk e kallxon babën pa e kallxon dajxhën** – Dikush që mburret vetëm me të mirën më të largët duke e fshehur të keqen më të afërt. (Mushkën e pjellë pela, e mbarsur me gomar, e vëllai, i pelës konsiderohet kali, pra daja i mushkës).

37. **Pa ni dhonërr e pa ni magjar, mos t'lasht Zoti** – Dhëndërri diku nuk respektohej sa duhet, prandaj e krahasojnë me gomarin, i bën të gjitha punët, nga turpi e respektii.

38. **Kur t'vejn mentë t'shkojnë dhentë** – Kur për diçka bëhet tepër vonë, është çdo gjë e kotë, humbja nuk kompensohet.

39. **Si dhentë n' krejp** – vrapojnë – turren pas diçkaje që vështirë mund t'i ndalë dikush.

40. **Kali maeir e shton taxhinë** – i miri nuk bën harxhime të kota. Ai kënaqet me aq sa i takon dhe aq sa ka nevojë, han pak e punon shumë.

Disa toponime që kanë të bëjnë me blegtorinë

Veprimtaria e blegtorisë dhe jeta aq e organizuar, e njerëzve që merren me këtë zanat të hershëm të shqiptarëve, përveç tjerash la gjurmë edhe në fushën e toponomastikës, e sidomos në mikrotoponime. Në kuadër të nevojës për komunikim në fushën e kësaj veprimtarie, u ndërtuan shumë emërtime bjeshkësh, malesh, arrash etj. Edhe në këtë rrafsh delja si kafsha më e popullaziruar, me të cilën lidhej më fortë njeriu, la gjurmë që edhe sot kur kjo degë ekonomike gati se po shuhet në këto anë, këto emërtime ruhen dhe përdoren nga banorët vendës.

Ne edhe në këtë rast do ndalemi në disa toponime të bjeshkëve të Sharrit, të koncentruar rreth fshatit Veshallë. Disa sosh që i kemi shënuar në bjeshkët e Gurgunicës të Malit të Thatë.

1. **Sheliçe** – emër bjeshke që i takon rajonit të fsh. Veshallë. Gjatë hulumtimit tonë në takimet me njerëz që janë marrë tërë jetën me dhentë dhe bjeshkët, mësojmë se kjo bjeshkë

është shumë e përshtatshme për shtjerrat, dmth. Vendi i shtjerrave. Kur e kemi para sysh se bariu i shtjerrave në këto anë quhet “shuligjar”, dhe emrin “shelek” të Naimit, mund të mendohet për të ardhur deri te konstatimi se ky toponim ka të bej me vendin e shtjerrave.

2. **Te Kroj Plakes** – bjeshka ku gjendet Kroj i plakës. Në këtë vend legjenda thotë se plaka me gjithë dhentë e saj, nga i ftohti, bora dhe fërfëllenza u bënë gurë. Sipas legjendës kjo ngjau kah fund ii Marsit, kur plaka mendoi se kishte dalë pranvera dhe kishte ardhur koha për të dalë në stan me bagëtinë e vet.

3. **Te Shtroungia** – vendi ku mileshin dhentë në drekë. Edhe sot në atë vend duken vathët prej guri me dyer të vogla prej nga dilnin delet një nga një. Në atë vend barinjte i sillnin dhentë që ishin duke kullotur meqë stanet ishin shumë larg.



4. **Të Stani Brigadës** – mikrotoponim në bjeshkën e Sheliçes, ku ishte ngritur stani i Ndërmarrjes ekonomike “1 Maj”, ndërmarrje kjo që në kohën e Ish Jugosllavisë kishte 30.000 dele dhe llogaritej më e madhja në vend. Ky stan i takonte njëres nga gjashtë Brigadat e kësaj ndërmarrjeje shoqërore. Sot kjo firmë është e privatizuar dhe ka 6000 dele.

5. **Te Stani Demës** – vend po ashtu në Bjeshkën e Sheliçes ku dilnin në stan familja e Demës Bexhetit që ishte ndër familjet me më tepër dhen dhe njëherit familja më e madhe që jetonte në një bashkësi.

6. **Te Stani Madh** – vendi ku edhe sot vërehen gurët e këtij stani që me siguri ka qenë i madh. Stanet që ishin të ndërtuar me mure gurësh, llogariteshin si stane me shumë dhen.

7.

8. **Te Gjuri Çobejve** – një gur ku pushonin dhe i bienin fyellit barinjte.

9. **Te Shpella Kuçe** – një shpellë e madhe në një gur të kuq, ku strehoheshin dhentë, gjatë kohës me mot të keq.

10. **Te Stani Islamit** – është mikrotoponim shumë i vjetër. Nuk dihet saktësisht se në cilën kohë ka ekzistuar ky stan. Aty ekziston burimi me i ftohtë në tërë bjeshkët e Sharrit. Dikur barinjte bënin gara se cili do ta mbajë dorën më gjatë në këtë burim. Ky vend ishte edhe vendi ku mileshin dhentë për drekë, sepse enën me Tamblin e dhenve e futnin në ujin e ftohtë të këtij burimi që mos të prishet deri në mbrëmje, kur duhet ta bartnin në stan.



11. **Te Argjaçi i Shterrpave** – Vendi ku flinin dhentë shterpa

12. **Te Argjaçi i Pllejave** – vendi ku flinin dhentë plleja

13. **Te Argjaçi i Moshkive** – Vendi ku flinin shtjerrat mashkuj që ishin të ndarë nga ato femra.

14. **Te Argjaçi Nesejmit** – vendi ku flinin shterpat që i ruante një bari i vjetër me emrin Nesim.

15. **Te Gjuri i Malë Çajanëve** – një vend mbi Veshallë, ku u vendos një familje blegtorësh, të ardhur nga fshati Çajë e Krahinës së Lumës. Kryefamiljari quhej Ismail që shkurtimisht e turrnin Malë. Kjo familje e ngriti stanin afër gurëve që sot e mbajnë këtë toponim. Ata qëndruan aty vetëm një verë, për t'u shpërngulur më vonë në fshatin Bozovcë, ku vazhdojnë të jetojnë edhe sot e kësaj dite.

16. **N'Xhibre t'Madhe** – Vendi që dikur ka shërbyer si argaç (vendi ku flenë dhentë). Meqë aty ka pasur shumë pleh.

17. **N'Xhibre t'vojl** – Është fjala për vendin që dikur ka qenë një orgaç më i vogël.

18. **Te Xhollet e Izetit** – Vendi ku janë gjollët që shërbejnë për t'i kripur dhentë. Izeti ka qenë me siguri ndonjë njeri që ka pasur shumë dhen aty diku afër gjolleve që edhe sot janë në Bjeshkën e Shelicës.

Toponime të këtilla, që kanë të bëjnë me stanin, gjollët dhe orgaçin i kemi hasur edhe në shumë bjeshkë tjera të Sharrit siç janë: ato të rajonit të fshatrave: Bozovcë, Brodec, Vicë, Sellcë, Shipkovicë, Gajre etj. Vlejnë për t'u përmendur edhe dy toponime – emërtime bjeshkësh në rajonin e Bozovcës: (Baba Hasanica)

19. **Baba Sanejca** – emër bjeshke me terrene shumë të mira për kullota. Si duket ky toponim, mund të jetë emërtuar në variantin sllav. Sipas të gjitha hulumtimeve tona, vijmë te konstatimi se këtë bjeshkë me dhentë e veta e ka shfrytëzuar një farë “Qehaje” që quhej Hasan. Me vdekjen e tij, mbeti plaka hasanica, për të vazhduar ta kalojë verën me dhentë në këtë bjeshkë.

20. **Sheremetajca** – Vend po ashtu afër fshatit Bozovcë që mban emrin e gruas së njëfarë të ndjerit Sheremetit, e cila si duket pas vdekjes së burrit, e vazhdon jetën bashkë me dhentë dhe si trashëguese e tij, identifikohet me këtë toponim.

Në bjeshkët e Malit të Thatë, siç e përmendëm edhe më parë, në mungesë të burimeve dhe lumenjve, bagëtia si dhe njerëzit, problemin më të madh e kishin ujin e pijshëm, prandaj ato ndërtonin gropa akumulimesh të ujit nga shiu dhe puse (bunarë). Këtë e dëshmojnë edhe këto mikrotoponime që i hasim në rajonin e Gurguricës.

21. **Te Bunari Shqerrave**

22. **Te Bunari Plljave**

23. **Te Bunari Lopëve.**

Dyndja nga bjeshka

E tërë kjo jetë e gjallë në bjeshkët e bukura të ditëve të verës me ardhjen e vjeshtës, i numëron momentet e fundit. Sipas planifikimit të punës dhe aktiviteteve për tërë vitin, këto barinj dhe familje të tëra që merreshin me blegtori, sipas kalendarit të festave pagane dhe atyre krishtere, e dinin ditën kur duhet ti lëshonin bjeshkët, me përjashtime të vogla të ndonjë vonese, nëse vjeshta ishte me mot të mirë.

Bora, që shpeshherë në këtë kohë i zbardhte majat e bjeshkëve, që ndonjëherë me erë të ftohtë u bënte me dije këtyre barinjve se nuk kanë më vend aty duke ua përkujtuar se është momenti për të marrë rrugën e gjatë ashtu si çdo vjet, që sa më lehtë të mbërrijnë atje ku do ta kalojnë dimrin, ndërsa banorëve tjerë të staneve u përkujtonte se është koha për tu kthyer në katund e lëshojnë vendbanimin e përkohshëm dhe bashkë me teshat (petkat) e shtratit, enët dhe bulmetin, të dyndeshin (u duna pi stani) për të



vazhduar jetën nëpër shtëpitë e veta. Para se ta merrnin rrugën e gjatë edhe barinjtë me tufat e veta zbritnin afër fshatit, për të kullotur ndonjë ditë nëpër ara, meqë kishin mbaruar të gjitha punët bujqësore dhe ishte mbledhur "beregëti". Barinjtë që nuk kishin tufë të mëdha dhensh, dimrin e kalonin aty ku jetonin, në fshat edhe pse me shumë vështirësi e pritnin "Shën Gjergjin", ndërsa të tjerët që nuk mund të siguronin ushqim të bollshëm për bagëtinë e tyre, ashtu si zogjtë shtegtarë merrnin rrugën për vendet më të përshtatshme për ta kaluar dimrin. **"Këshllarët"** (vendi ku barinjtë me bagëtinë e kalonin dimrin) e tyre ishin andej kah Maqedonia Qendrore e Jugore, në rrethinat e qyteteve"

Gjevgjeli, Strumicë, Shtip, Veles, Gradska, Demir Kapi etj; e dikur në Selanik. Këtë rrugë e bënin edhe blegtorët e krahinës së Opojës, nga ana tjetër e Sharrit. Ata me bagëtinë e vetë, në vjeshtë kalonin nëpër bjeshkët e Veshallës për të ardhur në Tetovë, e për të vazhduar rrugëtimin nëpër Shkup, që të mbërrijnë në vendin ku do ta kalonin dimrin. Këto vende ku do kalohej dimri, zakonisht ishin fshatrat e lënë nga popullata turke (jurikët) që ishin shpërngulur për Turqi. Blegtorët vendoseshin aty, në ato fshatra që ma lehte ta kalojnë dimrin. I meremetonin shtëpitë disa nga të cilat i kishin blerë dhe i bënin prona të veta.



Dikur, kah vitet e pesëdhjeta, shpërngulja për në Turqi mori përmasa të madha duke e goditur edhe popullatën shqiptare. Shumë shqiptarë të rrethinës së Velesit, Përlepës, Manastirit, bashkë me turqit, e ndonjëherë edhe ne emër të turqve, morën rrugën pa kthim të Anadollit. Familjet shqiptare blegtorale blenë shtëpi dhe tokë në këto anë, vetëm për ta kaluar dimrin. Në këtë rast po përmendim fshatin Biqirli, toponim turk që do të thotë **“Vend i kuajve”** (gjatë tërë dimrit kuajt kullotnin jashtë). Në këtë fshat që kishte qenë i banuar me popullatë turke, shqiptarët blenë shtëpitë nga turqit që po shpërnguleshin, bashkë me tokë për t’u siguruar ushqim kafshëve gjatë dimrit. Shtëpitë e para nga fshati

Bozovcë dhe Veshallë janë blerë kah viti 1956. Ky fshat që kishte mbetur me pak familje turke, u popullua me banorë të rinj të familjeve shqiptare. Vetëm nga dy fshatrat: Veshallë e Bozovcë u bënë afër 20 shtëpi: Kësisoj shpërnguljesh me motive të mbijetesës dhe ruajtjes së bagëtisë nga Malësia e Sharrit dhe Malit të Thatë pati edhe në shumë vende tjera e ndër to po përmendim edhe fshatin Topollnicë të Radovishit, ku blegtorët shqiptar kaluan në bujqësi dhe merreshin me kultivimin e duhanit. Disa familje jetojnë atje edhe sot e kësaj dite.

Kjo shpërngulje sezonale për motive ekonomike që përfshijnë tërë anëtarët e familjes, tregon rëndësinë jetike të blegtorisë për familjet shqiptare. T'i kthehemi përsëri jetës në fshatin Biqirli ku edhe autori i këtij studimi kaloi pjesë të fëmijërisë. Bashkë me pakë familje jurike (turke) në këtë fshat shqiptarët gjetën edhe disa familje vllahësh të cilët si blegtorë, në këto vende kishin ardhur më herët se shqiptarët. Për dallim nga shqiptarët, vllahët ruanin dhen të zeza, me lesh të gjatë dhe shumë të ashpër (dhentë vllahinka) dhe nuk lëviznin nga ky vend, pra aty jetonin verë e dimër. Gjatë kohës së verës ato dhentë i kullotnin vetëm natën sepse ditën bënte shumë vapë.

Kah viti 1972 të shekullit të kaluar, kooperativat shtetërore i zaptuan këto pasuri që shqiptarët i patën blerë me ato pak të ardhura që mezi i fitonin nga bulmeti i shitur. Ishte koha kur për shqiptarët dhe për tjerët hallexhinj, u hap rruga e kurbetit, ishte edhe fillimi i mbarimit të kësaj veprimtarie që ushtrohej me aq vullnet dhe dashuri. Barinjte e devotshëm i varën në gozhde opingat, rrogzinat, **ferexhen** dhe **kërlikun** dhe u nisën me trenin që çonte në Evropë, u nisën andej prej nga vështirë se do kthehen ndonjëherë.

E tërë kjo që po e rrëfejmë dhe që e mbështesim edhe me fakte shkencore, tanimë pothuaj ka mbetur vetëm një histori kujtimesh për njerëzit që janë pensionuar apo e presin ate, nëpër metropolet e Evropës. Ata u nisën për të fituar pak para dhe për një kohë të shkurtër të kthehen përsëri, mirëpo kjo nuk ngjan kështu. Blegtorët e rinj të dikurshëm tanimë janë vetëm turistë të bjeshkëve të bukura që tani e kanë humbur kuptimin.

Nevoja për të jetuar, ata i përcolli në kurbetin e pafund të përjetshëm. Ata me siguri u rrëfejnë fëmijëve ose nipave të vetë, atje në Evropë, për jetën e staneve për dhentë, dhitë, shtjerrat deshtë dhe për gjithë ata që i përmendëm, për ata që i përmend edhe Naimi në veprën madhështore "Bagëti e Bujqësia".

Prof.dr. Hamit XHAFERI

**TRADITA KULTURORE SHQIPTARE
NË MAQEDONI**

PËRMBAJTJA:**TRADITA KULTURORE SHQIPTARE NË MAQEDONI.....55****I. FESTAT DHE KËNGËT E MOTMOTIT..... 57**

1. Tradita e festës së Shën Gjergjit në fshatin Pirok të Tetovës 57
2. Tradita e festës së Shën Gjergjit në fshatin Çegran të Gostivarit 60

II. RITET DHE ZAKONET E LINDJES SË FËMIJËS 64

1. Ritet dhe zakonet e lindjes 64
2. Zakoni i prerjes së kërthizës dhe pagëzimi i fëmijëve 66
3. Këngët e djepit dhe të fëmijëve të posalindur 67
4. Ninullat në fshatin Xhepçisht të Tetovës 71
5. Gruaja shqiptare në imagjinaren e folklorit religjioz 74

III. KËNGË SYNETIE.....64**IV. LOJËRA FËMIJËSH..... 84**

1. Para me qarë (fitim)..... 84
2. Çeliku 84
3. Filxhanat 85
4. Alla osmane 85

V. RITET DHE KËNGËT E DASMËS..... 86

1. Tradita dhe bashkëkohorja në dasmat e fshatit Kamjan të Tetovës 86
2. Zakonet e dasmës në fshatin Çegran të Gostivarit 88
3. Ritet dhe këngët e dasmës në fshatin Pirok të Tetovës..... 90
4. Këngët e fejesës dhe roli i shkuesit në disa mjedise rurale shqiptare..... 96
5. Këngë popullore fejese dhe martese në fshatin Veshallë të Tetovës 101
6. Këngë dashurie 107
7. Baza religjioze e kurorëzimit..... 130

VI. VESHJET DHE LOJËRAT POPULLORE 131

1. Veshjet popullore 131
2. Veshja e meshkujve 132
3. Veshja e femrave..... 134
4. Lojërat popullore 136
- a) Lojërat që luheshin në "Odën nerashane" 136

VII. PËRRALLAT SHQIPTARE NË MAQEDONI..... 140

- Rëndësia dhe roli i përrallave 140

VIII. FJALË TË URTA NGA FSHATI PIROK I TETOVËS..... 144**INFORMATORËT:..... 148****MBLEDHËSIT: 148****BIBLIOGRAFIA 149**

Prof. Dr. Hamit Xhaferi

TRADITA KULTURORE NË DISA TREVA SHQIPTARE NË MAQEDONI

Ky është një hulumtim i veçantë në aspektin folklorik dhe etnologjik për shqiptarët e Maqedonisë perëndimore, në të cilën është kryer një veprimtari hulumtuese nëpër treva të ndryshme, pothuajse në të gjitha komunat e banuara me shqiptarë.

Shqiptarët e Maqedonisë si tërësi territoriale etnografike kanë një shtrirje interesante, sepse në këto treva të bashkuara ndeshim veçori të dalluara specifike në planin e përgjithshëm kulturor. Pasuria e treditës kulturore shquhet për llojllojshmërinë e formave, të cilat paraqesin njësinë e pandashme të traditës kulturore shqiptare në këto hapësira. Duke u sintetizuar shumë nga këto pikëpjekje, është krijuar një traditë të veçantë unike kulturore, që shprehet në folklor, sidomos në atë koreografik, pastaj në këngët e llojllojshme, në traditën e prozës popullore, në doke e zakone, në pasurinë e veçantë të veshjeve.

Traditën kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë, pas hulumtimeve të organizuara nëpër treva dhe lokalitete të ndryshme, me këtë studim shpresojmë se do të paraqesim në një dritë më të plotë e më të tërësishme.

Në këtë rast duhet të theksohet se kjo traditë kulturore edhe më parë ka qenë në një mënyrë apo tjetër objekt i studimeve, sidomos ato që e kanë trajtuar veshjen karakteristike në disa treva shqiptare të Maqedonisë perëndimore. Edhe pasuria folklorike e këtyre hapësirave është mbledhur, sistemuar dhe botuar në studime dhe monografi të ndryshme të disa studiuesve të folklorit burimor shqiptar nga Maqedonia, midis të cilëve do të veçoja me këtë rast Nuhi Vincën, Rahmi Tudën, Abedin Zenkun, Ibrahim Krosin, Kaim Murtishin, Edibe Osmanin, Feti Mehdiun, Bexhet Asanin, Mumin Zeqirin etj.

Ky studim do të sjellë në radhë të parë njohuri të reja për traditën e hershme kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë, do t'i vlerësojë shkencërisht të gjithë ata përbërës të traditës, që i dallojnë shqiptarët e Maqedonisë si trevë dhe regjion etnografik duke i sintetizuar përfundimisht disa rezultate të punës së

deritashme të folkloristëve. Por kjo nuk do të thotë se punët në këtë drejtim do të marrin trajtën përfundimtare. Përkundrazi, do të jetë edhe një nxitje e re për ta vazhduar punën në këtë drejtim. Ndër shqiptarët e Maqedonisë do të ketë punë edhe në të ardhmen për folkloristët dhe etnologët, sepse tradita popullore shqiptare këtu është ende e gjallë dhe shumica e llojeve të vlerave folklorike e kanë ende të hapur periudhën e tyre produktive. Këtu tradita po kultivohet me shumë sukses dhe me xhelozë të veçantë, por edhe po pëson ndryshime të kushtëzuara normalisht nga rrethanat e reja të jetës së shqiptarëve të këtyre trevave. Kjo traditë edhe brenda ecurive të reja të transformimeve ka nevojë të studiohet në mënyrë më të specializuar si në planin sinkronik ashtu edhe në atë diakronik. Është shumë e nevojshme që të veçohen karakteristikat e veçanta dhe ato të përbashkëta në aspekte më të gjera krahasimtare me trevat apo komunat fqinje dhe përgjithësisht me vlerat e pasurisë sonë të veçantë të traditës kulturore shqiptare dhe në planin më të gjerë kulturor.

I. FESTAT DHE KËNGËT E MOTMOTIT

1. Tradita e festës së Shën Gjergjit në fshatin Pirok të Tetovës

Shën Gjergji në popull merret si ditë kufitare midis dy stinëve të motit- midis dimrit dhe pranverës. Dita e Shën Gjergjit dhe ajo e Shën Mitrit janë marrë si ditë që caktojnë mbarimin dhe fillimin e stinëve. Kështu, për shembull janë folur izmeqarët, punën e kanë filluar prej Shën Gjergjit deri në Shën Mitër ose e kundërta. Izmeqarët janë paguar sipas punës – në dimër vetëm e vetëm për kafshatën e bukës, kurse gjatë verës edhe për fitim. Si të nënçmuar ata kanë fjetur shpesh në grazhde të ahurit, kurse ushqimin e kanë ngrënë ku kanë arritur. Ditën e Shën Gjergjit zakonisht theren pulat për të ngrënë, me qëllim që ajo shtëpi të ketë më shumë pula. Në këtë ditë gjithashtu me ëndje mbillen pemët e reja, sepse besohet se ato zënë me siguri. Përafërsisht deri nga vitet 1970-1975 ose më saktë deri në dalje në qarkullim të frigoriferëve me ngrirje të thellë, me të filluar të ngrirët kanë prerë guleqë-gjedhë të blera ca muaj më parë për mish dimri. Guleqët janë çmuar sipas peshës së dhjemit që kanë lëshuar. Ai që ka pasur gulak më të madh dhe i ka lëshuar më shumë dhjamë fshatarët e kanë quejtur “zotënejë”. Prej mishit të gulakut kanë bërë soxhukë ”rrajpa të ngrypur” dhe mish të thatë, të cilin pasi e kanë vënë të njomë nëpër grypa, më vonë e kanë nxjerrë dhe kanë tharë mbi koftora. Këmbët e gulakut, tashmë të thata, natën e mesit të dimrit zihen dhe bëhen byrjane me bollgur. Këto këmbë të ziera hahen atë natë me qëllim që gjatë vitit anëtarëve të familjes mos t’u therin dhe mos t’u dhëmin këmbët. Dita e Mesit të Dimrit ruan disa rite të Ditës së Mesit të Verës. Para daljes së kombajnave, gruri shihej dhe hidhej nëpër lëmë. Që të hidhej gruri sa më mirë, Ditën e Mjedis Dimrit gatuhet “arempite” prej mielli të misrit, të cilën pasi piquej, e nxirrnin në oborr mbi të cilën luhatnin tërplotën sikur hedhin grurin në lëmë. Edhe natën e Mjedis Dimrit piquet “kungull stambolli” kungull i bardhë, me qëllim që edhe njerëzit e familjes të bëhen të majmë si kungulli. Megjithëse 21 Marësi është Dita e fillimit të Pranverës, në popull kjo ditë llogaritet si Dita e Verës. Me këtë rast zihen kokrra misri me fi dhe gatuhet “ajrempite” me miell prej misri. Tri të enjtet e para dhe tri të enjtet pas Shën Gjergjit merren si **“Të enjtet e mëdha”**. Në këto ditë vajzat (më rrallë edhe djemtë) shkojnë në Rodina (rajon i fshatit tjetër) me qëllim që të kthejnë plisa trolli. Vajzat me këtë

rast shtrihen në kokërr të shpinës për të shënuar shtatin e tyre, kurse shoqja e saj, gërryen dheun me një thellësi deri në 5 cm dhe atë (trollin e gërryer) e kthen mbrapsht duke thenë: **"Për shëndet më të mire!"**. Midis vijave që kanë shënuar shtatin e vajzës, mihet një gropëzë trolli. Nëse në këtë gropëzë të dheut del ndonjë gjallesë: mizë, krimb dheu, etj., do të thotë se vasha në fjalë do të gëzoj shëndet të mirë. Në trollin e mihur të shtatit të vashës thuhet: **"Këtu të mbesin të ligat e të këqiat!"** dhe së largu hidhet ndonjë nga teshat: brez, mintan, këmishë etj., që do të thotë se flaken të këqiat e trupit sa më larg. Në këtë ditë shkohet për të mbushur ujë mineral të gazuar në fshatin Pallçisht apo Reçicë e Madhe. Deri kah vitet 1960 Shën Gjergji është festuar me të madhe. Përgatitjet për këtë ditë vazhdonin me javë të tëra. Të rinjtë e pamartuar zakonisht tuboheshin grupe-grupe të përbëra deri më 10 vetë dhe shkonin shtëpi më shtëpi për të lypur vezë, miell, drithë, tëlyn etj. Gjërat e mbledhura i shitnin dhe blenin për Ditën e Shën Gjergjit sheqer, miell të klasës së parë për të bërë gurabie. Natën e Shën Gjergjit, të rinjtë dhe të rejat së bashku nuk vënë gjumë në sy. Ata natën gatuajnë gurabie, ziejnë vezë, përgatisin ëmbëlsira etj. Vajzat zakonisht mblidhen nëpër familjet, të cilat kanë nuse të zënur. Vajzat këndojnë nusen dhe djalin, kurse nikoqirja së bashku me vajzat tjera përgatisin ushqimin. Ja për shembull një këngë që këndohej në Shën Gjergj nga vajzat zakonisht kur mblidhen nëpër familjet, të cilat kanë nuse të zënur, por kësaj radhe kënga i kushtojë djalit:

*Di bilbila me ni kallaj gruni
 Di bilbila me ni kallaj gruni
 xhi i bone nonës xhi t'përzuni?
 Nauk i bona xho, nauk i bona xho
 Për Bajram e Shëngjergj i lipsha minton.*

Pas darke, gurabitë i ndajnë në sasi të barabarta dhe thyejnë arra që i ruajnë enkas për këtë natë, që të jenë të forta si arrat. Para se të agojë, vajzat fshehurazi dalin në drejtim të arave të mbjellura me gurë e thekër. Në bimët e njoma të drithërave të bukës shkaraviten duke thënë: **"Të rritna si thekra -gruri!"**. Mandej kthehen në shtëpi. Pronarët e të lashtave duke ditur për këto shkaravitje, dalin që me natë t'i mbrojnë arat. Vajzat e lodhura nga ahengjet e pritjes së natës së Shën Gjergjit në mëngjes i zë gjumi. Vonë i zgjojnë nënat ose ndonjë nga shoqet, duke i fërkuar lehtë me degë drunjsh prej arre, që do të thotë: të rriten si drunjte dhe të jenë të forta si arrat. Pasi zgjohen, vishen me rrobat më të reja, i urojnë festën njëri-tjetrit dhe ua hedhin këngëve. Nëpër kopshte vëndojnë borsilog, luhaten nëpër luhaja,

sallanxhaqe etj. Kësisoj dëfrohen deri buzë mbrëmjes.¹ Përafërsisht njësoj si vajzat, natën e Shën Gjergjit e presin edhe të rinjtë - meshkujt. Nëpër fushë të rinjtë ngjiten drunjve pas vezëve të shpendëve dhe i mbledhin nëpër shtëpi. Po ashtu mbledhin ve pulash dhe bunjetë - dalin të shetisin nëpër rrugët e fshatit, duke gjuajtur njëri-tjetrin me vezë. Para Luftës së Dytë Botërore dhe ca vite pas saj, ka qenë zakon që të rinjtë të ndahen në grupe, të armatosen me shkopiinj dhe të zihen midis vetes. S'kanë qenë të ralla rastet e lëndimeve të rënda. Pas viteve 1960 rrahjet janë ndërprerë, po vazhdojnë ahengjet, duke pirë pije jo alkoolike dhe vende-vende edhe pije alkoolike. Tryeza e të rinjëve është tejet e pasur megjithëka që prodhohet në fshat dhe që gjendet nëpër dyqane. Edhe djemtë shkarravitën arave të mjellura me thekër dhe grurë, por jo të gjithë. Këtë sport e përdorin më së shumti djemtë që janë më të dobët me shëndet. Edhe djemtë, njësoj si vajzat, zgjohen duke i fërkuar me degë arrash për të njëjtin qëllim. Fëmijët deri në moshën 6-7 vjeçare nënat e veta i lajnë në mëngjesin e ditës së Shën Gjergjit me gjethe të trendafilave dhe jorgovanëve, duke mos përjashtuar as llojet e luleve të tjera.

Fëmijët madje i veshin me rroba të reja dhe në qafë u varin vargje me thelpinj kungujsh të egër. Amviset gjithashtu këtë festë e presin duke stolisur derët e shtëpisë, mashnës, dhomat etj., me degë të njoma shelgjesh, arash, etj. Gjithashtu, kur standardi jetësor ishte më i ulët, ato piqnin gurabie dhe i ndanin në pjesë të barabarta për tërë anëtarët e familjes. Tash ato vazhdojnë të pjekin gurabie, por për ndarjen e tyre nuk kujdesen. Amviset tërë natën nuk e shuajnë një dritë në shtëpi dhe interesohen që mos të shuhet zjarri në vatër. Në familjet që kanë bagëti, zonja e shtëpisë nxjerr jashtë mutinin, e stolis atë me lule dhe bar, tund kosin dhe tërë ditën e lume e le në afërsi të pusit ose të çeshmës, që lopët të kenë qumësht shumë, njashtu sikur pusi e çeshma. Megjithëse pleqtë dhe plakat këtë herë e lidhin me festa fetare, prapëseprapë mbi të gjitha sundojnë zakonet pagane. Që të kenë shëndet kafshët e shtëpisë, përgatisin "adete" të veçanta. Bagëtitë kur lëshohen për të parën herë në kullotë lëmohen me një kokë vezë prej kokës deri në bisht. Atëherë i zoti i shtëpisë mermëritë lehtas: **"Të bëhi si ve !"** që do të thotë kafsha të jetë e majme, e rrumbillacët si kokrra e vesë. Të njëjtën gjë fshatarët bëjnë edhe atëherë kur kafshët i përcjellin në kullotat e bjeshkëve. Kafshëve të punës: qeve, kuajve etj., ditën e parë të punës, mbi kurriz u hedhin fije kashte me qëllim që puna t'u vijë e lehtë.

Shënoi: **S. Jonizi**, studente - UEJL

¹ Daut Izairi. Piroku i ynë. fq. 176. Shtypi: "AZA-SEsoft", Tetovë, 1996

2. Tradita e festës së Shën Gjergjit në fshatin Çegran të Gostivarit

Fshati Çegran buron nga ajo lashtësi që lindi nga traditat, festat e mëdha popullore dhe zakonet tradicionale. Në këtë fshat më së shumti është festuar festa e Shën Gjergjit, pastaj dita e pranverës, festat e Bajramit. Por interesimi i vrojtimit tonë hulumtues në këtë trevë do të mbetet festa e Shën Gjergjit. Siç dihet kjo festë deri vonë është festuar në mënyra të ndryshme ndër shqiptarët e kësaj treve. Kryesisht kjo festë bie në javën e parë të muajit maj, ku dikurë është festuar dhe shndërruar në kremtim gjithpopullor. Në këtë manifestim kanë marrë pjesë grupe moshash të ndryshme, veçanërisht ato të reja. Kremtimi fillon në mbrëmje fill para fjejes ku në shtrat apo në hastër janë hedhur lule, barëra, e gjelbërime të ndryshme, është stolisur me to krevati prej druri dhe muret e dhomës së fjetjes. Fëminjtë, të rinjtë dhe të rejat, shkojnë tek kroni, lajnë fytyrën, bëjnë kurora prej luleve dhe degëve të buta të shelgjeve, stolisen dhe i vënë në kokë, disa për fat e disa për shëndet individual dhe familjarë, mbarësi, pjelluri etj. Vendi i manifestimit dhe takimit të njerëzve kanë qenë livadhi, kroi i fshatit rrëzë malit, fushat e gjelbërta, përrenjt me shelgje, stanet e barinjve, sidomos tek vatha. Stolisen me lule, gjelbërime dhe degë të posa shpërthyer dyertë e shtëpive, ahuri i lopëve, vathat e deleve, mëtini etj. Qëllimi ynë është që të ndalemi kryesisht në pikat në vijim:

- *Si është pritur nata e parë e Shën Gjergjit;*
- *Si janë mbledhur anëtarët e familjes me më të afërmit e tyre;*
- *Si kanë shëtitur, cilat moshë dhe ku;*
- *Me çka janë marrë atë ditë njerëzit, sidomos cilat moshë;*
- *Çfarë kanë ngrënë me rastin e kësaj feste;*
- *Kur janë zgjuar, në ç'kohë të ditës;*
- *Kur kanë kënduar, në cilën kohë të festës, cilat moshë dhe cilat përkatësi gjinore;*
- *Ku kanë shkuar, cilën kohë dhe ditë, cilat moshë dhe gjini*

Ja si e përshkruan këtë ditë kremteje njëra nga plakat e fashatit Pendije Selmani e cila insistoi me ngulm që emri dhe mbiemri i saj të mos publikohet. Ne pas një bisede të gjatë me te e bindëm se kjo që ajo do na evokojë është me rëndësi të madhe për disa kujtime si ajo e ka festuar Shën Gjergjin me familjen e saj kur ka qenë e re:

- Ni dit' para Shinxherxhit i bojshim ponët e shpejës e pretshim me vuol' të modhe këtë fest', i zishim voet dhe i ngjirosshim boja-

boja, i bojshim hazër ftallojshim konake, zishi kallena, koke që kur të vin' miç të va jepshin.

Kush kishte darsëm në verë ose në dimën i fkatshin cocat për të këndo. Mlidheshim ni grup coca pi të kojshis', feseve tjera, shkojshim ke ajo darsma këndojsim me dahere përjashta që të na xhexhje katondi se kush martohet, a gjemt' mlidheshin kit' me të katondit ene shkojshin në mol agje ndisshin zarme, mblidhshin guma pi çereve i diçshin i fugshin nëpër mol dhe kush e fukte gumën ma larg martoheshte ma frek, ashtu thojshin kusëm osht' bor' i modh dhe ka takat ma të fort'.

Ne cocat masi këndojsim, shëtetshim me çere me kal', para se t'hipshim, mershim shameja i vëndojshim në kreje, dokush me ferexhe muloheshte, që mos na shon' insont' nëpër odh', mershim ka di gjem para që mos na ngase dëkush. Hipshim dhe këndojsim për atë që martoheshte, që na f'katshim t'i bim' sefte daheres se darsma neste në në verë, jo atë natë.

Vashat apo gratë, në këtë ditë i lajnë disa nda teshat që i kanë përgatitur për pajë – për martesë, duke i nxjerrur nga arka e posaçme ku janë të palosura dhe i shpalosin tek gardhi i oborrit në diell. Me këtë rast ata këndojnë:

Notën e Shinxherxhit gjith' notën

Kum qajt', hase

Çerve dilberagës më ka

Me t'pa la, bjere be

Dilber aga bjere do ta lajë

Ostë havaje vronët dilber në dor do t'a thaj.

Kënga në vijim tregon fare qartë se në këtë lokalitet Shëngjergj është kremtuar nga vashat e reja. Kënga tregon nostalgjinë e vashës së fejuar që ka për festimin e fundit të Shën Gjergjit në shtëpinë e babës **“ene simjet do ta ruj' ke baba-o”**, ndërsa në mot **“mo e qera vjet ke dilberaga-o”**:

Oj lulie honmi lulje shelgut-o

Ku do ta rujsh' notën e Shinxherxhit-o

Ene simjet do ta ruj' ke baba-o

Mo e qera vjet ke dilberaga-o

Në një këngë tjetër pothuajse me tematikë të njëjtë bën fjalë për vashën ose nusen e re e cila natën e Shën Gjergjit e ka kaluar duke larë teshat e të fejuarit apo burrit të saj. Kënga tregon për larjen e këmishës së të dashurit të saj, sepse **“Ostë' havaj'e ngrofët në tel do ta thajë”**:

Notën e shinxherxhit gjith' notën

Kum qat', k'mesh trevir i Azbi agës

Më ka met pa la

Bjere be Azbi aga bjere do ta lajë'

Ene simjet do ta ruj' ke baba-o.

(**P. Selmani**, f. Çegran – Gostivar, 2007)

Tu këndo në çere me kal' ka odha gjemt që ishin nëpër udhë fukshin me voe laraske, me voe lajleku, me voe pule, vu fukshin cocave kush kapërcente që t'i shofin gjemt' dhe kanë piskëllo. Kishte dëni coc' që pi çerje zdripte dhe zeheshte, mrapa dashuroheshin me dënjonin ene martoheshte ose hikte.

Vishim në shpe heshim ke deni shpe lujshim loja xoupa, me filxhona, me koke, kush hopte dilte notën nje ke burimi për të mush ujë ose të peshin ka ni bukall. Cëllin e zente xhimin para mirshin bojca ose sirme pi noseve, se i mblidhshin disa ditë para dhe i lishin ka ftera, mershim lule, dimija dënjonën e bojshim nose dhe i thojshim se t'paska hije nosneja.

Kur buheshte pesë sahati i sabahit, dilshim përjashta kpotshim dega shelgu, lule fjalloska, i lajshim sejt' me k'to që të na hiçet mërziya. Dilshim në odhë kur shefshim deni çere me kalë ja fukshim degat e shelgut dhe thojshim mërziyat e meja i shkofshin kalit për ni motmot.

Ato shoçet tjera që fishin në atë sabah i ngreshim vu fukshim ujë dhe vu thojshim t'i fuga mërziyat tej, ato boheshin nervoz pse si kan' ngre ma herët dhe dënnjona idhnoheshte.

I mbushim kazonat me ujë vu fetshim lule mrenda dhe kur laheshim me gjith' lule, i lajshim collët me lule i thojshim ujtj teposh lala termo (të rritet). I lishojshim fjokët, i krefshim, mershim ni gjal me vete, shkojshim ke ni burim që hecte uji, na pritte ai gjali fjokët pak ka fondi që të na reten ma frek dhe thojshim si shkon ki ujtj ashtu të më shkojn' ene fjokët e meja.

Mrapa shkojshim ke moxhja e mershim mutenin e ndrojshim me tela me lule, tu këndo i ndrojshim ene temsejat, okllgijat kit enët e moxhes, ene këndoishim për dënjo që ishte i fejt ose për vllajn' tonë. Masi i ndrojshim, mershim i hajshim voet që i kishim zij ni dit para, bojshim gurubija, voen që e kishim ngjiros ma mer e rujshim kur de vije dënjo ma jabanxhi për t'ja dhon', se a dit' i derdhshim ke 30 koke voe pi n'sabah.

Ka dreka prap' mblidheshin cocat, shkojshim ke deni kuodër, k'potshim disa lule që quheshin kolaça, i varshim n'çaf', thojshim t'na buen façet si kolaça buke, disa me pee të kuç varshin hudra të mos na morin msesh. Masi i varshin k'to hujdiseshin për t'shko dekonnd për t'a festo Shinxherxhin.

Në katounin Çegran dita e Shinxherxhit o festo ma shom' ke Voda, ni mol përball katounit ku buron ujë dhe këto katounarë e kanë thirur "**Voda**".

Ke Voda mblidheshin afër 500-600 njerëz që e festonin, kishte xhipë që u bishin lodrave, kishte njerëz pi katondeve qera.

Aqe lujshtin valle me lodra, shtrojshin qebe, unxheshim, hajshim gurubija, voe, kallena, lujshtim deni loj' me xuopa, diftojshim dëni gaçk, kush e diftonte ma t'mer i ipshin deni xho për ta vesh, dëni mihir, llonçe etj...I mershtim ponët e dorës që punojshin me tëkçe me xhilponë, që i punojshim ojat kush i kishte bo ojat ma të mera ja mershtim irnek ose deni peçet që punoet me tëkçe..

A dëni coc' pi katondi shkojshin me ni katond qetër, ate afër festoheshte, ene atej shom' mer' por disa coca nuk i lishin babat a familjet për t'u largo pi katondi dhe reshin ne Çegran, a disa shkojshin ke "**ujti tharët**" që gjindet në katondin Çajlë...ene atej shom' njerëz pi Çegroni shkojshin, mendojshin se me vërte oshte ujti tharët, ai ishte ujë alis pop se rithte shom kadale dhe shom nolt pi mojës molit dhe i kishte met ujti tharët.

Kishim shom qef ta shom' at' vend, atej duheshte të ecish 2 sahat për të mre njer ke ujti, shom' pëstatshim, mirshim ka ni kov' e mushshim me ujë, i lajshim sejt, mrapa lageshim, ngiteshim me ujë, atej reth ujtit reshim gjat' se s'mon të vishim ene niher, thojshim mas ni motmoti a de vim' mo, sepse denjona martoheshte, fejhoheshte ene e kishin të ndalot' të dalin pi shpeje.

Masi vishim teposh' eceshte me vije shom të hollë që mund të ecte vetëm ni inson dhe prap' na boheshte udha shom e gjat'. Vishim ke vendi ku i kishim lon' qebet dhe dëni coce i jepshim ujë, reshim njer kur të fkase ozoni i akshomit,. Kur vishim për në shpej i thojshim ato që i kishim bo për kit ditën e Shinxherxhit, se kush thonte për vete se une kom kapërce shom' mer', deni shoçe që s'kishte erdh' me ne, ne drejt shkojshim ke ajo t'i diftojm' si kimi kapërcej, ajo ja zente të çeshe, ja qante se shom' baballar' nuk i lishin të shëtesin për ditën e Shinxherxhit.

Vishim në shpe, deni her' vishin dajxhollarët, hallat, tezët, kojshit', kujshdo që vinte bojshim çaj, hajshim xhoja që i kishim bo hazër dëni konak tatli etj. Dhe kjo dit' dojshim të na zgjase shom' se nuk punojshim, nuk shkojshim në fosh', nuk fsheshim, vetëm shëtetshim, hajshim hazer. Po pse e kishim qef, këtë ditë e pretshim me shom dashne t'modhe, me shpert, se ditët tjera nuk dilshim të shëtesim, i bojshim ponët e foshës, ponët e shpejës e nok si ju sh'tahe si nuk dini se çish jon' foshat çish jon' ponët e shpejës, ini mos hazër, me kit kushtet, në at' koh' s'kishim kurxho, vetëm me katër vjet shkollë, ene atë z'dojshin t'ët çojnë n'shkollë. Ju shtehe jeni bo hazgona, as nuk punoni, as nuk festoni festat e mera, e kini harou Shinxherxhin, vetëm shkoni atje ku u pëlçen...Kështu tha plaka 66 vjeçare.

(Informatore: **P. Selmani**, f. Çegran – Gostivar, 2007)

Shënoi: **S. Selmani**, f. Çegran – Gostivar, 24.12.2007

II. RITET DHE ZAKONET POPULLORE QË E SHOQËROJNË LINDJEN E FËMIJËS

1. Ritet dhe zakonet e lindjes

Ritet e lindjes dhe ato të martesës e të vdekjes, inkuadrohen në rite familjare, pasi për bujkun e blektorin e këtyre trevave të gjitha këto janë të lidhura ngushtë me familjen e tij dhe kanë për qëllim përparimin familjar. Kështu, mbarësia, pasuria dhe bëlloku në familjet e bujqërve e të blektorëve, varen në pjesën më të mirë, prej krahut të punës, prandaj sa më shumë njerëz të punojnë aq më shumë prodhim do të ketë një familje. (**Historia e letërsisë shqipe I-II, 1968:39**) Dihet mirëfilli se shtimi i familjes bëhet me lindjet dhe martesat, me nuset që vijnë në shtëpi. Ndërkaq, krah pune i sigurtë për familjen blektorale-bujqësore është konsideruar mashkulli, pasi femra martohet e shkon në shtëpi të tjetrit.

Zakonet e lindjes janë shumë të vjetra dhe i takojnë stadi të paganizmit. (**Agani H, 1963:50**) Ndër to gjejmë edhe sot e kësaj dite shenja të origjinës së tyre. Fetë e reja, krishtere dhe islame, sado që kanë prekë e kanë ndikuar në ritet e lindjes, prapëseprapë nuk ia kanë dalë në krye ta zhdukin elementin pagan, i cili madje edhe në disa treva dominon. Përkundrazi, ninullat apo ninanënat, me gjithë mbeturinat e lashta, përsëri gjithherë janë më aktuale, janë të lidhura më ngushtë me jetën dhe mpleksin vetvetiu çdo element të ri që duket në shoqëri.

Shtimi i familjes bëhet me lindjet, martesat, nuset që vijnë në shtëpi. Në kohën kur nusja mbetet shtatëzane urimet kryesisht janë bërë për lindjen e një djali, sepse në atë kohë ka qenë një mburrje e madhe për familjen dhe për shtëpinë që femija i parë të jetë djalë.

urimet në kohë të shtatzanisë janë bërë kryesisht për djalë. Mirëpo, kur ka lindur vajzë, kanë uruar: "**Ene me gjem mrapa!**"

Motrat këndojnë të emocionuara për çiftin e ri bashkëshortor, **mbetjen e nuses shtatëzane** duke manifestuar gëzimin e tyre se shumë e re ajo do bëhet nënë. Po kështu këndojnë dhe për vëllain e tyre i cili shumë i ri do bëhet baba:

Bilbili në lom

Bilbili në lom

Shom e re nausja jon'

Do na bohet non,

*Bilbili në arë
Bilbili në arë
Shom i ri vllaj jonë
Do na bohet bab’.*

(Bilbili në lom)

Kur ndonjë **nuseje i ka lindur vajzë** të gjithë e kanë shikuar të inatosur. **(Frashëri S., 1936:30)** Ka patur raste kur nga inati që ka lindur vajzë e kanë dëbuar nusen nga shtëpia dhe ka ardhur gjer në ndarje të çiftit bashkëshortor.

Kur ka lindur vajzë e kanë uruar **“Ishalla me ni gjal te vogel”**. Thonë se që në momentin kur nusja e ndjen barren, njeriun që e ka patur afër qoftë mashkull apo femër do t’i ngjajë femija.

Në çastin kur lind fëmija lajmin e parë e jep mamia apo siç e quajmë dhe tani në gjuhën popullore **Avonenja**. Pas mamisë lajmin e shpërnda nëpër gjithë lagjen dhe farefisin ndonjë femijë. Në momentin kur ai e ka dhënë lajmin si shpërblim i japin para. Lehona e posalindur në qoftë se nuk ka patur shumë qumësht të mjaftueshëm i ka jep gjë ndonjë grua tjetër e farefisit. Lehona 40 ditët e para nuk del askund nga shtëpia dhe nuk punon asgjë.

Gëzimi për lindjen e djalit i shprehur përmes këngës së motrave që ndjejnë një kënaqësi të veçantë me këtë rast. Bilbili është simbol i bukurisë së djalit të pasalindur. Kënga përcillet me një entuziazëm të papërshtatshëm të derës së madhe të shtëpisë, i familjes dhe farefisit në tërësi. Ja se ç’thotë kënga:

*O bilbil në arë
O bilbil në arë
Shiqir vllajt ton na o lije ni gjal
O bilbil katil
O bilbil katil
Kur o lije gjali jonë kimi bo shiqir
Kimi bo shiqir
Kimi bo shiqir në degë të arës
Na o hijeshau shpaje babës
Kimi bo shiqir në degë të thanës
Na o hijeshau shpaje nonës.*

(Bilbili në arë)

(Shënoi: **N. Asani**, f. Kalisht, Gostivar)

Fryti i dashurisë së një çifti bashkëshortor është lindja e fëmijës. Fëmijët janë ata që i japin një kuptim të plotë jetës bashkëshortore dhe fjalës familje. Në këtë punim do të japim një përshkrim me sqarime që u përket riteve të lindjes në kohërat e mëparshme, pra kohën e gjysheve dhe stërgjyshërve tanë.

2. Zakoni i prerjes së kërthizës tek fëmijët e posalindur dhe pagëzimi i fëmijës

Kërthiza fëmijës para shumë dekadash është prerë me vegla të ndryshme, si zakonisht me ato vegla që janë gjendur në shtëpinë e familjarit. Një gjë e tillë është bërë me anë të briskut të rrojës ose me kosë kur ka lindur djalë, me gërshërë apo drapër kur është lindur vajzë, duke besuar se ata do të bëhen punëtorë të mirë, korrtarë apo korrtare të mira. Domethënë se menjëherë pas lindjes, fëmijës i është prerë kërthiza. Këtë detyrë zakonisht e ka ushtruar ndonjë plakë me përvojë. Nga intervistat që janë bërë nëpër vise të ndryshme rurale me mosha të vjetëra, sidomos plaka dhe pleq, është konstatuar se kur fëmija ka lindur në shtëpi kërthiza i është prerë me brisk, ndërsa në qoftë se femija ka lindur në arë, kërthiza i është prerë me drapër. Prerja e kërthizës së fëmijës në fshatin Veshallë është bërë në këtë mënyrë: ajo plakë e cila e ka prerë kërthizën e fëmijës, këtë e ka matur tri gishta duke filluar nga barku dhe e ka lidhur me pe, pastaj në atë vend ku e ka lidhur ia ka prerë kërthizën. Pas kësaj peri ka qëndruar në kërthizë 7 ditë dhe vetvetiu kërthiza kur është tharë është shkëputur nga barku i fëmijës. Thonë se nëse fëmija ka qenë mashkull, atëherë kur do të rritet, ditën që do të bëhet dhëndër do t'ia japin kërthizën e vet që ta hajë.

(M. Muaremi, f. Veshallë, Tetovë)

Pagëzimi i fëmijës si zakonisht është bërë në bazë të emrave të gjyshërve apo stërgjyshërve që kanë vdekur me qëllim që ato emra mos të humbasin. Për pagëzimin nuk kanë vendosur vetë prinderit por të tjerët.

Larja e parë e fëmijës është gjithashtu një moment shumë i rëndësishëm ku besohet se do të ndikojë gjatë gjithë jetës së fëmijës. Ujin e kanë bërë me kripë me qëllim që t'i digjen puçërrat dhe të bëhet i shijshëm si kripa. Në ditën e parë kur fëmija lind bëhen petulla dhe ua ndajnë të afërmve. Të posalindurit ia presin kërthizën me brisk rroje.

Pas 40 ditëve lehona ka mundur të del nga shtëpia. Në shtëpinë e parë që ajo është futur, njerëzit e asaj shtëpie i kanë dhënë buk që të mos i përndjekë fukarallëku dhe tu hiqen minjtë nga shtëpia, ndërsa fëmijës i kanë dhënë vezë që të jetë i bardhë dhe i rumbullakët si veza.

(N. Jonuzi, f. Dobërdol, studente - UEJL)

3. Këngët e djepit dhe të fëmijëve të posalindur

Që ta merr fëmijën gjumi nënat u këndojnë ninulla të ndryshme. Ninullat janë këngë që dalin nga zemrat e nënave apo gjysheve, duke u dëshiruar fëmijëve të tyre gjumë të ëmbël, jetë të gjatë.

Ninulla e thirrjes së gjumit të ëmbël për marrë djalin, i cili vjen kah livadhi. Nëna e thirr gjumin jo vetëm që foshnja e saj të flej por edhe për tu rritur. Kur do të zgjohet, nëna do t'i japë përshesh me tëmbël:

*Hajde xhumo ka livadhi
Gjalin ton' të ma marish
Hajde xhumo, xhumi omël
Do i buj gjalit përshesh me tomël
Hajde xhumo ka shetajtën
Gjalin ton' o pse e rajtën.*

(Hajde xhumo)

Shënoi: N. Asani, f. Kalisht, Gostivar

Ninulla thirrja e gjumit që ta zërë fëmijën krahasohet me ëmbëlsirën e llokumit me sheqer dhe me arra, që njëherit simbolizon dhe bukurinë e fëmijës. Nëna duke dashur ta mashtrrojë djalin për të fjetur i këndon gjumit i cili vjen kah mulliri e bashkë me të dhe fëmijës së saj që ta zërë, se i ka ardhur mu tek syri. Po kështu ajo vepron me thirrjen e njëjtë me gjumin që është duke ardhur nga Vardari dhe i është afruar djalit mu tek balli. Ja ca vargje të ninullave që më së tepërmi janë kënduar:

*Hajde xhumo xhum'
Sheqer e llokum
Llokumi me ara
Di dale dilberit përpara
Hajde xhumo ija - ija
Merma gjalin me kobija
Hajdo xhumo ka mullajni
Ija djalit mun ke sajni
Hajde xhumo ka Vardari
Ija gjalit mun ke balli.*

(Hajde gjumo)

(N. Jonuzi, f. Dobërdol, studente - UEJL)

Kënga "**Luli-luli n'gjep pi druni**" tregon përkundjen e djalit në djep prej druri, duke i dëshiruar nëna djalit të saj kur të rritet të bëhet plak katundi, simbol i mençurisë, urtësisë dhe kuvendimit. Gjithashtu nëna gjatë përkundjes e thërret gjumin për djalin e saj duke i sjellur dhe leblebija. Gjumi është afruar diku tek mulliri, domethënë i ka ardhur djalit mu tek syri. Ndërsa kur e

thërret nëna gjumin te Vardari, tregon se djalit i ka ardhur mu te balli. Ajo e pyet gjumin ku ka vajtur, mos vallë e ka harruar djalin e saj? Tani e thërret sërish gjumin e ëmbël që t'i sjelli djalit përsesh me tëmbël:

*Luli-luli n'gjep pi druni
Do d'boj nona pjak katundi-o
Ajde xhumo ija - ija-a
Bjeri gjalit ilbibija.
Ajde xhumo ka mulleni
Ija gjalit m'un ke seni
Ajde xhumo ka Vardari
Ija gjalit m'un ke balli
Ajde xhumo ka ke shkojve-o
Hasan agën mos ma harojve-o
Ajde xhumo xhum i omël-o
Bjeri gjalit keksa me tomël.*

(Luli-luli n'gjep pi druni)

Kjo këngë djepi përshekruan dëshirën e rritjes së djalit duke e krahasuar me shiun rosa-rosa dhe me rritjen e djalit si kullosa. Këtu kemi një paralelizëm të qëlluar se si kullosa rritet nga kushtet klimatike, kurse djali rritet nga sevdaja, ose kullosa rritet nga shiu, ndërsa djali rritet nga mallëzimi.

*More bir sheni rosa- rosa-o
Retet Hasan aga si kullosa-o
Kullosa mi retet pi havajës-o
Hasan aga retet pi sevdejës-o
Kullosa mi retet pi shenit-o
Hasan aga retet pi mallzemit-o.*

Shënoi: **S. Selmani**, f. Çegran, Gostivar

Të kënduarit e ninullës për ta marrë djalin gjumi i cili vjen nga Vardari duke i bërë djalit të vogël dritë te balli, apo nga mulliri i cili i bën dritë te syri:

*Hajde xhumo ka Vardari ija
Gjalit drit ke balli
Hajde xhumo ka mulleini
Ija gjalit drit ke seni*

Ninulla përkundja me djep prej druri dhe dëshira për t'u bërë plak katundi i cili simbolizon njeriun e mençur dhe të parë të fshatit:

*Luli luli nona gjalin
E përkondi në gjep pi druni
De vej nona pjak katondi.*

Shënoi: **V. Dauti**, f. Çegran - Gostivar

Ninulla e dëshirës për rritjen e djalit nga një pëllëmbë për çdo ditë, të ushqyerit të nënës me banane dhe babait me simita dhe ta ruaj Zoti:

*Rajtet gjali jonë rajtet
O ju lumshin durët kush e rajtën
E rajtën nona me banone
I lutna zotit të na e lone
E rajtën baba me simita
E rajtën allahi
Ka ni pllom përdit.*

Përshtkrim i bukurisë së djalit që krahasohet me pëllumbin, rritjes së flokëve të krahasuara me mëndafshin:

*More vllaj jonë
O more gugash
Ato fjokët tauja
Si doni mundash
Nuk jon' mi mundash i shehrit
Jon' fjokët e gjalit ton' dilberit.*

(More vllaj jonë)

Shënoi: **N. Asani**, f. Kalisht, Gostivar

Ninulla për rritjen e djalit, dëshira për trup të shëndoshë dhe për ta bërë synet:

*Luli luli nona gjalin
Shtatin si edek të më retet
Ta bij sinet.*

Ninulla për rritjen e djalit, dëshira për ta shëtitur në krah, përkundja me dëshirën për trup të shëndoshë shtatin si fidan se është djalë i vetëm me shumë motra:

*Luli luli nona gjalin
Nona gjalin do ta reti
De mor n'kra dë ta shëteti,
Nona shtatin si jedek
E përkondi e kom hasret
E përkondi shtatin si fidan
Se qietër gjal nona nok kam.
E përkondi e kom hovardar,
Se k'to motrat qietër vlla nok kan.*

Ninulla e përkundjes së djalit me dëshirën që të rritjet sa më parë, të shëtisë kah mejdani, të arrij nëna ta martojë se motrat e kanë vëlla për mallë, me trup të shëndoshë:

*Luli luli gjalin frek tëm retet
Ka Majdoni tëm shëtetje
E përkondi nok e lëshoj
Njehi nona ta martoj.*

*Ta martoj e kom hovardar
E kan motrat vlla për moll
Ta martoj shtatin si hedek*

Ninulla e përkundjes së djalit në djep me drejtimin kah xhamia, gëzimi i shtëpisë dhe familjarëve me lindjen e tij, me dëshirën që të rritjet shpejt, të shkojë tek daja dhe tezja, të shëtisë kah mëhalla dhe medrezeja:

*Luli luli gjalin ka xhameja
O g'zo nona o g'zo shpeja
Do shëtesim gjalin ka muhalla
Të na retet të na shkoj ke daja
De shëtesim ke medrezja
Dë na retet dë shkoj ke tiezja.*

Ninulla e dëshirës së nënës që djali i vetëm të rritet ndër dy lale e lule si leblebija dhe drita, të ketë mjedis të hollë, të shkojë në qytet në Gostivar dhe Tetovë, të shoqërohet me shokë, të shëtisë gjëkund nëpër male, të martohet me një nuse si drita që të habitet fqinjësia, me dasëm të madhe me muzika, t'i këndojnë motrat fodulle:

*E res nona gjalin ovardar
E res nona do çoj në Gostivar
E res nona gjalin mjedis holl
Të më rëttët të më shkoj në Tetovë
E res nona gjalin hasret
Të më retet të më shkoj n'qytet
E res nona gjalin nëpër qoshe
De martoj me shok e me shoqe
E shëtët nona nëpër male
Dë ja buoj darsmën e madhe,
E res gjalin si alitreka
D'ja boj darsmën si alitrika
D'ja boj darsmën me muzika ,
D'ja mor nosen si alitrika
E res gjalin si elbebija
D'ja mor nosen de çuditet kujshija
E res gjalin ndër di lale
Këndojn motrat ovardare*

*E res djalin ndër di lule
I këndojn motrat fudulle.*

Ninulla e dëshirës së nënës që djali të rritet, të ketë shtatin e fortë, të arrij t'a dërgojë në kurbet për të fituar, për t'u kujdesur për nënën dhe babanë, të arrijnë ta martojnë, nusja të kujdeset për prindërit, t'u bëjë atyre kafe, të pastërojë shtëpinë:

Reta gjalin nona shtatin si jedek

*Njehi nona ta çoj n'gurbet
 Gjali të fitoje
 Nonën babëm t'a çëlloje.
 Nonën babën unë di çëlloj
 Ater nona gjalin de martoj
 Shtatin si edek tam
 Or nosen të na boj izmet
 Nosja gjalit t'i ijet shelafe,
 Në saba të në bjer kafe
 Ene kafen dë ta boj
 Vjerit e vjerës do ja çoj
 Nosje gjalit të më jet shelafe
 Ene shpejën të ma çistase*

Këndoi: **S. Veseli**, f. Çegran - Gostivar

Shënoi: **V. Dauti**, f. Çegran – Gostivar

4. Ninullat në fshatin Xhepçisht të Tetovës

Këngët e djepit ose nina-nënat janë këngë që e ëma i këndon fëmijës. Ato përshkruajnë kryesisht dëshirat e saj dhe të familjes. Me anën e tyre nëna shpreh ëndërrat për të ardhmen e të lindurit apo të lindurës, pra i këndohen njësoj si djalit ashtu edhe vajzës. Këto gra të talentuara, përmes vargjeve, fjalëve të matura, me rima të ndryshme përcjellin porosi të ndryshme. Nënëat zakonisht kur këndojnë urojnë që fëmijët e tyre të bëhen të fort, që të punojnë në ara pa u lodhur fare, këta urime ishin për djemt, kurse për vajzat, uronin që të bëheshin të bukra sy zeza, belholla etj. (**Agani H., 1963:53**)

Me ninullat dhe me këngët e tyre fëmijët kënaqen, dëfrehen dhe çlodhen. Duke i dëgjuar nina-nanat, foshnjat qetsohen sepse ato ua ndjellin gjumin i cili i përkund si vala e detit.

Në ninullat, qëllimi kryesor i nënës është që t'a përkund foshnjën për ta zërë gjumi, që ai të rehatohet. Ajo këndon kështu:

*Hajde more xhum ka shutajtën
 gjalin tem t'ma rajtish.
 Xhum more xhum taj ka shkove
 gjalin tem të vogël e harove.*

Nëpërmjet interesit për të ardhmen e lumtur të fëmijës, nëna ka shprehur ndjenjat më të ngrota që i biri të bëhet i pari në kantund dhe t'i bëhet i aftë për kuvend:

*Kuni kuni nana gjal katundi
pishi -pishi nana gjal fildishi
nani-nani, nani-luli
birin ta zane gjumi
gjumi amël si tamël.*

Edhe për vajzën dëshirohet që të rritet e të bëhet e madhe. Të jetë më e mira ndër të mirat. Nëna e krahason vajzën e saj me lulet e kopshtit, pra dëshiron të jetë e hijeshme:

*Nani-nani, luli
caucën teme të ma mare gjumi
tu boft sajni si filxhan
ene vetlla si gajtan*

Një këngë tjetër që këndohet është:

*Nani-nani, nani-luli
Bijën të ma zane xhumi
xhumi amal si tamël
Me ni lule bijën e ze xhumi
Luli-luli-luli bijën e nanës o*

Gjatë hulumtimit tonë nëpër këtë trevë, të themi të drejtën këta këngë na bënin të ndjejmë një kënaqësi të madhe. Edhe pse kohën tonë kur ne kemi qenë në djep nuk mund ta kujtojmë, këtë mund ta bëjnë vetëm nënat tona. Mirëpo me moshën që kami tani, këtë punë të zellshme që jemi duke e bërë, na bën që veten tonë ta vëmë në djepin e nënës duke imagjinuar vetveten sikur të ishim të vegjël. Nostalgjia dhe kureshtja e madhe, na shtynte diçka thellë në shpirt të pyesim dhe interesohemi edhe më tepër për ninulla tjera të bukura:

*Luli luli gjep pi druni
do të boj nana pjak katundi.
Xhum more xhum ka shutajtën
gjalin e vogël e ma rajtën*

Nërsa një tjetër këngë uron që djali të flej se nëna e ka të parin në atë nahi. Të bëhet i madh si dushku:

*Fij gjali nanës fij
të ka nana gjal nahij
të më bëhesh i madh si dushku në jahi*

Ninulla për thirrjen e gjumit të vajzës së vogël, të rritet e të bëhet e bukur si lulja e verës, ta ketë syrin si filxhan, me gushë të bukur dhe shtatin si bajrak:

*Nani-nani , luli
 cacën teme të ma mare gjumi
 u bafsh si ni lule në ver
 tu boft' sajni si filxhan
 tu boft' gusha për merak
 tu boft' shtati si bajrak.*

Shënoi: **F. Jakupi**, f. Xhepçisht, Tetovë

Vlen të përmendim, se nëna shqiptare edhe pse e paarsimuar, me rastin e këndimit të këngëve të djepit është treguar si një psikologe e mirëfilltë. Këtë fakt e vrejme në këngët ku nëna me mjeshtri të rallë, me shpreje popullore dhe poetike të zgjedhura, pa e trembur dhe pa e frikësuar e vë foshnjën e saj në gjumë.

Përkundrazi sot në ndonjë rast të rallë ndeshim në ndonjë nënë të re që preferon ta vë foshnjën e saj sa më shpejt të fle, duke e frikësuar atë e duke i thënë se nese nuk fle do ta haj kjo apo ajo egërsirë.

Kur rritet djali, i mbath këpucët e del në mejdan, babai e merr për dore e shpie në dyqan për t'i blerë sheqerka a bombone, por ai s'don as sheqerka as bombone se e malisin, por don akulllore se e flladitën:

*Vajshi kundrat gjali jonë
 E dul në majdon
 E kapi babi për dore
 E çoj në diqon
 E pajtën gjalin ton' xhi don me ngron
 A sheqer a bombone,
 A hallv' a terhon
 Z'du sheqer e bombon se më malitën
 Du ni akullorre se më flladitën.*

(Gjali jonë)

Në qoftë se fëmija nuk ka mundur të merr guximin të ecte, ka patur frikë, e kanë nxjerrë në një udhëkryq, kanë marrë një pe të kuq dhe e kanë prerë me qëllim që t'i pritët frika dhe të fillojë të ecë.

Kënga mbi gugatjen, llazitjen dhe belbëzimin e parë të djalit që krahasohen përmes katër simboleve kryesore të jetës, siç janë drapëri, dita, drita dhe kënga:

*Mori karahone si drapën
 Shajfnja gjalin ton' si gugatën
 Mori karahone si ditën
 Shajfnja gjalin ton' si llozitën
 Mori karahone si ndriçon
 Shajfnja gjalin ton' si këndon.*

(Gjali jonë)

Shënoi: **N. Asani**, f. Kalisht, Gostivar

Momentin që i mbijnë fëmijës dhëmbët e parë, kush ia sheh i pari e ka patjeter që t'i blejë një këmishë.

Thonjtë kur ia kanë prerë për së pari herë ia kanë marrë dhe ia kanë hedhur përreth xhamisë, me qëllim që ai ose ajo të jenë fetar. Kanë besuar se fëmiu merr mësysh. E kanë veshur me rroba të pista ose u kanë varë nga një sy që të mos vuajnë nga syri i keq.

5. Gruaja shqiptare në imagjinaren e folklorit religjioz

Eshtë e njohur se magjitë në folkloristikë konsiderohen si krijime gojore, formula magjike verbale, të cilat në sytë e të paditurit kanë fuqi të fshehtë magjike. Në folkloristikën e shqiptarëve në Maqedoni por edhe në disa shtete ballkanike magjitë kanë mbetur thujtë të pastudiuara të themi fare, edhe pse që nga shekulli i kaluar, në kohën e Rilindjes, shumica e mbledhësve të krijimeve popullore i kanë mbledhur dhe përshkruar në mënyrë jo sistematike dhe pa ndonjë kriter të caktuar.

a) Magjitë e grave në krijmtarinë popullore shqiptare

Në të kaluarën magjitë kanë qenë privilegj i burrave. Me kohë këtë rol e marrin gratë dhe dalngadalë ua kanë marrë rolin udhëheqës burrave. Ky fakt vërtetohet në magjitë shqiptare dhe ato maqedonase, ku sot vetëm gratë merren me to. Ndeshim raste fare të rralla të merren me magji, siç bie fjala disa priftërinj dhe hoxhallarë.

Për shembull për përmirësimin e disa marrëdhënieve në



martesë, vetëm gratë kanë përdorur magji që është një fakt interesant. Ekzistojnë shumë raste që për shkaqe religjioze ose bestytnie, të paraqiten dy lloje gjuhësh, thuajse krejtësisht të ndryshme veçanërisht tek gratë. Fallxhoret dhe magjistaret përdorin disa fjalë të pakuptimta, derisa shikojnë fall dhe bëjnë magji. Elemente të këtilla te popujt ballkanikë janë si rrjedhojë e elementeve të magjive së Lindjes, të bartura bashkë me mjeshttrinë e fallit dhe magjisë. Ato janë dhe konsiderohen për rrethin gjithmonë të pakuptimta. Gjithashtu janë të rëndësishme edhe gjuhët speciale të tyre, të cilat janë ruajtur si gjuhë të feve dhe të ritualeve të ndryshme religjioze. Kështu gratë që parashikojnë fatin, zotërave u drejtohen me gjuhë që nuk është e (përditshme) e zakonshme për vetë popullin, domethënë kanë fjalor special dhe fjalor tjetër me të cilin u drejtohen këtyre.

b) Klasifikimi i magjive

Në përgjithësi magjitë bëhen individualisht ose në mënyrë kolektive. Magjitë përdoren për raste dhe nevoja të ndryshme të njeriut në jetë. Sipas botëkuptimeve, përfytyrimeve, lakmive ziliqare të sëmura, këto bëhen apo përdoren për të sanuar, për të arritur një gjendje të dëshiruar, për t'i krijuar tjetrit një plagë, një të keqe, një fatkeqësi, ose për të shëruar një gjë të tillë. Sipas kësaj del se magjitë si të tilla ndërmerren nga dora dhe syri i lig dhe i kiiq i njeriut apo e kundërta e kësaj:



- a) magji për sëmundje
- b) magji për fatkeqësi atmosferike
- c) magji për veprim mbi pronën
- d) magji të tjera.

Shënoi: **N. Asani**, studente – UEJL

III. KËNGË SYNETIE

Kënga paraqet ardhjen e berberit te oborri për ta bërë synet djalin i cili qëndron në prehër të nënës dhe se lëshon dot nga prehëri. Nna duket se nuk dëshiron që djalin t'ia dorëzoj berberit pasi nuk i beson dorës së tij:

*Mori vin berberi termo lomës-o
Hasan aga në prenin e nonës-o
Nona pi preni se lishonte-o
Berberit teslim s'un ja bonte-o
Dorën e berberit se besonte-o.*

Kënga pasqyron një pjesë të ceremonialit të synetisë, kur djalin e shëtisin dajallarët me kal me shalë, të cilët janë fort të pashëm dhe e darisin nipin e tyre me florinj:

*More Zaim aga hip kalin me shal
Do t'morëm përpara ni trom' dajollar
Ni trom' dajollar kit për hije-jo
Secëlli do fugje mendurije-o.*

Ardhja e berberin duke thirrur që derën t' ia hapë djali që bëhet synet. Derën nuk e hap pa e pyetur babanë, pasi ky ka dhe një vëlla tjetër për synet dhe për këtë duhet pyetur xhaxhai:

*Mori vin berberi rak e tak në der,
Haj çilma derën e modhe o Semir dilber
Derën s'un ta çeli pa pet babën-o
Ma të modh e kena Albin agën-o
S'un ta çeli derën pa pet xhulin-o
Ma të modh e kena Semir xhulin-o.*

Kjo këngë bën fjalë për merakosjen e djalit para bërjes synet dhe lutjen e nënës që ai të bëhet gati e t'i krehë flokët. Gjithashti nëna e lut që ta vë stolisjen e arit dhe të mos qaj se nuk do t'ia shohë lotët, as t'ia dogjëjë zërin:

*Haj be Zaim aga krefi fjokët-o
mo qaj non' ate t'i shofe lotët-o
haj be Zaim aga ven alltonin
mo qaj nona të ta xhexhe zonin.*

Kur djalin e hipin në kal dhe e shëtisin kah Senakosi, ky u lutet nuseve të dajallarëve që t'i këndojnë gjatë gjithë kohës sa është duke shëtitur. Ndërsa kur hipi në kal e vajti kah Gostivari, tani do tu lutet tezeve që të këndojnë pa u ndalur fare derisa ai të kthehet: *Hip kalin Besmir aga shkoj ka Sanakosi*

*u lutem dajcave meja kojkat mo m'i sosni.
Hipi kalin Besmir aga shkoj ka Gostivari
u lutem tezeve meja kojkat mo mi nalni.*

Djali i ankohet nënës se është duke plasur nga sikleti, se do ta shëtisin dajallarët me qerren me dërrasa që është plot me glasa. Po kështi djali i ankohet nënës se do ta shëtisin dajallarët me qerren e kuqe e cila është e vogël si guguçe:

*Thot' Besmir aga oj nono mi pjasa oj nona mi pjasa
d'om shëtesin dajallarët me çere me drasa, çerja pjot me glasa
Thot Besmir aga oj nono mi nuçe oj nono mi nuçe
d'om shëtesin dajallarët me çeren e kuçe çerja si gogufçe.*

Kënga përshkruan bukurinë e djalit i cili do bëhet synet në hotel. Vargu tjetër thotë se djali është i veshur si sulltan dhe do të bëhet synet në restorant. Vazhdon me refrenin se është duke zbardhur drita dhe do bëhet synet me muzika:

*Besmir aga si dilber-e oj lule oj lale
De boj sinet në hotele oj lule oj lale
Besmir aga si sultan oj lule oj lale
De bojm' sinet n'restorane oj lule oj lale
Besmir aga zbardhi drita oj lule oj lale
De bojm' sinet me muzika oj lule oj lale.*

Përshkruhet berberi para shtëpisë duke qëndisur fesin e zotërisë. E pyesin djalin se ku është nisur? Bëru gati se vjen berberi dhe dili para. Motra e djalit që bëhet synet thotë se një berber është përpara votrës duke qëndisur fesin e vëllali motrës:

*Nji berber m'un përpara shpis'
T'uj qendis fesin e zotnis'
Ku m'je nis be dilber Zaim aga
Haj se vin berberi hajde dili para
Nji berber m'un përpara votrës
T'uj qendis fesin e vllaut motrës
Ku m'je nis be dilber Zaim aga
Haj se vin berberi hajde dili para.*

Kënga përshkruan gëzimin e madh që ka nëna me rastin e bërjes synet të djalit të saj. Ky akt ceremonial zhvillohet në një ambient të bukur të bahçes me limona e portokalla. Nëna është tejet e lumtur, asaj i gëzohet zemra, goja i këndon:

*Ni bafçe me portokalla
Me limuna mrenda nones
Ylber agës-o i gëzoet zemra,
Zemra i gëzon, goja i këndon
Lumja-o e lumja-o
Gjalin sinet e bon.*

Këndoi: **H. Ameti, P. Selmani**, f. Çegran, Gostivar.

Shënoi: **S. Selmani**, f. Çegran, Gostivar

Kënga popullore “**Agim aga sa i vogël ije**” ravizon figurën e djalit të vogël nga i cili kërkohet ta thërrasë berberin për ta bërë synet. Berberi edhe kur vjen dhe kur shkon, gostitet me sheqrpapare. Ky duke ardhur lamës për ta bërë synet, djali qëndron në prehër të nënës. Kjo nga prehëri se lëshon dot pasi nuk dëshiron t’ia dorëzoj aq lehtë berberit. Ka frikë për birin e saj dhe i lutet Zotit që ta kalojë lehtë këtë sfidë. Djali i saj herë quhet aga e herë lule, pasi është i veshur me pallto e pantallone. Vashat i këndojnë duke e krahasuar me bilbilin dhe duke e porositur që mos të trembet kur e merr daja për ta furur në dhomë tek berberi, pasi ai nuk do t’i bëjë asgjë vetëm se synet:

*Agim aga sa i vogël i’je-o
Thëire berberin të vëije-o.
Berberi de hype e de dal-o
De t’i apim konak sheqerpapare-o.
Mori vjen berberi termo lomës-o
Agim aga në prehnin e nonës-o,
Nona pi prehni se lishonte-o
Berberit teslim s’un ja bonte-o.
Nona pi prehni da lishone-o
Berberit teslim de ja bone-o
Sollde Agim aga t’na shputoje-o!
De ta bojm synet Agim agën-o
De ta bojm synet përmi lule-o
M’i gzoftsh be Agim aga setre e pantulle.
Bylbyli n’jarem, bylbyli n’jarem
Hajde be Agim aga, hajde mos u trem
Se nuk t’boj daja-o asni sen
E kom pru daja berberin të t’boje synet!*

(Këndoi: **H. Sejfulla-Reçani** nga Gostivari)

Kënga “**Dë ta bojm sinet Gajur Agën**” përcillet me dajre. Bën fjalë për rrjedhën e synetisë, për derdhjen e gurit dhe mbledhjen e tij nga tezet. Kur do bëhet synet, gurin sipas traditës do ta plasin motrat duke thërritur të gjitha me radhë. Pasi bëhet synet djali atë e dërgojnë tek xhamia. Ky i porosit motrat që ta këndojnë dhe të lozin. Motrat e këndojnë vëllain e tyre se kur do ta bëjnë synet do ta dërgojnë tek tezja duke e veshur me pantallone kadife e këpucë të zeza:

*Dë ta bojm’ sinet Gajur agën,
Për sinetin e Gajur agës
Gurin dë ta derdhim
Kit tezet e Gajur agës
Me ren dë i mledhim.*

*Dë bojm' sinet Gajur agën
Gurin dë ta pjasim
Kit motrat e Gajur agës
Me rend dë t'i fkasim.
Dë bojm' sinet Gajur agën
Da çojm' ka xhamëia
Të m'këndoni e tëm luni
Oj motrat e moia!
Da bojm' sinet Gajur agën
Dë ta çojm ka tezja
Me pantulle has kadife
Me kundra të zeza.*

(Këndoi: **F. Ramadani**, f. Kalisht - Gostivar)

Kënga “**Or bilbil firak, or bilbil firak**” përcillet me dajre kënduar nga vashat për djalin që bëhet synet. Figura e tij krahasohet me bilbilin. Djali i thotë nënës se paratë e berberit s’duhen llogaritur se çka të dëshirojë ai do t’i japë. Ai i mbath këpucët dhe del te xhamia duke i porositur motrat që t’i këndojnë me gjithë zemër pa pushuar se do ua lëshojë telat gjer në themër e krah më krah. Motrat i këndojnë vëllait me epitetin bilbili në çadër duke e porositur që mos të frigohet se Zoti i ndihmon në synetllëk. Djali kërkon nga nëna që t’ia hedhi bohçellëkun, kjo bohçellëkun nuk e llogarit fare, por nuk ka guxim t’ia dorëzojë djalin berberit. Në fund nëna dhe bohçellëkun do ta nëkojë dhe djalin berberit do t’ia dorëzojë:

*Or bilbil firak-e, or bilbil firak
Paret e berberit, nono, mo mi bon hesap.
Paret e berberit, non', mo mi bon hesap
Ç'të doje shpëirti berberit oune dë t'i ap
- Veshi koundrat Nagip aga e dul ka xhamëia
- Të m'këndoni mo pushoni aj motrat e meia!
Ene të m'këndoni me xhith zemër-o
Dë va lishoj telat njer në themër-o,
Ene të m'këndoni me xhith ishtah
Dë va lishoj telat-o krah më krah.
- Bilbili në çadër, bilbili në çadër
Mos u freik be Nagip aga se allahi kadër
Se allahi kadër sinetllokun
- Fugma mori nono bofçellokun!
- Nona bofçellokun se nëkonte
Berberit teslim s'ei ja bonte
Nona bofçellokun dë nëkoje
Berberit teslim de ja boje.*

Këndoi: **M. Sejfullai**, f. Strajan - Gostivar

Kënga “**Hajde Blerim aga hipe Zogun**” përcillet me dajre duke i kënduar vashat Zogut që është sinonim i djalit dhe ta shëtisi tërë Pollogun. Djali nuk dëshiron të shëtisë vetë, por me babain i tij me treçind vetë. Të gjithë këta kur do të nisen, përnjëherë të krisin me revole e pushkë duke ia dhënë valën nga të gjitha anët Pollogut. Që dasma të dëgjohet botërisht dhe ata që nuk e duan këtë familje le të pëlçasin nga gjelozia. Vashat duke kënduar kërkojnë nga daja t'i hipi Gjokut e ta marrë përpara Zogun që është sinonim i djalit, ta mbajë atë fortë se është i vogël, mos trembet e të qajë, por goja sheqer le t'i hajë:

*Hajde Blerim aga hipe zogun
Dil e shetajta Pollogun!
- Un' Pollogun nauk e shetajta vetë
Të m'shetajse baba me treçint vetë!
Ata treçint vetët de najsin
Krejt me pishtolla të krajsin;
Ata treçint vetët kur de dalën
Me pishtollat të ja apin valën.
Ene t'apin valën n'kët e on'e m'at onë
T'ndaiet darsma Blerim agës
Në krejt kët dinjon.
Ata treçint vetët kur de najsin
Bumet, pushkët dëue të kërcasën
Ata ç'i s'na don le t'pëlçasën
Se sot Blerim aga n'a bon darsëm!
Hajde more dajxho hipe Gjokun
Merre përpara Blerim zogun
Merre përpara ene mbaje
E kemi të vogël mo na qaje
Goja sheqer le t'i hajë!*

Këndoi: **R. Idrizi**, f. Xhurxhevisht - Gostivar

Kënga “**Mori vin berberi pejtën për ka nie**” e përcjellur me dajre nga vashat të cilat i këndojnë çunit. Berberi nga Gostivari me çantën jeshile hyn në fshat duke pyetur ku e ka shtëpinë e re çuni? Përgjigja është se atje poshtë ndër ograda ku është ngritur flamuri. Babai i çunit ia tregon konakun dhe hyjnë në dhomën e shtruar me sixhade. Berberi pyet për çunin a është rritur, merr përgjigjen se është rritur është bërë tamam. Porositet të punojë ngadalë me kujdes që të mos trembet çuni. Berberi është i preokupuar për te si ta marrë me pahir. Dasmën e çunit do të nxirret në radio:

*Mori vin berberi pejtën për ka nie,
Pejtën: Mirsad aga, ku e ka shpejn e re.
- E ka ç'a gje posht n'egrade*

*Dë hipje n'uod me sexhade.
 O more berberi Gëstivarit,
 Puno me kadale mo na tremish gjalin.
 Vin berberi Mirsad agës me çont' jeshile
 - Kom gajle Mirsad agën si ta marr ndë hide.
 Vin berberi Mirsad agës me babën e vet.
 I del ja diften konakun
 Ke shpeja e re ka ngulë bajrakun.
 Mori vin berberi t'uj na porosejt
 Pejtën: Mirsad agën a ma kini rej?
 - Ene mi o rej, mi o bo tamom
 Darsmën e Mirsad agës da çesëm n'radion.*

Këndoi: **H. Selimi**, f. Forinë - Gostivar

Kënga **“Hajde or berber, unxhu n'hastër”** e përcjellur me dajre, bën fjalë për dy çuna që janë pa bërë synet. Ajo thotë se që të dy janë pa bërë gati, ende nuk janë veshur me tesha synetie me këpucët e zeza nga Gjakova dhe telin e shamatën të blerë nga Tetova. Vashat i këndojnë berberit duke e pyetur ku është nisur? Përgjigjja është se babai i çunave e ka thirrur me dy pika teli **“pi k'tou e njer ke un, berberi”**. Pastaj vazhdon refreni e ka thirrur me dy pika ari **“pi k'teu e njer në Gostivar-e”**. Për të vazhduar me vargjet: **Po mi vjen berberi avli më avli-e/ I ka moushun durët me sheqer mavi-e.** Vashat këndojnë në formë të dialogëzuar se atë sheqer **“mavëie”** berber kujt ia sjell, përgjigjja është se ia sjell çunit dhuratë për ta mashtruar. Berberi troket në derë dhe kërkon që t'ia hapë derën çuni. Përgjigjja është se çuni do ia hapi derën bashkë me babain e tij me dajre e me lodra:

*Hajde or berber, unxhu n'hastër
 Kemi di dilbera pa bo hazër,
 Ene pa j'bo hazër, pa i ndërrou
 Telin e shamatën pa ja vënou.
 Telin e shamatën pi Tetove
 E kondrat e zieza pi Xhakove.
 A more berber ku mi i'je neisun
 Baba i Agron agës mue më ka grishun.
 Më ka grishun me di pëika teli
 Pi k'tou e njer ke un, berberi,
 Më ka grishun me di pëika are
 Pi k'teu e njer në Gostivar-e.
 Po mi vjen berberi avli më avli-e
 I ka moushun durët me sheqer mavi-e.
 - At sheqer mavëie, berber kuj ja bie?
 - Ja bi Agron agës hejdie.
 Ja bi Agron agës ta kënxhi-e.*

*Ene vjen berberi: tak e tak në dierë
- Hajde çilma derën o Agron dilber!
- Oune dierën dë ta çeli bashk me babën tem
Me dahire e me luodra se berberi vjen!*

Këndoi: **F. Memeti**, f. Çajle - Gostivar

Kënga "**Po vin dajallarët me dashin e zi**" e shoqëruar me dajre, bën fjalë kryesisht për dajallarët që janë duke ardhur në dasëm tek nipi që bëhet synet dhe si dhuratë i sjellin një dash të zi. Ndërsa xhaxhallarët vijnë duke kënduar lozur e kënduar me lodra "**dil Faton aga ke kodra/ dil ta shofish, Faton aga, fëisin për akolla!**". E porosisin nipin e tyre që mos të trembet nga berberi po të bëhet trim:

*Po vin' dajallarët me dashin e zi
nono, me dashin e zi.
Po vin dajallarët me dashin me bojë
nono, me dashin me bojë.
Dajallarët e Faton agës
nëipit vin mas,
- Mos u traïm be biri dajës
të na boesh trëim
të na boesh, gjali dajës
se berberi vëin!
Po vëin minxhallarët me lodra,
dil Faton aga ke kodra,
dil ta shofish, Faton aga,
fëisin për akolla!*

Këndoi: **Sh. Izeiri**, f. Banjicë - Gostivar

Kënga "**More Vullnet aga topi telit**" e përcjellur me dajre. I këndohet djalit që bëhet synet, duke i mveshur epitetin si "**aga**" dhe "**topi telit**" me rastin e takimit të tij të parë me berberin. Kënga tregon se takimi do bëhet tek arra me dajallarët e tij. Përshkruhet gjithashtu profesioni i berberit me "**dorën e omël**" i cili do të gostitet me petulla me "**tomël**". Moment tjetër i rëndësishëm është ardhja e dajallarëve me dashin me "**bojë**" me rastin e dasmës së synetisë së nipit të tyre. Dëshira e nipit është që dajallarët ta shëtisin me "**limuzin t'kuce!**". Djali i drejtohet nënës së tij her "**nuçe**" e herë gjyshes "**oj nono, mi p'qakë**" se dajallarët me këtë rast do ta darisin n ipin e tyre, duke e mbuluar me paratë franga zviceriane e marka gjermane:

*More Vullnet aga, topi telit-o
Si di dalësh para berberit-o?
- Dë t'i dal përpara njer ke arra-o
Be dajxhallarët përpara-o.
Berberi dorën e omël-o*

Dë t'i apëm petlla me tomël-o.
 Dë vin' dajallarët me dashin me bojë
 Mori me dashin me bojë,
 Vullnet agën sinet dë ta bojm'
 Mori, sinet dë ta bojm'!
 Thot' Vullnet aga: oj nono, mi nuçe
 Tëm shetëisin dajallarët me limuzin' t'kuçe!
 Thot' Vullnet aga: oj nono, mi p'qakë
 Tëm mulojnë-o dajallarët
 Krejt në frong e n'markë

Këndoi: **H. Ameti**, f. Çegran - Gostivarit

Kënga "**More Fehim aga topi telit**" përcillet me dajre. I këndohet çunit që bëhet synet, duke i mveshur epitelin "**aga**" dhe "**topi telit**". Vashat i këndojnë duke e pyetur çunin për takimin e tij me berberin dhe thonë se berberi e ka "**dorën e omël**", do të gostitet me petulla me "**tomël**". Kënga tregon se çuni do t'i dalë përpara berberit gjer tek arra me dajallarët e tij. Por në këtë variant të këngës çuni i thotë nënës se ka një nevojë e kjo është që "**tëm vin' dajallarët me dashin me bojë**". Dëshira e nipit është që dajallarët ta shëtisin me "**Gjokun e kuç!**". Çuni i drejtohet nënës "**non-o, maja përmaç maja**" se dajallarët do ta shëtisin me "**arab' me jaja!**". Kjo e siguron djalin e saj se nuk do ta lënë "**ishkil**" do ta shëtisin dajallarët me "**tomofil**" dhe me lodra me të tërë miqësinë që është ftuar në këtë dasëm të madhe, me pehlivana, duke i gëzuar kështu shtëpitë tona:

More Fehim aga topi-j telit-o
 Si di dalish para berberit-o?
 Berberi dorën e omël-o
 De t'i çesim petlla me tomël.
 De-j dal përpara njer ke arra-o
 Me dajxhallarët përpara-o/
 Thot' Fehim aga: non', kom ni nevojë
 Tëm vin' dajallarët me dashin me bojë.
 Thot' Fehim aga: e kom shpertin ngusht'
 Tëm shëtesin dajallarët me Gjokun e kuç.
 Thot' Fehim aga: non-o, maja përmaç maja
 Tëm shëtesin dajallarët me arab' me jaja!
 - Mo ki gajle Fehim aga, nuk ta lom ishkil
 Dë t'sheteisin dajallarët o me tomofil.
 Ene me tomofil e me lodra
 Krejt miçsein' o për akolla,
 De bojm' seir o me pelivona
 Ene t'i gzojm' o shpeijat tona!

Këndoi: **F. Aqifi**, f. Çegran – Gostivar

IV. LOJËRA FËMIJËSH NGA FSHATI KALISHT I GOSTIVARIT

1. Para me qarë (fitim)

Fëmijët bëjnë një vijë të cilën e quajnë vija kufitare. Përtej kësaj vije nuk mund të kalohet. Prej kësaj vije në largësi prej 3-4 metrash vihen paret e hekurta në kënde dhe me nga një **“pish”** në dorë hudhej në drejtim të pareve të cilat janë të vendosura në këmbë, ai i cili i bien pares dhe e rrëyon me **“pishin”** ka të drejtë t’u bjerë edhe pareve të tjera. Lojtari merr aq para sa i rrëzon me pishin. Në rastin kur ai nuk mund t’i mëshonte apo rrëzonte paranë, lojën e vazhdon lojtari tjetër. Nëse asnjëri nuk i kapte paratë me **“pish”**, ai i cili është më afër kishte të drejtë të gjuante i pari. Loja luhet me numër të pacaktuar lojtarësh.

2. Çeliku

Është lojë fëmijërore e cila po ashtu luhet si paratë me qarë (fitim). Por ndryshimi është se kjo lojë bëhet me dy shkopinj. Njëri shkop është me gjatësi diku 80 cm, kurse shkopi tjetër është i vogël i cili quhet **“Çeliku”** dhe është i gjatë diku 15-20 cm. Së pari fëmijët e hapin një gropë të vogël, mbi këtë gropë vënë **“çelikon”**. Ndërsa në njërin skaj të shkopit të madh e fusin ndër këtë gropë **“çelikon”** dhe fuqishëm i mëshojnë me shkopin e madh duke e ngritur sa më lart. Në anën tjetër lojtarët tjerë e presin që t’a kapin **“çelikon”**. Nëse ndonjëri prej lojtarëve e kap, atëherë ky e merr lojën. Nëse asnjëri nuk e kap dot, atëherë ata gjuajnë në drejtim të gropës se hapur mbi të cilën është i vendosur shkopi. Nëse i bie shkopit, atëherë lojën e merr ai i cili e gjuan shkopin. Nëse nuk e gjuan atë, atëherë lojtari **“çelikon”** e vë në gropën e hapur, ashtu që në njërin skaj kur t’i bie **“çelikut”** ky të kërcente përpjetë, duke i rënë me shkopin me qëllim që ta ngre sa me larg atë. Largësia e cila fitohej prej vendit ku gjendej **“çeliku”** deri te gropa e hapur, matet me shkopin dhe ajo largësi quhej **“Kale”**. Loja gjithashtu luhet me sa lojtarë të duam. Fitues i lojës ishte ai i cili bënte më shumë **“kuaj”** (domethënë ai i cili e çonte më larg **“çelikon”**).

3. Filxhanat

Fëmijët marrin një “**temsi**” (tepsi) dhe në te i vendosin 9 filxhana të kthyer mbrapsht. Tek njëri filxhan e fshehin një unazë apo para metali. Prej 9 filxhanave vetëm 3 sish kanë të drejtë t’i hapin. Nëse unaza apo paraja është tek njëri prej këtyre 3 filxhanave, atëherë fitohet loja. Nëse nuk është unaza apo paraja tek asnjëri prej 3 filxhanave, atëherë humbet loja dhe si ndëshkim për humbjen e lojës e han dajakun (kuptohet kjo bëhet në mënyrë të improvizuar). Dajaku bëhet në këtë mënyrë: merret një “**postaqi**” rrotullohet në formë të gypit dhe i biejnë kah shpina lojtarit që e ka humbur lojën.

4. Alla osmane

Lojtarët e kësaj loje kapen dorë për dore, formojnë një rreth me fëmijë dhe rrotullohen duke kënduar: **Oj alla osmane kap kapedane, / a ka udhë me dalë nëpër Gostivar**. Dhe kështu me radhë kalojnë ndër krahërorët e njëri-tjetrit.

Shënoi: **N. Asani**, studente – UEJL.



V. RITET DHE KËNGËT E DASMËS

1. Tradita dhe bashkëkohorja në dasmat e fshatit Kamjan të Tetovës

Në këtë trevë janë ruajtur shumë lloje dhe zhanre të këngëve. Zanafilla e këtyre këngëve është aq e vjetër sa është e vjetër vetë martesja. Këngët që këndohen nëpër dasma janë bartur brez pas brezi por më së shumti i kanë ruajtur femrat, kryesisht vajzat dhe gratë jo shumë të moshuara. Njëra ndër këto lloje të këngëve janë padyshim ato të dasmës.

Në krahasim me të tjerat, këngët e dasmës janë më tepër të përhapura në këtë trevë, si në fshatrat malore ashtu edhe në ato të fushore. Këto këngë janë të shkurtëra, por secila prej tyre ka përmbajtje të veçantë në vete. Këngët e dasmës fillojnë të këndohen nga grupe të ndryshme vajzash dy gjer më shtatë ditë para se të fillojë dasma, domethënë atë ditë kur bëhen gati **“petkat”** e nuses dhe duhet të nisen të shkojnë te miqtë e rinj. Atë ditë vajzat e përgadisnin shtëpinë për dasëm dhe duke punuar këndojnë këngë të ndryshme, ku përmes këtyre këngëve lavdërohen djali dhe nusja. Meqë dasma është momenti më i lumtur dhe më i pritur në familje, vetëvetiu lindin rite të ndryshme dhe këngë të llojllojshme rreth saj. Këngët e dasmës në shtëpinë e dhëndrit janë të shumta dhe mjaft të larmishme. Ata fillojnë të këndohen kur merret shenja e parë kur lajmin e mirë për dhëndërin, familjen e farefisin e tij e sjell **“shkusi”**. Në këtë shtëpi me këtë rast mbretëron një gëzim i madh gjithëfamiljarë. Lajmërimin e këtij gëzimi e bëjnë vajzat e rrethit më të ngushtë të familjes. Mandej, në mënyrë spontane tubohen të gjitha vajzat e lagjes dhe të farefisit dhe me defe në dorë këndojnë këngë për mësitin. Këngët këndohen pranë dritares me qëllim që të dëgjojë i tërë fshati. Vajzat i këndojnë edhe mësitit i cili luan rolin e ndërmjetësuesit. Ky në fillim e sjell një dhuratë nga ana e vajzës që do të thotë se është shenja e parë, kur me këtë rast vajzat fillojnë të këndojnë këngët nuses së ardhshme, e cila i palon teshat dhe i përgatit për mësitin. Pasi të kryhen këto formalitete, tash më kur dihet se dy të rinjtë do të martohen, atëherë familja e djalit fillon me përgatitjen e dasmës. Tri javë para dasmës, dasmori përgatitet duke blerë fustana të ndryshëm për nusen, ku puna e parë është qepja e teshave të nuses. Me këtë rast merret nusja dhe dërgohet te rrobaqepësi për të marrë masën, që nusja t’i ketë taman teshat,

pra t'i rrinë mirë në trup. Një javë para se të fillojë dasma, zakonisht dita e diel, në shtëpinë e dhëndrit prap mblidhen vajzat dhe familja më e afërt që ta qërojnë "**grurin**" apo "**orizin**", nga i cili pastaj shtypet "**qeshkeku**", domethënë gruri i zier mirë dhe i shtypur. Vajzat pa ndërprerë i këndojnë edhe dhëndrit edhe nuses, duke ua bërë me dije se dasma prej sot fillon. Të hënën përsëri, përveç vajzave në shtëpinë e dhëndrit, që në mëngjes vijnë edhe gratë e fisit më të gjerë, të cilat duhet ta përgadisnin ëmbëlsirën, ku këndohet nusja e cila së shpejti do të ndahet nga familja e saj. Të martën, dasmori bën përgatitjen intensive për fillimin e dasmës, ku e fillon me "**prerjen**" (therjen) e ndonjë kafshe, si bie fjala ndonjë muzat, lopë shterpë, viç, dele. Këtë ditë në shtëpinë e dhëndrit ekspozohen teshat që i ka përgatitur shtëpia e tij, por edhe dhuratat nga farefisi. Të gjitha teshat janë të varura në mur, ku janë të shënuara emrat se kush çka ka dhuruar nga farefisi. Këto tesha vështrohen nga një një numër i madh grashë të rrethit familjar dhe të fashtit dhe më pas komentohen nga ana e tryre për pamjen dhe bukurinë, për mënyrën se si janë përgatitur. Aty janë të ekspozuara edhe ari dhe sende tjera të çmueshme. Vajzat duke kënduar i çojnë porosi nuses se së shpejti do t'ia sjellin teshat dhe arin që ia ka blerë shtëpia e dhëndrit. Tri ditë para se të fillojë dasma, kemi disa këngë kushtuar ritit të "**petkaxhinjve**". Petkaxhinjt janë të afërmit e familjes së dhëndrit, të cilët janë të zgjedhur me numër tek, zakonisht 13 ose 15 anëtarë, të cilët kanë për detyrë që nuses t'ia dërgojnë fustanet dhe arin që ia ka blerë shtëpia e dhëndrit. Të gjithë teshat janë të përgatitura mirë nëpër valixhe. Por bashk me rrobat, nuses i dërgohet edhe këna, e cila përdoret për ngjyrosjen e flokëve. Me kënen shprehet fillimi i dasmës të nusja, vajza pasi i vesh pa dëshirë, rrobet që ia ka sjellur familja e burrit, i përfaqon gratë me radhë dhe del në dhomën tjetër për tu zhveshur duke i hequr teshat dhe vishet sërish me rroba vajzërie. Ditën e premtë, në mëngjes herët, shoqet mblidhen dhe e zgjojnë nusen nga gjumi duke i kënduar këngë. Këto këngë duken se janë shumë pikëlluese, pasi është faza përfundimtare e jetës së saj rinore në shtëpinë e babës. Andaj nusja (vajza që gjendet në prag të martesës) u drejtohet shoqeve që t'ia zbusin të keqen. Ndërsa në shtëpinë e dhëndrit, kryhen përgatitjet e fundit. Është zakon që të shkohet te secila shtëpi e bijave që t'i ftojnë (grishin) gratë dhe burrat për të marrë pjesë në gëzimin familjar. Kur vijnë bijat dhe vajzat e reja në të hyrë në oborr ia nisin këngës. Gazi dhe hareja shtohet ditën para se të merret nusja. Te burrat këndohen këngë madje biejnë daullet dhe zurlat. Nën zërin e daullave dhe zurlave e shtypin "**qeshkekun**", që tregon se çifti do të fillojë një jetë të re. Te gratë ka vetëm dajre dhe

vajzat që i bien deficit, kryesisht janë vajzat e mahallës që i këndojnë të gjitha nuses, veçanërisht nuset e reja, ku në këto këngë lavdërohet shtëpia e djalit. Në mbrëmje te gratë bëhet sërish gezim i madh. Më interesante nga të gjithë ditët është kur shtypet “qeshkeku” dhe nata e qerres ku bëhet përgatitja e qerres me qilima të kuq, shenjë që tregon se është qerre nuseje. Këtë mbrëmje bëhet aheng edhe më i madh në krahasim prej ditëve të tjera, ku luajnë djemë e vajza së bashku duke kënduar e vallëzuar. Posa zbardh dita, zgjohen të gjithë gratë dhe bëhen gati të shkojnë të marrin nusen. Në këtë akt ceremonial marrin pjesë një numër i madhë i grave, pastaj dhëndri nxirret në oborr, duke e shoqëruar dhëndërin një i afërm i familjes që është i martuar rishtazi ku këtë e rruajnë dhe e qethin në praninë e të gjithë të pranishmëve në dasëm që janë e urojnë dhëndërin. Për ta marrë nusen nisen dasmorët në mënyrë të organizuar. Nuses i këndohen këngë me dajre, kurse kjo përgatitet dalëngadalë të dalë, pastaj këndohen këngë edhe për babain e nuses që janë këngë prekëse. Krushqit janë të gostitur nga mikpritësit, ndarja e nuses nga prindërit paksa është trishtuese, pasi del nga shtëpia kur krushqit e marrin duke e dërguar në shtëpinë e dhëndrit. Dhëndri e pret nusen para oborrit, pasi zbresin të gjithë gratë prej qerres, me nusen e re mbetet vetëm një grua. Para se të zbret nusja i bëjnë disa adete ku krejt këto simbolizojnë: disiplinën, bereqetin dhe besimin në fe, që duhet nusja t’i plotësoj në shtëpinë e re.

Nuses i këndohen këngë në mënyrë të pandërprerë, pastaj i ulin një djalë në prehër, ku ajo i jep një dhuratë. Në mëngjes zgjohen të rinjtë herët dhe vajzat duke u rënë dajreve e nxjerrin nusen në oborr që kjo tu derdh ujë ku të gjithë do i lajnë duart. Të nesërmen përsëri nusen e nxjerrin me një netëll në dorë e cila është e zbukuruar dhe fshinë oborrit e shtëpisë në mënyrë simbolike. Në mbrëmje e përgatisin një darkë të madhe ku nusen e re e vënë në sofër për herë të parë në shtëpinë e burrit me plot mysafirë të pranishëm në atë sofër.

2. Zakonet e dasmës në fshatin Çegran të Gostivarit

Lidhur me zakonet e dërgimit të mësitit, fejesës së nuses, qëndrimit të saj ndër fejesë, dërgimit të peshqeshave tradicionale të veshjeve artizanale dhe ushqimeve të ndryshme gjatë festave të Shën Gjergjit dhe Bajramit, bërjes së ceremonive gjatë këtyre festave, organizimin e dasmës për marrjen e nuses dhe ceremonitë që pasojnë me këtë rast, ne do shërbehemi me rrëfimet e amvises 67 vjeçare, **Pendije Selmani**, nga fshati Çegran, 4 vjet shkollim:

Kur e zeshim nosen çojshim shkuz, e forcojshim i çojshim ni mihir, sëllde shkuzi e çonte mihirin ene e dante xhevapin. Nëse ishim pi ni katondi nok folshim me fesin e noses, se ishte mare. Sa e mirshim nosen, ato ç'i ishin pi larg, as ç'i i njijsim, sëllde pejtshim a osht' coc' zengeni, a kan' dhen'?. Nosja rente ni motmot a di vjet e dhonme. Mas si e forcojm' nosen bojshim rende kur vinte **Shinxherxhi** ene **Bajromi**. Për **Shinxherxh** çojm' shinxherxhllëk, dimija, kmesh, kovrak me oja, çorap'. Do mlidheshin coca pjot ene gjeth' notën da rujshin notën e Shinxherxhit t'u kendo me dahere. Dilshin notën, shëtetshin napër odh' me dahere t'u këndo, bojshim elfene, zishim kallena. N'saba ngrejshim, bojshim petlla i hajshim me pekmez, me mjolt, i ndrojshim mutit', tondshim at' dit' se o dit' Shinxherxhi. Ato cocat do hajshin për sell' petlla, ka dreka mirshin nja tre coll' i çojshin collët raçet ke nosja, mapa çojshin petlla, voe t'zime, në ishte larg i çojshim me çere, në ishte n'gat shkojshim n'kom'.

A për **bajromllëk** prap' çojshim raçe, amën shkojshin borat i çojshin raçet, meku bonte ni tres' buk, hajshin buk ene vishin. Ene për **Bajrom** si për Shinxherxh i mlidhshim bijat, cocat, dajcat, tezet ene mas si vishin borat hajshin buk ke shpeje gjalit ene derdheshin napër shpeja.

Kur vinte vakti t'a morim nosen ni jav' para boheshim hazer. **Notën e hon'** i mlidhshim kit mikeshat ka ishin ka nok ishin. **Ditën e hon'** i çojshim petkat, di tres' buk bonte meku agje ene shkojshin borat i çojshin petkat 20-30 bora. **Notën e mort'** vendojn' bajrak noset, cocat me kon' sheqeri, do lishojshim tela, këndojsin cocat me dahere përjashta, shkojshin mirshin erfene me çere me kal' ke ato njerzit ç'i i kishin ma afër, ke ato larg nuk shkojshim. **Notën e mërkor'** do mlidheshin bora, gra, borat e shtepshin qeshkekun grat' kënojsin. Qeshkeku oshte ni gur' kolar, kush ka pas mulle at' gurin e kan' mor', kush ka pas darsëm. Me qeshkek e kan' bju grunin, kan' mor di gurzi ene ni shkop, njoni e ka vërtet qetri ka shte' grun' ç'i t'vije nosja me bereqet, a grat' okolla kan' kendo kan' bo qife. Mapa ngrejshin, lujshin kit' bora e gra. **Ditën e mërkor'** e ndrojshim çeren ç'i do hipje nosja. Shteshin di maxhetore gra, ç'i do bojshin buk 10 dit' ç'i t'han' miçët, mikeshat, ç'i i ka trumo i zoti shpejës, ene di dajrexhica ç'i di bishin daheres 10 dit'.

Notën e ejte ndroeshin grat' bojshin sir, ndroeshin me dimija me tela, me lule, me shamota, pjaka e t'reja gjeth' notën lujshin valle. **Ditën e ejte** kur ngrejshin ka 4 sahati, shkojshin e mirshin nosen me 2 çere gra e bora. Ato çeret i mulojsim me qelima ene me çarçafa, qilimat i vendojsim saprende a çarçafat para ene mrapa. Ate hipshin grat' a borat hunxheshin para. Grat' quheshin

ingje borat krufç, ingjet lujshin, këndojshin mrenda n'od', krufçit reshin n'konok. Nje' sa lujshin ingjet valle nosja boheshte hazër, kur dilte nosja grat' i kënojshtin kojka. Kojke par' ishte:

*Mori ka ra hona në livadhe,
thoni noses ton' ne n'a dale,
ene ne n'a dale t'uj fol e t'uj çesh,
ka erdh serbes zollva me ingje e me çer'.*

Mapa hipën nosja n'çere me gjeth' ingjet, vin' ke shpeje borit. Kur hen nosja n'avli, vjera ene bori e shofin me set, i vendojn' ke kreja lakna, çep' ç'i nosja t'bohët e mençme, t'sellet mer' me njerzit e borit, mapa i vendojn' 3 k'sula ç'i t'boje gjem', a nje' sa i bojn' hadetet ingjet i këndojn' noses. Mapa bori e zdripën nosen pi çerje, kur e zdripën ja këndojshim ket kojke:

*Mori nosja jon' kur do zdripish,
santir e dimija mo naj grisish.*

Mas si e zdripin me kojka e shten nosen mrenda, e lin' nosja pragun me sherbet ç'i t'i duket omël ke shpeje borit. Ka 2 sahati mlidheshin gra pi katondi, pi miçseje, ndroeshin me dimija, e ndrojshin ene nosen, e çitshim n'lom' ene vishin kit e shifshin, ene lujshin valle grat' ene cocat, këndojshin me dahere, hajshin buk, ene ka sahati 6 soseshte siri. Mapa e mshilshin nosen me dhondrin ene shkojshtin napër shpejat e veta. **Ditën e xhuma** ngrejshin e çitshin nosen ke ujt, i këndojshin me adhere, n'akshom mlidheshin farefesi e vendojshin nosen sefte n'dark ene soseshte darsma.

Ditën e shton' kur ngrejshin n'saba e ndrojshin nosen, mlidheshin grat' e kujshis', nosja fshente sefte me netëll, ato grat' i këndojshin okolla:

*Kur t'morish të fshesh mi nose,
fshe qosh e buxhak,
kush të heje kush të dale,
t'i jese merak,
fshe nose fshe me skrapina,
sa të pjase ajo shoçe shkina.*

Shënoi: **S. Selmani**, 24 dhjetor 2007

3. Rritet dhe këngët e dasmës në fshatin Pirok të Tetovës

Prindërit, që atëherë kur i biri i tyre rritet, interesohen për t'i gjetur nuse. Më parë, kur diferencat në mes komunitetit kanë qenë të mëdha nga pikëpamja ekonomike, pasi i pasuri nuk ia ka dhënë vajzën të varfërit për dy arsye:

a) mungesa e sigurimit ekonomik dhe

b) pamundësia e të varfurit që ta presë e përcjellë mikun e pasur me ushqime të majme, shtresa e mbulesa etj.

Ka qenë e pranishme ndjenja fort e zhvilluar tek babai e vajzës, që mos t'a fejojë të bijën për të varfër, sepse e ka ndier dinjitetin e tij të thyer dhe të nënçmuar karshi fshatarëve.

Në shumë raste marrja e nuseve është bërë nga fshatra të largëta deri në 10 km. Kjo, sipas mendimit tonë, është bërë me qëllim të caktuar, sepse prindërit e vajzës e kanë xhelozuar dhëndrin. Sikur bija e tyre të martohej në afërsi, ata dhëndërin do të kishin rast t'a shihnin më shpesh të pispillosur – si shenjë krenarie e tij kundruall prindërve të vajzës së martuar. Më parë kanë qenë të rralla rastet e marrjes me dashuri të të rinjve dhe të ikjes së vajzës me të dashurin. Vajzën e ikur me dhunë shpesh e kanë kthyer në shtëpinë e prindërve, me ç'rast janë ndezur emocionet brenda anëtarëve të familjes dhe farefisit të afërm. Kanosjet, ftohjet midis njerëzve, zënkat dhe grindjet kanë qenë dukuri të zakonshme.

Në këtë mes nuk kanë munguar as rrahjet, respektivisht vrasjet. Natyrisht herë-herë ikjet e vajzave kanë qenë të suksesshme kur të rinjtë kanë këmbëngulur në dashurinë e tyre dhe femra ka vazhduar jetën normale në familjen e burrit.

Pajtimet midis bijës së ikur dhe miqve nga një anë dhe prindërve të vajzës me dhëndërin dhe familjen e tij janë bërë kryesisht në raste vdekjeje, dasme etj..., kur pjesëmarja e tyre në gëzim apo hidhërim ka qenë e pashmangshme. Zakonisht pajtimeve u ka paraprirë një ndërmjetësim i ndonjë njeriu dinjitoz, që është dërguar nga njëra prej palëve për të marrë pëlqimin a pajtimin. Këta (misionarë) të pajtimit, fshatarët i quajnë “Rixhaxhi”.

Në shtëpinë e djalit për martesë, vajzat këndojnë këto këngë:

*Bilbili në lamë, bilbili në lamë
Nause do t'i zamë Hasan agës
Nause do t'i zamë ni qibare,
T'i zdrajte kama në nalle,
T'i zdrajte dora në maxhe,
Nause do t'i zamë ni delije.
E donte nana për hije !
Nause do t'i zamë ni sherete,
Do ja zgjedhje motra e vete.*

*Shkon nana në darsëm, unxhet në kraje të lamës
I thot' caucës hovardare, oj bija e nanës,
Oj bija e nanës, kane shaum tapkane,
E kam nana Hasan agën pa kurrni behane.*

*Oj bija e nanës kone hovardare,
 Haj merre Hasan dilberin, mbaron shkollën të madhe.
 More Hasan aga, more hovardar
 Do ta zgjedhi nana nausen me ilin' në ballë.
 Me ilin' në ballë, ftajrën si hanëz,
 Ç'at ma të majrën e nanës.
 Ç'at ma t'majrën ç'i ka nana nji,
 Do e çoje dinjajën me kovrak terma,
 Me kovrak terma, me kovrak të bardh'
 Da e çoje dinjajën si në Gostivar.*

Kur prindërit e djalit vendosin t'a nxjerrin nusen, tek prindërit e saj dërgojnë një ndërmjetës, shkesin. Shkesi për t'ia arritur qëllimit bën disa pokushe (magji). Shkesi, nëse është stina e vjeshtës apo e dimrit, në tagarin e shtruar përpara tij, e mbledh thëngjillin kope, që ka për qëllim dakordimin e mendimit të dy palëve (mbledhjen e mendimeve në një – të përbashkëta). Gjatë stinës së verës dhe pranverës, kur moti bën ngrohtë, shkesi përpara mbledh grimca, duke i bërë ato si kope.

Gjithashtu në xhep merr një dry të mbyllur, që është një formë e magjisë që edhe prindërve të vajzës t'u mbyllet goja si dryni. Bisedën zakonisht e nisën me fjalët e njohura **“Allahun emrile”** (me urdhërin e Zotit) dhe në vazhdim ia shfaq dëshirën e atij prej të cilit është autorizuar për shkesëri. Natyrisht ia nis ta lavdëroj familjen e personit prej të cilit është dërguar. Zakonisht vihen në pah pasuritë që dispononin dërguesi i mësitit (shkesit), vetitë e tyre dhe virtytet e djalit. Babai i vajzës (kryefamiljari i shtëpisë) si zakonisht falenderohet me fjalë të buta, po asnjëherë nuk e këput fjalën menjëherë. I përgjigjet se për këtë çështje do të kuvendojë me antarët e familjes dhe se përgjigjen do t'ia japë një ditë tjetër.

Deri kah vitet e 1950, kur vajza lihej pa shkollë dhe kontaktet e saj ishin të prera me meshkujt dhe rrethin, asnjëherë nuk pyetej për fatin e martesës së saj. Të shumtën e rasteve fatin e ka prerë babai i saj, vetëm në raste të rralla, që është konsultuar edhe ajo. Tani ajo bëhet vetë faktor i dorës së parë për ta përcaktuar fatin. Atëherë kur vajza s'ka lidhje me djaloshin që e kërkon bekimin e saj, antarët e shtëpisë: nëna, motrat, nusja e vëllait etj., ia venë në vesh sihariqin, që ka të bëjë me fejesën e saj. Në këtë mes zakonisht përjashtohet babai. Nëse vajza nuk dëshiron të martohet në atë familje dhe për atë djalë ajo kategorikisht thotë se nuk dëshiron të martohet. Natyrisht, nënkuptohet se vajza e refuzon propozimin. Atëherë ajo kur dëshiron të martohet për djalin e caktuar, që ka shprehur dëshirën ta kërkojë për nuse, si

me turp përgjigjet se ku të dëshirojë babai dhe nëna. Kësisoj edhe mrret miratimi i vajzës.

Kur vajza në këto raste nuk don të përzihet në punët e prindërve dhe fatin e saj e lenë në duart e tyre, ata domethënë babai dhe nëna e saj ia japin shkuesit përgjigjen. Në këto raste, kur shkesi i parë nuk ia ka arritur qëllimit, atëherë janë dërguar edhe të tjerë shkuesë, po ashtu edhe ndonjë të afërt të prindërve të vajzës ose ndonjëri që gëzon autoritet ndaj tyre. Shkesi kur merr pëlqimin e të gjithëve për dhënien e vajzës, atëherë fillojnë bisedimet rreth kërkesave siç janë: nderi, koha e marrjes së nuses, dita e marrjes etj. Shkusi kthehet sërish dhe ua kumton të gjitha kërkesat e mikut të ri. Shkusi pasi merr pëlqimin e pranimit të kërkesave nga ana e dhëndërit, atëherë kthehet përsëri dhe merr “marhamën” - shenjë që është bërë fejesa e dy të rinjve.

Nderi (pagesa për nusen) dhe kërkesat e tjera zakonisht janë përcaktuar sipas shkallës ekonomike të dy familjeve. Nëse prindërit e vajzës kanë qenë ekonomikisht të dobët, për përgatitjen e së bijës kanë kërkuar shuma më të mëdha të hollash. Sipas të dhënave disponuese, këto shpenzime (kërkesa) gjatë viteve 1970 kanë qenë më të mëdha. Fshati Pirok së toku me rrethinën e vet, si fshat fushor dhe i pasur në krahasim me të tjerët ka qenë në shënjestër të shumë prindërve, që kanë dashur t'i martojnë fëmijët në këtë fshat me qëllim që t'ua sigurojnë jetën e mirë vajzave. Për këtë qëllim dhëndërit kanë paguar shuma të vogla se ata të fshatrave që kanë pasur nivel më të ulët ekonomik. Si të themi Pirokasit kanë gëzuar një fare privilegje në këtë drejtim. Pas viteve 1970 kjo dukuri shënon rënie të mëtejshme. Në zbehjen e kësaj tradite shekullore të shëmtuar, kanë ndikuar një sërë faktorësh, sidomos njohja dhe dashuria e të rinjve, shkollimi, arsimimi shëndetësor, shkalla ekonomike etj.

Para Luftës së Parë Botërore, shuma e nderit mesatarisht është sjellur rreth pesë lira prej dukati, përveç nderit është praktikuar dhurata prej një shume prej një lire dukati secilit vëlla të nuses. Pas Luftës së Dytë Botërore (deri nga viti 1930) përveç lirave në dukat për secilin vëlla të të fejuarës, janë paguar edhe shuma të tjera në emër të nderit. Nderi është shpenzuar kryesisht për përgatitjen e pajës së vajzës. Fort të rralla kanë qenë rastet kur kjo shumë është shpenzuar për nevoja të tjera nga ana e prindërve të vajzës, për plotësimin e këtyre obligimeve dhe shpenzimet e dasmave, herë-herë prindërit e dhëndërit kanë shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme². E gjithë kjo procedurë përcillet

² Daut Izairi. Piroku i ynë. fq. 165, 166, 167, „Shtypi:”AZA-SEsoft”, Tetovë, 1996

prej këngëve të vajzave, atëherë, kur shkuesi vetë ta kërkoj një vajzë për një djalë rapsodet këndojnë:

*“Shkuz more shkuz me openga,
Me kangë nausja e keçe s’të shtajmë mbrenda!
Shkuz more shkuz me këmajsh najllon,
Me kanë nausja e majr’do t’shëtajsim me ballon!”*

Shkuesi në shenjë të fejesës së kryer, nga ana e nuses sjell këto peshqesha: një “marhamë” për agababën (vjehërrin), një shami për hankonenen (vjehërrën), një “çevre” për dhëndrin, një shami ose “kovrak” për vete. Peshqeshet janë të stolisura me lule. Pas fejesës zyrtare, vazhdojnë urimet e farefisit, miqve, dashamirëve nga ana e djalit. Që të gjithë uruesve u

nxirret sherbet, aluzion që jeta e të rinjve dhe miqësia të jetë e ëmbël si sherbet. Nëpërmjet të të njëjtit shkues, prindërve të nuses u dërgohet një pjesë e nderit. Me arritjen e nishanit të fejesës, vajzat i këndojnë këto këngë:

*“Marhama me taufa, marhama me taufa,
E zgjodhe ndër cauca, Hasan aga.
Marhama me tel, marhama me tel,
E zgjodhe ndër gjem – Xhemile hanëm.
Kapërcej bilbili përreth derës,
Bilbil kë më bëne mu të mjerës?!
Nauk të bana xha, nauk të bana xha,
Ta dhash Hasan agën dilber në dinja,
Rrajtu mi Xhemile hanëm, rrajtu ene më.*

Pas marrjes së marhamës ose nishanit kur djali që është fejuar nuk gjendet në shtëpi, por gjendet ushtar ose në kurbet, me dajre këndohen këto këngë:

*Fishëlloj pampuri ka Shkupi,
O Hasan dilber ku të hupi?
Mos e m’baj at gajle, nana jeme,
Si më ka çu’ do t’më bjere.
Dilber Hasan aga ka do shkoje,
Udha karanfila do zbiloje.*

Gjatë festave të vitit vajzës i dërgohen dhurata si për ditën e Shëngjergjit, pra i dërgohet “**shëngjerqllëku**”. Edhe kjo dhuratë ka shënuar metamorfozat e veta. Deri kah viti 1970 asaj i dërgohej zakonisht 1 kg. sheqer, një palë nallane dhe një shami, më vonë i dërgohen 2 kg. sheqer për gurabie, sheqerpare, dimi ose fustan, kombinizon etj. Që të gjitha janë të stolisura me “**telatina**” dhe lule, për festën e **Bajramit** i dërgohet “bajramllëk”. Deri nga viti 1970 i dërgoheshin zakonisht dimi prej basme ose triko së toku me një “**kovrak**”. Më vonë këto dhurata dyfishoheshin për nga kostoja. Asaj tash i dërgohen dimi me sërm, super-kombinizon, këmishë

prej më të mirave, kovrak, këpucë me take prej më të mirave dhe tortë ose sheqerpare edhe këto të stolisura me tela dhe lule. Kohëve të fundit sheqerpare i dërgohet nuses edhe në fillim të ramazanit dhe për Vitin e Ri, por në krahasim me festat e tjera fetare dhe pagane, për festën e fundit i dërgohet diçka simbolike. Gjatë jetës në shtëpi të babait si e fejuar gjithashtu i dërgohen peshqesha në rastet, kur ajo marton të vëllin ose ndonjë të afërt. Kësaj radhe peshqeshat janë të ngjashme me të parat.

*Oj Xhemile hanëm lule – pembe
Do t'çojmë sheqer të bajsh erfene
Do t'çojmë sheqer, e major mori,
Ato shoçet shkina mos i përzij.*

*Ta çojmë shinxherçllëkun sikur ije vet'
Oj Xhemile lule, t'i bajsh me shëndet,
T'i bajsh me shëndet, e majo, t'i gëzojsh,
Kur do t'vajsh te Hsan aga, lule t'i ushtojsh,
Me tela me lule të naj hijeshojsh.*

*Kur mi hecën Xhemile hanëmi, shaum me serbesllëk,
Do t'i çojmë të majrës o bajramllëk.
Për bajramllëk, e majra m'i ishte
Ma e majra ndër shoçet m'i ishte.*

Gjatë kohës së fejesës, e fejuara përgatit pajën-çejzin, kurse familja e dhëndrit përgatisin rrobat. Pasi blehen rrobat, kërkohet “masa” nga ana e nuses, që t'i dërgojë në terzi. Për masë jepet vetëm një jelek. Masa është shenjë se edhe dasma do të bëhet së shpejti. Këtë akt e përcjellë kënga:

*Oj Xhemile hanëm, a si sose punët më,
Mi thot' Hasan aga, do ta marr e nauk e la,
Oj Xhemile hanëm, në qosh të çardakut,
A i sose hanëm, ojat e kovrakut,
Ojat e kovrakut, i kom sos' e kom bo pale,
Pres agababën të më çoje fjalë.*

Nëse nusja merret ditën e enjte, petkat shkojnë ditën e hënë. Që t'i shohin të tjerët, petkat e nuses-djalit varen që të premtën në dhomë. Nëse nusja merret të dielën, i zoti i shtëpisë gjatë tri ditëve të para: të premtën, të shtunën dhe të dielën ftohen petkaxhinjtë. Nëse ajo merret të enjten këtë e bën tri ditët e para, petkaxhinjtë zakonisht sjellin dhurata (armagane). Rëndom sillen dimi, top dimi, fustane, “komashe”, etj. Nuk përjashtohet as dhurata në të holla. Pas mbledhjes së petkaxhinjve mblidhen rrobat, që kanë qenë tri ditë të varura dhe vendosen nëpër çekmexhe, arka ose valixhe:

*Do t'i çojmë nishanet me jarëm –junli,
Do t'i pëqasim hasmit andej e këndi.
Andej e këndi për ukolla,
Xhemile fellënza ashtë e jona.
Do t'i çojmë nishanet, mos i ngreni për së nelti,
Do t'i çoje Hasan aga nishane dovleti.*

Miqtë e rinj nga ana e nuses me dasmorin që shkon së bashku në shtëpinë e Tyre, së bashku me petkaxhinjt bëjnë tallje të shumta, hajgare dhe “garaz”. I thonë se nëse mungon diçka nga ato që kanë porositur, nuk do t’ia japin nusen ose nuk do t’u shtrojnë drake, ose sheqerparen e kanë bërë me kripë ose këpucët ua kanë mbushur me diçka (lecka, gjell të trashë, eshtra etj.)...Pasi kthehen petkaxhinjt në shtëpinë e dhëndrit, aty gatuhet kulaç, që do ta thyejë dhëndëri e nusja në mëngjesin e parë. Kulaçi ka ritualin e vet. E zonja e shtëpisë, pasi e bën gati lëndën e nevojshme për kulaç, thërret dy vajza për ta gatuar. Ajo që e gatuan në kokë vendos kulaçin e dhëndrit, me qëllim që të lindin meshkuj. Kulaçi përzihet me sherbet me qëllim që midis nuses dhe dhëndrit të ketë jetë të ëmbël. Vajzat gjatë gatimit nuk flasin me qëllim që nusja të jetë e urtë. Krejt ky ritual përcillet me këngë dhe dajre.

Shënoi: Samije Jonusi

4. Këngët e fejesës dhe roli i shkuesit në disa mjedise rurale shqiptare

Dëshira për fejesën e djalit:

*Këto motra sëll i këndojnë
U rret vllaj u bo tamom
Ker de njeftin o ta fejojnë
Këndojnë motrat hiç pa ndal
E dum nosen ovardar
Këndojnë motrat ndër di lule
Ja dum' nosen shom fodulle
Këndojnë motrat hiç pa ndal
E dum nosen për vlla për mall'
Këndojnë motrat nok pushojnë
Për vëllajnë sëll këndojnë
Këndojnë motrat hiç pa fond
Kërkojnë nose mo kiet n'katond
Këndojnë motrat shkojnë tu fjaroe
Dunë kunatën e mallzoe*

Këndojnë motrat ndër di mona
 G'zohet baba g'zohet nona
 Këndojnë motrat ke avlia
 G'zohet motra g'zohet shpija
 Kanë dal motret ndër jahat
 Ka erdh nosja shtatin si bajrak
 Presin motrat në avli
 Na vin nosja birinxhij.

Këngë për shkuarjen e nënës në dasëm:

Shkon nona në darsën
 Petën, petën
 Hamni Arben agën a e retën
 Ene mi o retun mi o bo tamom
 E kërkon nishonin mi për Bajrom
 Ene mi a reto o bo tamom
 Midisin e holl' fishikli kollon
 Me çafën e bardh' për peslir' allton

Pëlqimi i një vashe nga familja e derës së madhe, ashtu siç është edhe djali:

Oj coc' e katondit hasharije
 Ke Xhevdet dilberi don të vije
 Thot' nona e ka gjalin e rije
 Nok ja vënë havalen përmi krije.
 Oj coce katondit me hije
 Me nom ta ka vo nishonin Xhevdet aga piliwoni
 Ta kan von nishonin don të more
 Se më ije coc' e dierës modhe
 Se mi ije coc' zengeni
 Se coca e zengenit ke zengeni
 Ke zengeni don me shku
 Hamoret e grunit mos i mallzo
 Hamoret e grurit nok i mallzoj
 Me Xhevdet dilberin do ta çoj dinjon.
 Oj coce katondit oj shelafe
 Dë t'morim për çaj e për kafe
 Për çaj e për kafe të na bojsh izmet
 Ta kijesh të hecmen serbes e serbes
 Ta kiesh të folmen, tu fol e tu çesh
 Tu fol e tu çiesh do ju dal
 Shatin pi krave do ja mar
 Lum nona gjalin ç'i e ka.

Oj coce katondit shtatin si bajrak
 Aj ke Xhevdet aga se i ka met merak
 I kam met merak ovardare
 Se mi ije coc' pi derës madhe.

Përshkrimi i vashës së cilës synohet t'i dërgohen shkuesit:

Coc' moj coc' me fjokët sa ni duj
 Me gjalin e huj me shaka mos luj
 Me shaka mos luj
 Se të kubitën
 Hem t'i çon shkuzët em të lipën
 Ene kur të lipën të ijesh në bes
 Xhevdet aga të prët në der'
 Të prët në der' aga të prët
 Kort aga me fishek aga me barot
 Çish të duhen Xhevdet aga gjith ato fishek
 E zdripi fëllënzën e molit
 Kit do t'i gjek.

Vargjet për shkuesin:

Shkuz mare shkuz me openga
 Me qonë nosja e kieçe
 S'të shtemë mrenda
 Me qonë nosje e merë
 Do t'bojmë petlla.

Të sharët e vajzës nga të tjerët kur asaj i dërgohen shkues për fejesë:

Hipa me ni moje moli binte ni ros' shej
 Të xhexha mi fëllënze molit ku të shajshin tej
 Ku n'të shajshin tej mi emën mera
 Tej të lipshin ke Armend zotneja.

Këndoi: Adile Dauti 69 vjeçare pa shkollë

Synimi i vashas për t'u fejuar (martuar) me djalin e fshatit:

Çon për nose Xhevdet aga lulja rente mindil
 Si mos e mor Xhevdet agën unë de boem sil
 Unë de boem sil do helmohem
 Mas Xhevdet dilberit nok martohem.

a) Roli i shkuesit (mësitit):

Për t'i bashkuar ose fejuar dy të rinjë, rolin më të madh e luan shkuesi (mësit), por në kohërat para një gjysmë shekulli, nëna ka qenë ajo që e ka zgjedhur nusen e djalit. E tërë historia e ceremonisë së fejesës fillonte përafërsisht kështu: nëna e djalit shkonte në darsëm, edhe pse mund të ndodhte që mos të jetë e thirrur në atë dasëm, por ajo shkon vetëm që të shohë vajza të bukura për djalin e saj. Shikon cila është më e bukura prej tyre dhe atë e „lipën” (i dërgon mësit) për djalin. Kuptohet se fillimisht zgjedh një „shkuz” (mësit) të mirë që e ka familje djali, por edhe që e njeh shumë mirë familjen e vashës. Shkuesi (mësit) këtu e ka rolin më të madh për dhënien e pëlqimit si nga ana e prindërve të vajzës ashtu edhe të djalit. Edhe pse nuk njihen paraprakisht vajza e djali, ata fejohen dhe nuk shihen deri në ditën e dasmës.

Përshkrimi i pamjes trupore-fizike dhe veshjes së djalit

*Hecën Xhevdet aga zdretën
A ju lumshin duorët kush e retën
E ka ret nona jo me simit
E ka retun Zoti shishët ka ni pllom' përdit
Ka ni pllom' për dit ne ta rese
E kimi të hashët të lulzove.*

Paraqitja e fuqisë fizike të djalit e cila krahasohet me pehlivanin:

*Armend aga në kreje të shkollës
O pilivoni babës
Baba pilivon do ta boje
Asni pilivon qietër mos e zdroje.*

Kthimi i djalit me tren dhe përshkrimi i bukurisë trupore:

*Hena me ni bafçe të mbledh lule
Vin ni pampor dal kadale
O more pampor çish kije në vagon
E kom Armend agën shtatin si fidon
Shtatin si fidon, bulkën me ni onë
Me kondrat e zieza zdretën e vekton.*

Pritja e djalit për tu kthyer nga kurbeti:

*Fishëllon pampori e vikatën
Mo na biesh notën Armend agën
Mo na besh notën o pampori rri
Të na biesh ditën me mizhdexhi.*

Kthimi i djalit nga kurbeti me tren:

*Vin ni pampor tu mi fishëllo
E ka hip Xhevdet dilberi vin tu këndo
Ce mo këndoj mi nono ce mo këndoj
E kom hip pamporin ke shpeja do shkoj.*

*Fishëllon pampori me kronde
Xhevdet aga do na vije sonde
Haj di dalim para dilberit
Do ja morim okat e sheqerit
Haj di dalim para fodullit
Do ja morim okat e llokumit.*

**Përshkrimi i djalit të cilit vasha e fshatit i kërkon
“merhamën”**

*Xhevdet aga në diqon
Kom përmi kom
I ka shko coca e katondit
I gërkon marhom
Coc' moj coc' moj shelafe do t'morim
Për çaj e për kafe
Për çaj e për kafe të na bijsh izmet
Kije honkonien për buk e për pet'
Kije agababën e rij gajlet ç'i t'i hek.*

**Vasha kërkon nga i dashuri i saj që ky t'ia dërgojë
shkuesët:**

*Nxhieshi couca ni skutaçe, skutaçen me flutra
Haj merem be Samir aga se jom shom e hejshme
Se jom shom e hejshme be dilber shko e diftoj babës
çomi shkuzët samir aga tre ditë para javës
Se jom shom e heshet dijlbër shko e diftoj nonës
çomi shkuzet samir aga tre ditë para t'honës*

Të dërguarit e nishanit të nuses:

*Do t'i çojmë nishonet në hase
Ato shkina shoqe ne pjasin
Ndash ne pjasin, ndash ne tagariten
Armend aga ka mor emër merem.
Di çojmë nishonet në arëm jumli sa t'i pjasim
Hasmit andi e këndi
Andi e këndi për okolla
Fëllënza e malit osht e jona
Këndoi: Nazmije Bedriu 64 vjec, 4 vjet shkollë.
Shënoi: Vlora Dauti, f. Çegran – Gostivar*

Këngë nusërie me motiv përshkrimi të veshjes

*Oj lule honëm, mori shtat selvie
Do't çojm' dimija me telivizije
Dimija me telivizije mi se lagoda
Tej lule di çesish nova moda
Oj lule honem oj dilije di vejshish tej së kan hije*

Të kan hije oj pi lule oj se lagoda
 Se dimijat me tilvizije se mi ka shom boja
 Këndoi: Adile Dauti 69 vjecare e pa shkolluar
 Shënoi: Vlora Dauti, f. Çegran – Gostivar

5. Këngë popullore fejese dhe martese në fshatin Veshallë të Tetovës

Këngë fejese:

Po na pajkin lapat e monit
çomi shkusët Hason aga ukolla Bajromit
Po na pajkin lapat e xhethit
çomi shkusët Hason aga ukolla Shënxehtit

E more ju shkus me openga
Na e praut darin drit' e mrenda
E more ju shkus me jemenoja
Na e praut darin te zotnoja
Me na e prau hoj nausen e mir' dë va varim ka ni lir'
Me na ardh nausja e keçe dë va varim ka ni tençe

Shkon termo Hason dilberi me këmajsh me lule
A e bone bofçen hazër oj cauca fodulle
Une bofçen hazër e kom pregadit
Shkusit e Hason dilberit i pres not' e dit'
I pres not' e dit' te pojata
Dë va ap kuferin me kovraka
I pres not' e dit' te avlia
Dë va ap kuferin me shamia

Biri dahires me di duër
Lum të majrën ton' kush e muër
Lum kush e muër e ka pas kismet
Ai xhi deshti s'ën e muër, met me duër n'xhep

Frajni era e na hini mrena
Lulije fëllëzën na e do zemra
Na e do zemra, na e ka pa ftajra
E ka pas kismet ajo e majra

Këngë me rastin e dërgimit të nishanit:

Hason aga raj te dera
Najllon çevren ja mer era

*Najllon çevrja e çenajsme
Ja ka çue ni gjoj dalldajshe*

Këngë me rastin e dërgimit të bohçes:

*Ori po be vdora floçe-floçe
Na a hunxh e majra palon bofçe
Shaum të palojshe e majro shaum të na çojsh
Ene ago babën mos e harojsh
Ene ago baba nauk harohet
I pari n'dari dë palohet
Ene k'to çerapët lule-lule, lule kuj ja ke çue
Une ja kom çue ago babës, drënafile bardh i Hason agës*

Duke vejtur me vekë

*Oj Lulije honëm në razbue
Na i çite ment te tingllue
Ment va kom çit minxhallarve
Te u vijt marhoma agallarve
Ment va kom çit duqonxhive
Te u vit marhoma petkaxhive*

Marrja e masës

*Po kënon bilbili përmas moshën
Oj Lulije honëm na ep mosën
Hajde na ep mosën drënafile e busulegj
Të ka preje ago baba dimia jelek
Hajde na ep mosën drënafile e orgovon
Të ka preje honkonenja dimia minton*

Ndarja e vades

*As mos u hidh e majro, as mos u përdridh
Hajde na ep izën se dë çarojm drith
Izën sën u ap ene sivet
Jom te lujt me shoçet me shaum lezet*

Të qëruarit e drithit

*Da çarojna drithin pi hamarit
Me sheqer të kuç pi Gostivarit
Da çarojna drithin pi sënajkit
Me sheqer të kuç pi Selanajkit*

*As mos u hidh e majro, as mos u përdridh
A të kan dëftaue se dë çarojm drith
Mu më ka dëftaue non e baba*

*Dë çaroje drith Hason aga
Mu më ka dëftaue vëlla deri
Dë çaroje drith Hason dilberi

*Da çarojna drithin me shosha
Majr ta bona ori shoçe dosa
Da çarojna drithin me dërmona
Majr ta bona ori shoçe zona

*Do ta çojna drithin te mullajni
Ori dë martohet hason trajmi
Ore mullajxhi ore hajdut
Drithin e dhondrit mos na e hup
Ore mullajxhi ore hajdut
Drithin e nauses mos na e hup
Me irish nause lulja e duël te dera
Dë ma çarojn drithin njera un e njera
Me irish nause lulja e duël në lom
Dë ma çarojn drithin non mori non
Me irish nause lulja duël te pojata
Dë ma çarojn drithin njera un e ngrata*

Dërgimi i petkave (teshave)

*Di çojm petkaxhijt udhës epër
Dë krajsin pishtollat përstepër
Di çojm petkaxhijt trajdhet e pes vet
Lulije fëllëza raj ngat nonës vet
Raujëm mori non se dom morën
As s'të rauj oj bijo, as s'të prauj
Najsën darsmën gjali për tauj*

Bërja buk për petkaxhinjt

*E mori mahalla kallanxhive
A du bajni buk petkaxhijve
A du bajni ju be derra, a du bajna vet
Vajn ago baba me harxhin e vet
Kafen e sheqerin i ka në xhep*

Bërja e sheqerpaes për petkaxhinjt

*Xhi ka nona nauses xhi hi e xhi del
Njera un e njera sheqerparja nauk ëm del
Nona nauses mos u bon budalle
Bajshe ni temcoj ma të modhe
Atëher sheqerparja do të dale*

Vënja e kë nës

Vine konën me pika pika
 T'kom pas nona bajrak nër çika
 Vine knoën dumonali
 T'kom pas nona zoj shpie ti
 Vine konën e atij derrit
 Leja mollin Hason dilberit

Mësimi i vajzës nga nëna si të sillet me vjehrrën

Non dë losh, non dë xhojsh kaj motër kaj
 Si kjo nona ajo s'osht kaj motër kaj
 Nona t'ka idhnaue motër, ene t'ka pajtaue
 Ajo nona dët idhnoje, barkin dë ta shpoje
 Belan xhi da bajsh oj motër, kitve d'va kallxoje

Nisja e krushqive

Kur di najsim krushët sokakit
 Gjemt e ri përpara bajrakit
 Kur di najsim krushët përpyet
 Gjemt e ri me ka nizat vet

Po të lutem Hason aga, po të baj rixha
 Kur ti najsish krushët te xhamia mos mi ma
 Se shoçet e mia plasin te ka

Bartja e bajrakut

Kush e heshojte sokakin
 çai Hason aga me bajrakin
 Kush e heshojte avlijën
 çai Hason aga me duriën

Pyetja e nuses me çka dëshiron ta marrin (Me qerre katundi, me veturë apo kalë me shalë)?

Me xhi t'vajm tët morëm ori gjoj bilbile
 A me çer katauni, a me limuzin
 Z'due çer katauni ranga-danga
 Due limuzin allafranga
 Z'due limuzin se frajk hupem
 Me kal me shal ma majr dukem

Porositë e vajzës për shpëjarët në prag të shkuarjes nuse.

O njojne nausen o xhi po thot
 Mo ma harojni kalin
 Se me çato dë vaj da mor gjalin

O njojne nausen o xhi po thot
 Mo ma harojni dullakin
 Se çataj e kom dada merakin
 O njojne nausen o xhi po thot
 Mo mi harojni çajzmet
 Se me çato di shëtajti vajset

Martesa: këngë shpotitëse, tallëse nga vashat në shtëpinë e burrit

Kush të përcauëll nause njen në venin ton
 çai vëlla derri, bulkën si kumon
 Kush të përcauëll nause njen te mullajni
 çai minxho derri, musteçe majni
 Kush të përcauëll nause njen në sinauër
 çai dajxho derri, bulkën si kauër

Martesa: këngë shpotitëse, tallëse nga vashat në shtëpinë e babës

Vet deshte shoçe kurvo, vet kie met
 A dish kur më thae t'met skutaçja shkret
 A kitove shoçe kurva se dë vaj opet
 Ne më lasht Hason dilberi nja di a tre net
 Sa ta kajm ni gajle, sa ta kajm ni dert

Në shtëpinë e nuses këndojnë vashat nga ana e dhëndërit që ajo të bëhet gati për tu nisur për një gjysmë ore sipas porosisë së dhëndërit

Hajde nause hajde lule, hajde bonu gati
 Na ka çue Hason aga për ni xhims sahati
 Ori nause lule mas mo çollo
 Hajde hipe kalin, mo na vono
 Thot Hason aga të di sojt të t'i shoh
 Hason aga sojt dë mi shohësh
 Kur dë vaj te taj sën em njohësh

Në shtëpinë e nuses këndojnë vashat nga ana e dhëndërit që ajo të bëhet gati për tu nisur. Këngë shpotitëse, tallëse

Hajde nause hajde lule, hajde hipe kalin
 Leje nause leje lule, leje vëlla shkavin
 Hajde nause hajde lule, hajde hipe gjokin
 Leje nause leje lule, leje vëlla popin

Bërja dhëndër

Da bajm dhondër Hason agën me setre pantulle

*A da begjenajsish ori nause lule
Si se begjenajsi shtat bajrakin
Se dë ma heshoje sokakin*

*Ore Hason aga direki shpis
Hajde hiçi petkat e beqaris
Hajde veshi petkat e dhënëris*

*Për Hason agën xhi mvajn sa keç
O si dë hije në burra pleç
Për Hason agën xhi mvajn idhni
O si dë dahet pi gjemve ri
çiti Hason aga nja di pajka lot
Për nonën tone xhi t'ka desht ma fort*

I këndojnë vashat nuses për hankonenen

*Nausja majr ene gjali majr
Honkonenja shaum e vështajr
Honkonenes do t'ja baj hallin
Vajn akshomi do t'ja mor gjalin*

Hyrja e dhëndërit në dhomë të nusja

*Zhingër-zhingër po ja bon sahati
Mshilne dhondrin se u bo vakti
Zhingër-zhingër po ja bon kusia
Mshilne dhondrin se u bo jacia*

*Hason aga sëkmet e munashta
Si i çite bijat përjashta
Dë shkojna dë flena napër moshna
T'i mushim krajet me kashta*

Këngë për nusen me rastin e futjes në dhomën e dhëndërit

*Hec nause lule, hec me sevda
Oda e Hason agës kërkon temena
Kërkon temena me di duër
Se të kimi nause biluër
Kërkon temena pi për trolli
Se të kimi nause Stambolli*

Thyerja e kulaçit

*Ori nause lule o me sevda
Theje kolaçin me temena*

**Nusja me gjygyim në dorë u shti t'i lajnë duart
shtëpijarëve**

Ori nause lule o me sevda
O mere gjimin me temena
Të na çesësh sojt o me i la
Ori nause lule sërtike, me çit me la sojt taj nok dike

**Këngë shpotitëse, tallëse për nusën si ajo e përgatit
ushqimin**

Hec nause lule, hec me sevda
O mere shkopin me temena
Ori nausja jon lule ftaue
Të na bajsh pet se imi umtaue
Ori nause lule sërtike
Taj me bo pet hiç nok dike
Ori nausja jon lule ftaue
Nona jote hiç s'tpaha mcaue
Ori nause lule xhi bone
Taj temena pse sna bone
Ori nausja jon lulja barit
E pahe inotin si t'magjarit

Fshirja e nuses me netëll

Ori nause lule o me sevda
O mere netllën me temena
Fshoj pak ma heret se dilli ka ra

Vajtja e nuses në krua

Ene nona nauses a hutaue
Ja kimi çit bijën në kraue
Nona nauses mos u bon budalle
Pa dal nër kraue nok o qare

Shënoi: Mamudije Muaremi, f. Veshallë – Tetovë

6. Këngë dashurie

Këngë dashurie me motiv të përshkrimit të veshjes së djalit

Shkon djali mpër odhe xdretën e veton
Me kndrat e zeza fakëllojshin
Çarapët me tel xixëllojshin
Çarapët më tel xixëllojshin
Dorët e fëllonzës e marojshin

Adile Dauti 69 vjecare e pa shkolluar

Këngë dashurie me motiv të vardisjes së vashës

*Shkova në livadh të koseti
 Erdh ni coc e mer më smetejti
 Ni coc e mer tu mledh lala
 Tu erdh dal kadale
 Hiçu ovarbare mos u smetejt
 Se ma lae livadhin pa koset*

Adile Dauti 69 vjecare e pa shkolluar

Këngë dashurie me motiv përshkrimi të bukurisë së vashës

*Shkon coca për odhe zdretën e vekton
 O mi djali ri shom e don
 Shom e don cocen se mi ish qibare oj vardare*

Adile Dauti 69 vjecare e pa shkolluar

Këngë dashurie me motiv qortimi të vashës nga ana e prindërve

*Hipa me ni moje moli
 E xhexha follonxen e molit ku të shajshin tej
 Ku te shajshin tej moj emër mera
 Tej ke shkou ke zotneja*

Adile Dauti 69 vjecare e pa shkolluar

Shënoi: Vlora Dauti, f. Çegran – Gostivar

a) Këngë dashurie të fshatit Forinë - Gostivar

Kënga flet për preokupimin e vashës së dashuruar me një djalë, por që këtë dashuri të tyre e pengon nëna e saj. Fundja është të bërit **“munxhi”** nënës që të mos dalë në mëhallë për ta marrë djalin që është **“ovardar”**. Variantë tjetër e të bërit “munxhi” nënës nga ana e vashës që ajo të mos dalë “n’kujshi” dhe kështu të ia arrij qëllimit vasha me djalin e ri:

*Te i ri e un’ e re
 kë do bojm’ be gjal’
 s’na la nona me u mor
 more ovardar.
 Di bojm’ nonës ni munxhi
 mo dale n’mihall’
 do t’a mor une at’ gjalin
 se osht’ ovardar.
 Di bojm’ nonës ni munxhi
 mo dale n’kujshi*

*do t'a mor une at' gjalin
se osht' gjal i ri.*

(Do t'a mor une at' gjalin se oshte i ri)

Kënga rrëfen për ngjyrosjen e përparses së vashës ngjyrë sutliashi për hirë të djalit që e dashuron shumë. Dashuria e saj matet me florinj të veshit dhe se as nëna as babai nuk e kanë kuptuar këtë sekret. Kjo të lë të kuptosh se as prindërit s'kanë çka i bëjnë kësaj dashurie të madhe:

*E nxhiesha skutaçen si siltiash
xhon hak be dilber aga
shom të kum dash.
Shom të kum dash be dilber
si lirat në vesh
nona ene baba
s'un na morën vesh.
S'un na morën vesh
o more deli
nona ene baba
s'un na ren' karshi.*

(E nxhiesha skutaçen)

Kënga tregon për djalin e ri që shkon në shkollë të cilin e dashura e tij e përsëndet për çdo ditë duke e vonuar në orë të mësimet. Halli është se si t'i përgjigjet mësuesit për ta justifikuar vonesën?! Djali do të zgjedhë të vërtetën duke i treguar **”ç'agje përti me ni vetull holl”**:

*E mor çontën gjali
i ka dal dashnorja para po ja bon me dor'
hiçu mi dashnore mos më smetet
jom tu shko në shkoll
collët jon' rëndet.
Collët jon' rëndet, kan' he me mëso
do më pese mësousi te ku je vono
do mo pese mësousi ku ke met kaç von'
ç'agje përti me ni vetull holl.*

(Vetull holla)

Kënga bën përsëkrimin e vashave në një bahçe të veshura me fustana kadife **“laçe-laçe”** të cilat janë në pritje që të dashurit e tyre t'u dërgojnë mësitët. Por këta nuk i dërguan dhe nënat e tyre e diktuan sherrin që kanë bërë me këtë rast:

*Ishin ni trom' coca në has bafçe
fostonat kadife laçe-laçe,
fostonat kadife ni çeshete boj
preita shkuzët ç'e çaj gjali nok mi çoj.*

*A se shef be dilber se nona më diktoj
nona më diktoj pi sheherllëkut
t'u ja vu sahonat e teherllokut.*

(Nona më diktoj pi sheherllokut)

Kënga rrëfën për përvëlimin dhe dashurinë e madhe që ka vasha për të dashurin e saj që e quan herë **"dilber aga"** e herë **"sulltan"**. Kjo është duke u kujtuar vetëm me **"hulajat"** e tij që janë i vetmi satisfakcion që **"mendja si del"** apo i shkon **"pirishon"**:

*Sa të du be dilber aga
përvëlohem o,
me hulajat toja dilber
sëll kujtohem o.
Me hulajat toja o more dilber
me nok qon' hulaja jote
mu mendja më del.
Me hulajat toja o more sullton
me nok qon' hulaja jote
mendja pirishon.*

(Hulajat e dilbierit)

Kënga këndon për vashën e bukur të djalit që kërkon nga **"e mera"** mos të ruhet se e kanë pëlqyer njëri-tjetrin, janë të gatshëm për tu marrë dhe se me këtë rast janë vetëm ata të dy:

*E due të merën
sa çu duhet
e mera pi mije
ne mo ruhet.
Mos u ruj e mero
po shko sallëm
imi begenes
po jemi morën.
Na ke begenes
po na ke erdhun.*

(Shkon e mera t'u u rujtun)

Djali e thërret vashën **"oj çaf-hajmali"** dhe e pyet **"Kujt ja çëndes hase çevren oj se sirmelije"** vasha i përgjigjet **"ja çëndesi ati gjalit të ja çoj hedije"**. Por pyetja dhe përgjigja nuk përfundojnë me kaq. Djali sërish e pyet të dashurën e tij **"vetull gajton"** për të marrë përgjigjen përfundimtare **"ja çëndesi ati gjalit të ja çoj nishon"**:

*Oj çaf -hajmali, oj çaf -hajmali
kujt ja çëndes hase çevren*

oj se sirmeli.
 Kujt ja çëndes hase çevren
 oj se sirmelije
 ja çëndesi ati gjalit
 të ja çoj hedije.
 Kuj ja çëndes hase çevren
 oj vetull gajton
 ja çëndesi ati gjalit
 të ja çoj nishon.

(Kuj ja çëndes hase çevren)

Kënga paraqet vashën e cila ka hipur në një maje të malit për të ndezur zjarrin. Por ka rënë shiu dhe ka fryr një erë e lehtë, zjarrin s'ku mundur dot ta ndezi vetë. Rrugëdalja e vetme është dashuria e cila është e ndezur përherë, nuk njeh as erë as shi, por njeh **“fodull agën e ri”**, duke ndenjur të dy me të dashurin **“ndër ni trëndafil kadife”**:

Hipa me ni moje moli
 nok më niezi zarmi
 era frente, sheni binte
 zarmin nok m'a linte.
 Oni be fodull aga
 se jemi të ri
 ndër ni trëndafil kadife
 do rena të di.
 Ndër ni trëndafil katmer
 do rena përher.

(Do rem' të di ndër ni trëndafil)

Djali i këndon vashës së bukur duke kërkuar prej saj njërin sy me gjithë vetull. Vasha i përgjigjet me fjalët **“Senin s'un t'a ap se do qerohem/ Vetllën s'un t'a ap se do shumtohem/ Pa senin e zi nose s'un bohem”**:

A mori e mera për tepër
 Nama njonin sej me gjeth vetull
 Senin s'un t'a ap se do qerohem
 Vetllën s'un t'a ap se do shumtohem
 Pa senin e zi nose s'un bohem.

(A mori e mera)

Djali i këndon vashës **“ovardare”**, **“Retju ati gjali dal-kadale”**. Vasha i përgjigjet me fjalët: **Se do retem nok do bohem qetër/ Jom si lira sukullot me letër**. Po kështu kënga thotë: **Ene se do retem javash-javash/ Mori jom si lira me sinxhir në çaf**. Këtu përshkruhet rritja e vashës lozonjare, pamja, bukuria e saj që krahasohen me lirën dhe zinxhirin prej ari që i rrijnë bukur në qafë:

*A mori te coco ovardare
Retju ati gjali dal-kadale.
Se do retem nok do bohem qetër
Jom si lira sukullot me letër.
Ene se do retem javash-javash
Mori jom si lira me sinxhir në çaf’.*

(Hajde mori coco retu dal-kadale)

Vetë titulli i saj “di karanfila” simbolizon vashën dhe djalin, rininë e tyre, dashurinë, që krahasohen me bukurinë e lules dhe të karafilit që kurorëzohet me martesë. Vashës me hijeshinë e saj si lulja manushaqe s’mund t’i gjejsh dot asnjë të mete, pasi djali “**fodull aga**” e ka këputur me dorën e vet si “**karanfili në bafçe**” e “**karanfili n’saksi**”. Lumturia, kënaqësia dhe bukuria e tyre paraqitet e dyanshme:

*Na kan çel di karanfila
di lule kumone,
de morëm cocën delie
pa kurni behone.
Pa kurni behone
lulja manushaqe,
e kpote be fodull aga
karanfil në bafçe.
Karanfil në bafçe
karanfil n’saksi,
u poçëm be fodull aga
të hieshëm të di.
Karanfil në bafçe
karanfil në dru,
lumi te be fodull aga
çi më more mu.*

(Na kan çel di karanfila)

Vashat këndojnë dashnoren e djalit “**fodull aga**” e cila është e veshur me këmishën basëm, duke e porositur që t’i vë ojat e “**kovrakut**” dhe të bëjnë dasëm. Po kështu asaj i këndojnë kur është e veshur me bluzën najlon “**haj do boj m nishon**”. Kënga pyet vashën emërmirë me ç’do të këmbehet nishani, përgjigjja është: **un’ me bofçe t’modhe dilbier/ te sère me lira**. Por kur pyetet sërish emër rënda, përgjigjja tjetër është se: **un’ bofçe të modhe dilbier/ te sère me fronga**:

*Oj dashnorje fodull agës
me këmeshën basëm
veni ojat e kovrakut
haj do bojna darsëm.
Oj dashnorje fodull agës*

me bluzën najllon
 veni ojat e kovrakut
 haj do boj m nishon.
 Me ç'do ta ndrojm' nishonon
 mori emën mira
 un' me bofçe t'modhe dilbier
 te sere me lira.
 Me ç'do ta ndrojm' nishonin
 mori emën rond'
 un' bofçe të modhe dilbier
 te sere me fronga.

(Oj dashnorje fodull agës)

Kënga tregon për vashën e bukur dhe “**delije**” e cila është e dhënur mjaft pas djalit “**fodull aga**”. Vashat që i këndojnë i thonë asaj: **Ne i'je tapkone coco mo lisho ishta/ jazijën e Zotit hala se ke pa**. Përgjigjja e saj është se “**jazijën e zotit**” e di vetë dhe fati i saj është vetëm “**dilber fodull aga**”:

*Mori coco sa delije qonke
 mas fodull agës shom tapkone.
 Ne i'je tapkone coco mo lisho ishta
 jazijën e Zotit hala se ke pa.
 Jazijën e Zotit une e di vet'
 dilber fodull aga mu boft kësmet.*

(Mori coc' delije)

Kënga përshkruan veshjen e vashës me “**këmëshën pembe**”, por halli është se a e do nëna e djalit si të tillë? Problemin e këtij halli e zgjidh vetë vasha e cila “**Asaj nonës fodull agës do t'i çoj ni lule**” dhe nëse e do “**fodull aga**” i saj edhe nëna e tij do ta dojë. Alternativa tjetër është se “**Asaj nonës fodull agës un' di çoj ni lale**” dhe nëse e do “**fodull aga**” asaj do t'i thotë hiç mos ki gajle! Dhe në fund vasha thotë se “**Asaj nonës fodull agës di çoj ni selom**” nëse më do “**fodull aga: te dom dush ma shom**”:

*Mori coco me këmeshën pembe
 ta pes a të don kjo nona jeme.
 Asaj nonës fodull agës do t'i çoj ni lule
 si tëm dute fodull aga
 ene te dom dush.
 Asaj nonës fodull agës un' di çoj ni lale
 si tëm dute fodull aga
 te hiç mo ki gajle.
 Asaj nonës fodull agës di çoj ni selom
 si tëm dute fodull aga
 te dom dush ma shom'.*

(Mori coco me këmeshën pembe)

Kënga bën fjalë për vashën „**ovardare**” që është duke ndenjtur në ballkon të babës së saj dhe prej djalit të ri kërkon një fotografi. Fotografia është shenjë dashurie dhe kujtimi që ka ajo për të dashurin. Dëshiron ta ruaj fotografinë në valixhen e saj apo në gji për të mos ia harruar hijen „**dylberit**”:

*Coca ovardare
në ballkon të babës vet
pi ni gjali t’ri
gërkon ni siret.
Gërkon ni siret
ta maje n’kufer
mos ta harroj hijen tonde
a more dilbier.
Gërkon ni siret
ta maje në xhi
mos ta harroj hijen tonde
o te gjali i rri.*

(Coca ovardare gërkon ni siret)

Kënga paraqet vajtjen e djalit tek shtëpia e të dashurës dhe kërkon t’i dale përpara „**vetull holla si peni**” mos ta hajë qeni. Vasha i përgjigjet se tri orë para mëngjesit qenin e ka lidhë, por kur „**kapërcei fodull dilbieri/ zemrën ma ka dridh**”:

*Mori vetull holla si peni
dilëm para mo më haje çeni.
Tre sahat para sabahit
çenin e kum lidh
kapërcei fodull dilbieri
zemrën ma ka dridh.
Tre sahat para sabahit
çenin e kom k’to
kapërcei fodull dilbieri
zemra m’ka trishto.*

(Kapërcen fodull dilberi)

I këndohet vashës herë si vetullhollë e herë si vetulltrashë që është rritur për beg e për pashë. Vasha thotë si begu ashtu dhe pashai i kanë dërguar mësit, por tek djali i ri „**baba m’ka hujdis**”:

*Mori vetull holl’
mori vetull trash’
qonke rret për bieq
qonke rret për pash.
Biegu më ka lip
pasha më ka lip
ke çaj gjali rri
baba m’ka hujdis.*

*Biegu m'ka gërko
pasha m'ka gërko
ke çaj gjali rri
baba m'ka vendo.*

(Mori coc' sa qonke rret)

Kënga përshkruan dashurinë dhe merakun e vashës për djalin **"fodull aga"** të cilin kur vinte në shkollë me shikimin magjik se linte rehat: shumë me vrull mësonte, stilolapsin e coptonte, zërin e gojës kur ia dëgjonte:

*Të dojsha be fodull aga
të kisha merak
kur vishe ke shkolla
s'të lisha rahat.
Të dojsha be fodull aga
të dojsha
kur vishe ke shkolla
të çëllojsha.
Shom' me ishte dilbier mësojsha
penkallën e dorës e captojsha
zonin e gojës kur ta ngjojsha.*

(Të dojsha be fodull aga)

Kënga pasqyron djalin i cili s'është rehat derisa e pyet vashën me sytë e zinj si rrushi: cëllën begenese te bije nonës bij? Përgjigjja e vashës është se e ka pëlqyer **"fodull agën"** dhe është e lumtur se **"e man' bulkën me ni on"**, se kur ia hedh sytë ai të shkryn:

*Andi vi e këndi vi
more rosh o rosh i zi
cëllën begenese te bije nonës bij.
Begenesa fodull agën
Non' e lumja non'
e man' bulkën me ni on'
non' e lumja non'
kur ja fugën set' të shkren
non' e lumja non'.*

(Begenesa fodull agën)

Kënga paraqet djalin i cili është duke ecur rrugës **"hije napër hije"** dhe se shumë i ngjajnë **"dilbierit"** xhinset **"mavije"**. Djaloshi porositet që t'i mbajë veshur rregullisht këto dhe **"pi cocës katondit dilbier dorën mos e hiç"**, pasi vasha e fshatit ka shumë **"iftibar"** dhe **"kur mi hen ndër shoçe si kali me shal"**:

*Shkon për odhe çe'çaj gjali
hije napër hije
shom hije i kan' dilbierit
farmerkat mavije.*

Farmerkat mavije dilbier
 baj' e mos i çit
 pi cocës katondit dilbier
 dorën mos e hiç.
 Dorën mos e hiç
 dorën mos e ndal
 se coce katondit dilbier
 ka shom iftibar
 kur mi hen ndër shoçe
 si kali me shal.

(Pi cocës katondit dilbier dorën mos e hiç)

Kënga tregon vashën gojëmbël që është e lumtur se babai do ta përfillë dëshirën e saj për fejesë. Nga admirimi ajo i uron babës parajsën pse do ta fejojë me një djalë të mençur që e ka dashur që në bangat e shkollës:

Mori goj sheqere, goj llokume
 do më ape baba ku du une
 babës i kum thon' e xhiet xhenetin
 do ma apësh at' gjal sheretin
 babës i kum thon' shpena posht' mo t'raft
 do më apësh për at' gjalin
 në shkoll' e kum dasht'.

(Mori goj' sheqere)

Kënga tregon vashën e cila kërkon takim me djalin në vendin e njëjtë „**dil ku dole prom**“ për ta lidhur dorën e besën „**me mindil najllon**“. Vendi i takimit për të biseduar dhe njohur me njëri-tjetrin është ndër një hije apo errësirë larg syve të botës. Vasha ka informacione se djali i saj qenka i fejuar! Përgjigjja e djalit është se „**Nok fejohem une mori vetull holl/ nok e harroj besën ç'i ta kum dhon**“:

Dil ku dole prom' be gjalo
 dil ku dole prom'.
 De lidhim dorën e besën
 me mindil najllon .
 De lidhim dorën e besën
 ne të di ndër hije
 sa të shof be dilber aga
 ç'far jazije kije.
 Te paske be fodull aga
 jazi të shkollomun
 erdhën e më than' be dilbier
 se ije fejomun.
 Nok fejohem une
 mori vetull holl

*nok e harroj besën
ç'i ta kum dhon.*

(Dil ku dole prom')

Kënga paraqet vashën që i këndon djalit i cili është duke e shaluar dhe se **"cocën e katondit"** e ka hutuar. Ajo ankohet se e ka mashtruar, nuk i ka dërguar mësit dhe nuk e ka marrë, por **"more hase çevren e ja grise"**:

*A more te gjal, a more te gjal
ati kalit mer' kur i vone shal'.
Kur i vone shal' e shalove
cocën e katondit e hutove
e rene e rene nok e more
More k'mesh treviri e ja çove.
Kur i vone shal e shalite
cocën e katondit e smetete
e rene e rene nok e lipe
more hase çevren e ja grise.*

(More gjali katondit)

Kënga rrëfen për vashën vetullhollë që është duke ndenjtur në dritare dhe bën oja, por një djalë nuk e lë rehat duke i hedhur herë me ftoja e herë me molla. Vasha pyet djalin pse e nget, pasi **"me t'pa baba ene nona del ene të vret"**:

*Coca në dollap maron oja
Çe'çaj gjali i fugën me ftoja,
coca në dollap vetull holla
çe'çaj gjali i fugën me molla.
Çe'çat vetull hollën
o gjal ce e nget
me t'pa baba ene nona
del ene të vret.*

(Coca në dollap maron oja)

Kënga pasqyron djalin i cili shkon për rrugë duke u kujtuar, por e dashura e dikton hidhërimin e tij dhe i thotë: **Ngreje bulkën se set' t'jon qeromun**. Vasha i arsyetohet të dashurit se letrën që ia ka shkruar ai nuk ka patur mundësi t'ia kthej. Djali me anë të letrës i kërkon takim vashës që e quan herë vetullzezë e herë vetulltrashë. Sinonimi vetullzezë simbolizon takimin kur do shkojë ajo tek tezja, ndërsa vetulltrashë kur do shkojë te daja:

*Shkon gjali për odhe tu kujtomen
Shom' qonke be gjal i idhënomen
Ngreje bulkën se set' t'jon qeromun.
Bulkën gjalit po ja mirte era
Letrën ç'i ma çove s'un t'a fkeva.
Në at' letrën tonde dilbier shkrojshe nja di fjal'*

*A oshte e mondmja coco në takim me dal.
Do dalim n'takim mori vetull zeza
Do t'paraqitem gjalo kur do shkoj ke tezja
Do dalim n'takim mori vetull trasha
Do t'paraqitem gjalo kur do shkoj ke daja.*

(Letra e gjalit)

Vashat janë të merakosura për kujdesin e përgjithshëm të djalit në shtëpi, ata e quajnë „**dilbier**” kur ai vinte nga shkolla me çantën lulemolle. Përgjigjja e djalit është që të mos merakoset aq shumë vasha vetullgajtan se „**e kom nonën meraklije mu më ren në kom**”:

*Çonta e gjalit diega lule molle
kush të bon izmet be dilbier
te kur vin' pi shkolle.
Mos e baj te gjith' at' gajle
oj vetull gajton
e kom nonën meraklije
mu më ren në kom'.*

(Çonta e gjalit diega lule molle)

Djali i këndon me shumë afsh vashës së Çegranit duke ia kërkuar takëmin e duhanit – cigarellëkun prej qelibari: **Freni era e Çegronit veri-veri/ që ma bone qilibarin e mero mori**. Vasha e veshur me xhaketë „**xhomli najllone llastik në mjedis**“ i përgjigjet djalit „**fodull aga**“ që aq shumë i është vardisur se qelibari i tij është i paluar në dyshek. Kjo është dakord me vardisjen e tij që dëshiron me e marrë, por këmbëngul në seriozitetin e kësaj pune „**mo na dalën fjal**“. Fjala mori dhenë, ajo kur arriti gjer në Selanik, thuhej se „**fodull agës d'ja morim vresnekun**“, kur arriti në Bukuresht u tha se „**fodull agës do ja morim eshin**“:

*Freni era e Çegronit veri-veri
që ma bone qilibarin e mero mori.
Qelibari jot pal' e në dishek
heni vera duvel vera
coca me xhaket.
Xhaketja xhomli najllone
llastik në mjedis
amënot be fodull aga
shom' ije vardis.
Shom' ije vardis be dilbier
te don me më mor
amënot be dilbier aga
mo na dalën fjal'.
Fjala duvel mor' Selanekun
fodull agës d'ja morim vresnekun*

*fjala duvel mor Bukureshin
fodull agës do ja morim eshin.*

(Mos mu vardis be dilbier aga)

Kënga bën fjalë për vashën “**delije**” me flokët e ngjyrosura me këne që është duke bërë oja ndër hije. Pra përshkruan pamjen, bukurinë dhe punën e saj. I dashuri i saj “dilbieri” dëshiron të ia “**rriumulloj**” flokët e ngjyrosura për bukuri duke e marrë “**lulen**” e tij përpara që duket si një zonjushë e vërtetë:

*Oj coca delije
bon oja ndër hije
i pikoj lules shameja
fjokët konalije.
Fjokët konalije
të lime me boj'
po m'i thot' dilbieri
do ja rriumulloj.
Do t'a mor lulen përpara
si dëni gëspoj.*

(Coca delije bon oja ndër hije)

Vashat i këndojnë djalit duke e krahasuar me guguçen që fërfëllon dhe hip në ballkonin e djalit duke kënduar. Pra korespondenca e vashës me djalin bëhet përmes guguçes. Kur kjo hip në degë të arrës, vasha i dërgon përshëndetje djalit “**përtinës babës**”, kur kjo hip në degë të thanës, ajo i dërgon përshëndetje “**përtinës nënës**”. Në fund e porositi të dashurin e saj të mençur se do t'i dërgojë përshëndetje rregullisht, por nëse e diktojnë prindërit, atëherë “**diel ene më vret**”:

*Fërfulloj gëgufcja
fërfulloj e fërfulloj
në ballkon të ati' gjalit
hipi e këndoj.
Hipi e këndoj në deg' të arrës
do t'çoj selom përtinës babës
hipi e këndoj në dieg' të thonës
do t'çoj selom përtinës nonës.
Do t'a çoj selomin
o te gjal sheret
me më dikto baba-nona
diel ene më vret.*

(Selomi i cocës)

Kënga paraqet pamjen dhe tiparet e vashës me “**hajmali në çaf**” dhe rrethanat e zhvillimit të ngjarjes gjatë shkuarjes për të korrur “**ke çaj gruni bardh**” ku ka mbirë një dardhë. Del në skenë

djali i ri i cili kapërcen aty pranë me “**alldurinë**” që i bënte 1000 lira kali me shalë dhe i thotë “**pon’ e mar’**”:

*Oj dora ragush
hajmali në çaj’
haj do shkojm’ do korim
ke çaj gruni bardh’.
Ke çaj gruni bardh’
na ka bi ni dardh’
kapërci ni gjal i ri
më tha pon’ e mar’.
Më tha pon’ e mar’ ji erdomxhija
1000 lira i bon’ alldurija
më tha pon’ e mar’ ke arre babës
1000 lira i bon’ kali shalës.*

(Haj do shkojm’ ke gruni bardh’)

Kënga pikëzon djalin e ditur, pamjen dhe bukurinë e tij që krahasohet me borzilokun dhe në anën tjetër vashën që është moshatere me te. Vasha këndon për shkollimin e djalit në shkollë fillore dhe të mesme me dëshirën që “**do na dale ç’e çaj gjali profesor i ri**” dhe do t’i mësojë të gjitha vashat. Por ky ka hallin e të dashurës së tij se është shakaxhie dhe do ta pengojë gjatë procesit të mësimt:

*Busuliek açik
busuliek açik
dal t’a pes’ at’ gjalin
a e kom vresnek.
Vet’ ije pismen be gjalo
po te vet’ e din’
4 vjjet në shkoll fillore 4 gjimnazi
do na dale ç’e çaj gjali profesor i ri.
Profesor i ri do na mësoje
kit’ cocat e kursit do t’i këndoje
s’un i këndoje cocat une pi tije
dom çeshish mori shakaxhije.*

(Gjali pismen)

Kënga nxjerr në pah tiparet dhe vetitë bezdisëse të djalit ndaj vashës i cili i vjen tek dera asaj pa e thirrur. Ai duket si “**bilbili teleisun**” por i vështirë në synimet e veta dashurore:

*A more bilbili teleisun
ç’aj gjali qonka i bezdisun
më vinte ke dera pa e grishun
ç’aj gjali qonka i vështer’
më vinte ke dera pa e therun.*

(Gjali i bezdisun)

Kënga shfaq mendimet e djalit mbi vashën e bukur syzezë e sylarë që „**n'aj thajti dushnjët o në mol o**“. Vasha tregon se „**dushnjët mi jon' thajt' pi havajës**“ për shkak se rritet ky djali prej sevdasë që ka ndaj saj, prandaj kjo i thotë „dilbierit“ se „**nok t'i thajta un' t'i thajti era**“ dhe se këtë djalë ma do zemra:

*Sej zezo mori sej laro
si n'aj thajte dushnjët o në mol o.
Dushnjët mi jon' thajt' pi havajës
rretet ç'e çaj gjali pi sevdajës
nok t'i thajta un' t'i thajti era
dilbier ç'e çat gjalin ma don zemra.*

(Ç' at' gjal' ma don zemra)

Kënga shpalos bukurinë e flokëve të gjata të vashës e cila i krehte tek „**kapixhiku**“ mu në çastin kur aty pranë kapërceu djali. Djali habitet duke e kthyer kokën prapa dhe i thotë „**mashalla sa fjokët e gjata**“. Nga tërheqja e vëmendjes shkon në xhami për t'i shkruar vashës dy hajmali „**me boj' more**“, por ajo i lëvdohet djalit se „s'un më more“. Kur tenton për së dyti t'i shkruaj tek hoxha „**hajmalijën me boj' pembe**“, ajo tani do t'i thotë „**gjal me hajmalija s'un më rene**“:

*Krefi coca krejën në kapixhik
kapërciu ç'aj gjali ene u çudit.
U çudit e më çëlloj përmapa
mashalla sa fjokët e gjata.
U çudit e më shkoj ke xhameja
shkoj t'ëm shkroje n'ja di hajmalija.
Shkroje hajmalijën me boj' more
gjal me hajmalija s'un më more.
Shkroje hajmalijën me boj' pembe
gjal me hajmalija s'un më rene.*

(Coca me fjokët e gjata)

Kënga flet për vashën syzezë që duket si lulebari e cila është duke shëtitur kah **Vardari**. Këtu dëgjon një zë të një djali që është duke biseduar me shokët e vet. Vasha mahnitet nga djali që e thirri i cili për te është më i mri:

*Sejzeza sej lule bari
haj do shkojm' teposh'
ka bash Vardari.
Mu ka bash Vardari
jalla kush më thret
ene ç'e çaj gjali
me shokët e vet
ene tu bo llaf
tu bo muhabet.*

*Mu ka bash Vardari
kush më thejri
ene ç'e çaj gjali ma i meri.*

(Kush më thejri ka bash Vardari)

Kënga tregon djalin e shkolluar dhe miken e tij që sillet me dashuri e me ngrohtësi. Vasha vetullzezë e fshatit është e merakosur për të dashurin se është duke lexuar gazeta dhe duke mësuar shumë, e porosit këtë që të vë syza për të mos u verbuar:

*Hena me ni od' dierën pi xhomi
ate m'çonte ç'e çaj shkollovoni
ate m'çonte lexonte gazieta
coca e katondit vetullzieza
coca e katondit sëll kujtohet
veni dilbier sizat mo qerohesh.*

(Gjali shkollovan)

Kënga përshkruan bukurinë e vashës, flokët e zeza të saj, karafilat e ngulur në brez. Vasha do një djalë dhe karafilin e bardhë që i vjen një erë e këndshme thotë **"s'kom mas kujt ta çoj un' e mjiera"**. Edhe djali ka të njëjtin hall, nuk ka pas kujt t'ia dërgojë karafilin? Vjen porosia e vashë që thotë **"vene be fodull aga vene me ni dru/ të freje veriu sabahit do ma bjere mu"**. Djali do t'i thotë mikes së tij se **"veriu nok ta bie, veriu nok ta bie/ oj te coca ovardare kush e din ku ije"**:

*Mori coco me fjokët e zieza
nguli karanfilat napër brieza
karanfilit t'bardh i vin era
s'kom mas kujt ta çoj un' e mjiera
vene be fodull aga vene me ni dru
të freje veriu sabahit do ma bjere mu
veriu nok ta bie, veriu nok ta bie
oj te coca ovardare kush e din ku ije.*

(Nguli karanfilat në briez)

Kënga është e krijuar me shije të hollë për nga veçoritë e larta artistike. Është një pasqyrim i mirëfilltë i synimeve dhe dëshirave të familjes së djalit për të marrë nuse të bukur **"delije"**, me flokë të gjata **"si lulja tu çiel"**. Duke e vështruar këngën në paralele, sipas zakonisht flokët e gjata të nuses me vetullat gajtan do të mbushen **"pjot me mendurije"**. Sigurisht se nga specifikat e kushtëzuara nga përfillja e islamizmit mendurijet prej ari janë të ndaluara, siç thotë kënga **"se me mendurije nok dilet n'majdon"**:

*A more dilbier, a more dilbier
do ta morim nosen si lulja tu çiel
si lulja tu çiel me fjokët e gjata
kur do hecje de çellojm përmapa*

*mashalla sa fjokët e gjata.
Ene fjokt e gjata oj delije
do t'i mushi pjot me mendurije
oj coca delije oj vetull gajton
shiqir mendurijet çu u bon zabron
se me mendurije nok dilet n'majdon.*

(Do ta morim nosen si lulja tu çiel)

Kënga është e përshkuar me shprehje emotive të dashurisë që shpërthejnë nga zemrat e dirlta të dashurisë së vashës dhe të djalit si bie fjala **"kur do shkojsh termo be dilbier çëllo pak okolla"**. Fjala është se diku mbi hambar është duke punuar vetullholla **"ni gajton jeshil"** dhe nëse nuk e merr djalin e zemrës do të bëhet **"sil"**, apo kur **"punon vetull holla ni trabzon të bardh"**, nëse nuk e merr këtë djal do të mbytet në **Vardar**:

*Kur do shkojsh termo be dilbier
çëllo pak okolla
ç'agje maj hamar be dilbier
punon vetull holla.
Punon vetull holla ni gajton jeshil
si mos e mor ç'e çat gjalin un' do bohem sil
punon vetull holla ni trabzon të bardh
si mos e mor çeçat gjalin do metem n'Vardar.*

(Kur do shkojsh termo be dilbier çëllo pak okolla)

Kënga tregon se as djemtë nuk janë gjakftohtë ndaj botës lozonjare të vashës së fshatit **"ç'e çaj gjali nok të mer për hije/ të ta pruobje menden si e kije"**. Për këtë arsye, vërehet se dashnorët janë shumë vigilent me njëri-tjetrin: **"pruobja menden tabihatin/ o kinxhi me lara"**. Këta i vërejmë duke u përpjekur për t'u njohur e afruar, moment që krijon bazën për lindjen e dashurisë, me qëllim që **"mo të thoen shokët n'kafe/ o dashnorja jieme"**:

*Oj coce katondit oj delije
mos kujto se sëll te n'dinjo ije
ç'e çaj gjali nok të mer për hije
të ta pruobje menden si e kije.
Pruobja menden tabihatin
o kinxhi me lara
mo të thoen shokët n'kafe
e kum dash' ma para.
Pruobja menden tabihatin
o kinxhi bieslieme
mo të thoen shokët n'kafe
o dashnorja jieme.*

(Pruobja menden cocës)

Kënga tregon nisjativën e dashurisë së vashës për djalin që e quan **“fodull aga”** kur zemrat rinore kaplohen nga zjarri i hyjnisë së dashurisë. Por, droja është se a thua vallë do pajtohen nëna dhe baba dhe po qe se ata nuk janë dakord, atëherë vasha i thotë të dashurit: **hen merëm me zort**. I dashuri nuk është i gatshëm ta grabisë, por dëshiron t’i dërgojë vashës mësit: **un’ do t’i çoj shkuzët/ do vin’ do të lipin**. Vasha pajtohet me veprimet e të dashurit të saj, vetëm e vetëm sa t’i shohin nëna dhe babai dhe **“sa t’mi shofin shoçet e meja”**:

*Sa të du be fodull aga
Un’ të dua fort
me nok m’dhon nona e baba
hen merëm me zort.
Nok të mor me zort
nok jom gjal xhipi
un’ do t’i çoj shkuzët
do vin’ do të lipin.
Çomi shkuzët dilbier fodull aga
sa t’mi shofin nona ene baba,
çomi shkuzët more gjal zotneja
sa t’mi shofin shoçet e meja.*

(Do t’i çoj mi coco shkuzët)

Kënga tregon për ndërrimin e kushteve jetësore dhe ndryshimin shoqëror në parësi të familjes së djalit **“gjal’ pi qehaje”** dhe në vegjëli të familjes së vashës **“coc’ fukaraje”**. Edhe këngëtari popullor e dallon një botëkuptim të tillë të përkatësisë klasore në të pasur dhe në të varfër **“coce fukarajës s’ën boje ke ne/ se s’ën i ngarkoje traktorat me pjie”**. Familja e djalit kërkon një nuse ku spikasin veçoritë fizike të botës femërore, të jetë e derës së madhe, e bukur, e shëndoshë, e aftë për punë, se **“coce fukarajës s’ën boje ke un’/ se s’un i shkarkoje traktorat me grun”**:

*A more te gjal’ pi qehaje
nok ije për coc’ fukaraje
coce fukarajës s’ën boje ke ne
se s’ën i ngarkoje traktorat me pjie
coce fukarajës s’ën boje ke un’
se s’un i shkarkoje traktorat me grun’.*

(Nok imi për coc’ fukaraje)

Kënga flet për lidhjen e dashurisë së vashës dhe caktimin e pikëpjekjeve martesore. Ndonëse vërehet përdorimi i monologut në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve e herë-herë edhe të tablove të situatave **“ngata krejën në penxhere/ k’pota lule vere”** ose **“ku do shkojsh ku do martohesh/ moj coca esmere”**, skaliten fuqishëm marrëdhëniet e dashnorëve në të gjitha sferat e interesit

të tyre. Në portretizimin e botës femërore të denjë për dashuri, spikasin krahasimet dhe epitetet e qëlluara mirë: **coca esmere, emën mira, emën bukra** etj.:

*Ngata krejën në penxhere
k'pota lule vere
ku do shkojsh ku do martohesh
moj coca esmere.
Ku do shkojsh ku do martohesh
mori emën mira
un' do ta mor ç'e çat' gjalin
se do baj shom lira.
Ku do shkojsh ku do martohesh
mori emën bukra
un' do ta mor ç'e çat' gjalin
do baj shom' boçuka.*

(Ku do martohesh mori coc' esmere)

Tek kjo këngë gjejmë idealin estetik dhe atë të bukurisë së femrës ku janë reflektuar drejtpërdrejtë në kushtet konkrete jetësore si p.sh.: **fodull aga, do bajsh takon, do bajsh tasfes, peslirat në çaf, di lirat në vesh**. I riu dhe e reja duhen pa djallëzi, me gjithë zemër, përpiqen të kenë një jetë bashkëshortore të mirë në rrethanat e njëmendëta jetësore:

*Oj coca me non',
oj coca me nom'
hajde ke fodull aga
te do bajsh takon
te do bajsh tasfes
peslirat në çaf'
di lirat në vesh.
peslirat në çaf 'une di vendoj
me gjalin e ri dinjon' do ta çoj.*

(Oj coca me nom')

Kënga shpalos një ambient interesant, ku do t'i vërejmë të dashuruarit të takohen përmes vërshëllimës kur djali i lëshon dhentë **"More gjalo dhent' kue i lishove/ ce su f'kate po u fishëllove"**. Pengesa e të rinjëve që të dashurojnë, vetvetiu ka krijuar rrethana të vështira për dashuri të lirë të botës femërore. I vëllai e zë vendin kryesor si konservativ dhe ruajtës të **"moralit"** të motrës **"fishëllova fort, fishëllova fort/ amën oj coca delije/ zhiexhi vllaj i jot"**:

*More gjalo dhent' kue i lishove
ce su f'kate po u fishëllove
fishëllova fort, fishëllova fort
amën oj coca delije*

*xhiexhi vllaj i jot
xhiexhi vllaj jot aj vëlla deri
kur ka fishëllë aj gjal dilbieri
xhiexhi vëllaj jot, vëlla budalla.*

(Kur i lishoj gjali dhent')

Shënoi: **I. Osmani**, f. Forinë – Gostivar

Dëshira për ta parë vajza djalin:

*Hitonja, hitonja rabën
Don lulja ta shofe Armend agën
Hitonja, hitonja çerin
Don lulja ta shofe dilberin
Don lulja ta shofe gjizelin*

Këngë martesore e dashurisë me motiv përshkrimi të bukurisë së djalit para kohës së Luftës së Dytë Botërore

*Hipi djali velispiti po mi shkoj ke bjeshka
Nok t'ka hije velispiti me petka të leshta
Nuk t'ka hije velispiti more teveqel
I ka hije Armend agës me petka kanger
Nok t'ka hije velispiti o more budall
I ka hije Armend agës me kmesh e kravat
(kënga është e vjetër rreth 100 vjet)
Këndoi: Adile Dauti 69 vjecare e pa shkolluar*

Këngë martesore e dashurisë me motiv përshkrimi të bukurisë së vashës gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore:

*Andalushe faqe-kuqe
Bus' bërbuqe skep xhilpane bisht gërshane
Ka grika po vjen ni zaa, a s'jemi ne të zotit,
Pushkat kërcasin bombat po na pjasin
Pushkat mitrolezat rrejn' pa pushim
Dallalla, dallalla...*

Këndoi: Shaip Imeri 77 vjet pa shkollë

Kënga është kënduar para 70 viteve kur kanë ardhur partizanët nga Shqipëria në Maqedoni - Brigada e Shtatë e Qemal Agollit.

Hipa e djalit në një mollë të fshatit për ta parë fëllënzën e tij:

*Hipa me ni moje moli
Fuga me ni moll
Kur e pash fëllënzën e molit
Zdrete me ni k'mesh të holl'*

*Zdrete e vektonte haj ke Xhevdet aga
Kom përmi kom.*

Vashës i vardisen djamt e fshatit në një bahçe me molla:

*Hena me ni bafçe të mbledh molla
M'jon' vërtet beqarët okolla
Njoni nam ni moll, qetri nam ni moll
Mere be Xhevdet aga mjedisn e holl
Mere be Xhevdet aga senin rrosh të zij
Mo të jese hishkill hovardar
E ka nona coc' për mall*

Djali i këndon vashës që e dashuron duke qenë i gatshëm për t'a fejuar atë:

*Mori lulja e pranverës 15 vjet don me u fejue
Mi gzofshë 15 pranvera moj e vogel je për mue
O pse moj bukuri kemi ndodhur jabanxhi
Flokte e tu kaçurela për mi ballë hije të bajnë
Mi gzofsh 15 pranvera moj e vogël por si hanë
O pse moj bukuri kemi ndodhur jabanxhi.*

Vasha dëshiron të ia shohë djalit syrin pasi ka siklet për te:

*Xhevdet aga ka diere diqonit
Nok i duket seni pi xhomit
Ngreje dilber xhomim
Sa ta shoh senin
Sa t'a çies pi barku idhnemin.*

Preokupimi i vashës si do e kaloj jetën me djalin:

*Piskëlloj fëllënze molit
Po na boni uj
Si do bojsh e mero me gjalin e huj
Me gjalin e huj hujet do ja m'soj
Kollaj kollaj
Dinjon do ta çoj.*

Grabitja e vashës nga djali në një bahçe verore:

*Hena me ni bafçe verore
Më pikoj xhilpona pi dore
Ce fëllënza e molit nok e more
I heni Xhevdet agës në kom'
Xhevdet aga më grabiti.*

Këngë martesore e dashurisë me anë të shortit:

*Haj do çesim short
 Cellën e don ma shom
 At' si e kum dasht pi moti
 Ashto m'ra pusto shorti*

Të qarit e vashës nga sikleti gjatë grabitjes:

*Piskëlloj fëllënze molit e na dul në lom'
 Nok i zente shivet lulja
 Po na qante shom'
 Mo na qaj mi lule, mo na qaj shom'
 Do shkojsh ke dilberi
 Do çojsh dinjonë.*

Rrugës e dikton vasha se grabitësi është i dashuri i saj:

*Kur e mora odhën hiç nok mu m'tek
 Me Xhevdet dilberin isha zatek
 Xhevdet dilberi shtatin si bajrak
 E ka mor fëllenzën e molit nok i met marak.*
 Nazmije Bedriu 64 vjec, 4 vjet shkollë.
 Shënoi: Vlora Dauti, f. Çegran – Gostivar

Këngë martesore e dashurie pa pëlqimin e prindërve:

*Shko Nusret aga odhës tu mi fishëllo
 Me kondërat e zeza tu mi kërcëllo
 Mo mfishello be djali i kondraxhiut
 Se do kujtue nana se vertet' me don
 Un' nuk te dojsha lule mori couc'e sherit
 Mori coc'e sherit po odha më ra
 Frente er'e Gostivarit fesi nuk të linte ke djali kondraxhiut
 Un' të mora me të hikme couc'e sheherliut*

Këngë martesore e dashurisë pa pëlqimin e nënës:

*O bilbil i tezes çik tezja çik
 Pi merakut tond be djalo
 Jom tha e jom nxhit
 Jom tha e jom nxhit, jom bo si lulja
 Nona nuk më la ku dojsha une
 Nonës i kum thon' n'kije imonin
 Si tem apish ke Ramadon shkollovoni
 Nones i kum thon' do shkojsh n'xhenet
 Si t'ma apësh Ramadan agën si e deshta vetë*

Këngë martesore e dashurisë për zgjedhjen e djalit të pasur:

*Mori frejni era e bijne bashalarëve
Lum kush merte gjem pi veshallarëve
Djemtë e veshallarëve mi jon' në majdon
Kaput kaferengu bulk me ni onë
Djemt e veshallarëve jon' dilbera
E krkujshin kafe njer ke dera
Djemt e veshallareve jon' sulltana
E kërkujshin kafen njer ke loma.*

Këndoi: Fetije Imeri 55 vjecare e ka kryer shkollen
fillore ne Çegran

Këngë martesore e dashurisë për zgjedhjen e vashës së pasur

*Mi këndon bilbili ke veremi, Xhevdet aga gërkon coc'
zengeni
Mi këndon bilbili nëpër hane, shpeje xhevdet agës shom e
madhe
Ene shom e madhe bohum me meremet
I ka thon' coca e katondit un' do vij vetë
Mi ka thon' Xhevdet dilberi mo ija vetë
Se dë dal ke dera modhe do t'i lishoj çent
Do t'i lishoj çent pi sinxhiri
Se më ije bij pi katili
Do t'i lishoj çent pi kotari se më ije bij pi budalli
Këndoi: Hajrije Imeri e pa shkolluar 73 vjecare,
23.11.2007*

Këngë dashurie me motiv të vardisjes së djemëve

*Hena me ni bafçe verore
Mu vertetën djemt beqarët okolla
Njoni k'pot ni deg tjetri k'pot ni deg
Kpote be Armend aga mos te jese gjieg

Coc' mori coc' me gjith ato fjokë
Pi mallzemit s'en kum hej ndër shok
S'en kum hej ndër shok s'en kum bë di llafe
Te kom begenes ndër skutaçe
Ene në skutace dimijat maveje
Hajde ke ne mori sej maveje

Mi coco me minton kadife
Armend aga do t'çoje do t'lipe
Do t'çoje do t'lipe e do t'more*

Se mi je coc' pi derës modhe

Se mi je coc' ovardare

Këndoi: Adile Dauti 69 vjeçare e pa shkolluar

7. Baza religjioze e kurorëzimit

Martesa ka pasur dhe ka dhe sot bazë religjioze, duke u konsideruar si vullnet i Zotit dhe duke fituar bekimin e prindërve dhe të Zotit. Kjo më së shumti ndodh në mesin fshatar ku ende është prezente martesa ku merr pjesë kleri islam në kurorëzim e çiftit të ri, sidomos në kurorëzimin kishtar tek shqiptarët ortodoks që jetojnë në fshatrat e **Rekës** së **Epërme** ose nëpër qytetet Gostivar, Tetovë, Shkup e gjetiu. Në esencë në fshatrat tradicionale ka qenë prezente pozita inferiore e gruas ndaj mashkullit, ku një tendencë e tillë hetohet edhe sot si diçka që ka qenë e përforcuar me pikëpamjet fetare dhe religjioze të disa religjioneve (krishtere dhe islame). Femra është dashur jo vetëm t'i përmbushë nevojat seksuale të burrit, por edhe të tregojë aftësi dhe nderime tjera (si p.sh. puthje të dorës së vjehrrit, vjehrrës, larje të këmbëve të anëtarëve të familjes etj.).

a) Gjendja e gruas shqiptare sipas disa grimcave kanunore

Gruaja sipas kanunit, në familje ka qenë dhe në disa zona rulale malore edhe sot e kësaj dite është shumë e nënçmuar. Për martesën e fëmijës vajzë dikur ka vendosur babai, i cili mund ta japte kur të dëshironte dhe ku të vendosë ai. Ky shpesh mund ta premtonte bijën e tij edhe para se të lindëte kjo. Të drejtë për ndarje bashkëshortore aso kohe por edhe sot aty-këtu ka patur vetëm burri. Ai është konsideruar si trashëgimtari i vetëm, derisa gruaja nuk ka trashëguar asgjë. Mbajtja e ferekses së gruas shqiptare muslimane – më tepër është prapambetje konservatore, sesa traditë ose nevojë fetare?

Të integruar në mënyrën tradicionale të të jetuarit, gratë shqiptare muslimane në disa mjedise rurale të malësisë edhe sot, kanë qenë dhe janë tërësisht të orientuara në marrëdhëniet brenda në familje dhe në fqinjësinë e afërt. Vërehet se ngadalë dhe vështirë i pranojnë vlerat e reja për ndryshim të marrëdhënieve në mes gjinive. Lirimi nga vetëdija religjioze dhe paragjykimet fetare nga të cilat del edhe pabarazia mes gjinive, kërkon kyçje në vërshimin e emancipimit intensiv që kryesisht shprehet me tri shkallë të nivelit emancipues:

- a)emancipim politik
- b)emancipim kulturor
- c)emancipim i femrës mbi baza të barabarta.

VI. DISA TË DHËNA PËR VESHJET DHE LOJËRAT POPULLORE TË FSHATIT NERASHT TË TETOVËS

1. Veshjet popullore

Një ndër bukuritë e kulturës shqiptare janë veshjet popullore, si qytetare, krahinore, apo të mbarë viseve shqiptare anë e kënd. Janë aq të panumërta sa të duket sikur çdo lagje identifikohet me veshjen e saj për të mos thënë më tepër çdo familje apo fis. Të mahnit bukuria, estetika, laramania e ngjyrave, të harmonizuara me mjeshtrinë e hollë të krijuesit popullor, me dizajnimin dhe koloritin e ambientit jetësor shqiptar me të gjitha begatitë e jetës.

Dukuri të vaçantë përbën shpirti prej artisti të vërtetë i shqiptarit i cili ka bërë një punë madhështore të arteve të këto kostume. Veshja i ngjanë një petku magjik që josh me ngjyrat dhe dekoret e larmishme. Larmi të ndryshme ngjyrash e dizajnesh, nuk di ç'të them, fjalët janë të pakta.

Asnjë petk tjetër i moderuar nuk e ka bukurinë as vlerën e kostumit tradicional shqiptar. Veshjet kombëtare shqiptare janë



një thesar i vyer në kulturën tonë kombëtare e më gjerë, por të paktë janë shqiptarët që e ruajnë me aq kujdes këtë thesar që t'iu mbetet brezave për të ditur identitetin e paraardhësve të tyre.

Gjatë kohë gratë dhe vajzat e Nerashtit veshjen e burrave, grave, fëmijëve, apo çejzin e kanë përgatitur vetë. Si lendë e parë është përdorur leshi, pambuku dhe mëndafshi natyrorë. Leshin

dhe mëndafshin e kanë siguruar vetë, pasi ky fshat është dalluar në Pollog për rritjen e dhenëve dhe kultivimin e krimbit të mëndafshit. Ja si e kanë kultivuar krimbin e mëndafshit:

Kanë blerë fara që quhen fara bubash, i kanë mbajtur në vend të ngrohtë dhe ato për një kohë janë shndërruar në krimba. I kanë ushqyer me gjethe manash derisa janë rritur. Pasi janë rritur kanë filluar të hypin në disa degë që ua kanë përgatitur njerëzit dhe kanë filluar të krijojnë një rrjetë rreth vetes. Atë rrjetë njerëzit e kanë marrë, e kanë futur në **ujë**, e kanë përpunuar dhe e kanë përgatitur **mëndafshin**.

Veglat që janë përdorur për përgatitjen e leshit si lendë e parë për prodhimin e fijeve kanë qenë të thjeshta siç janë: **furka**, **shtiza** dhe **boshti**.

Veglat që janë përdorur për **endjen** e **fijeve** të **leshit**, **pambukut**, **mëndafshit** dhe për përgatitjen e tyre për vek kanë qenë: **endësi**, **elemja**, **çikriku** dhe **cezat**.

Veku ka shërbyer për vejtjen e fijeve të leshit, pambukut dhe mëndafshit. Me të kanë vejtur **pëlhura**, **çarçafe**, **marhama**, **jastëk**, **skutaçe**, **breza**, **kashnik** dhe **sixhade**. Karakteristike për këtë fshat ka qenë vejtja e sixhadeve të nuseve që kanë qenë shtroja më luksoze dhe është shtruar në dhomë vetëm kur kanë ardhur mysafirët.

2. Veshja e meshkujve

Burrat për veshje kanë përdorur: kësulën, marhamën, çevren, sherveten, lurkën, tirqit, mintanin, jelekun, brezin, këmishën, çorapet, fanellën, xhemperin, ndortat, rrogzinat, opingat, gëzofin, pallto dhe pantallona të leshta.

Kësula - në fshatin Nerasht e kanë mbajtur kësulën e bardhë të leshtë. Mirëpo më vonë është mbajtur edhe kësula e zezë prej stofi dhe kapela moderne franceze (bereta).

Marhama dhe çevreja - këto janë përdorur gjatë fejesave me nishane. Marhama është vejtur, ndërsa çevreja është punuar me dorë dhe ka shërbyer si veshje dhe zbukurim.

Lurka - ka qenë veshje e sipërme



e burrave e cila është qepur prej kashniku me krahë të shkurtër deri në bërryla dhe me lake të lëshuar pas shpine për tu mbrojtur prej të ftohtit dhe reshjeve. Lurka është mbërthyer me tri kopëza.

Tirqit - janë veshje e poshtme e burrave të punuara prej kashnikut me katër liq. Tirqit më tepër janë mbajtur të zeza, por janë mbajtur edhe të bardha me gjashtë e më tepër fije gajtani.

Këmisha - është vejtur prej pambuku dhe mëndafshi dhe ka qenë e gjatë deri në gjunjë. Në dorë dhe në fyt kanë patur sëmka. Më vonë janë përdorur këmishat prej basme, me pala dhe hajmali përpara. Këto këmisha kanë qenë të shkurta për dallim prej atyre të pëlhurës.

Mintani - është veshur mbi këmishë dhe është punuar prej shajakut të bardhë ose të kuq me gajtana të zi.

Jeleku - është punuar me krahë me ngjyrë të zezë në fyt i zbukuruar me ngjyrë të kuqe. Më parë është punuar prej shajaku e më vonë edhe prej stofi.

Brezi - ka qenë i gjatë gjashtë e më tepër metra ndërsa i gjërë 25 cm. dhe është përdorur për mbështjelljen e mjedisit. Ka shërbyer edhe si zbukurim të meshkujt. Brezi është punuar prej leshit dhe me shumë ngjyra.

Çorapët - janë punuar prej leshi me shumë ngjyra duke u shtuar edhe tel. Këto lloje të çorapëve janë punuar edhe me çez, ndërsa për veshje të rëndomtë janë punuar shollat.

Lurka - është veshje e sipërme e burrave që është veshur gjatë kohës së ftohtë dhe është punuar prej shajakut me krahë të gjatë, me jakë si lurka dhe e gjatë deri në lak të këmbëve. Më shumë e kanë përdorur barinjtë.

Gëzofi - është veshje e burrave më në moshë dhe është mbajtur dimrit kur ka mbajtur shumë ftohtë. Është punuar prej lëkurës së deleve shterpa dhe dallon nga lurka pasi krahët i ka më të shkurta dhe mbërthehet me tri komca.

Opingat - janë punuar prej lëkurës së thatë të gjedheve dhe prej tyre janë punuar dy lloje të opingave, me tegjel që kanë qenë më të mira dhe pa tegjel që kanë shërbyer për mbathje të përditshme.

Ndortat - kanë shërbyer për lidhjen e opingave dhe janë punuar dy lloje ndortash: të rëndomta dhe të gurit.

Rrogzinat - janë shirita të vejtur prej leshi, që kanë shërbyer për ta mbështjellur këmbën prej majës së gishtave e deri nën gjunjë.

3. Veshja e femrave

Femra për veshje ka përdorur **dimi, mintan, jelek, kovrak, tilben, këmishë, skutaçe, çorape, kollan, bashllëk, tërlik, xhar, perçe, çarçaf.**



Dimitë - janë punuar sipas moshës. Vajzat kanë veshur dimi të bardha të qepura prej pëlhurës së bardhë. Poashtu, ata kanë përdorur dimi të kaltra, që rëndom janë përdorur për dallim nga dimitë e bardha që janë veshur në dasma dhe festa. Për nuset janë punuar më shumë lloje të dimive siç janë: **junlie, kumashe, basma** dhe **santinet**. Santinet e mira punohen me xhepa, shkeka dhe shirita. Gratë në moshë kanë bartur dimi prej basme me rrudha të paqëndisura. Këmisha është punuar për nuset e reja, prej mëndafshi dhe pirinxhiku që e kanë vejtur deri sa kanë qenë ndër nishane. Këmishat e mira janë me mënga të gjera dhe qafë të çelur të qëndisur me oja dhe sëmka.

Jeleku - është veshja më e bukur e nuseve. Më parë janë qëndisur me mëndafsh, ndërsa sot me sërmë. Jelek kanë mbajtur edhe gratë më të moshuara por pa qëndisje të punuara prej basmës së dimive.

Mintani - është i ngjashëm me jelekun por dallon me atë se mintani ka mëngë të gjata.

Kovraku - është shami e hollë me ngjyra të ndryshme e qëndisur me oja. Vëhet në kokë nga nuset e reja. Gratë e moshuara kanë bartur shami me oja të imëta, ndërsa vajzat i kanë vënë pa oja. Sot përdoren edhe tilbeni dhe bashllëku.

Kollani - nuset e reja e kanë vënë në bel që ka shërbyer si zbukurim. Kollani është punuar prej argjendi. Më parë është bartur kusheki që është vejtur prej mëndafshi.

Skutaçja - është punuar prej leshi dhe pambuku e më vonë prej juni. Atë e kanë bartur të gjitha femrat të lidhur për midisi. Skutaçja ka shërbyer si zbukurim dhe të mbrohen dimitë nga ndyrja.

Nallet - janë punuar prej druri me madhësi të këmbës me një rrip përsipër dhe kanë shërbyer për mbathje.

Tërliku - është përdorur si mbulojë dhe është punuar prej basmës së zezë me gjatësi deri në fund të këmbëve.

Xhari - është përdorur si mbulojë. Në mjedis ka qenë i ngushtuar me llastëk dhe përpara është mbërthyer me kopsa.

Perçja - ka qenë një pëlhurë e hollë me të cilën gratë e kanë mbuluar fytyrën që të mos shihen.

Çarçafi - është përdorur për mbulojë, sidomos nuset e reja dhe gratë kur kanë dalë te fqinjët ose në ograde.



Veshje kombëtare

4. Lojërat popullore

Nerashti gjatë kohë ka qenë i shkëputur dhe i izoluar nga Tetova dhe fshatrave përreth. Kjo ka ndikuar që ky fshat në shumëçka të dallojë prej fshatrave të Pollogut. Një specifikë e këtillë vërehet edhe në jetën kulturore të tij, që ka qenë shumë e begatshme dhe e llojllojshme.

Në atë shtëpi ku vinte mysafiri mblidhej i tërë fshati dhe luhej, këndohej, kallëzoheshin përralla dhe vallëzohej tërë natën.

"**Oda nerashtane**" dallohej me shumë lojëra që luheshin dimrit kur vinin mysafirë dhe qëndronin tre deri më pesë netë e më tepër. Vazhdimisht gjatë të gjitha lojërave që janë luajtur nëpër odat e Nerashtit, ndaj mysafirëve ka patur një kujdes dhe respekt. Në "**Odën nerashtane**" humori ka patur një vend të merituar.

a) Lojërat që luheshin në "Odën nerashtane"

Boza: e luanë personi që e ka përsosur mirë këtë lojë. Mbushet një legen me ujë dhe me një partall (lečkë) në dorë hyhet në dhomën e mysafirëve. Loja fillon më fjalët hajde bozë, boza kajmak, kush do të blejë. Boza fillon të shitet, personat që blejnë bozë, por edhe të tjerëve iu mëshohet me partallin e lagët në fytyrë, kokë dhe kështu loja vazhdon deri në fund.



Bati: është luajtur në dy mënyra në dorë dhe në këmbë. Bati në dorë është luajtur nga më shumë persona të radhitur në odë në formë të gjysëm rrethit. Personi që e udhëheq lojën e fsheh **myhyrin** (unazën) dorë më dorë, duke ia lëshuar dikujt në dorë. Personi që e fsheh myhyrin iu drejtohet me fjalët "**Kush e ka myhyrin**". Dikush reagon dhe thotë "**E ka filani**". Personi që e udhëheq i mëshon me bat personit që reagoi dhe drejtohet kah personi që iu përmend emri duke i mëshuar me batë, kush e ka myhyrin, ky i drejtohet dikujt tjetër deri sa të gjendet myhyri. Personi që e gjen myhyrin ngritet dhe e fsheh përsëri atë dorë më dorë dhe kështu vazhdon loja deri në fund.

Bati në këmbë: është lojë më e rëndë por më tërheqëse për mysafirët. Lojën e luajnë më shumë persona, të gjithë dalin në mes të odës dhe ulen, këmbët i qesin përpara duke formuar me gjunjët një kënd të ngushtë. Në këtë formë radhiten të gjithë lojtarët deri në mbyllje të rrethit. Një lojtar vullnetarisht hyn në mes të rrethit, i cili ka për detyrë të nxen batin gjatë lojës. Loja fillon me fjalën bat-bat duke i mëshuar personit në mes me bat dhe me shpejtësi bati shtihet ndër këmbë duke i dhënë lojtarit tjetër ky i mëshon duke bërtitur bat-bat-bat dhe me shpejtësi të madhe e fësheh batin ndër këmbë duke ia dhënë dikujt tjetër. Loja vazhdon derisa ta nxen batin e vazhdon personi që i zihet bati dhe kështu vazhdon loja deri në fund.

Bleta: e luajnë tre persona, njeri prej tyre ka rolin kryesor dhe udhëheq me lojën. Tre personat qëndrojnë në këmbë në mes të odës. Personi që udhëheq qëndron në mes dhe mban kapuç në kokë. Me të filluar loja dy personat anësh duhet t'ia rrëzojnë kapuçin personit në mes. Loja fillon me fjalën bëzja-bëzja prej personit në mes duke i mbajtur duart në gojë dhe njëkohësisht me duar tenton t'iu mëshon në dorën e majtë ose të djathtë të personave që rrinë anësh. Nga ana tjetër këto dy persona mundohen t'ia rrëzojnë kapuçin prej koke duke i mëshuar. Loja vazhdon derisa t'ia rrëzohet kapuçi prej koke.

Filxhanat: luheshin së bashku mysafir e nikoqir, të cilët përzimas ndaheshin në dy grupe. Secili grup kishte udhëheqësin e tyre që i fshehnin filxhanat. Loja luhej deri sa të gjenin myhyrin në filxhan. Kur e gjenin myhyrin fshehte grupi tjetër. Loja luhej deri në fitore. Fituesit i rrihnin me pustaçi pas shpine grupin që humbte lojën.

Gjidi gjidi-zët: kjo lojë luhet prej më shumë personave, njeri prej tyre e udhëheq lojën. Të gjithë duhet të kenë kapuç në kokë me përjashtim të njërit. Të gjithë radhiten në rresht. Loja fillon prej të parit duke i ndërruar kapuçat njëri pas tjetrit, personi që ngelën

pa kapuç i mëshohet më **batë** prej atij që udhëheq. Loja shkon shumë shpejtë deri në mbarim.

Kallaisja: luhet prej dy grupeve të ndara nga shtatë veta dhe një person që i udhëheq. Njëri grup nxirret jashtë odës së mysafirëve, ndërsa grupi tjetër mbetet brenda në odë i ulur. Që të dy grupet i lyejnë duart me ziftë dhe i mbajnë fshehur. Personi që udhëheq e merr grupin që është jashtë dhe e fut brenda në odë duke qëndruar në këmbë pranë grupit tjetër. Loja fillon me komandimin e udhëheqësit, kallaisja bëhet me dorë, fytyrë për fytyrë.

Klença: e luajnë dy persona të cilët lidhen krah për krah në pozitë paralele duke qëndruar në shpinë dhe me këmbë bëhet luftë kush do ta ngrejë njëri-tjetrin. Fitues është personi që do t'ia dalë ta ngrejë.

Lavërtari: e luajnë tre persona, dy luajnë rolin e qeve e një i udhëheq. Loja fillon kur lavërtari hyn në dhomën e mysafirëve dhe fillon të lavrojë, duke ecur nëpër dhomë, lavërtari u mëshon me thupër mysafirëve, për të liruar sa më shumë vend për të lëvruar, po ashtu edhe qetë fillojnë t'i vrasin mysafirët. Lavërtari disa herë rrotullohet nëpër dhomë dhe ata dalin nga dera e odës.

“Mihiri” në shkëmb: kjo lojë është luajtur me mjeshtëri të madhe nga personat që e kanë ndier veten të aftë. Myhyri është vënduar në shkëmb. Lojtari ka hipur me dy këmbë në shkëmb dhe është dashur me gojë ta marrë myhyrin prej shkëmbit dhe përsëri të bie me të dy kambët në shkëmb.

Ndërkëmbësat: i luajnë dy persona që qëndrojnë në mes të odës. Të dyve u lidhen duart me **“marhamë”** (shami) ndër këmbë. Loja fillon duke e shtyer me këmbë njëri-tjetrin. Personi që e nxjerr prej ode është fitues.

Nusja e Arapit: kjo lojë është shumë interesante. Arapi përgatitet jashtë, në odë hyn me nusen e vet duke mbajtur në një dorë foshnjen, e në dorën tjetër **“dahiren”** (defin), nusja i shkon pas. Arapi “dahiren” ia jep një mysafirët t'i bjerë, ndërsa foshnjen ia jep një mysafiri tjetër ta përkundë. Arapi fillon të luaj valle me nusen e vet, në një çast foshnja fillon të qajë i drejtohet personit që e mban foshnjën dhe i bie duke i thënë **“luje-luje”**. Ndërkohë nusja e arapit i ulet dikujt në prehër, ai e sheh dhe hidhërohet duke vrapuar t'i bie me batë nuses dhe personit. Në moment një person tjetër fshehurazi ngritet dhe fillon të luaj me nusen e arapit, ky e sheh dhe vrapon duke u mshuar të dyve. Në momentin kur vëren se fëmija vdes hidhërohet dhe fillon t'u mshojë të gjithëve që gjenden në odë dhe kështu loja përfundon.

“Pampuri”: e luajnë më shumë veta. Loja përgatitet jashtë. Pesë persona qëndrojnë në këmbë në një largësi të njeriut. Mbi to

nxirren katër persona në pozitë horizontale duke i lidhur te duart dhe këmbët. Njeriu i parë luan rolin e lokomotivës, komandohet prej një personi, ndërsa brenda në dhomë qëndrojnë katër persona në këmbë. Loja fillon e treni hyn në dhomën e mysafirëve duke vazhduar rrugën nëpër dhomë. Personat që qëndrojnë në dhomë në këmbë u qësin vagonave ujë dhe kështu loja përfundon.

Vërtitja me shkop: luhet prej më shumë personave në dhomë. Merret shkopi me dorë dhe në pozitë vertikale vihet në tavan. Personi duhet të vërtitet dhjetë herë duke shikuar lartë dhe pastaj shkon ta hapë derën.

Valavica: e luajnë dy veta, dalin në mes të odës të ulur këmbëkryq dhe këmbët i mbajnë fortë me dorë. Qëndrojnë karshi njeri-tjetrit në distancë prej gjysmë metri, pranë kanë **“batin”**. Loja fillon duke ndjekur njeri-tjetrin dhe duke i mëshuar me **“batë”**. Fitues është ai që i mëshon më tepër.

1. Lojërat që luheshin jashtë

Përveç lojërave që janë luajtur në shtëpi ka pasur edhe lojra që janë luajtur jashtë. Do të përmendim vetëm disa prej tyre:

“Sinushk”: kjo lojë është luajtur me 3-4 persona. **“Sinushk”** është quajtur një copë druri që e ka rolin dhe formën e topit. Është luajtur me shkop me qëllim që **“sinushka”** të hyj në gol. Fitues është sigurisht ai që jep më shumë gola.

“Mikër”: është luajtur me dy persona. Kanë vënë dy shtylla në vend të portës. Janë larguar disa metra prej tyre dhe është dashur që me shkop, ta fusin topin në portë. Fitues është ai që jep më shumë gola.

Islami A., *Nerashti fshat pitoresk i Tetovës*, Shkup 2002

Informatori: **F. Murati**, f. Nerasht - Tetovë

Shënoi: **H. Murati**, f. Nerasht, Tetovë

VII. PËRRALLAT NË DISA TREVA SHQIPTARE NË MAQEDONI

1. Rëndësia dhe roli i përrallave

Përrallat si gjini e pasur folklorike në trevat shqiptare në Maqedoni konsiderohen si gjini e rëndësishme e prozës tregimtare, thesar shumë i çmueshëm dhe burim i pashtershëm i krijimtarisë popullore dhe prodhimit të vet shpirtëror. Rrëfyesit popullorë me të cilët kontaktuaam janë të mendimit se ato kanë origjinë të vjetër. Vlen të theksohet se nga përmbajtja e tyre kuptojmë se kujt populli i takojnë, domethënë vlejnë si identifikim i elementit kombëtar. Përrallat shqiptare të këtyre trevave në përgjithësi kanë përmbajtje edukative, pasi gjeneratat e hershme kanë besuar se mrekullitë e tyre u janë dukur si të vërteta apo të mundshme. Përralla në këto vise janë reflektim i jetës së këtushme të lidhur më drejtpërdrejt, sidomos luftën e së mirës kundër së keqes. Këtu përralla rrëfëhet nga individët, pleqtë e plakat, thuret në mënyrë narrative në formë të prozës, domethënë rrëfimi i tyre është i lirë. Në to lavdërohet trimëria, besnikëria, mikëpritja, e drejta, ç'është e shtrembura, e vërteta prej të pavërtetës etj. Përrallat shqiptare janë edhe pak fantastike me elementet (personazhet) që është karakteristikë për përrallat tona: drangonjtë, shtozovallet, zanat e malit, kuçedrat etj. Që të shihet mënyra se si rrëfimtaret tanë tregojnë përralla, ne do të prezentojmë disa prej tyre të rrëfyera nga goja e rrëfimitarit popullor.

a) "Minxha Veselçe"

Ka ken' çish ka ken'. Ka ken' ni pjak, aj pjaki ka pas ni grue. Pi pasunejs' ka pas safi ni vnesht'. Ajo vneshta ka bo shaum raush, majrpo a stërvoj ni dhelpeñ ene ja ka hengër rraushin ene i ka bo daum. Niher dhelpeña në vnesht e zatekën iriçin ene i thot' ija me mu agje në mjedis ka rraush të majr' me i ha k'to pi traulli posht'. Iriçi i thot' une frajgem, se m'em zan' Minxha Veselçe d'om mbajse, taj shko vet'. Dhelpeña i thot' ija, ija me mu se une di shaum ustalleçe ene do shpotojm', s'un na kapje. Iriçi i thot' nauk, nauk, shko vet'. Dhelpeña shkon n'mjedis të vneshtës po Minxha Veselçe e kishte vu foken. Dhelpeña ha e ha, ha e ha, u llej ene boni të dale. Majrpo, foka ja zu kaumën. Asaj i hipi piskellajma, iriçi e

ndajti ene ju havajt! He, mi dhelpe kur të thash ç'i de ngelish me Minxhen Veselçe, ç'taj hakat shpëto. Jo be vlla çekur ç'i hakati po kot e kam. Po taj thae ç'i din' shaum ustalleçe? Jo be vlla kit i kam harrau! E mi dhelpe nëgo pak. Kur do zbardhoje taj bonu si e cofëtene kur do vaje Minxha Veselçe aj kodrës kullet (khe, khe) athere ta dish' ç'i vajn. Kur de't havajtet d'et bjere tre her me shkoptaj, mo capat, kur de liroje foken – k'ce! Kur u havajt Minxha Veselçe i tha: he pusti të paska zen' foka jeme, ç'taj do boj' ni qirk për pjakën teme pi likurës tande, ene i ra tre here me shkop. Ene kadale zu ta çelje fokën kadale, kadale ene kur u çel dhelpe brof, ene drit kodrës terma aj u çudit pi të k'cajmes. Kur m'rajni ke iriçi aj ju nxhit për bishti, Minxha Veselçe kur e pa pi s'largu menoj për iriçin se asht' shport' ene vikati: eh pusti ene shportën e paska mar' ta mbushje!

Pra, tregimtari në trevat unë ku jetoj tregon në të folmen popullore te vendit tim. Ai e parashtron mjeshtërisht përmbajtjen. Personazhet i përmend që në fillim. Thekson vendin se ku zhvillohet ngjarja, emrin "**Vneshtë**" e përmend disa herë duke e lëvdëruar rrushin e saj. Iriçin e tregon si të mençur dhe modest, prandaj fjalët e tij i thotë me pushime dhe të theksuara. Shpesh ato edhe i përsërit. Momentet më interesante i thotë me zë të ulët dhe shumë ngadalë (me pushime). Shprehjen "Kur de liroje fokenkce" e thotë ngadalë, kurse fjalën "kce" e thotë prerë dhe me zë! Kur Minxha Veselçe konstaton se dhelpra ka rënë në kurth, ai gëzimin e vet e shpreh duke thenë "He pusti...". Këtë frazë e thotë edhe një herë në fund kur është edhe i habitur edhe i nevrkosur. Përralla ka përmbajtje humoristike dhe u tregohet më së tepërmi fëmijëve pasi që është si një fabul. Qëllimi ishte se nuk duhet të lavdërohem para se ta kryejmë një punë. Nuk duhet të mbahemi se i dimë të gjitha punët dhe se jemi me të mençur se gjithkushi.

b) Rrëfimi i gaçkës "Mreti mendemadh"

Une jom 67 vjetshe, emnin e kom Pendije, kum li në Çegron, jom ret me ni familje me kallaballëk. Baba jem ishte njeri i but' i donte shom collët ene për not' na diftonte gaçka. Sa ereshte ne heshim mrenda ene i ndizshim fenerat, hunxheshim okolla, aj zente t'diftoje, amën shom mer' i diftonte kadal-kadale. Për ne ishte interesont t'a ngjojm' se nok kishim televizija radiona si ju, ini t'u naj çit ment, atëher kishte lezet jeta, nok ç'tahe. Çe masi kërkon t'ët diftoj xhoja pi ma para, n'at vaktin tem une do ta diftoj me gjeth qef gaçkën ç'i e kum majt ment pi e vogël, se ket gaçk' e kisha qef shom ene e kum majt ment. Me ket gaçk' i kam ret ene collët e mej, ene collët e collve, ç'tahe do ta diftoj ene tej:

- Ka qon' ç'ka qon', ka qon' ni her moti, ni non' ene ka pas vetëm ni gjal, k'to ishin fukara, masi u ret' ki gjali bjiti ni magar, me at' magarin bante dru pi moli i binte n'shpe. Ni dit' tu shko n'mol, do coll' kishin xhet ni zhelk, kishin mor do shkupi ene hakatshin ta vrasin zhelkën. Merpo ki gjali t'u shko n'mol me magarin u ka thon' collve: linja zhelkën do vu ap ka ni pare. E mer zhelkën ene e shten ke ni fer' ene shkon n'mol t'boje dru. Kur ka erdh pi moli e ka shkarko magarin, hen mrenda han buk ene bin t'fin. Kur ngrejjet n'saba e mer magarin prap' shkon n'mol. Kur ngrejjet nona zarmi osht' i ndezët, mutfaku i fshet, ka vendot uj' përmi zarm ene thot' vetmevete: ce be bir mjaft se dru bije po ene shpejën e ke fshe?! Ka akshomi vin gjali pi moli nona i thot' si i kishe bo ponët, ki gjali çuditet ç'thot' nona kshto, une as sent nok kum bo! Ngrejjet n'saba gjali kusëm do shkoje n'mol, del ke odha e lidhën magarin ke ni fer' ene hipën n'tra t'shufe kush do vije nonës t'ja fsheje mutfakun. Zhelka o bo nose, shefak ka dhon' aj mutfaku pi asaj se shom e heshme ka qon' ene shom mer e ka fshe. Zdripën ki pi trau ene e mer korubën e zhelkës ene e fetën n'zarm. Kjo nosja i thot': mo se koruba jem, bon për ilaç. Ni dit' mreti e çon izmeqarin e vet ta fkase ket gjalin t'shkoje ke shpeje mretit. Ki shkon, hen ke mreti. Mreti i thot': për 24 sahat tëm bojsh ni xhame, me nuk ma bo do ta pres krejën! Ki gjali shkon ke shpeja tu qajt', i del gruja para ene e pejtën çish kie ç'i qan? Ki gjali i difton çish i ka thon' mreti. Gruja i thot': ooo po kollaj o kjo, shko ke nona ime ene fkate oj xhishe ajo do dale para, di gërkojsh ni kok' arr' ajo dot ape, mere at' arën, vendoje ene saprend ene për fondi ni gur', selli arës ene hik ene do bohet xhameja. Nesrit prap' e vikati mreti ket fukarajën, ki shkon amën ka kujto se do t'i ape doni bakshish, kur ka shko mreti i ka thon': t'shkojsh të ma shofish babën ene nonën ku i kom n'xhenet a n'xhenem se do ta pres krejën. Ki fukaraja shkon ke shpeja prap' tu qajt, gruja i del para ene i thot': ç'kie ç'i qan? Ki i thot' po m'ka thon' mreti çekshto... çekshto. Gruja i thot': ooo po kollaj oshte, shko ke nona ime thoj' nama pelën alle. Shkon ke xhishja ajo ja ep pelën alle, ki i hipën pelës, ajo i thot' mshili set', ki gjali i mshelën, mapa i thot' çili, kur i çelën set' ka mre n'haret. Shkon ja shef nonën para, mapa shkon ke baba, baba i thot' t'i dëftojsh gjalit tem se në filon vendin ka ni qip me lira. Ma mapa pela i thot' kti gjalit mshili set mapa i thot' çili set ene del ndinjo. Shkon ke mreti ene i difton. T'nesërmen mreti e fkatën prap', kur shkon gjali aj i thot': tëm xhojsh ni coll sa ka li, me kërthizën pa pre ene t'kiet ni tokmok n'dor sa her ta fkas tëm përgjigjet! Ki prap' shkon n'at irnek n'shpe tu qajt, gruja e pejtën ce qan ene ki i difton grues ço pona. Ajo i thot' po kollaj osht nona jem, sot ka pjell ke filon shpella shko do


ta xhojsh. Ki shkon fkatën oj xhishe, aj colli vogël thot': bujrëm inishte! E mer inishtja me kërthizën pa pre ene i thot' nama mu ta maj tokmokun aj thot': nok vet do ta maj! E çon gjalin e vogël ke mreti, mreti e pejtën ki i ep përgjigje me at tokmok i bije kres mreti vdes. Mapa e fkatën dhondrin, nonën, motrën ene kit k'to do rojn' mo ke shpeje mretit me kit pasunen' e mretit.

Gaçka n'shkall, shëndeti n'ball.

Më tej plaka thekson:

Çekjo oshte ajo gaçka ç'i ene sot e k'saj dite kur e diftoj mteket aj vakti jem, ç'tahe ki vakti ç'taheshëm o presh kit, po ç'tbojm motet shkojn amën xhojat maen mend.

Informatori: **P. Selmani**, f. Çeçgran - Gostivar



VIII. FJALË TË URTA NGA FSHATI PIROK I TETOVËS

Të gjitha fjalët e urta që përdorura në fshatin Pirok, sigurisht, se nuk e kanë burimin e tyre nga ky fshat, por si të tilla përdoren edhe në Fushën e Pollogut e më gjerë. Nga vetë kuptimi i shprehjes “fjalë e urtë” kuptojmë një mendim të shprehur me pak fjalë. Fjalët e urta janë thënie të shkurtëra që bashkëjetojnë në popull dhe pasqyrojnë urtësinë dhe përvojën e gjatë jetësore të individit. **(Shala, D. 1983: 435)** Shqiptarët e trevës së Pollogut, por edhe ato të fshatit Pirok, fjalën e urtë e kuptojnë si fjalë e rrallë, fjalë e zgjedhur, fjalë e vjetër, si fjalë me “temsil”, e folme me “temsil” etj.

Nga kjo rezulton se fjalët e urta, kuptohen si mendime të thella me anë të të cilave del në pah urtësia e individit të dalë nga gjiri i popullit. Kësisoj në fjalën e urtë gjen kuptimin e vet të plotë urtësia e gjeniut të popullit që bazohet në logjikën dhe gjykimin e shëndoshë dhe në eksperiencën e gjatë jetësore. Në realitet fjalët e urta i shpiku, i sajoi dhe trilloi vetë ky individ i popullit, duke i marrë nga njerëzit e zgjuar, mendjemprehtë, mendjehollë, të moshës së pjekurisë dhe maturisë. Vlerësimet, gjykimet, pikëpamjet, arsyetimet dhe opinionet e të cilëve kapërcyen dhe u transmetuan nëpër ecurinë e zhvillimit të kulturës shpirtërore, duke i përvetësuar gjeniu i popullit si pronë të vetën. Veprimtaria e fjalëve të urta, del qartazi nga të shfaqurit e mendimeve dhe ndjenjave me fjalë ose në një mënyrë të zhdërvjellët, reale dhe të prekshme të ideve të rralla me përhapje e sintetizime të gjera, të cilat fare lehtë mbahen mend dhe nuk harrohen. Vlerësimet dhe idetë në fjalët e urta pasqyrohen në formë të kursyer, që plotësohen me mendime, shpjegime dhe përligje që nuk kuptohen aq lehtë. Rrethana e krijimit të kësaj forme të artit, gjegjësisht të fjalës së urtë, ka qenë qëllimi individëve të popullit që eksperiencën e tyre jetësore ta pasqyrojnë në formë të organizuar me anë të të shprehurit gojor, që të tjerët mund ta kuptojnë dhe mbajnë në mend fare lehtë. Përgjithësisht, fjalët e urta, kanë disa domethënie: konceptimin vështrues fillestar apo të posaçëm, përmbajtjen semantike të brendisë, këndvështrimin metaforik apo sekret etj. Ja disa shembuj fjalësh të këtilla që i ndeshëm nga informatorët e fshatit Pirok:

Arna imi, arna skimi.
Ataj ç'i ka çer, ni k'majsh ma tepër, nëgoja llafet.
Arma ma e fortë kundër anmikut ashtë ditunia.
Bagërdari m'hahet, kusëja s'mlahet.
Besnik bëhu, bes mo'ze.
B'gjite nji arë, shtove ni hambar.
Buka ashtë direku i shpajrtit.
Bukës mos i b'gjer me shkelm.
Caulla nauk të pajtën, a kije a skije, aj kërkon.
Caulla pa nënë si nata pa hënë.
Cofi dhaeja u prajsh miçsaeja.
Çdo xha ç'i zdrajtën, nuk është alltën.
Çeni, çenin se ha.
Çenit sa ashtë i vogël i prajtën veshët.
Dardha e ka bishtin përmbra pa.
Dardha pajkën ndër dardhë.
Dasma pa mish nauk bohet.
Degën ku rajn' vet mos e pre se bije vet.
Dele mo ma turbëllo ujtin.
Delja ç'i ndahet pi dhenve e han uki.
Di gra, di bela.
Dija e vret hasmin.
Dorën e thatë askush nauk ta puthën.
Duro o barku i unët, se Allahi di sosje punët.
E ka gjeg' tamblin pa e frëjn ene kosin.
Fukaraja kur bën darsëm, p'qasën lodra.
Gaca e mblaume e përvlaume.
Gajlja e jeme ashtë përher ma e madhe se e jotja.
Goja e vogël ashtë po han shaum.
Guha ashtë mish po kocaj grin.
Guri ashtë i rand' n'vëdin e vet.
Gjali i p'qakut i sokakut.
Gjali me di baba mbet pa ksulë.
Gjeli hikën njer te p'qehi i vet.
Ha bukën tande, baj gajlen e huj'.
Haj tiri, tiri, si baba biri.
Hekrit i sajillet sa asht' i nxefët.
Hesapi i shpajës nauk del n'pazar.
Hiçe pinin po mos e k'put.
Hik pi se vapit, mo hish n'gjinah.
Hin n'valle ep ni pare.
I drejt si tërkuza n'thes.
I drejti do heke izeet, po dë dale n'selamet.
I ngjanë peni arnës.

I joti, në ta han mishin, kocin ta run'.
 I ka ra shara në gozhdë.
 I ka ra kosa gurit.
 Kadal beg se ka hendek.
 Kafja është e zezë, po e pajn' agallarët.
 Kafja pa duhan si xhumi pa jorgan.
 Kali huj të len në batac.
 Kalin e ortakve e ha uki.
 Kë dë bojsh, do ta bojsh ene njo do ta shtojsh.
 Kë hiton, nauk ka rra sheqeri n'ujë.
 Kë ta bën fumoja, sun ta boje qetër kush.
 Këm' sakat e gojë shpat.
 Kros more kros, si t'u zu, t'u sos.
 Kunglli nauk shkon përher për ujti.
 Ku dhem dhambi, agje shkon guha.
 Ku është peni i hollë ataj kputet.
 Ku s'ka pula, mo bon ish.
 Kur kije mash' mo i diç durët.
 Kur vajn' ment, kanë shku dhent.
 Kush ha hudra i vajn era.
 Lagu sot t'ët ruaj nesër.
 Laj ni grosh' pa ujë.
 Lark sajve, larg zemrës.
 Lira e vogël ashtë po ban pare.
 Llafin përtajpe pa folë.
 Ma i randë se llafi i fumëjs nauk ka.
 Ma majr' doniher se asnjihet.
 Malli i babës ma lirë shajtet.
 Me majkun ha e paej, allëshverish mo bon.
 Me mo kan' ulaja, hupet fukaraja.
 Me ni lule z'del vera.
 Mishi pi thoj nauk ndahet.
 Mo bën hop pa me k'caej.
 Mo fjarë nalt se bije posht'.
 Mo i çesh shokët se të vajn' në kokë.
 Mo t'u boft malli pare se frajk harxhitet.
 Nauk bohet mjerka non'.
 Nauk rajhet në di stolica.
 Në u hup vanthi, veshi ashtë.
 Në dinja vatan, në ahiret iman.
 Në kataund vjetër mo çit adet të ri.
 Ni here në motmot del e kullot.
 Njeri lidhet për llafi, hajvani për kërpeshi.
 Pa me ngron' hudra nauk të vajn era.

Paet niçin vet' bon si din vet'.
Pare selam, pare qelam.
Parja e bardh ruhet për ditën e zezë.
Pi drunit të keq del arna e majr'.
Ra fajti na mbajti.
Raj' n'të drejt' dë dalësh selamet.
Rëskun mo e prajt pi havaje, po shko e kërko.
Rraj shtremët e fol drejt.
Rrajtet fumoja, shtohen gajlet.
Rrena frajk del n'mejdan.
Sa do punojsh aq dë kesh.
Sa e kije jorganin aç zgjati komët.
Sa han gusha nuk bon fusha.
Sajlli magarit t'i m'teket magarit.
Shoçi ene majku njihen në zor.
Shpaja kan' për femën.
Thonji pi mishit nauk ndahet.
U krenofsh e xheçsh belan.
Udha e drejt' t'çet n'selamet.
Ujti flin, hasmi nauk flin.
Vet' aga, vet' pasha.
Xhëja e huj të len në udhë.
Xhumi ashtë xhims vdekje.
Zanatin m'soje pa ani se nauk e punon.
Zarmi e kashta nauk rajn' me ni vent.

Shënoi: Samije Jonusi, f. Pirok, Tetovë

INFORMATORËT:

Banjicë – Gostivar: Këndoi Sheqibe Izeiri, 85 vjecare.

Çajle – Gostivar:

Këndoi Flora Memeti, 27 vjecare, amvise.

Çegran – Gostivar: Pendije Selmani, 67 vjecare (4 vjet shkollim), amvise, **24.12.2007.**

Çegran – Gostivar: Sabrije Selmani, me shkollë fillore, 55 vjecare

Çegran – Gostivar: Haqime Shabani, 70 vjecare, amvise, e pa shkolluar.

Çegran – Gostivar: Nazlije Ameti, 60 vjecare, amvise, e pa shkolluar.

Çegran – Gostivar: Këndoi Simije Veseli, 47 vjecare, ka kryer shkollë fillore, amvise.

Çegran – Gostivar: Këndoi Hyrije Ameti (62 vjecare), amvise.

Çegran – Gostivar: Këndoi Fehime Aqifi, 67 vjecare.

Çegran – Gostivar: Xhezmi Selmani, 4 vjet shkollim, 67 vjecar

Çegran – Gostivar: Afet Shabani, 4 vjet shkollim, 70 vjecar

Çegran – Gostivar: Këndoi: **F. Aqifi** nga Çegrani i Gostivarit

Forinë – Gostivar: Këndoi Habibe Selimi, 72 vjecare.

Kalisht – Gostivar: Këndoi Fatmire Ramadani.

Nerasht – Tetovë: Këndoi SHKA “Rilindja”

Nerasht – Tetovë: Femije Murati, lindur më 29 nëntor 1926 në f. Dobrosht, e martuar në f. Nerasht (81 vjecare).

Reçan – Gostivar: Këndoi Hanife Sejfulla-Reçani në moshën 44 vjecare nga Gostivari.

Strajan – Gostivar: Këndoi Mihone Sejfullai, 70 vjecare.

Xhuxhevisht – Gostivar: Këndoi Rivajete Idrizi, 46 vjecare, amvise.

MBLEDHËSIT:

Çegran – Gostivar: Selxhan Selmani (studente UEJL, 2007).

Çegran – Gostivar: Vlora Dauti (studente UEJL, 2008).

DOBËRDOL - Tetovë: Nerisa Jonuzi (studente UEJL, 2008).

Forinë – Gostivar: Ilmije Osmani (studente UEJL, 24 dhjetor 2007)

Kalisht – Gostivar: Nazmije Asani (studente UEJL, 2007)

Nerasht – Tetovë: Havije Murati (studente UEJL, dhjetor, 2007)

Nerasht – Tetovë: **Abaz Islami**, *Nerashti fshat pitoresk i Tetovës*, Shkup 2002.

Pirok – Tetovë: Samije jonuzi (studente - UEJL)

Veshallë – Tetovë: Mamudije Muaremi (studente UEJL, 2008).

Xhepçisht – Tetovë: Flora Jakupi (studente UEJL, 2008).

BIBLIOGRAFIA

- Agani Hilmi, Letërsia popullore – dispensa (pjesa e parë), Prishtinë, 1963, f. 50
- AIKP, „Qysh millet far’ë grunit-o“ në „Valle nga krahina e Shpatit“, Elbasan, 1981, Kf. Nr. 106/5 (Mbledhur nga prof.dr. R. H. Bogdani; shih edhe: prof.dr.Ramazan H. Bogdani në „Gjurmime koreografike“, Tiranë, 1995, f. 298-299.
- Arsoska Violeta, Emancipacijata na muslimanskata žena i međunacionalnata ramnopravnost, në Glasnik na Institutot za Nacionalna Istorija.
- Baçe Shpresa, Valle rituale të tokës dhe të shiut, Kultura popullore, 1-2/1994, Tiranë, f. 179.
- Bakija-Gunga, Drita, Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist (1945-1978). Prishtinë 1986.
- Bandić Dušan, Tabu u tradicionalnoj kulturi srba, Kultura, Beograd 1981.
- Basha Petrit, Kulti i Tomorrit, Kultura popullore, 1-2/1994, Tiranë, f. 198.
- Bethe E., te Pauly Wissova - Kroll Real - Encyklopadie 17, shtylla 2. 1966.
- Çabej Eqrem, Studime dhe artikuj, Disa figura të besimevet popullore shqiptare, Studime albanologjike, Folklor dhe etnologji, II -1972, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1974, f. 15.
- Çabej Eqrem, Studime dhe artikuj, Disa figura të besimevet popullore shqiptare, Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji, II-1972, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1974, f. 7.
- Folklor dhe etnologji, XII - 1982, Prishtinë, f. 25.
- ¹ Po aty, f. 23.
- Frashëri S., Folklor shqiptar, Durrës, 1963, f. 30.
- Gjorgjiev Gjorgji, Transformacija na makedonskoto semejstvo vo Kanada i SAD.Skopje 1994.
- Historia e letërsisë shqipe I-II, Prishtinë, 1968.
- Izairi Daut, Piroku i ynë, fq.176, Shtypi: ”AZA-SEsoft”, Tetovë , 1996
- Kartalov Hristo, Sociologija na seloto, Skopje 1996.
- Kasapi Gjylmsere, Roli i gruas shqitare në shoqërinë maqedonase në Pozita e gruas në rrjedhat bashkëkohore shoqërore, 1995.

- Kočovski Ilija, *Ženata vo makedonskata narodna kniževnost*, Bitola 1989.
- Krasniqi Mark, *Aspekte pagane të traditës së kërshëndellave, Gjurmime albanologjike*, L'epopee de la femme Turque (1919-1923), Ankara 1977.
- Levaković Hasan, *Ženata vo islamot*, Skopje 1999.
- LXXI = LXXXI, *Apostujt* 8, 7; LXXIII = LXXXVIII, *Luka* 14, 2, *Khs. Dhe vrejtit tona në Lingua Posnaniensis VII, 157 v., Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe 24 v. (Eqrem Çabej)*.
- Papleka Ndoc, *Miti kozmogonik në një rit shërimi*, *Kultura popullore*, 1-2/1993, Tiranë, f. 37.
- Penusliski Kiril, *Mitot i folklorot*, Skopje 1996.
- Svetska Konferencija za pregled i ocena i dostignuvanje ON za ženi, *Najrobi* 1985.
- Shala Demush, *Letërsia popullore, Shkolla e Lartë Pedagogjike – Dega e Gjuhës dhe e letërsisë Shqipe*, Universiteti i Kosovës, *Enti i teksteve dhe i Mjeteve mësimore i KSAK, Prishtinë*, 1983.
- Shkëndija I*, Nr. 11-12 (1941), f. 3.
- Tërnavci Halit - „Përparimi“ nr. 1/1968, f. 27.
- Vesković-Vangeli Vera, *Ženata vo opšttestvotovo tranzicija-eden istoriski aspekt na primerot vo R.Makedonija. Në Sovremenost*.

Prof.dr. Mustafa IBRAHIMI

**VËZHGIME MBI DISA DUKURI
SOCIOLINGUISTIKE TEK SHQIPTARËT E
MAQEDONISË E MË GJERË**

PËRMBAJTJA

A. ZHARGONET	154
1. Zhargonet – shenjat e kohës së re.....	154
1.1. Rreth termit zhargon.....	155
1.2. Mospajtimet rreth fenomenit të zhargonit	157
1.3. Zhargonet leksikore.....	158
2. Zhargoni dhe stili.....	159
2.1. Zhargonet dhe dëshmitë e tij në gjuhën shqipe	159
2.2. Fushat ku paraqiten zhargonet.....	161
2.3. Shkurtime dhe simbolet e ndryshme.....	162
2.4. Fjalët e huaja	162
3. Llojet e zhargoneve.....	163
3.1. Zhargonet e adoleshentëve.....	163
3.1.1 Shembuj nga fjalori i adoleshentëve	167
3.1.2. Gjuha e adoleshentëve në internet.....	168
3.1.3. Zhargone frazeologjike.....	171
3.2. Zhargonet e të dashuruarve	173
a) Për dashurinë dhe gjithçka që lidhet me të	175
b) Për karakteristikat e vajzave.....	176
c) Për karakteristikat e djemve	178
ç) Zhargone që lidhen me veshjen dhe takimet e të rinjve.....	179
d) Zhargone që lidhen me karakterin e adoleshentëve	180
dh) Sjelljet e të rinjve.....	182
e) Pamja e jashtme	182
3.3. Zhargonet subkulturore	183
3.3.1. Zhargonet mbi emërtimin e lëndëve narkotike.....	183
3.3.2. Terme zhargoni që lidhen me emërtimin e cigareve.....	185
3.3.3. Zhargone mbi alkoolin.....	185
3.3.4. Zhargone që lidhen me emërtimin e policëve	185
3.3.5. Zhargone lidhur me botën e automobilave	186
3.3.6. Zhargonet mbi kriminelët dhe hajnat.....	186
3.3.7. Zhargone mbi marrëdhëniet familjare	187
3.3.8. Zhargone për sende nga amvisëria dhe prodhime tjera.....	187
3.3.9. Zhargone që lidhen me sportin.....	187
3.3.10. Zhargone që lidhen me ushtrinë.....	188
4. Zhargonet profesioniste	188
4.1. Politikë.....	188
4.2. Zhargone që lidhen me ekonominë.....	189
4.3. Që lidhen me teknikën dhe shëndetësinë	190
4.4. Zhargonet mbi toponime ose institucione	190
4.5. Lloje tjera të zhargoneve	190
5. Prapashtesat si bazë për zhargonizmin e fjalëve	191

B. PËRZIERJA E FJALËVE (BLENDET)	192
1. Rreth termit Blend	192
2. Ndarja sipas fushave	193
3. Modele krijuese	195
3.1. – Modeli i parë (klasik).....	195
3.2. – Modeli i dytë	196
3.3. – Modeli i tretë:	196
3.5. – Modeli i pestë	198
3.7. Kategori të veçanta, pa ndonjë analizë gjuhësore.....	198
5. Eksperimente tjera verbale.....	200
6. Përfundime mbi blendet	200
C. EUFEMIZMAT DHE TABUTË	202
1. Vdekja	203
2. Sëmundjet.....	206
3. Seksualiteti.....	210
3.1. Emërtimi i organeve seksuale	210
3.1.1. <i>Emërtimi i organeve seksuale te njerëzit</i>	210
3.1.2. <i>Emërtimi i organeve seksuale te kafshët</i>	211
3.2. Procese seksuale	211
3.2.1. <i>Procese seksuale te njerëzit</i>	211
3.2.2. <i>Procese seksuale te kafshët</i>	213
4. Ndjenjat (mashkull - femër).....	214
5. Bota shtazore	216
6. Bota bimore	223
7. Qenie Mitologjike dhe fetare.....	223
8. Nevojat biologjike të njeriut.....	227
9. Pjesët e trupit të njeriut.....	229
10. Fenomene natyrore	229
11. Mjete teknologjike	230
12. Eufemizma që lidhen me jetën familjare.....	230
Ç. PARAGJYKIMET MIDIS POPUJVE, GJUHËVE DHE KULTURAVE TË NDRYSHME	231
1. Paragjykimi estetike.....	231
2. Paragjykime pragmatike.....	232
4. Stereotipat midis qyteteve dhe fshatrave	236
5. Barsoletë të përdorura si rezultat i paragjykimeve	237
PËRFUNDIM	238
POROSIA UNIVERSALE E DUKURIVE SOCIOLOGJISTIKE	238
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	240
1. Literatura për zhargonet, blendet dhe paragjykimet.....	240
2. Literatura për eufemizmat	240

Prof.dr. Mustafa IBRAHIMI

VËZHGIME MBI DISA DUKURI SOCIOLINGUISTIKE TEK SHQIPTARËT E MAQEDONISË E MË GJERË

A. ZHARGONET

1. Zhargonet – shenjat e kohës së re

Ne shkencën e gjuhës ekzistojnë nivele të shumta që ende nuk janë të hulumtuara. Një prej tyre janë edhe zhargonet me çka linguistika nuk është hermetike, por më e hapur, më komunikuese dhe më e gjallë. Pikërisht kjo bën që ajo as të mos vjetërsohet dhe as të mos bëhet e papërdorshme. Gjuhët lindin edhe mund të vdesin, por këto kanë të bëjnë me shoqërinë. Sa kohë që kjo e fundit është e gjallë, ka veprimtari shoqërore, politike dhe veprimtari në të gjitha fushat e tjera të jetës, ajo zhvillohet dhe shkon duke iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë.

Në sociolinguistikën e sotme, përgjithësisht në gjuhësi dihet se domosdoshmëria për zhvillim gjuhësor lind mbi bazën e domosdoshmërisë shoqërore. Pra nëse shoqërisë i del kjo nevojë ajo duhet ta plotësojë atë me mjetet që ka ose duke krijuar mjete të tjera. Dhe gjuha pikërisht kështu vepron, zhvillohet për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë. Por gjithashtu gjuha është e larmishme dhe në hapësira të ndryshme për motive të ndryshme sipas një çelësi që quhet sot çelësi i sociolinguistikës i Joshua Fishmanit. Që do të thotë gjuha është e larmishme sipas këtyre pyetjeve : *Kush flet? Me kë flet ? Ku flet? Kur? Për çfarë? Dhe në cilin varietet gjuhësor ?*

Duke u mbështetur në analizat dhe rezultatet e deritanishme të fituara nga hulumtimet e shumta linguistike dhe sociolinguistike për zhargonet, sot para nesh shfaqen, kryesisht dy çështje:

- së pari vetë termi zhargon nxit paqartësi dhe hamendje të shumta si tek laikët ashtu edhe në qarqet shkencore, dhe

- së dyti, të përqendrojmë vëmendjen në rolin eventual që mund të luajnë zhargonet në proceset e ndryshimeve gjuhësore.

Por sa herë që flitet për zhargonet, tek gazetarët por edhe tek të gjithë tjerët pa përjashtim, ekziston një paqartësi dhe hutitë. Shpesh herë shtrohet pyetja vallë zhargonet e pasurojnë apo e shëmtojnë gjuhën – ndonjëherë na duket se bëjnë të dyja. Vallë kjo është e mundshme dhe ku është e vërteta?

Në këto pyetja ne nuk duhet të çuditemi, sepse dyshimet e këtilla janë të pranishme edhe tek diskursi profesional. Kjo nga fakti se tek të rinjtë zhargonet gëzojnë një popullaritet të madh, kurse tek gjuhëtarët kjo has në kundërshtim, sepse ata mendojnë se s'ka përgjigje definitive. Ne do të orvatemi të paralajmërojmë disa drejtime në të cilët duhet shkuar për të sqaruar këtë dilemë.

1.1. Rreth termit zhargon

Që të diskutojmë për zhargonet ne duhet të merremi pak edhe me këtë term. Siç dihet termi zhargon përdoret në kuptime të ndryshme. Në përgjithësi zhargon quajmë çdo varietet folës të një gjuhe që shërben për komunikim brenda një grupi të caktuar shoqëror, sipas profesionit, statusit social, moshës etj., që në një mënyrë anëtarët i lidh interesi i përbashkët ose mënyra e jetesës që mund të jetë i përcaktuar edhe sipas territorit (Bugarski 2006:12).

Sipas Otto Jespersenit, *fjalorët e thjeshtë të slangeve (lexo zhargoneve) përfshin jo vetëm ato fjalë që u përgjigjen zhargoneve, por edhe fjalë nga argodialektet, por edhe vulgarizmat. Të gjithë atyre u jepet veçori lokale, ashtu siç përdoren në qytetet e ndryshme, si Parisismen i Villatit dhe Londonismen i Baumannit.* (Jespersen 1970:129).

Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, fjala zhargon shpjegohet si, *“e folme e një shtrese të ngushtë shoqërore ose e një grupi njerëzish të një profesioni, e cila ka shumë fjalë e shprehje të veçanta, profesionale ose të huaja, të panjohura a të krijuara posaçërisht etj. dhe nuk kuptohet lehtë ose nuk kuptohet fare nga shtresat e tjera shoqërore. Zhargon profesional. Zhargoni i oborrit mbretëror (i aristokracisë. Zhargoni i mjekëve (i piktorëve, i studentëve, i bojaxhinjve)”. (QEP – Fjalor shpjegues elektronik) si dhe Fjalori i gjuhës së sotme letrare shqipe (1980).*

Sipas Jani Stefit, *“zhargonet janë të folura klasash, që kanë në themel sistemin gramatikor dhe fonetik të gjuhës amtare, por që*

bëhen të pakuptueshme nga leksiku i stërholluar me fjalë e shprehje të veçanta, sidomos të huaja". (Stefi 1970:74)

Sipas fjalorit të akademisë serbe, "zhargonet janë të folme të përfaqësuesve të një mjedisi të caktuar shoqëror, profesioni, krahine me fjalë specifike e ndonjëherë edhe të pakuptimë për të tjerët". (RSANU:23)

Për termin zhargon në kontekst ndërkombëtar përdoren edhe terme alternative ndërkombëtare si **sleng** (me burim nga anglishtja) dhe **argo** (me burim nga frëngjishtja). Këto terme mund të kenë edhe dallime të vogla të interpretimit të këtyre fenomeneve.

Në gjuhën shqipe janë përdorur edhe **argodialekte**. Sipas Jani Stefit, fjala. **argo** (regj. *gjuhë e rrugëve franceze, gjuhë e rrugaçëve*) është e folur e një grupi të ngushtë social, që ndryshon nga gjuha amtare vetëm për nga fjalori i pakuptueshëm nga të tjerët. *Argotë janë të folme të fshehta të krijuara artificialisht nga nevoja që të mos kuptohen nga të tjerët*. (Stefi 1970:74-75). Kurse sipas Fjalorit të Akademisë serbe, "**argo** është e folme e posaçme të njerëzve të një profesioni të caktuar ose të një mjedisi të caktuar shoqëror". (RSANU:23).

Para shkencës edhe më tej qëndron e hapur pyetja, si është e mundur me një term të tillë të mbulojmë dukuri të ndryshme siç janë gjuha profesionale dhe ajo e rrugës?

Duke mos pasur qëllim të japim përgjigje definitive, ne do të orvatemi të paralajmërojmë disa drejtime në të cilët duhet shkuar për të sqaruar këtë dilemë.

Zhargoni njëkohësisht është lloj gjuhe dhe mënyrë e të folurit, i cili s'ka kufi. Pikërisht këtu paraqiten edhe dilemat, sepse në këto dy raste kemi dukuri kundërshtuese. Zhargoni në gjuhë, si inventar është spontan, kreativ, imagjinues, humoristik, pra në përgjithësi mund të vlerësohet si pozitiv (zhargonet subkulturore dhe i adoleshentëve). Nga ana tjetër, zhargoni në të folur që është punë e stilit, është i shabllonizuar, nuk është imagjinues dhe kreativ dhe vlerësohet si negativ (zhargonet profesioniste, si ai mjekësor, juridik, sidomos ai politik. (Bugarski 2006:17).

Zhargoni është gjuhë për të tallur. Në të përherë ka diç humoristike – fjala e re vjen si një zëvendësim të këndshëm i të vjetrës. P.sh. për danezët transformimi i fjalëve *melodonte* për melodi, *brolly* për umbrella ose *Frikodonse* në vend frikadelle (Jespersen 1970:132) janë vetëm fjalë të thjeshta tallëse dhe shohin vetëm një lojë fjalësh. Nga ana tjetër, njerëzit që kanë shije më të lartë ndoshta këto fjalë do t'i shmangin dhe nuk do t'i përdorin. Prej këtu zhargoni mund të përkufizohet si oscilim midis "gjuhë së profesionit dhe gjuhës së rrugës".

Zhargonet përherë duhet të jenë të freskëta, nga këtu nënkuptohet se disa zhargone pas një përdorimi e humbin atë vlerë. Disa fjalë kanë fat të shpërndahen dhe të përdoren nga i tërë populli, kurse disa përdoren vetëm në një mjedis të caktuar. Kështu p.sh. secili nga dy universitetet binjak, ai i Oksfordit dhe Kembrixhit në zhargonet e tyre kanë shumë fjalë që nuk i njohin njëri – tjetri. E njëjta gjë është edhe me Filadelfinë dhe Njujorkun edhe pse janë vetëm dy orë larg njëri-tjetrit. (Jespersen 1970:130).

Nga ana tjetër disa fjalë të cilët fillimisht janë krijuar si zhargone, aq janë përshtatur sa që asnjë më nuk kujtohet se ndonjëherë kanë qenë të tillë. Ata janë bërë pjesë e përditshmërisë së asaj gjuhe. Pikërisht kjo e bën zhargonin aq tërheqës, që në një mënyrë e vështirëson kufizimin e tij me format tjera të gjuhës.

1.2. Mospajtimet rreth fenomenit të zhargonit

Edhe sot e kësaj dite nuk është sqaruar kjo dilemë, edhe më tej rri e hapur pyetja se si mundet që vetëm me një term të mbulohet dukuri të tilla të ndryshme siç është gjuha e profesionit dhe asaj të rrugës, dhe krejt ajo që mund të futet midis tyre.

Prej nga mospajtimet? Nga shqyrtimet e shumta për fenomenin e zhargoneve, dy mendime na duken si më të afërta: **mendimi sociopsikologjik** dhe **mendimi linguistik**.

Nga ana **sociopsikologjike** ekzistimi dhe lindja e zhargoneve vjen si rezultat i një grupi të caktuar shoqëror, i cili afirmon identitetin e vet dhe verifikon se është pjesëtar i atij grupi. Por a është i shmangshëm kjo dukuri e cila në pamje të parë duket si fjalor vulgar dhe i pakuptueshëm? Jo, kjo është e pashmangshme thonë psikologët. Më kot duhet të mundohen të rriturit të eliminojnë fjalorë të tilla tek fëmijët e tyre në moshën e adoleshencës. Kjo për shkak se për momentin, në shkollë, niveli arsimor dhe edukativ nuk është në shkallën e duhur. Por fenomeni i ka rrënjët më thellë. Është pikërisht mosha e adoleshencës, mosha e cila ka predispozicionin e mohimit të vlerave. Sipas psikologëve, kjo ndodh për shkak se kjo është mosha kur adoleshenti lufton të formojë identitetin e tij, dhe këtë ai e bën duke mohuar vlerat e shoqërisë, dukë formuluar fjalë të cilat i di vetëm ai, fjalë me të cilat merret vesh vetëm ai dhe që janë shpikje e tij. Kjo situatë paksa egoiste nga ana e tyre zgjat për sa kohë që adoleshenti ndjen se ka formuar identitetin e tij, megjithatë, psikologët shpjegojnë se zhargone dhe fjalë të tilla, shumë rrallë lënë gjurmë dhe vlera negative tek ata. Zhargonet përherë duhet të jenë të freskëta, nga këtu nënkuptohet se disa zhargone pas një

përdorimi e humbin atë vlerë. Disa fjalë kanë fat të shpërndahen dhe të përdoren nga i tërë populli, kurse disa përdoren vetëm në një mjedis të caktuar. Është një fenomen momental, kalimtar dhe pa pasoja shpjegojnë psikologët.

Megjithatë, problemet e vërteta paraqiten në aspektin **linguistik**, kjo nga fakti se në kuadër të linguistikës bën pjesë gjuha si sistem, por edhe ligjërimi si manifestim i atij sistemi – kurse fjala zhargon në mënyrë implicite përdoret për të shënuar ndonjë karakteristikë, qoftë të gjuhës ose të ligjëritimit.

Në nivelin gjuhësor i cili më së miri është hulumtuar, termi zhargon ka të bëjë me njësitë leksikore dhe frazeologjike, e sidomos ato gramatikore e fonologjike, andaj edhe pak kuptohet nga folësit e tjerë të së njëjtës gjuhë. Nga edhe nuk vlerësohet mirë nga mbrojtësit e gjuhës letrare.

1.3. Zhargonet leksikore

Deri sot, më tepër janë studiuar zhargonet që konsiderohen si inventar i njësitë leksikore të përfshira në regjistra të caktuara. Këtu kemi të bëjmë me procesin e zhargonizimit të disa mjeteve gjuhësore në kontekst të mekanizmit krijues, si një lloj të futjes së zhargonit në gramatikë.

Të tilla janë p.sh. eksperimentet gramatikore të tipit të argodialekteve, ose lojërat e adoleshentëve me rregullat fonotaktike, si **reme sheve** (*e merr vesh*); *inva* (*avni*). Këto gjëra lehtë vërehen dhe si të tillë klasifikohen si zhargone. Gjithashtu kemi të bëjmë edhe me një proces tjetër zhargonizimi të mjeteve gjuhësore, në kontekst të mekanizmave krijuese, si një mënyrë e përfshirjes së zhargoneve në gramatikë. Zhargonizimin e diskursit profesional mund ta vërejmë në bazë të disa shembujve marrë nga terminologjia informatike dhe kompjuterike.

Mbarova **kopirajtin**; *le të bëhet publiku* *çik më open mind*; Me **photoshopin** do të **fleshohet scratch**; çdo vit Zingarelli (një nga fjalorët më të njohur të italishtes) **axhornohet** me shumë fjalë dhe shprehje të reja (kryesisht me ato të përdorimit në 'botën' e komunikacionit nëpërmjet **sms** ose **e-mail-eve**); ë...ç; Shkova tek **website-i** i gazetës Tema dhe gjeta një artikull që më detyroi të hapja një kategori të re: kategorinë **Gold**.

Pa bërë ndonjë analizë të thellë, nuk e kemi vështirë të zbulojmë se kemi të bëjmë me kombinimin e dy elementeve të dy gjuhëve të ndryshme në vetëm një fjalë, pra një përzierje të anglishtes, shqipes dhe shqip-anglishtes; anglicizmave të adaptuar, gjysmë të adaptuar dhe të pa adaptuar; dhe që është më e

rëndësishme mjetet standarde përdoren në mënyrë zhargonike: *softuer / sotware, ueb / veb, e-mail / email/ imejl* (postë elektronike), *kopirajt, networkun / netuorkun / networkun* (rrjetin), *download / daunlodoj / daunladova* (shkarkoj), *talkim* (bisedojmë) (Çepani 2006:396);

2. Zhargoni dhe stili

Zhargoni në thelb është sociolekt që përputhet me stilin funksional por edhe me dialektin. Kështu ai merr pjesë në tre tipat e shtresimit të gjuhës- *social, funksional dhe territorial*. (Bugarski 2006:20)

Me fjalë të tjera zhargoni njëkohësisht është lloj i gjuhës dhe mënyra e të folurit, i cili s'ka kufi. Pikërisht këtu paraqiten edhe dilemat, sepse në këto dy raste kemi kuptime kundërshtuese.

Zhargoni në gjuhë, si inventar është spontan, kreativ, imagjinues, humoristik, pra në përgjithësi mund të vlerësohet si pozitiv (zhargonet subkulturor dhe i adoleshentëve). Për dallim nga ky, zhargoni në të folur që është punë e stilit, në përgjithësi është i shabllonizuar, nuk është imagjinues dhe kreativ dhe vlerësohet si negativ (zhargonet profesioniste, si ai mjekësor, juridik, sidomos ai politik. (Bugarski 2006:17). Të dyja llojet e plotësimit të dukurive zhargonike, kanë edhe veti të përbashkëta, nga e cila më kryesorja është se jashtë grupit nuk kuptohen, por kjo më tepër bën pjesë në anën sociopsikologjike se sa në atë linguistike. Kështu p.sh. secili nga dy universitetet binjak, ai i Oksfordit dhe Kembrixhit në zhargonet e tyre kanë shumë fjalë që nuk i njohin njëri – tjetri. E njëjta gjë është edhe me Filadelfinë dhe Njujorkun edhe pse janë të larguar vetëm dy orë. (Jespersen 1970:130).

Nga ana tjetër disa fjalë të cilët fillimisht janë krijuar si zhargone, aq janë përshtatur sa që asnjë më nuk kujtohet se ndonjëherë kanë qenë të tillë. Ata janë bërë pjesë e përditshmërisë së asaj gjuhe. Pikërisht kjo e bën zhargonin aq tërheqës, që në një mënyrë e vështirëson kufizimin e zhargonit me format tjera të gjuhës.

Çfarëdo burimi që të jetë i zhargoneve, ata karakterizohen me vetitë gjuhësore siç janë: produktiviteti leksikor dhe inovativ, fleksibiliteti gramatikor, ekspresiviteti semantik (sidomos në drejtimin pejorativ dhe ironizues), pastaj aspekti metaforik dhe asociativ, si dhe loja humoristike me zërin dhe kuptimin. (Bugarski 2006:21).

2.1. Zhargonet dhe dëshmitë e tij në gjuhën shqipe

Në Evropë e në “Kontinentin e ri” studimet e këtij lloji filluan shumë vonë, në gjysmën e dytë të shek. XX, kur lindi edhe interesimi për sociolinguistikën. Deri atëherë interesimi gjuhësor shtrihet vetëm në dialektet shoqërore, gjuhët konvencionale, gjuhët e fshehta ose gjuhët e zanatit. Nga ana tjetër, mungesa e interesit nga ana e gjuhëtarëve futet në një kuadër më të gjerë, të natyrës sociokulturore: problemet e të rinjve, si grup social, nuk kishin marrë rëndësinë e vërtetë të tyre. Në fakt të rinjtë, vetëm në shekullin e XX, për herë të parë fitojnë rolin e grupeve autonome dhe homogjene. Në të kaluarën rëndësia e familjes, me ritet e saj “homogjenizuese”, i kishte penguar të rinjtë të kishin një “hapësirë të tyre. (Radtke 1992:7).

Në gjuhën shqipe studiuesit më tepër janë marrë me krijimin e listave të zhargoneve leksikore, karakteristike për një profesion të caktuar ose grupi shoqëror. Në kohët më të hershme pesha ka qenë në studimin e gjuhëve të fshehta të zejeve të caktuara (*purishtja, delibapçja* etj), duke kaluar në mbledhjen e zhargoneve të adoleshentëve.

9. Çfarëdo që të jenë burimet e zhargoneve, ata karakterizohen me vetitë gjuhësore siç janë: produktiviteti leksikor dhe inovativ, fleksibiliteti gramatikor, ekspresiviteti semantik (sidomos në drejtimin pejorativ dhe ironiues), aspekti metaforik dhe asociativ, pastaj loja humoristike me zërin dhe kuptimin. (Bugarski 2006:21).

Sa i përket mënyrës se si krijohen zhargonet, ekzistojnë me dhjetëra mundësi krijimi, si p.sh.:

- Zhargone me kuptime të reja të nxjerra nga fjalët ekzistuese standarde, shpesh që krijohen me anë të metaforizimit: *sheik* (shitës rrugor i benzinës), *kodosh* (që nuk e jep votën e premtuar një partie), *patolog* (i sëmurë mental) etj.

- huazimet, shpesh të modifikuara nga gjuhë të ndryshme, sot më shpesh nga anglishtja: *kull, faca, çao, xhoint*

- përputhje: *shverc-komerc*

- permutimi i rrokjeve dhe tingujve "stilin mbrapsht" duke përfshirë edhe inversionet humoristike fonotaktike: **reme sheve** (*e merr vesh*); *inva* (*avni*)

- shkurtimi: *profi, tung, flm, edra* = kucedra, për dashnoret e tmerrshme, ose gratë që të hanin çaçkën e syrit, “Baxhelle” = “elle”. Nga kjo edhe fragmenti legjendar i greqishtes “ella kopella” merr kuptimin e vet të plotë dhe përfundimtar; *lici* Kej se Lici (Kujdes se po vjen polici).

- inicialet: *tdsh* (të dua shumë), *tdf* – kuptimi origjinal: të dua fort, të dashuroj fuqishëm, përdoret: të dhj... fenë - *Ia DF* atij kokrrës.

Në Shqipëri nuk ka ndodhur si në vendet e tjera perëndimore që të rinjtë t'u përshtaten lëvizjeve dhe subkulturave rinore. Prej këtu edhe situata sociolinguistike në Shqipëri ndryshon mjaft. Madje fjala *zhargon* nuk pasqyrohet në "Fjalorin e gjuhës shqipe" 1954. Por, tek të rinjtë shqiptarë në Kosovë dhe Maqedoni, për arsye të ndryshme (që lidhen kryesisht me një farë liberalizimi të diktaturave, deri diku zhargonet e studentëve kanë ekzistuar, funksioni i tyre ka qenë kriptik, si dhe studimet për to nuk kanë munguar. (Ymeri 2002:25). Në literaturën gjuhësore shqipe problemi i zhargonit është trajtuar zakonisht shkaras, nën hijen e problemeve të tjera, ose thjesht është dhënë nocioni i dialekteve shoqërore për qëllime mësimore. Mendime për dialektet shoqërore (gjuhët speciale, të folmet konvencionale) janë shfaqë nga prof. **E.Çabej** në kursin e gjuhësisë, zhvilluar më 1948 pranë Institutit Pedagogjik të Tiranës; nga prof. **M.Domi**, **Sh.Demiraj**, **J.Gjinari**, **S.Floqi**; në kurset e zhvilluara më vonë në Fakultetin Histori-Filologji". Cituar sipas studimit të **Q.Haxhihasanit** (Haxhihasani 1964:99). I rëndësishëm për temën në shqyrtim është edhe studimi i i prof. **Çabej**, "*Disa eufemizma të shqipes*", *Studime gjuhësore, IV, f.17. Prishtinë 1977*. Shënime të shkurtra, por me vlerë për disa karakteristika të zhargonit, kanë edhe J. Thomai në tekstin *Leksikologjia dhe Xh.Lloshi Stilistika*. Vlen të përmendet edhe punimi i C.Tagliavini, "*Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*", *Le terre albanesi redente I Kosovo. Roma 1943, f.73-82*.

2.2. Fushat ku paraqiten zhargonet

Shpeshherë qëndrimet ndaj të tjerëve tregohen edhe nëpërmjet frazave ironike, ku një shprehje tregon të kundërtën nga ajo që me të vërtetë është, p.sh. kur themi "**djalë i mirë**" merr kuptimin "**dasë i hatashëm**" ose nëse "*ai di shumë për atë*" në thelb ai nuk di asgjë.

Ironi gjejmë edhe tek **nofkat**. Mund të marrim nga letërsia të cilat janë inspiruar nga jeta e vërtetë. "*Andreja i vdekur*, e quajnë ashtu sepse për babanë e tij kanë menduar se ka vdekur, kurse ai u paraqit si i gjallë" (Goldschmidt, Sam. Skr.VIII, f.320).

Kjo mund të takohet edhe tek indianët: një fis, fqinjët e tyre i quajtën si "**të vrenjtur**" për shkak se për herë janë qeshur (Geschlachts-en persoonnamen der Peigans, f.9)

Shpesh herë te zhargonet ndërliidhen terme shumë të largëta se sa në jetën normale. Do të tregojmë shembuj nga anglishtja: filologun e njohur gjerman **Karl Mullenhoff** në jetën fëmijërore , por edhe më vonë e quanin **Cato (Katon)**, sepse babai i tij ka qenë katolik, kur edhe vëllai i tij më i vogël u nis për në shkollë, e emërtuan **Lelius (Katoni)** dhe Leliusi janë dy traktate të Ciceronit që i kanë mësuar në shkollë. (Jespersen 1970:136).

2.3. Shkurtime dhe simbolet e ndryshme

Shkurtime luajnë një rol të madh te zhargonet, sidomos te nxënësit dhe studentët. Në anglisht kemi **lab** për *laborator*, **gym** për *gjimnastikë*, **maths** për *matematikë*. Në frëngjisht: **pneu** për *pneumatique*, **velo** për *velocipede*, **le metro** për “*chemin de fer metropolitain*”, **perme** për *permission* (“leje” në gjuhën ushtarake) etj. Shumë prej këtyre nga zhargoni kanë hyrë në gjuhët letrare, p.sh. **kilo** (në tërë Evropën), **piano** për *pianoforte* (ose fortepiano), **auto** (frëngjisht dhe gjermanisht) etj.. Në Skandinavi kemi edhe **bil** për *automobil*, , anglisht **cab** për *cabriolet*, **bus** për *autobus*, **foto** për *fotografi*.

Megjithatë raste cungimi ka edhe me fjalë të zakonshme shqipe: **nar** për *katundar*, **ot** për *otoman* (E Durham për vitin 1909); Nxënësit e shkollës ushtarake “Skënderbej” quheshin **begsa**. Shembuj të tjerë janë: **usho** për ushtar, **kusho** për kushëri, **gabi** (në togun Te Firma Gabi) për **gabelin**. (Lloshi 2001: 175).

Me rëndësi është të theksohet se mundësia dhe dëshira më e madhe për shkurtime është në shoqëritë e industrializuara të kohës sonë me jetën e shpejtë urbane, sesa të themi siç është edhe sot e kësaj dite në orient, ku koha nuk ka rëndësi të tillë, ku për ta nuk ka ndonjë rëndësi shprehja “koha është para”.

Kur jemi te shkurtime ndonjëherë ndodh të paraqiten edhe asociacione tallëse. P.sh. në Angli nxënësit e shkurtojnë fjalën **dictionary** (fjalor) në **dic**, mirëpo **Dick** është shkurtesë e emrit **Richard**, ata edhe fjalorin e quajnë *Richard*. Njësoj edhe **bill** (llogari) bëhet **william**, sepse **Williami** ka formën e shkurtë Bil. (Jespersen 1970:138).

2.4. Fjalët e huaja

Shumë shpesh , në rreshtat e shkruar shqip, hasen fjalë e shprehje nga anglishtja, italishtja e ndonjë gjuhë tjetër duke i përdorur në forma të shkurtra. Një problem të madh paraqesin dhe termat e ndryshëm të informatikës, të cilët herë shkruhen si në

original, e herë sipas shqiptimit që i bën gjithsecili në shqip duke sjellë kështu jo vetëm deformim, por edhe fjalë të ndryshme për të njëjtën term. Përveç fjalëve që jetojnë prej vitesh, shkojnë edhe më tej duke krijuar fjalë “të reja”, ku i përziejnë rrënjët e fjalës së huaj me ndajshtesat dhe mbaresat e shqipes.

Ja disa nga fjalët e huaja që ndeshen dendur nëpër forume e Chat-e të ndryshme: *ok* (në rregull), *fedbeka / feedback* (reagim), *impakt* (ndikim), *interne* (brendshme), *resurse* (burime), *satisfacion* (kënaqësi), *shopping* (blerje), *softuer / sotware*, *ueb / veb*, *e-mail / email / imejl* (postë elektronike), *networkun / netuorkun / networkun* (rrjetin), *download / daunlodoj / daunladova* (shkarkoj), *talkim* (bisedojmë), *goim* (shkojmë), *noticieur* (kam vënë re), *speakim* (flasim), *llok-un / lukun* (paraqitjen), *shatoj*, *afaron / afaruar* (punë, çështje), *beneficioneve* (bamirësi), *definim* (pëcaktim), *elaboron* (përpunon), *lokale* (besnik), *indulgjencë* (përmëshje, favor) (Çepani 2006:396); *kopirajt*.

3. Llojet e zhargoneve

Nxitja për krijimin e zhargoneve vjen nga një farë ndjenjeje e superioritetit intelektual (Jespersen 1970:129). Shumë fjalë që i njohim mirë vjetërsohen dhe na janë mërzhitur t'i përdorim edhe më tej, andaj kërkojmë fjalë të reja të cilat do të na plotësojnë dëshirën për diçka të re dhe zbavitëse. Pra zhargonet në një mënyrë janë pjellë e imagjinatës sonë dhe dëshirës për lojë. Ata krijojnë diçka të re, edhe atje ku nuk kërkohet diç të re. Në vetëdijen tonë fjala e vjetër është krejtësisht e mirë, por në pyetje janë vetëm ndjenjat tona që nuk mund ta durojnë më atë fjalë.

Ekzistojnë disa lloje të zhargoneve. Ndarja themelore mund të jetë në zhargone: të **adoleshentëve**, **subkulturore** dhe **profesioniste**. Pra ekzistojnë *zhargone rrugaçësh, studentësh, ushtarësh, narkomanësh, kriminalësh* etj., ekzistojnë edhe zhargone të hobeve të posaçme si dhe profesioneve të caktuara.

Zhargonet **subkulturore** dhe ai i **adoleshentëve** përshkohen me imagjinatë, spontanitet, humor dhe kreativitet përshkrues, andaj në përgjithësi mund të vlerësohen si pozitive. Midis këtyre kategorive nuk ka kufi të caktuar, shpesh herë në të njëjtën kohë janë edhe të njëjës edhe të tjetrës kategori. Përkundër kësaj Zhargonet **profesioniste** karakterizohen me mënyrën shabllonike dhe zakonisht ky lloj zhargoni vlerësohet si negativ.

3.1. Zhargonet e adoleshentëve

Ndryshimet më të mëdha në gjuhë dhe shoqëri pa mëdyshje i bëjnë të rinjtë. Nëse materiali evidentohet në mënyrë kronologjike, mund të vijmë në përfundime se rinia gjatë viteve 1990-2000, si inspirim për kreativitetin e tyre humoristik verbal shumë pak ka përdorur anglizmat. Pra, më tepër janë mbështetur në prapashtesat dhe fjalitë burimore në të cilat karakteristike kanë qenë shënimet semantike. Siç mund të shihet sot anglicizmat janë në rritje e sipër në të gjitha frontet.

Zhargoni i sotëm i të rinjve në përgjithësi, (gjimnazistët në veçanti) është krijuar më së shumti nga ata vetë. Një pjesë janë fjalë të gjuhëve të huaja, fjalët e tjera krijohen mbi bazën e fjalëve ekzistuese, por me përdorim të ndryshuar. Shpeshherë, zhargonet rëndohen deri në atë masë, sa që krijojnë një gjuhë të tyre bazuar në rrethin shoqëror, para së gjithash për të mos u dalluar apo dhe për të mos u kuptuar nga pjesa tjetër, e cila nuk bën pjesë në këtë rreth. Nuk përjashtohen dhe rastet kur këto fjalë përhapen si virus mes gjimnazistëve, sepse konsiderohen **trendy** apo në modë... Pjesa më e madhe e fjalorit që përfshinë këto zhargon, ngjizet nga fjalë që përgjithësisht konsiderohen si vulgare.

Rinia sot ka krijuar gjuhën e tyre për t'u mos kuptuar nga të tjerët, por edhe nga prindërit. Në Amerikë ka një website për prindërit me një listë të madhe "slangu" ose gjuhe e krijuar nga rinia. Edhe në Itali, adoleshentët dhe të rinjtë kanë publikuar në internet fjalorët me zhargonet e tyre. Madje, vizitorët, të cilët "lundrojnë" në këto faqe edhe mund të shtojnë fjalë nga bagazhi i tyre. Ky fjalor ka mijëra fjalë. Pasi klikon në një shkronjë, në këto faqe mund të gjesh të sqaruara në detaje, se në çfarë viti është hedhur në rrjet, cili qytet e ka "shpikur" dhe çfarë kuptimi ose kuptimesh ka ajo fjalë.

Shpikje të tilla ka tek të gjithë popujt e botës, adoleshentët janë ata që preferojnë t'i përdorin jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në fraza këngësh, poezish apo edhe më gjerë.

Përveçse fjalëve në shqip, në zhargonin e gjimnazistëve zënë një vend të madhe dhe huazimet nga gjuhët e huaja. Kryesisht, ato nga italishtja, anglishtja, frëngjishtja dhe në nivel më të ulët nga greqishtja, apo turqishtja. Por, duhet theksuar që kohët e fundit, pjesë e zhargonit të tyre janë bërë dhe fjalë nga spanjishtja dhe kjo për shkak të telenovelave. P.sh. *"Kam fillu me marr içik vesh nga spanjishtja dhe kur dum` të themi ndonjë gjë që nuk duhet ta dinë çunat e klasës, flasim gjysma spanjisht"*.

Ky zhargon fjalësh, në dukje banale, është kthyer tashmë në modë. Fjalori i përshtatur e shqipëruar nga vetë "akademikët"

përdoret vetëm para mësuesve, prindërve, të rriturve apo edhe të afërmve, kurse adoleshentët përdorin edhe fjalorin e tyre.

Në shumë shkolla, sidomos në ato të vjetrat, të tipit të konvikteve, ku nxënësit kanë jetuar së bashku por shpesh të ndarë nga bota, duke menduar se përbëjnë klasë të veçantë të të privilegjuarve, është zhvilluar një gjuhë të posaçme, që në thelb ka qenë zhargon. Madje janë shënuar edhe fjalorë me dialekte të tilla shkollore, si p.sh. në **kolegjin e Vançesterit** dhe shkollën e **Herlufsholmit në Danimarkë** (Wrench 1891). Karakteristike e kësaj të folmeje është se fjalët formohen në atë mënyrë që merret fillimi i pjesës së parë të fjalës dhe i shtohet pjesa e dytë e fjalës tjetër (Shih për blendet f.192), p.sh. **toelk** (në vend **tykmoelk**), **tonen** (në vend të **tykmoelkkonen**) etj. Duhet të theksojmë se fjalët mund edhe të shtrembërohen dhe të krijohen fjalë të reja, siç janë krijuar në **akademinë ushtarake Ecole Polytechnique** në Francë. (shih në *Memoires de la Soc. De Linguistique XV*). (Jespersen 1970:131).

Në praktikat e formimit të fjalëve të nxënësve dhe studentëve, janë ndjekur edhe mënyra dhe kombinime tjera, si:

a) **kombinimet e rrokjeve argotike**, p.sh. mbas rrokjeve që formohen me **-u-** shtohet rrokja **-furt**, mbas rrokjeve me **-y-**, **fyrt**, pas rrokjeve me **-i-**, **-a-** rrokja **iks**.

b) **kthimi i fjalëve mbrapsht** P.sh. *imzilanoicanretni ratelorp – internacionalizmi proletar*; *yk fesor pre kun aj perksh re-fa* (ky profesor s'ia shkrep fare).

c) **shformimet e fjalëve të gjuhës amtare me anë të metatezës e anagramës**: p.sh. nxënësit e ish-shkollës normale të Elbasanit në vitet 1930-35 kanë përdorur më tepër zhvendosjen e rrokjeve, vendosjen e rrokjes së mbrapme para së parës: *vet / te-ve; shko-lla / lla-shko; mu-ri / ri-mu; profesori / sori-profe*. (Haxhihasani 1964:120). Me metatezë *u palose* (p.sh. u lapose, buçko!) për dikë që zgërraqet fare. (Lloshi 2001:175)

Këto modifikime janë praktikuar edhe në gjuhë tjera, p.sh. në italishte *presto/sto-pre; molto/to-mol*; në anglisht: *penny/venep*; në frëngjisht : *toulon/lon-tou*. (Ymeri 2002:24).

Nëpër shkollat shqiptare, si në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni nuk ka ndodhur si në vendet e tjera t'u përshtaten sjelljeve e lëvizjeve të subkulturave rinore të markës perëndimore. Ky proces te ne filloi vetëm pas viteve 90, tani më dihen edhe faktorët pse ishte kështu. Informacione edhe pse të pakta, por mjaft interesante për gjuhën e studentëve na sjell Qemal Haxhihasani në artikullin “*Të folmet shoqnore. Dogançja, e folmja shoqnore e zejtarëve shëtitës të Permetit dhe të Leskovikut*”. Botuar në revistën “*Studime filologjike, Tiranë, 1964/1,2,3*, pra në tre vazhdime. Këto

informacione i përkasin viteve 1930-1935, kryesisht nga ligjërimi i nxënësve të shkollës normale të Elbasanit. Ai jep të dhëna për ekzistencën dhe funksionimin e kësaj të folmeje, bazën e saj, si dhe ndonjë veçori gramatikore. Këto të folme janë të thjeshta dhe "shquhen nga një ngjyrë humoristike si edhe nga një karakter fshehtësie jo të thellë. Pra autori sjell disa njoftime edhe për të folmen në zhargon të nxënësve. Duke pasur parasysh kohën dhe mentalitetin konservator të qytetit të Elbasanit si të gjitha qytetet tjera shqiptare, kjo e folme përdorej për të fshehur probleme të tilla tabu, si dashuria etj.

Në një letër të shkruar nga një arsimtare dhe drejtuar një studenteje në Fakultetin e Letërsisë kemi të vetmin njoftim për zhargonin e studentëve pas Çlirimit. Kështu që e shohim të arsyeshme ta sjellim këtë letër të plotë: *Oram e rushad! Maj rim ëtëk jorishëd dhe roi yt...Npnup emit e nishik rram shev ën ipëtsh. Oja i shik ënëth ët tjavëll edhe ia shik rushubm Nërolv. Rim ësm eshoth it rehta es oja ëtshë eraqiliz. Op nu akçalladub kunët avogjêd.* (Përkthim: Maro e dashur! Jam mirë, këtë dëshiroj edhe për ty... Punën time e kishin marrë vesh në shtëpi. Ajo i kishte thënë të vëllait dhe ai kishte mbushur Vlorën. Mirë më thoshe ti atëherë se ajo ishte ziliqare. Po unë budallaçka nuk të dëgjova). (Ymeri 2002:24).

Sot, duket se askush nuk reagon përballë një fjale apo shprehje të adoleshentëve, pasi në të vërtetë nuk ua dinë kuptimin e tyre. Nëse dëgjoni në gjimnaze "**Erdhi kuçedra**" apo "**Erdhi e madhja**", në të vërtetë nuk bëhet fjalë për ndonjë figurë përralle. Bëhet fjalë pikërisht për mësuesen. Mësuesja është epiqendra edhe e shumë sharjeve të tjera: "**Të ndërrofsha fenë!**" ose "**Më pafsh tavanin e dhomës!**", janë vetëm dy nga ndërthembjet e nxënësve për mësuesen, pas një ndëshkimi... ; Hasëm shumë dëshmi, ku shkolla etiketohet si "**bordellacion**"... Drejtuesit e shkollave janë gjithashtu në shënjestër të kësaj harlisjeje të fjalorit: Drejtori quhet edhe "**polic pa pagesë**" ose "**koka e kuçedrave**", apo "**bosi i letrave**"... (kjo e fundit, sipas shpjegimeve, sepse nuk ka në kontroll asgjë tjetër, veç firmës dhe letrave). Klasa, njihet edhe si "**këndi i lojërave**" ose "**kopshti me lule**", por dhe si "**loja luftash**"...Shkolla, duket qartë që është një vend që nuk u pëlqen. Prindërit shpesh quhen "**tutori**" ose "**bebister**"... "I them "tutor" se harrojnë që nuk jemi më të vegjël... 17-vjeç i ke thënë lamtumirë fëmijërisë dhe je mjaft i rritur për t'i marrë vendimet vetë,- na tha një "përdorues" 17-vjeçar i termit Tutor. "**Orgjia**" (shoqnia) është një tjetër term interesant. Dhe këtu ta presin shkurt: "*Orgji për shoqinë, sepse të dyja funksionojnë në grup dhe kanë më shumë se dy persona...*". Në këtë mënyrë ata mund të mësojnë fjalët që

përdoren tani dhe të kuptojnë fëmijët. Kjo është thjesht punë "stili". Për adoleshentin është shenjë që tregon se nuk është jashtë kohës, që ka "stilin" e kohës.

Pra, dialektizmat, fjalë të përziera shqip, anglisht, italisht, sipas rastit, përbëjnë bazën e "shpikjeve" të shumta dhe plot fantazi. Zhargoni, vërtet ekskluziv i gjimnazistëve, dallohet menjëherë që nga mënyra e përhëndetjes, si: "ç'kemi tezoro!", "ciao yll bote!", "po ku je o rrusho!", "bye, bye!", "ho mi shtrige...!", "in boka lupu andej nga brindezi!"... E, nga ana tjetër: "shi, shi, kur bo kakërdhia dhe ajo vrromsja!", "ta çaj farfallën", "marmit-shpuar", etj. "Përkëdheli" që nuk i bëjnë përshtypje askujt. tashmë janë edhe "idiot, debil, budallaqe, femër/çun krize, muzike llahtar/lemeri, çun lac ose katal, femër baxhelle, etj.pederast, kurvë..."

3.1.1 Shembuj nga fjalori i adoleshentëve

Drejtori: *bosi i letrave, koka e kuçdrave, polic pa pagesë* (Alb); *ai i madhi, ai që e mban veten, ai që i mson msusët, baba i shkollës, bos i ditarave, bos i klincive, brko, dasa, direktor, exheli, i Biligradit, i madhi kataundit, jorgovani, shpageta, polici pa rrog* (Te); *bosi, bos i bosave* (Gv); *bosi i shkollës* (Gv), (Te); *i madhi* (Gv), (Kç), (Te); *komandanti* (St), (Te); *polic* (Gv), (Kç); *shefi* (St), (Te); *i madhi, mauti i madh* (Pp);

Nota kaluese: *baza për notën më të ulët kaluese; u avullua nga leksioni; mori ni bander* (mori notë të dobët) (Pp)

Ai që ik, që braktis mësimin: *i bëri shapin* "iku e braktisi mësimin". Prej këtu ai që ikte pa leje quhej **shapist**. (sipas modelit *i bëri naftën* "zëvendësim eufemik për një fjalë të pahijshme) (Lloshi 2001:174);

Klasa: *banesa* (Kç); *çerdhja, kafazi i art, restoranti, sallon ondulimi ndreçu vet, shpaja e caullve, shtabi, vendtakimi, zbavitje* (Te); *grazhd lopësh, shtallë e lopëve në krye me muzatin* (Gv); *këndi i lojërave, kopshti me lule, loja luftash* (Alb); *kuvendi special, parlamenti, zyra* (St); *burg* (Gv, Kç).

Mësuese: *Betoveni, bosja, frajerica, kreje shpatuke, madhsaja fizike, msuse, nëna e dit e caullve, policja, prespektiva, profka, shpicollka, shtriga, xhixha* (Te); *gëgufshe, kobra, kulçedra* (St); *mcuska, mendjeshitëse, msusja* (Gv); *e madhja, kuçedra* (Alb, Te); *kuklla* (Gv, Te); *kuçedrta e zjarrt* (Kr)

Prindërit: *aj i jemi, ambasadorët, budigart, kujdestarët, pleçt, Rambo 1, Rambo 2, shefat, sudi, t'mojt, t'shpajës, t'vizave* (Te); *bebister, tutori* (Alb); *edukator, këshilltar, kujdestar* (St); *exhelët, liderët, policët, sponzorët* (Gv); *fbi* (Kç).

Roja civile e shkollës: *allaxhe, klishi, partall (Gv); baloja, lici, pashuk, qylaxhiu (Alb); çuvar, kujdestar, sekjuritasi, shërbetor, shërbetor zilje (Te); patrulla civile (St); shumar (Gv, Te); zhirafa (Shk);*

Shkolla: “*institucioni*”, *aqje ku është zhivoti, burgi i Idrizovës, disko, fati i martesës, humbje kohe, kalimi i kohës së lirë, kisha, livadhi, Mek Donallc, oborri, qendra e dashurisë, shpaja e dit, shpaja e lojave, shpaja e t'mençmive pi ka fundi, xhunglla (Te); bordellacion (Alb); hapsëne, igralishte, vendtakim (Gv); kafaz, mësojtorja (St); shporeti (Shk);*

Festë: *aheng, duam harem (Alb); babina, bereqet, darsëm, fiesta, hajde disponim, marrje mendsh, tollovej, zbavitje (Te); mbrëmje, parti (St); tollovi (Gv); ditë pushimi (Gv, Te); hallakatje (Alb, Te); zhurk (St, Te).*

3.1.2. Gjuha e adoleshentëve në internet

Me zhvillimin e teknologjisë, sidomos me paraqitjen e internetit dhe celularëve kanë ndryshuar mënyra e të shkruarit, ku karakteristike janë shkurtime dhe simbolet. Nga vitet '90 e këndeje këtë trend e kanë ndjekur edhe nxënësit dhe studentët shqiptarë. Ata përdorin dendur simbole dhe shkurtime të natyrave të ndryshme (Çepani 2006:308-309):

1) Shkurtesa me shkronja:

shqip: *flm*- faleminderit, *flmnsh* - faleminderit shumë, *sps* - s`ka përse, *skgj* - s`ka gjë, *klm* - kalofsh mire, *klb* - kalo bukur, *gz* – gëzohem, *upp* - vij pas pak, *psh* - përshëndetje, *nqs* - në qoftë se, *mgjth* – megjithatë, *dmd* - domosdo, *diç* - diçka, *mgjth* “megjithatë”; *mm* “mirëmëngjesi”; *msg* “mesazh”; *nqs* “në qoftë se”; *ps* “poshtëshënim”; *psp* “prapëseprapë”; *sh* “shumës”; *sh.m.* “shkolla e mesme”; *gjths* “gjithsesi”; *gjthsh* “gjithashtu; *ikm* “ia kalofsh mirë”; *klm* “kalo mirë”; *sps* “ska për se”; *tkxh* “të kam xhan”; *tpf* “të puth fort”; *tung* “tungjatjeta”; *ugh* “i mërzhitur”; “*tdf*” Të dua fort: (Te); *td* (të dua), *tdi* “turbo disel ineksion”; *tdsh* “të dua shumë”;

anglisht: *asl* “age/sex/location”; *b* “be”; *cu* “see you”; *lu* “love you”; *frng* “dy javë”; *hi* “përshëndetje”; *asps* “sa më shpejtë të jetë e mundur”; *cem* ‘krim’; *ily* (i love you),

2) Shkurtesa me shkronja dhe numra:

a. **shqip:** *1herë* (njëherë), *1jtë* (njëjtë), *1ra* (njëra); *1ri* (njëri); *1soj* (njësoj); *as1* (asnjë), *gjith1* (gjithnjë); *2shim* (dyshim), *2tësor* (dytësor); *3gom* (tregom), *çka ka 3* (çka ka të re); *3këndësh*

(trekëndësh); **4or** (katror), **4këndësh** (katërkëndësh); **5imist** (pesimist); **7or** (shtator); **pye8** (pyetet); **bër8** (bërtet), **sh8** (shtet); **universi8** (universitet); **vër8** (vërtetë); **vi8** (vitet); **8ova** (Tetova), **8ovare** (tetovare), **8ris** (tetris); **9or** (nëntor); **10or** (dhjetor)

b. **anglisht:** 2u “tu you”; 4 you “for you; b4 “bifore”; b4n “by for now”; b4u “before you”; f2f “face to face”; f2t “free to talk”; ly4e “love you forever”; m2 “me too”; m8 :”mate”; o4u “only”; g2g “got to got; h2sys “hop to see you solon; h8 “hate”; w8 “wait”

3) **Shenjat:** & ose + “edhe”; *** = “puthje”; “vazhdoni”; = “për”; ;) -kur ja bën me sy; :) -buzëqeshje; :D -e qeshur gojë hapur; :-O -e qeshur kur befasohesh ; :P -e qeshur me gjuhën jasht; (H) -e qeshur e ngrohtë; :@ -e qeshur e nervozuar; :5 -e qeshur konfuze; :\$ -e qeshur e turpshme; :(-e qeshur e pikëlluar; :(-qarje; :| -e qeshur zhgënjyese; (A) -engjell; |-) -i pikëlluar; *-) -i kujtuar

4) **SMS porosinë**

Sot kemi parasysh që fjalët dhe ndjenjat shprehen edhe nëpërmjet çatëve dhe internetit . Pra kanë ndryshuar metodat. Dikur shkruheshin letrat e dashurisë dhe mendohej të viheshin në letër fjalët e zemrës. Njerëz që nuk dinin të shkruanin i thoshin një shoku ose një personi tjetër, më shkruaj një letër. Po të bëjmë një krahasim ato, ishin si puna e serenatave që bëheshin nga dikush tjetër, në emër të dikujt tjetër. Letrat kanë pasur një karakter të tillë të foluri që në shkrim duheshin figura letrare siç mund të përmendim si mu dogj zemra, jam i përvëlur etj.

Ndërsa rininë e sotme e karakterizon shprehja më e lirshme, madje ndodh që janë më vulgare se dikur. D.m.th elementet e të folurit të të rinjve dikur kanë qenë më pak lënduese dhe pa fjalë të ndyra. Sot në zhargonin e të rinjve nuk mungojnë edhe fjalë të ndyra por ky është një fenomen i përbotshëm, nuk ndodh vetëm tek shqiptarët. Ndërkaq, sikundër thamë, është edhe dukuri kalimtare. Nuk zgjat përgjithmonë.

Pjesë nga disa prej SMS-ve, marrë nga celularët e adoleshentëve (me dëshirën e tyre)

SMS 1: Karamele!-ncuq...jo

akullore?! Ncuq , jo pra jo...

sheqer atëherë: -jo jo

Dreq....nuk gjej asgjë kaq të ëmbël sa ty...!

SMS 2: Xemla po nisem për Elbasan. Do vij të djelën. Ok kukla ime? Mos u mëzhit. Të djëlëndo rrimë bashkë 24 orë non stop.Puç.

SMS 3: Drenushë fjet? E mirë. Të puth me ndjenjë te gusha e te buza. Gjurmë të ëmbël! Tonji

SMS 4: O tutul (gjoja kukull) pse s'ma vare fare sot? Ç'po bën? Me kë je ? Të thup (puth) fot.

SMS 5: Arushi, t'uroj që për këtë Vit të Ri, të gjesh një pulë llasticë.Po ti k'të e ke!! Atëherë t'uroj të gjesh një pulë budadhaqe.Po edhe këtë e ke Arushi! Po ti i paske të gjitha Arushi!!!

SMS 6: Lali si po kalon ? Ende në Gjermani? Të hëngsha zemrën se më ka marrë malli.

SMS 7: "Ej s'vi dot tani se jam me plakun. Po e mar me t'mir ti zhvat një dhjeçe. Hahahaa aman se m'vdiq dhe ky trapi... ku do jeni ju pastaj?"

SMS 8: "...Flor, shifena te "Klasik" në 6 e gjys`. U thuj dhe atyre kurvave të vijnë se skam impuls cel. Puc Jona".

SMS 9: "...Kujt i shaje fytyrën e bukur, ti kurvar i dreqit.... eee? Mir mir, se ta tregoj unë qefin kur takohemi!"

SMS 10: "Nesër, dy orët e para m'i justifikoj pak, lolol! Futi ndonjë nen, asaj bibës. Se mos vej mungesa ajo fikfishkura, se ja çava sumën! Folim pastaj, bye bye!"

SMS 11: "Yll, po morën gjë ata të mit`, u thuj që jemi bashk e do flem nga ti, se jam e prenotume. Do dalim jasht TR me amoren...! Ciao!"

SMS 12: "Ç'kemi tezoro, na kujto ndonjëher për kafe, jo për gjë, po na rritet roga...! Ciao!"

5) Tekste mesazhi

Teksti 1

Sapo futeshim te "Asim Vokshi" asistuaam në një skenë të tillë: "...Hë mi kurve, e solle surratin? Kam gjys` ore që pres kulon tate k'tu...!". Me këto fjalë e priti shoqen e vet që po afrohej, një bashkëmoshatare e saj në pritje... Shoqja qeshi, i tha diçka zëulët dhe të kapura përkrahu, të dyja vajzat u drejtuan për jashtë shkollës. Vetëm pak minuta më pas, "mbajtëm shënim" një tjetër shpërthim. Kësaj here, një vajzë që i qahej shoqes së vet për dikë, me sa kuptohej nga dialogu, një djalë: Vajza 1: "...Ai k... na shiste pordhë me atë sh.... që e pamë në lokal dje. Po, do më kërkojë ai mu`, do më kërkojë, po s'ka për të gjet p... si unë...!". Vajza 2: "...Po vari leshtë o yll, se s'ia vlen ai shkërdhata, që të hongsha synin unë ty! Mos u mërzit kot, se s'ia vlen o zemra ime...!"

Teksti 2

"Idiot, debil, budallaqe, pederast, kurvë...", janë tashmë "përkëdheli" që nuk i bëjnë përshtypje askujt. Dialektizmat, fjalë të përziara shqip, anglisht, italisht, sipas rastit, përbëjnë bazën e "shpikjeve" të shumta dhe plot fantazi. Zhargoni, vërtet ekskluziv i

gjimnazistëve, dallohet menjëherë që nga mënyra e përshëndetjes, si: "Ç'kemi tezoro!", "Ciao yll bote!", "Po ku je o rrusho!", "Bye, bye!", "Ho mi shtrige...!", "In boka lupu andej nga Brindezi!"... e, nga ana tjetër: "Shi, shi, kur bo kakërdhia dhe ajo vrromsja!", "Ta çaj farfallën", "Marmit-shpuar", etj.

Teksti 3

"-O Robo, ç'kemi. - Përgjigjet shoku - Më iku zari, isha me një tribale sot. Ia kthen tjetri- Oho, ti je Toç kukulle plako- po hë si vajti? -E hodha zarin por përfundova në rrugë boshe se I kishin ardhur hallat nga amerika. -Po ty si të eci.- Hiç, me një bundër sot".

Teksti 4

"...Hë mi kurve, e solle surratin? Kam gjys` ore që pres kulon tate k'tu...!". Me këto fjalë e priti shoqen e vet që po afrohej, një bashkëmoshatare e saj në pritje... Shoqja qeshi, i tha diçka zë ulët dhe të kapura përkrahu, të dyja vajzat u drejtuan për jashtë shkollës.

Teksti 5

Vajza 1: "...Ai k... na shiste pordhë me atë sh.... që e pamë në lokal dje. Po, do më kërkojë ai mu`, do më kërkojë, po s'ka për të gjet p... si unë...!".

Vajza 2: "...Po vari leshtë o yll, se s'ia vlen ai shkërdhata, që të hongsha synin unë ty! Mos u mërzit kot, se s'ia vlen o zemra ime...!".

3.1.3. Zhargone frazeologjike

S'merr vesh, nuk e vret mendjen: **ai është 8 pa 10**

Kur sorollatet: **andej këndej gjithandej**

Merr iniciativa i pari: **angazhohu në jetë**

Takohen rrallë: **bashkëjeton një herë në javë**

Që ka dy lidhje njëkohësisht, ose kur partneri është i sjellshëm:

dashnor i/e rregullt

Dhënia fund një bisede të bezdisshme ose një diskutimi të gjatë:

dhe produkte të tjera ushqimore

Lloj kërcënimi: **do të shkrij komplet**

E anashkalon bisedën: **dredhje beli**

Është përdorues i vjetër i lëndëve narkotike: **e bën vizën sa**

tavolina

Është e dashura e atij/asaj: **e ka kap ai/ajo**

Që nuk tregohet i sinqertë: **e ka muhabetin me të futme**

Po devijon: **e ke hap krahun**

Fantastike: **e papame**

Pi shumë cigare: **e pi cigaren me llullë, e ha cigaren fare**

Merr substanca narkotike: **e tërheq**

Kur bën diçka shpesh ose kur është specialist në një fushë: **e vdes fare**

Femër seksi: **është bishë fare**

Djalë që i di rregullat : **është çun me etapa**

Është djalë, vajzë e mirë : **është grup fare**

Është nën efektin e lëndëve narkotike : **është i bomë**

Është djalë i mirë dhe mbi të gjitha shakatar : **është njish**

Është për ta rrahur : **është për t'i fut çorapen në gojë**

Shumë kuptime, ik se na mërzi, ai është i bezdisshëm : **futja vrapit**

Vajzë që lexon libra ose e aftë : **goc e lexume**

Mënyrë për të shmangur bisedën, për ta anashkaluar

bashkëbiseduesin : **hajt se folim**

Pusho mos fol : **haspi karalloi**

Pirje drogash : **i fus një tegel**

Ka përfunduar si punë : **i ka vdek nona atij muhabeti**

flet përçart : **ia fut për kënaqësi**

Është jashtë bisedës, ose jashtë rrjedhës : **jashtë orbite**

Ka mbaruar komplet : **ka mërdhif**

Do të fejohe, martohet, do ta marrë për grua : **ka në mend me e mor**

Për diçka që nuk të pëlqen, ose nuk mund të vazhdojë më :

kafshatë që s'kapërdihet

Shkalla sipërore e të thënurit, gënjeshtar i madh : **mashtues me patentë ndërkombëtare**

Më fal se të bezdisa e thënë me ironi : **më fal se të fika llullën**

Gjasme : **me haspi**

Jam shumë i shqetësuar : **më ka ik petlla/zari**

Mos më mërzi shumë : **mos më çaj tallamandrën**

Na prishi punë: **na ka fik derën**

U mërzi tëm duke pritur, duke ndenjmur kot: **na u llash trapa**

Na mërzi me atë lloj bisede: **na zuri treni ose autobusi**

Krahasim për mashkullin: **rri si 200**

Është e re: **new entry**

Pantallona demode që janë me bel të lartë: **pantallona deri te zemra ose deri te goja**

Për qejf, për argëtim: **për shkepje**

Mënyrë për të ngacmuar femrat: **për ty boj pesë vjet burg**

I jep rëndësi, e fryn më tepër sesa duhet, ose një person që hyn me krenari: **pompozitet**

Merret me punë të pista: **punon**

Lloj betimi: **qafsha për zotin**

Kodi për të thënë se çmimi është tepër i shtrenjtë: **qeka çmim i leverdishëm**

E rëndomtë: **rozgo**
 Katundar: **rural komplet**
 Nuk e vret mendjen: **ta boft zoti mar**
 Kërcënim: **ta çaj gojën**
 Mallkim: **të honkshin qentë**
 Që nuk të ndihmoj dot: **të mushme e ke**
 Mallkim: **të rraftë ngordhja**
 Mënyrë për të treguar fortësinë: **të tërheq zvarrë**
 Lloj sharjeje: **të thy në mes**
 Ironi për një person që ka pretendime: **tip delikat**
 E humba toruan: **u fiksova fare**
 Vajzë simpatike, që vishet bukur: **vajzë kopertonash**
 Mos i jep rëndësi: **vari teneqen**
 Sharje që i drejtohet mësueses nga ndërthëmbjet e nxënësve pas një ndëshkimi: **të ndërrofsha fenël më pafsh tavanin e dhomës!**
 Fshatari kooperativist: **katnar**
 Kur e tepronin me furcet: **ec bojaxhiu**
 Na iku : **na e hoqën petulla -ën ose trurin.**
 Njeri kot, mbiemer denigrues: **pemthym**
 Njeriu shtesë që nuk i ndahej një çifti : “Beni vjen gjithmonë me ne” një nga parodistët e Vlorës.
 Ai që nuk mendon: **e kishte trurin fushe ose pa brazda.**
 Takim me një femër: **do shkoj t'i ndërroj vajin makinës**
 Ke punuar gjë kohet e fundit : ke rregulluar ndonjë femër kohet e fundit
 Kujdes se po vjen polici: **kej se lici**
 Bëj nevojën e vogël: **i jap kalit uj; ti jap uji kalit,**
 Bëj nevojën e madhe: ia paguj borxhin popit;shkoj ne kancelari ;
tia paguj popit (Pp)
 Rrotullohem : **u bona tornado**
 Kërcej në uj: **i dhashë me gjiks**
 Ha shumë: **e musha rezervarin**
 Qeshem shumë - **u mpaka**
 Kënaqem - **u dërmova,**

3.2. Zhargonet e të dashuruarve

Për të folur për zhargonin e të dashuruarve, do të duheshin net të tëra dimri. E po të tentonim të bënim një liste më fjalët që ata përdorin, do krijoheshin pafundësi listash. Është kaq e larmishme gjuha e atyre që duhen fjalorë të shumtë, sepse fjalët që

dëgjon tek një çift nuk i dëgjon tek çifti tjetër. Vëzhgimi tregoi se deri diku ata kanë krijuar një gjuhë të tyre.

Nga anketat sociolinguistike, të bëra jo vetëm këtu, por edhe në botën e jashtme rezulton që të dashuruarit kanë një gjuhë që është krejt personale, krejt vetjake . Një onomastikë trupore, si të thuash vetjake. Në raportet e tyre, shkëmbimet e tyre dashurore përdorin një gjuhë shumë mikluese, shumë përkëdhelëse. E përbashkëta për të gjithë është se u rikthehen përkëdheljeve fëmijërore. Përdorin zbulime të tilla si **zemra** por e thonë edhe **zemla**. Në vend të **shpirti im** , hera-herës e thonë edhe **piti im**.

Pra rikujtojnë diçka nga fëmijëria e tyre, nga ato që i kanë pasur si përkëdheli nga mjedisi familjar, dhe i vënë në zbatim pikërisht në këto çaste. Mund të jetë çast i përkohshëm, por sidoqoftë është më mbresëlënëse në jetë. Elementi i ligjërimit të të dashuruarve ose zhargoni i tyre është si një lule shumë e bukur për një periudhë të caktuar të jetës, që më vonë mbetet si ajo lulja e pikturuar në faqet e një libri. Si të thuash ruan format por jo njomëshinë. Të gjithë kujtojnë edhe kur arrijnë një moshë të thyer se edhe ata kanë folur dhe çuçuritur me njëri-tjetrin ashtu si të rinjtë e sotëm. Është më se normale që një i ri dhe një e re të flasin në gjuhë që s'është kurrsesi standarde. Mund të mos jetë as dialektore por një gjuhë e shpikur, një gjuhë e tyre.

Nëse një adoleshent do të thotë **"bundër"**, prindi nuk ka si ta kuptojë se *i biri ka qenë me një femër të përdalë*. Nëse adoleshenti do të thërrasë **"teze"** e ëma vetëm sa do të gëzohet duke menduar se i erdhi që larg e motra. Por në të vërtetë, kuptimi i saj përdoret për një *femër të shëmtuar*. Prindi nuk do të kuptojë as fjalorin e *"masturbimit"* i cili është koduar së fundmi prej adoleshentëve si **"rrugë boshe"**.

Më kot prindi do të mundohet të gjejë as **"hallat nga amerika"**, kur bëhet fjalë për periodat tek femrat, apo të gjejë kuptimin e **"lekngrënës bushtër"** e cila përkthehet me *numrin 141 të telefonisë celulare*.

Në se dikë e dashuron përdoren termat: **"Burimi"**, **"zjarmi"** apo **"bebushi i vogël"**. (Kjo e fundit, thuhet vetëm në rastet kur "ja vlen", d.m.th., kur të ka hyrë pak në zemër... "Nuk përkëdhelen të gjitha, se jo për të gjitha ndodh të ndihesh njëlloj". Nga femrat dëgjohet shpesh **"çuni"**, **"zemra"**, **"frajer"**... Këto janë fjalët që përdorin gjimnazistet, për t'iu drejtuar të dashurit. Nga ana tjetër, nuk mungojnë në rrethin e gjimnazistëve dhe nga ata gjimnazistë që kanë lidhje me më shumë se një partner. Edhe atyre ua kanë ngjitur pullën: **"Doganë me shumë kalime"** dhe një tjetër **"dyqani me listë"**. Për femrat që ata konsiderojnë si të përdala, përdoren fjalë si: **"Kuti votimi"**... Për djemtë me shumë partnere thuhet

"bariu", "tren me shumë tunele" dhe "çezme me shumë burime...". Çfarë është "Parking i vjetër"? Kush do mendonte, se bëhet fjalë për një vend ku më parë ishte parkuar makina e tij, le të korrigojë veten! E thënë nga një gjimnazist, ky togfjalësh ka një kuptim krejt tjetër. Në zhargonin e adoleshentëve të sotëm, "parking i vjetër" quhet *ish-e dashura*...;

a) Për dashurinë dhe gjithçka që lidhet me të

I dashuri: *ashiki, bejbi, burri, çokollata, çokoluk, cuci, ilaçi i zëmrës, jarani, llokum, loçka, pllumbi, shpajrti, tërkuza (litari), tipi, xheloz, zarmi, zogi (Te); burimi, çuni, zjarmi (Alb); dashnija, lepurushi (St); lalushi, njeri jem, polici, shaci (Gv); shpirtë (Gv, Kç); zogu (Kç, St); advokati (Gv, Te); bebushi i vogël, frajleri (Alb, Te); fraeri (St, Te); zemër (Alb, Di, Kç, St, Te); loçka (Shk).*

Ish e dashura: *ajo e para, femra e një kohe, nuk e njoh, stacioni i vjetër (Gv); bifsha Jugosllavija, femra me ni vakët, hupsha e hupët, ish femna, lëfsha, lulja e vyshkur, plaka (Te); eksi, rametlija (St); ranafila, vozitje e lirë (Kç); parkingu i vjetër (Alb, Te); bifsha (Gv, Te); (Shk); parking i vjetër (Kr); rafmetlija, eks (Pp)*

Jo e virgjër: *a msau të mbushet me benzin, cauc hënëm, e piu dhe e hëngri, e prajshët, e ushtuar, gum e shpuar, u lirau nga bara (Te); e ka hongër, e përdorët, e prejshët, teneqe (Gv); e ka thy akullin, i ka liru gypat (St); ka fut ujë komardarja (Alb); tunell (Gv, Kç); e prisht, e shpume, e hapt (Shk); e praishme (Pp)*

E përvetësova: *e fitova, e fuga mbaj viti, e ktheva, e palova, shtajna n'dor, e specializova, e zuna, ja mora dorën, ja mora mend (Te); e kapita, e përtypa, e regjistrova (St); e fuga për mbi vete, e hujdisa (Gv); e kuptova, e morra vesht, më bie në mend (Kç); e mora (Ks); e palosa (Alb); e kapa, e mora, e e zdrova (Gv, Te); e hangra (Shk); e palosa, e shtajna n'dor, e kurdisa (Pp).*

Marrëdhënie seksuale: *i lajm raçet, pozita 69, ta boj hazër tavën, ta hapi kanallin, ta kalli shporetin, ta mbiti miun, ta ndroj ulen, ta ndroj vajin, të kryjm detyrat e shtëpisë (Te); këndo ndonjë këngë tjetër (Kç); një parti, ta laj makinën, të lirohëm, të luaj tenis, të vritem (Gv); të ndërroj vajin, të shkund oxhakun (Alb); e punoj vendin, e bëj një tur, një parti (Shk); ti derdh puplat (Di); te nroj uljen, da laem (Pp)*

Masturbim: *alltobën (Gv); dashnorja e perjetshme (dora), ja futa Tiran-Durrës, rrugë boshe (Alb); dorontina (Te); rrugë e keqe (Kç). i mshoj me dorë, e thira doruntinën, e zuna rugin (Shk); qaki, rukije, desanka, me dorr (Pp)*

Meshkuj që shkojnë më partnere më të mëdha se vetja: dashi, fiçin, karajnfili, mbroje, shfaler (Te); karafil (Alb); mendjemadh (Gv); nëna me djalin, viç (Gv, Te).

Për djemtë me shumë partnere: aj i afti, diler i grave, Don Zhuan (Te); bariu, çezme me shumë burime, tren me shumë tunele (Alb); bythë grist, frajer (Kç); djalë me sëmundjen e sidës, djali me pula (Gv); manjak, qefli (St); avanturist (Gv, Kç, Te); Bos, don zhuan.

Femrat që konsiderohen si të përdala, prostitutë: ato t'asaj dore, dorë dhënë (Gv); bundra, kuti votimi, mësimore (Alb); bushtër, cauc udhnash, çerap për të gjithë, e reh fiçin, hotelja, i bie bithës, i bon hizmet sendit, kanaxhexhja, karrike për të gjithë, meraklie n'sallata, mësimorja, ndyrësinë, nën Tereza, nuse diqani, pushimorje, tunell (Te); lavire, vajzat e mbara (St); qendër rrospija (Kç); orospi, prostitutk (Gv, Te); kurva (Gv, Kç, Te); nauk diften nishpai, gjymbyshlije, dordhanme (Pp).

Homoseksual: aerodromi, çavo, çift romantik, çifti simpatik katastrofal, femën, homo, i asaj dore, shasko, shminki (Te); as tekë as tiqe, djal me mikrofon në dorë, prosha (Gv); fashkull (Alb); gej (Gv, Te); pederast (Alb, Te); peder (Gv, Kç, St, Te); i dorës së dytë (Shk); buljash, pederishte, i limaut, dora e dyt (Pp).

Kurvat kur shkonin të gjithë: bang-prove (Alb); ke samarxhiu (Pp).

Për femra që kanë lidhje me më shumë se një partner: avanturiste, borbardha me xhuxhat, e palodhshmja, fraerica, meraklija, puntorja e shaum ndrimeve, teshka kategoria (Te); doganë me shumë kalime, dyqani me listë (Alb); femër e prishur, fuks, kurv, mban di karpuzi n'dor, me firm, njeri që nuk prish qejf (Gv); koketa (Shk); coc me emer (Di); dordhanmja (Pp).

Për gjoksin e një vajze në përmasa të mëdha: air bag, jastëk me ujë, kamare drunjësh, mlekara, topa kosharke (Gv); ballon, Çiljeta, mullar, Pamella, qumshtorja Munevere, shkëmb (Te); gjyle, molla (St); qumshtore (St, Te); ballkon (Alb, Kç, Te); Lopë shteti, qumshtorja munevere, ballona (Shk); bapka (Pp); qumshtore (Di).

Prapanicë: bagazh, bithët e kcajme mbas, garazh, magazin, të prapmet (Te); e ngrefët, fiellga, si bmw Z3 (Gv); legen (paska legen të mirë kjo vajzë), (Alb); mollaçe, topka, tuçka (St); zuz', golle (Shk); stamollka, palare (Pp).

Periodat (menstruacioni): ato xhëjat, miçët, mikeshat, të kuçet (Gv); ditët, teze (St); hallat nga Amerika, i kanë ardh turistet, hanet e grave, tezja (Alb); mikeshat mujore, misafiret, shoçet, tezë me ferrari të kuç (Te); redet (Kç); rendi (Di, Te, Pp); tezë (Gv, Kç, Te); Teshat e kuçe (Shk); të kuçet, ato (Di); rendi, barku i dhëm (Pp).

b) Për karakteristikat e vajzave

Vajzë që e mban veten për vajzë të bukur: Adelina Ismajli, Anxhelina Xholi, bukuroshja, bukuroshja e mamit, çallomxhije, folirante, Leonora Jakupi, Madona, Pamella, Rosalinda (Te); Genta (Kç); Mia (St); i ka hi vetja në qef (Gv, Kç); Brinty Spears (Alb, Te). Shkira, ja lidh nalt (Shk); JL (Di); bugarka (Pp);

Vajzë simpatike, e mirë: barbi, llokum (St); dallëndyshe, pjeshkë, rrush (Kç); e han pazari, e heshta, e shishët, shkon, si koukëll, teshki (Gv); e shajshët, e thjeshtë, gurabije, hahet, keksi, kukëll, kull, kulumri, lezetja, pëllumbësh, simpatike, ubavka, zan mali (Te); haet (Alb). Ftyr gurabie (Shk); për en kaup për ta pai (Pp)

Vajzë simpatike, e vogël: bebeskho lice, dalldajshe, flutër, kumbull, llokum i vogël, majni i razvirët, pëllumbesh, pupteshk, sa ni pare (Te); bukuroshe, gollupe, tulipane, zog koçke (Gv); e lezetshme, voglushe (Kç); pipe, zogës (St); zogle (Alb); fëllënz (Kç, Te); zogëz (Alb, Kç, Te); tupacke (Di); zogule (Kr); fllanx, zuogz, gullap (Pp).

Vajza me këmbë jo të drejta: buk pa gjudit, jo e gjuditme, kamshtremta, këm kolarja, këmshtremta, kokoshk, kom kolarja, kthesa e krabzës, lëvorja e banënes, makarona, me këmët "o", shtremëlakja (Te); gjysëm hark, këmbë shtremër, shtraf (Kç); kom-pasi, pata (St); kthesa 180° (Gv); kthesa e kamzës (Alb); shtremsha (Gv, Te); shkronja O - shkoronja Z (Di); pedalli, velespiti (Pp).

Vajzë e cila përpiqet të jetë në modë: e prapambetët, katundare me shkoll, modelare, selaçk pa shije, selake mode (Te); seljaçk pa traktor (Gv); katundare prestigjioze (Alb, Te); katundare luksoze (Alb, Gv, Te); kullerk (Shk; Te); fshatare e pacivilizuar (Di)

Vajzë e kaluar në moshë: 100 000 km të kaluara, beqaresha, beqarja plak, cauc me leqe, e ka hëngër, e konzervuar, e lën pas dore, e mbetët, ka hi n'shtëm, kapetane, plakaric, plakë muhalle, stara moma, vejushk (Te); beqareshk e stacionuar, çupa plak (St); bërthamë e thyer (Alb); bilmet, couc me mote, nëna e caullve të kataundit, speca djegëse, turshi (Gv); plakushka (Pp)

Vajzë me pretendime: ambicioze, vizioniste (St); filozofe, frajeric, papagallk, papaqalle, vesvese (Te); kardinale (Alb); llafazane (Kç, Te).

Femër e shëmtuar: akapajtsh, baloshka, bërllok, Beti, big nenja, dertina, e bajalldisshme, e beçmja, e shëmtuar, e shëmtuara Beti, femën e betçme, flajjtsho, gëllgejkja, gjindihalle, halla, ja ka fejt pula makazna, krokodilla, lop, ta hipën vajlltin, ukubete, zgjepsh (Te); e zdrouit, Oliva, shtrig, tat e modhe (Gv); gjyshe, shuke, urith (St); shtrigë (Kç); teze (Alb, Te); gërbaic, e beqme, strashillo, lugat, shtrig (Pp).

Femër kur është me rroba që e tregojnë gjysmë të zhveshur: bukureshka e shpalaume, bumllajm, cop e fort, cullak, dritare e hapur, ferari, goliçe, goll, haxhuze, kuçka (Te); goliqe, seksi (Kç); pa kabin (Gv); porshe, siren (St); kabriolet (Alb, Te); ti merr sayt, goliqnat (Pp).

Femër moderne me tatuazhe: capja e Zendelit, e gërvishtur, e ngjyrosur, e vizatuar, evropjank, femën e klasit par, krejzi, kullerk, lavire, narkomane, sharke, shkin (Te); drogirashk, femën e prejshët (Gv); tribale (Alb); e zhgaravitura (St); drogirashkë (Kç); e qëndisura, tigrasha (Gv, Te); e vizatuar (Gv, Kç, Te).

Femrat e bëshme, seksi: avion, ballon, big mama, bithët top, bollejc, buci i lezetshëm, e fort, gjiksmadhja, luanesha, pel, peshk, lop, traupin lini (Te); pantera, gomë (nga mjedisi i shoferëve) (Alb); bomba e fort, të lezetçme (Gv); e prishur, shkërdhage (Kç); bomba, granata (St, Te); lavire, teshki (Gv, Te); copë e fortë (Shk); ayll drite, ballaum (Pp); pantera (Kr)

c) Për karakteristikat e djemve

Djalë budalla, jo i mençur: dardalec, dru, faliçën, fall, gllup, godi, hajvan, hup fajlle, hupsh, i çaukët, i fshojtët, i shkundët, i vokët, i zdraum, lesh, lolo, mendja, papak, qutuk, ngrofsh, tollum, trampall, trap, troshki, traup, tupi, val me menden, viç, zgebe (Te); harabel (Shk); i gërvishtët, i hupt (Di); i ka mbetur ora mbas, i ka shitur drutë, i kapitulluar, i lodhur, i raskapitur, i sosur, i vrarë, mizerabel (St); i lonem (Ku); trullan (Ks); i trash, i zdrot, koktul, kupuk, teveqel (Gv); llosh (Alb); lole, mendje leht (Kç); i hupët, torllak (Gv, Te); gjindihall (Kç, Te); i hallakat (Shk); i lagti, i shkaundmi (Pp)

Djalë i fuqishëm: azgan, bos, gjiksi, gorilla, Hitleri, me mishçe, robot, Rambo, Shfajcenigeri, starlia, Tajsoni, Tarzan, Terminator, trajm, zarmi (Te); levë (Alb); pelivan, traktor (Gv); bullduzher, vigan (St); deli (Kç); bager, luan (Gv, Te); i fort (Gv, Kç, Te); tigër (St, Te, Gv); kal (Gv, Kç, Ks, Te); bilder, azgan (Shk).

Djalë i respektueshëm nga shoqëria: ari, baba, bos, cari, dilber, faca, i kulturumi, i madhi, i ndershëm, minister, mreti, talent (Te); dak (Alb); daso (St); esnaf, vllaqko (Kç); fraer (Ks); gjal e xhims, ulla, zotri (Gv); gjigand (Alb, Te); xhek (Gv, St); djal me shkollë (Shk.).

Djalë me mend: advokati i popullit, çuki i nënës, çun me botë, djal me naze, gjal me kultur, gjali i mamit, intelegjent, shkenctar, shkencëtar i pazbuluar, shkenctar i ardhshëm (Te); dilber, djal me tru, hallall (Gv); djal ideal (Ks); djalosh, pashë (Kç); filozof (St); djal me halle (Gv, Kç); hazgan, i mençëm, talent (Gv, Te); kliker (Shk.).

Djalë me pretendime: ai xhi flatoron, çerap, djal me ardhmëri, djal me mendime, djal që miret me ëndrra kolzish, fillozof, ja mledh kot, llafazan, papagall, vesvese (Te); djal me krijimtari (Kç); pretendues (Ks); djalë me kokë (St); kardinal (Alb, Te).

Djalë në modë, që vishet bukur: çun katalogu, djalë pasarelash (Alb); dasa, djal i modës, djal zengini, elegant, Gaxha, gjal me still, kavaler, kit stilla, manekin, model, modern, roker, shmek, shminker, shminki (Te); djal i rregulluar, maniken, top model (Kç); faca, tip (St); modest (Ks); panker, pasanik (Gv); boss, kuller (Gv, Te); fraer (Gv, St, Te); kulle (Shk.); picajku (Pp)

Djalë pa personalitet, i urtë: borzilok (Alb); caullishte, gjal shpaje, gllup, haxhuz, i shkundët, kinxh, llud, marsh, melaqe, ngrofsh, penzioner, plaku i urt, viç (Te); edebil djal (Ks); hazhuze, morsh, pa sher (Gv); i çmendur, pa sherr (Kç); palaço, qyl (St); i butë (Kç, Gv); i hupët, manjak (Gv, Te); pulë (Shk.).

Djalë që do të duket si i fortë: djal i hekurt (Gv); goku, Herkules, mendjemadh, Xheki Çen (Te); lac (Alb); robot (Kç); Tarzan (Ks); mendjemadh (Gv, Kç); Popay (Gv, Te); Herkull (Shk.); ramboja, i gufmi (Pp).

Djalë që ka diapazon dhe di të bisedojë: astronaut, djal kuvendi, djal me fakulltet, djal shpae, gjal për od t'burrave, llaçk madhi, llaçka, llafatar, muhabetçor, muhabetkafja, shkollar, taman djal (Te); çun tavoline (Alb); djal i kulturuar (Kç); djal me llaf (Ks); djal me muhabet, djal që rri në temë, fallxhor, xhuxh (Gv); llafazan (Kç, Te); renacak (Gv, Te); avokat (Gv, Kç); llafazan, papagall (Shk.).

Djalë që përpiqet të jetë në modë, por i paedukatë dhe i paarsimuar: ai që mbahet, foliront, i jep kosës, i ka hi viti n'qif, kejt baba be, kuller, njeri si s'din dinjë, palaço, s'kapën lidhje me centrallën, selak mode, troshka, troshka njer (Te); alabak pa klas (Alb); analfabet me shkollë, bari (Kç); fantazer, kuller pa brek, seljak (Gv); fantazer djal (Ks); langaç (St); alabak (St, Te); seljak (Shk.).

Djalë simpatik, i mirë: alltëni, alltoni, bukuroshi i mamit, domaquin, faca, i shajshti, i shejshët, oskar, s'mrëjhet, taman djal, tip (Te); çun për shpi (Alb); djal bukurosh, djalë për në shtëpi (Kç); djal me naze (Ks); fraer (Gv); llokum, pëllumb (St); çun bukurosh (Kç, Te); nobël, haet (Alb, Te); melaqe (Gv, Te); Bret Pit, Leonardo (Shk.).

ç) Zhargone që lidhen me veshjen dhe takimet e të rinjve

Është me kohën: trendy (Alb); e di xhi është moda, e di xhi o jeta, ec me botën, ec me kohen, fashion, i mordenizaum, in, modë, modernator, rinia, top (Te); krejzi (Gv); trendi (St, Te); modern (Gv, Kç, St, Te).

Një rrobë e blerë me çmim të lirë, por që pretendohet të jetë firmë e njohur: *falc rake, irame, levenck, partall, rake izbeglicash, skutaçe (Te); gabriela (Alb); pigjame (Kç); raçe pazari (Gv); tomi (St).*

Modern: *hip hop, i ngarendët me kohën, kit stilla, shtang (Te); i garendët me kohën (Gv); i kohës, trend (St); skorpions (Alb); i shekullit 21 (Shk).*

Kur një i ri ose e re vishet me rroba firme: *adidaska, didaska, dolçe gabanisti, firmato, la kosta, levisi, salomon, stilli (Te); ausllander (Kç); D & G, Guci dhe Armani (Alb); dilber, lepër mashkull, moderno, për D & G - dajca Garipic (Gv); diselashi (St, Te); Armani (Kç, Te); Versaçe (Alb, Gv, Kç, St, Te).*

Pantallona me pjesë të rrjepura: *i amosur (St); kabriolet, pantullana me golle, pantulle copa-copa, pantulle fukarash, pantulle si duket këma, pantulle si me ti hëngër çeni, pantulle t'çame, pantulle t'shkepta, pantulle të arnaume, pantulle të hallaktme, pantulle të vjetra, still kullerski (Te); me arna, pantulle me ajër, thes groshe (Gv); pantallona me ajrosje (Alb, Te); Pantulle me klim (Shk);*

Baret ku njihen vajza: *zyra e gjendjes civile (Alb); gardhi i ujetër, harem, kafe çuçek, kafe me muzika, pub, kafe nate, kafehone, kafic, kafje e madhe, konferenca e Parisit, shtabi, vendi i melaqeve (Te); shpi publike (Ks); diskotek (Kç); bar, zona e nxeht, zyra publike (St); kafiteri, shpija e dit, te vendi, vendi i melaqeve (Gv); tubim i kudrave (Gv, Te); lokal i femrave (Shk); toni i pagdhendur i pazarit (Kr)*

Të rinj që frekuentojnë shpesh diskotekat, pub-et: *ato si ja din rendin, ergele, t'dalët, zefklit (Te); hellaq, qent e sendviqëve (Kç); uliçar (Gv); yll i qiellit (St); zog nate (Alb); njeri i natës, i diskos (Shk);*

d) Zhargone që lidhen me karakterin e adoleshentëve

I zgjuar: *Ajnshtajni (St); aktiv, benzin, herhap, i ditshëm, i shkallitur, i zoti, ka krae, ka trau, kompjuter, përparimtar, svesën, talent, traun mbushti, trim, zarm e fjak (Te); bazut (Alb); i gjallë, kapacitet (Gv); gjeni (St, Te); intelegjent (Gv, Kç, Te).*

Idiot: *edepsës, gorilla, horongop, i paftajr, idiot, kopil, majmun, manjak, pa ftajr (Te); prost (Kç); toç kuklle (Alb); i mprehtë (Gv, Te); i poshtër (Gv, Kç, Te); kreten, (Shk); tokmak, teveqiel (Pp).*

I fëlliqur: *gore (Alb); i gërditshëm, i paedukumi, nemtur, pisdiven, qurash, shmokle, trash pala, zgebe, zhibitak (Te); i posaardhuri nga fusha (Gv); ibret, kore (St); palaqko (Kç); palafsh, pis (Gv, Te).*

Malok, në kuptimin i trashë: *alpin (Alb); buc panceri, gjigand, me kashtë, pjonci (Gv); bufe, i trash, pomparic, sallat, tul (Te); bure, rryp (Kç); bucki (Shk); drole (Di).*

I lehtë nga mendja: *budall, dembel, fjoll, fjurec, fush, gabel, gllup, hajvon, i trash, klloshar, kungëll, maler, mendjelehtë, plumb pa fleta, tralala, traup, tup (Te); fyell (Kç); i holl, i mprefët (Gv); harabel (Alb, Te); i fshim nga mendja, hupsh, tup (Shk).*

Njeri mendjelehtë: *budalla, dras, er mali, fjoll ka kraja, fmi, fush, fush pa bar, hupsh, i gërvishtët, i shkundët, livadh, ngrofsh, rifshi, tralala (Te); fiçkë, lole, tosho (St); i trash ka mendja, rafsh, torollak (Gv); trampolino (Alb). çka fluturon haet (Shk); flirec (Pp)*

Njeri negativ: *agresiv, ftajr prajshët, gjakftoft, i keç, i poshtri, idiot, negativna faca, nerva baza, ogurzez (Te); ai që prish shoqërinë (Kç); allkoid i dreçit, i tharët, stahor (Gv); bush(ra), (Alb); i lig, qafir (St); si bugar, rus (Shk). Bush (Kr)*

Njeri trupvogël: *deci, deci njer, mi goliç, mici, morr, patuljak, pumpzal, shkurtabiq, tupulak (Te); e ka gjek zameli, i shkallitur, mi pa kocka, ni metër e ni zhilet, popunçe, pupanec (Gv); mickrash, papi, përdhes, poç (St); porcion njeriu (Alb); picimul (Gv, Te); xhuxhi (St, Te); Nji metër e nji zhilet (Shk); shkurtale, potk, sa ni pllam, xhoxhuole (Pp)*

Nuk është i përfshirë: *birra e fundit e kavallit (Kç); degazh, jasht liste, jasht, jashta masës, raus, s'ash n'tem, skapën lidhje me centrallën, zelen karton (Te); jashta rrethit (St); aut (Alb, St, Te).*

Nuk është i zgjuar, është budalla: *dembel, fush, godi, hajvon, i mungojn shtrafat, i zdraum, kafsh shtëpiake, livadh, majzën pi dhallti sën e çet, ngrofsh, qul, teneqe e ndryshkur, torollak, tupak (Te); e ka shkel shleperi me pula, i hupët, i ndryshkur në tru, i zdrot (Gv); gllup, idiot, hupsh (St); karallo (Alb); majmun (St Te); Teveqel, tokmak (Shk). i vjerum(i humbur) (Di)*

Person i rëndomtë: *i thjesht (St); lavazhier (Alb); tren pa vagona, obiçen tip (Te); esnaf (Shk); makulic (Pp)*

E rëndomtë: *e dobët, e zakont, standart (Te); e zakontë (Gv); palidhje (Ks); rozgo (Alb); klasik (Te, St).*

Që nuk merr vesh s'ka asnjë lidhje me ambientin, nuk kupton: *hyr, mirë ardhsh, mirë të gjetsha (Alb); alo., e ka kap xhumi dimror, fush me lule, i hupët, kraje madh, ledin e papunuar, s'ka lidhje me centrallën, tupi i madh, UFO (jashtoksorë), (Te); është pi Marsi, killapa Jupiteri, ska lidhje (Gv); injorant (St); papak (Shk);*

Sharje për të thënë sa i trashë që je: *bollajca, buc panceri, buci, bucki, bure, deg me thera, dru pa gdhend, gjigant, kalosh, koktul, llaskuc, muzat, oki, pjanci, sjonci, tollumi, tulavec, vjomi (Te); i pa fe, të paska shku torba, të qenka sos taxhija (St); turullan (Kç); pallosh (Alb); trashavell, bucko, zumo, cacko (Shk); buce, top bote (Di)*

Sharje që përdorin adoleshentët mes tyre: *aj të mart topi (St); baba, ftajra jote, katil, lesh, nana, njeri, o pasiv, parazit, Shilibare, Shkëlbazije, tigr, piranajo (Te); fak ju (fuck you), Pippyy, Vushe (Gv); palltek (Alb); Fjalë të treta, fjalë në kub (Shk);*

Shprehje për t'i thënë tjetrit që je i paaftë: *aç dish aç folish, boshi, hec se marish er, hec se s'marish vesh, hec se se kapish, ku dish taj, livadh, pekmez, smotan, troshka (Te); Hajdar (Alb); larg ije (Gv); dërde, klloshar, voksh (Gv, Te); Takllabaz, gjitrimsh (Shk);*

dh) Sjelljet e të rinjve

Katundar: *baltaxhi, shatar, godi, i fushës, i malit, i prapambetur, katundar i mbetët, malok, malsor, nari, smotan, tarafall (Te); katundar, katundar me lopat, rot katundi (St); i pa ditur (Kç); kapor, seljak (Gv); rural komplet (Alb); selak (Kç, St, Te).*

Trashje: *bollejc, bosank, elefont, hecje e dietës, hona pesmdhajt, lop, none madhe, pufk, shishe pivës, Zade (Te); bombar, bucko, bure laknash (Gv); buci, tuli (St); drazhlla (Alb). Killazh (Shk);*
tullcek (Di)

Merret me punë të pista: *bagabont, i qmendur në kuptimin e plotë të fjalës (Kç); bandit, derr, gjubrishte, pishpirik, kali, Kazanova, kreten, kurvar, pis (Te); kriminel, mangup, rrugaç (St); punon (Alb); haram, ubica, vagabond (Gv); rezil (Gv, Te); kërlesh (Shk).*

I jep rëndësi, e fryn më tepër sesa duhet, person që hyn me krenari: *bo hop para se t'kcije, i dashuruari në vetvete (Gv); e bon mezhën bollejc, i ep kosës, i ep shaum kosës, i flladit lulet, mizën e bon bollajc, sharton, vervelexhi (Te); pompozitet (Alb).*

e) Pamja e jashtme

Ka fizik të mirë: *bomb këna, i razvirët, ka traupin e fort, loçk, mis i botës, miss (Te); fibër (Alb); muskuloz (Kç). top, bomba, cop e gjysë (Shk).*

Pa flokë: *i ditshmi, kungëll, lluster, llusto, mermer, qelosh, tas (Te); poç elektrik, qus, sheqer me bisht, stadiumi i Milanit, tavë piprikash (Gv); poq (Kç); kurumut (Alb); aerodrom (Alb, Te); qel (Gv, Te); kros (St, Te); qellaf, tullac (Kç, St, Te); poç (Alb, Gv, Te); koxhak (Alb, Kç, St, Te); aerodrom, koxhak, kurumut, poç, lluster, pasqyre, qelieshi, me dy suratna (Pp); pistë aerodromi (Kr.);* **kros (Di)**

3.3. Zhargonet subkulturore

Nga të gjitha llojet e varieteteve gjuhësore, zhargonet më së shumti u nënshtrohen ndryshimeve të shpejta. Kjo më së tepërmi vlenë për zhargonet e *narkomanëve, hajdutëve, policëve, burgut, lëndëve narkotike, rrugaqësh, ushtarësh, narkomanësh, kriminalësh* dhe zhargoneve të njëjta subkulturore, për shkak se përdoruesit e këtyre zhargoneve për herë janë në ballafaqim me pushtetin, duke u përpjekur të mbrohen me anë të idiomave të tyre të fshehta.. Andaj ekzistojnë edhe shumë zhargone lidhur me *policët, hajdutë, burgun, marihuanën* dhe emërtime tjera lidhur me këtë subkulturë.

3.3.1. Zhargonet mbi emërtimin e lëndëve narkotike

Të rinjtë mund të bëjnë një pazar të mirë droge edhe “poshtë hundës” së policit më të zot të qytetit. Dhe kjo jo në sajë të ndonjë teknologjie të përparuar, apo të ndonjë fshehtësie ekstreme. Çdo gjë është shumë e thjeshtë. Mjafton që në bisedën që bën të mos përmendësh emrat realë të lëndëve narkotike, por emrat me të cilat të rinjtë i kanë pagëzuar ato. Të ndodhur gjithmonë nën tryshinë e frikës së zënies më “presh në dorë” nga policia, të rinjtë kanë krijuar një fjalor të koduar. Ashtu si edhe të tjera zhargone të krijuara nëpër gjimnaze, për të mos lejuar mësuesen, apo prindërit të kuptonin bisedat e tyre, ky i fundit i shndërron në “inJORANTË” edhe vetë policët. Nëse deri pak kohë më parë përcaktimi “mall” apo “miell” do të kryesonte, tashmë ai duket shumë i rëndomtë.

Nëse një i ri thotë “**mallisht**”, prindit nuk ia pret mendja se fëmija i tij merr drogë. Dhe mund të ndodh dhe të lemeriset, kur fëmija thotë se kam një “**bombë**”, por e ka fjalën *për një cigare, puro e fortë*. Moria e përcaktimeve të futur kohët e fundit në fjalorin e përdoruesve të lëndëve narkotike janë sa të çuditshme, aq edhe të padeshifrueshme nga shumëkush. Si më të shumta në numër dhe më të lira në çmim, “pagëzimet” më të shpeshta u takojnë, përgjithësisht, drogave të lehta. *Cananabis sativa*, apo hashashi, ashtu edhe marihuana kryesojnë në këtë listë emrash me rreth 6 emërtime: **bixh, rab, e zezë, kallo, kërp, bar** apo **presaqe**. “Nuk përdor asnjëherë emrin e vërtetë, por vetëm këto lloj përcaktimesh”. Duke folur në këtë mënyrë, ata janë të qetë nga policia, apo nga të tjerët se askush nuk i kupton. Ndërsa emrat e mësipërm shërbejnë vetëm për ta identifikuar tipin e narkotikut, të tjera përcaktime tregojnë të dhëna më të detajuara për të. Pra nëse thuhet “**spinel**”, duhet kuptuar që bëhet fjalë për një cigare

hashashi në madhësinë e një cigareje normale. Kurse lloji i asaj që përmban në brendësi thuhet me **“5-fletësh”**, për hashashin dhe **“7-fletësh”**, për marihuanën. Nuk duhet të habitemi që edhe **“çokollata”** për këta të rinj nuk është asgjë tjetër përveçse të tymosësh kanabis të patharë.

Fantazia e të rinjve për emërtimet e drogave arrin majat te lëndët narkotike haluçinogjene. Në varësi të cilësisë dhe çmimeve ata i identifikojnë ato me marka makinash, marka veshjesh apo me fjalë të tjera jo shqipe. **“Smile”** (smail) është ekstaza më cilësor dhe si rrjedhim më i shtrenjti në qarkullim. Ndërsa pas saj vijnë ekstazat e pagëzuara **“Dolçe-Gabana”**, **“Smart”**, **“Miticubishi”** dhe **“Ferrari”**.

Për drogat e forta, ngaqë janë më të shtrenjta dhe më pak të përdorura, të rinjtë janë “kursyer” në emërtimet në zhargon të tyre. “Përdoren më pak, dhe kështu edhe emrat i kanë më të paktë”. Në “zhargonin narkotik” ato radhiten me emrat **“kokaqe”** për kokainën dhe **“e kuqe”** për heroinën.

Ja disa shembuj për emërtimet e ndryshme narkotike:

Ai që merr substanca narkotike: *mallisht, e tërheq (Alb); ai që e hek vijën, ai që lun me majll, bitango, droga, drogaxhi, herbapi, i bie hundës, mall t'bardh, parelia me kufer (valixhe), vagabond (Te); drugirash, e hek vijën (Gv); sheqerash, drogo (St); shpricajtet, e jek (Pp); drogirash (Gv), (Kç), (Te); narkoman (Gv), (Kç), (Te).*

Fraz. E bën vizën sa tavolina “është përdorues i vjetër i lëndëve narkotike”; Është i bomë “është nën efektin e lëndëve narkotike”; I fus një tegel “pirje drogash” (Alb).

Ekstazë: *dolçe gabana, mitcubishi, smart, smile, ferrari (Alb); dolçe gabana, dizellka, armani, bmw, jens staff, levis, leviska, llamburxhini, nike, smart, smile, mitcubishi, ferrari (Te); 24 orë në muaj, meçka (Gv); ferrari, mitcubishi, smart, smile (Alb), (Te)*

Heroina: *e kuqe (Alb); ajo që të bën të ndjehesh i disponuar, ajo që të fut në telashe, drogë, e kuçja, melhemi (Te); jonxh taze (Gv); helm (St).*

Kokaina: *kokaqe (Alb); bar, koka, kokos, majll misri, majlli i shrint, majll për kiflet, nisheste, pluhën sheqeri, sheqer i bardhë, majll (Te); e bardha (Gv); miell i bardhë, kok (Kç); bar taze (Gv), (Te); majll i bardh (Gv), (Te).*

Lëndë narkotike (hashashi, kanabis dhe marihuanë): *bar, e kuqe, e zeza, genci, kallo, kërp, miell, cigare e dredhur, çokollatë, presaqe (Alb); ajo e bardha, buka, krande, lapsi, nisheste, majll, pjuhni, taxhi e thatë (Te); kamilic, petard (Gv); e kuqe, e zez (St); pi mayllit, kraunde, pi e bardhës (Pp); çokollat (St), (Te), (Alb); miell (Alb), (St). Miell, miell tip 400 (Shk).*

Tymosja e kanabisit të pa tharë: *çokollata* (Alb); *bombone, karamele* (Te) *Tok, dhe, patos, parket* (Shk);

Cigare hashashi në madhësinë e një cigareje normale: *5-fletësh, spine* (Alb); *kecë, flet hashashi* (Ks); *cigare lulesh, cigare xhetha-xhetha, kaçak, xhoint, ni cigare t'holl* (Te); *cigare e përzier me barë* (Kç), *hashmik, petarde* (Gv).

Cigare marihuani në madhësinë e një cigareje normale që në brendësi përmban: “*7-fletësh*” (Alb); *cigare të mbushura* (Te)

3.3.2. Terme zhargoni që lidhen me emërtimin e cigareve

Cigaret e rënda: *bombë, granatë* (Alb); *cigare amerikane* (Ks); *bomb, bucko, cigare bosash, cigare e trash, dru i ndezët, hekur me tajm, helm, kasht kollomboçi, pelin, penicilin, tnt, tokmak* (Te); *granat, shkop i trash, tanke* (Gv); *cigare e madhe, pure* (Kç).

Cigaret e holla: *elektrodë* (Alb); *cigare damash, cigare femnash, cigare hajt-hujtesh, cigare konobaricash, cigare t'gjata, cigare t'mushme, elektroda, karthaja solenka t'lishta, xhoint, shkopaj* (Te); *cigare konobarkash, shkop sheqeri* (Gv), *shajka, (Gv), (Kç), sllim* (Te), (Gv); *slims* (St); *solenka* (St), (Te); *guozhd , zagrebačka* (Pp); *Fraz. E pi cigaren me llullë, e ha cigaren fare “pi shumë cigare”* (Alb).

Cigaret me filtër: kur u shfaqën në fillim cigaret me filtër në vitet 1970 bënë përshtypje dhe u quajtën: *cigare me tapë, cigare me pambuk, bythëpambuke*. (Lloshi 2001:177).

3.3.3. Zhargone mbi alkoolin

Për alkoolin: *qumësht pa ngjyrë* (Alb); *alkohol, benzin, gazoz xhi t'malitën, nitro, një e nxeht, një e Shkupit, piv, sok trëndafilash, uftëll, uj i ngrohët, uj i tharët, uj mejr, uj trajmash* (Te); *ujë i tharët* (Gv); *çaj i ftoht, got me uj, shijshëm* (St); *domaci, ujë trimash* (Kç); *lëng i raki* (Ks, Te); *uj tasi* (Te, Gv); *uj zemzemi* (Gv, Kç, Te); ; *ujë traimesh, lang shielgu, lang elbi, lang baurësh* (Pp)

3.3.4. Zhargone që lidhen me emërtimin e policëve

Emërtimi i policëve nga ana e adoleshentëve të kategorive të ndryshme përbën grupin më të popullarizuar. Kemi regjistruar këto zhargone:

Policët: të zinj të, lici (Kej se Lici - Kujdes se po vjen polici)(Alb); bezopasnite sill, dajxhët, personazhi i vicave, qent, rugaçët, të zit, ushtarët e dexhallit, xhandarët, xhaxhi polic, zagar (Te); insën pa pun, karabinjerët, Mensur, zagarët (Gv); humorist, uniforma (St); gllupat (Kç); cajkani, pajkani, panduri, qent, zagarët, t'zit (Pp); Të zinj të, zagarët (Shk);

Spiun person që nuk mban sekretin: shporte pa fond (Kr)

3.3.5. Zhargone lidhur me botën e automobilave

Llojet e automobileve: merxho, merxhan, meçka, arusha (mercedes), Follksiç, zhellka "breshka" (Folksvagen), peglica (Fiat 126), fiço (Fiat 750), 101, stojadin, (Zastava 101), Tamçe (Kombi TAM),

Automobil: lëvizës, makinë (Alb); kerr, tramafil (Ks); auto, çer, kuti me kollca, limuzin, rab, toçak me menjaç (Te); çere (Gv); makin, vetur (St), qere, limuzin, tromofil (Pp); kerr (Shk).

Makinë benzi që ka dal nga moda dhe nuk është avangard: Si 200 (Alb); e shekullit t'kalum, e tedhte përvës (1981), fiço, katërca, kërsh, muzeum, rangalle, shporet, stari tip, traktor (Te); e 71 shtathte përvit (Gv); e kohës gurit, shkatrin (St); me afat të skaduar, rosht (Kç); shkatraqe, trabant (Pp).

Makinë e tipit të fundit ose makinë e bukur, e madhe: 4 fenersh, kuklla vogël, goca ime, avangard, sllon (Alb); akull, auto, autobлиндë, çer pi fure, e fort, kukëll, lamburxhin, kobra, najnov tip, Porshe (Te); grenx, koc (St); aeroplan (Gv); ballon (Gv), (Te); avijon, minibarë (Kç), shevrolet, ballaum, mieqka (Pp).

Makinë e vjetër me të cilën është turp të të shikojnë: rrangalle (Alb); bërçk, breshka, drajveri, fiço, frizhider, prekolic e vjetër, rab hajvonsh, kënt, kërsh, kontinjer (Te); kolic, kulic (Te) (Gv); shporet (Te) (Kç); kadillak, shkatrejn, titanik (Gv); kaproqe, kërrsh (Kç); kant (St); kërntai, kant, shkatraqe (Pp); karantin (Shk); shrakatalke (Di).

3.3.6. Zhargonet mbi kriminelët dhe hajnat

Burgu: universitet pa mungesa, shtatë penxhere (Alb); hotel me pesë yje, mengele (Ks); ajo si hish kollaj po sën dalish, golle, hapsane, kafaz, katër mure, ku i bish kllavirit, kotare, kulibe çensh, n'hekra, n'kopshtin zologjik, në drina, qelia e zes, rahatllajk, sob pa dollap, vendbanimi i t'majrve, vorr për s'xhalli, reshetka, zandon (Te); shkolla pa nota, tangshtell (Gv); hotel me pesë yje, bausstell

(Kç); *qorka, qeli* (St); *aps, nën ije; ku shkulen kompirët, ku i bie kllavirit* (Pp); *qendër për rehabilitim, vend për pushim* (Gv), (Te); *hapsane, çeli* (Shk); *parku i mbyllët, vendi i kasapave* (Kr)

Merret me punë të pista: *punon* (Alb); *bandit, derr, gjubrishte, pishpirik, kali, kazanova, kreten, kurvar, pis* (Te); *haram, ubica, vagabond* (Gv); *kriminel, mangup, rrugaç* (St); *bagabont, i çmendur* (Kç); *rezil* (Gv), (Te).

3.3.7. Zhargone mbi marrëdhëniet familjare

Për vjehrrën nga nuset: *tenxhere me presion, macja e zezë, kanceri* (Lloshi 2001:177).

Raportet familjare midis vëllezërve: *paska hy macja e zezë "kanë mospajttime dhe janë para ndarjes"*.

Për bashkëshorten: *e ka me vete rimorkion* (Lloshi 2001:174); *e ka me vete prikolicën* (Pp).

3.3.8. Zhargone për sende nga amvisëria dhe prodhime tjera

Sapuni: *sapun me rahat* (për sapunin e tualetit që hyri në fshat në vitet 1960. (Lloshi 2001:177).

Detergjenti: *faks* (lloj detergjenti i pranishëm në vitet 1980, por pa pritmaa u zhduk), prej këtu lindi njësia frazeologjike *humbe si faksi "s'ta ka farre"*.

Çamçakëz: *hudhër* (Alb); *ballon, gum, gum për pufka, përtypse, sakëz* (Te); *partall* (Gv); *sakuz* (Shk); *llastëk* (Gv, Kç); *zhvake, zvakaç* (Gv, Te); *mastik* (Gv, Kç, St, Te); *sakës* (Pp); *sakec* (Di)

3.3.9. Zhargone që lidhen me sportin

Lojërat gjithashtu krijojnë grupe me zhargonin e tyre:

Futboll: *është me penallti në tru; hap lojën; shihi numrin; kuqezinjte* (Shqipëria); *azurët* (Itali); *ballistët* (fansat e KF Shkëndija – Tetovë); *shvercerët* (KF Slloga – Shkup); *leku i madh* (futbolli)

Shahu: *petull* (zero e remisë në shah); *e bëri ylber* (e rrahu keq në shah, nga *do të skuq të bëj me bojë - e bëri me shtatë bojëra*) (Lloshi 2001:174).

Tifozët: *tifoz valutë*

Bilardoja: *flet me spondë*

3.3.10. Zhargone që lidhen me ushtrinë

Në Shqipëri: *Ke variant; rul* (Lloshi 2001:174).

Në ish-Jugosllavi: *çato* (evidentuesi i çetës); *gushter* “zhapinj” (ushtari i ri); *xhomba* (ushtari i vjetër);

4. Zhargonet profesionale

Përkundër kësaj Zhargonet profesionale karakterizohen edhe me mënyrën shabllonike dhe pretencioze të përdorimit të termeve lidhur me një profesion, gjë që ia vret veshin dëgjuesit të jo atij profesioni. Pra bëhet fjalë për terminologjinë e një profesioni të caktuar, të cilët sipas parimit i takojnë gjuhës standarde, por sipas përdorimit mund të themi se bëhet fjalë edhe për zhargon. Meqë ka të bëjë në të folur, është punë e stilit, nuk është imagjinues dhe kreativ dhe vlerësohet si negativ (p.sh. zhargonet profesionale, si ai: mjekësor, juridik, sidomos ai politik).

Edhe pse gjuha standarde për nga natyra e saj reziston zhargonet, por jo përherë është e suksesshme, sepse zhargonet në jetën e përditshme kanë depërtuar thellë, jo vetëm në gjuhën e të rinjve por edhe në stilet e ndryshme të saj. Me këtë zhargonet në disa raste edhe e pasurojnë gjuhën letrare, sidomos letërsinë bashkëkohore urbane. Kur është fjala për veçoritë e diskursit administrativ, gjuhës së institucioneve zyrtare, dokumenteve dhe punonjësve shtetëror është përplot me zhargone specifike profesionale. Kështu në rrethim arsimor dëgjojmë: implementim i **kurikulumeve, departamente, evoluim;** në atë ekonomik **tenderë, tranzicion** etj. që nuk është edhe aq **transparente** që sjell edhe deri te paqartësitë e shumta.

Në shtyp priren që gjithçkaje t'i gjejnë një emërtim tjetër, një barasvlerës, që të kristalizojë qëndrimin ose vlerësimin përkatës. (Lloshi 2001:226). “Formula e tillë gazetareske” kemi shumë.

4.1. Politikë

Spiun, person që nuk mban sekretin: *afije, jallanshahitë, 1200-sh* (Alb), *BBC, burimi i infos, CIA, fesatxhi, gorobi e pekme, haxhuze, informacioni, llafatore, shpijon* (Te); *mizevir* (Kç); *pa mos fol plasën, spiun nuk është ama llafin sën e mbaje* (Gv); *tradhtar* (St); *FBI* (Gv, Te); *tasker, avokat* (Shk);

Parlamenti: *baballarët e kombit, të zgjedhurit e popullit* (me admirim); *karrigethyerit, kriptokomunistët* (kur duhet dënuar)

Politikanët : *moterqira, të shiturit, karrigemdhenjt, nacionalizma zero, zënia e karriges*

Kryeqyteti: *zemra e atdheut; xhungëll*

Kundërshtarët politik: *ata, këta*

Shoqnia: *banda, cipiripi, kompanija (Te); kallaballëku, kolektivi, mafija, rps (St); orgjia (Alb); vllaznija (Gv); kllapa, servisi i filxhanave, tamba-llamba (Gv, Te); grupi (St, Te).*

Atëdheu: *altari i shpirtit, drita ushqyese*

Lufta: *shkallëzimi i luftës* (nga teoricienti i Pentagonit Kan në janar 1966); *çshkallëzimi; lufta speciale; perdja e hekurt* (është e U.Çerçillit); *kolona e pestë* (nga një gjenerali të Frankos 1938);

Barasvlera shprehëse pëndoren edhe si një mjet të mirëfilltë të luftës politike. P.sh. në luftën e Vlorës më 1920, gazetata proqeveritare përdorën këto mjete : *luftë mbrojtëse, luftë heroike për të mbrojtur nderin dhe prestigjin e Italisë*; opozitarët italian u quajtën *tradhtarë, nxitës të armikut, goditës pas shpine*; disfata e italianëve ishte *mynxyrë, plagë e rëndë, gabim i rëndë*, për Musolinin kjo ishte *Kaporetoja shqiptare* (si disfata e rëndë italiane në kaporeto më 1917); Sipas “Historisë së Shqipërisë” (1984, vëll.III) kjo ishte Lufta e armatosur çlirimtare; italianët quhen *pushtuesit italianë*; lufta karakterizohej: *kryengritje e armatosur, konflikt i armatosur, kryengritje çlirimtare, luftë çlirimtare antiimperialiste, faqe e lavdishme e historisë*; kurse pjesëmarrësit quhen *fshatarët kryengritës, patriotët trima, forcat popullore kryengritëse, luftëtarët e çlirimit*. (Lloshi 2001:227).

- Mjaft interesant është edhe paswordi i shprehjes partizane VFLP, kuptimi i së cilës nuk u shkonte ndërmend gjermanëve. Në popull shkurtesa VFLP interpretohej “**Viçi Feni- Lopa Pordhi**” në fakt shkurtesa simbolizonte sloganin “**Vdekje Fashizmit – Liri Popullit**”

4.2. Zhargone që lidhen me ekonominë

Shkon pas parasë: *diftajrsh, ekonomisti, i smunt mbas pareve, kasirant, koristash, prevarant (Te); koristaç, muftë, qen zorësh (Gv); lekist / lekiste (Alb, Te); bythxhani (Pp)*

Korrupsioni: *virusi i gripit; “O Mete, për vete” (Alb)*

Nafta: *floriri i zi, ari i zi*

Minatorët: *njerëzit e nëntokës*

Inxhinierët: *kirurgët e tokës*

Pyjet: *ari i gjelbër, mushkëritë e tokës*

4.3. Që lidhen me teknikën dhe shëndetësinë

Tlevizioni: ekrani i vogël

Numrat prefikse të shtrenjta të telefonisë celulare: *free sex, hot, sex line, zona e nxehtë (St); harom pare, të mrazën ka xhepi (Gv); lekngrenëse bushtër (Alb); t'krajta (Te); 0500-ni (Pp)*

Plotët: *rojet e qiellit, njerëzit e qiellit, shqiponjat e qiellit (me admirim); korbat e zinj, kasnecët e vdekjes (kur duhen dënuar)*

Mekët: *mantelët e bardhë*

Zemra: *pompë (Alb); akullumator, bushpumpa, hard, korason, radari i dashurisë, srce (Te); aparat, motor traktori (Gv); muskul (Kç); ora, tika-taku (St); motor (Gv, Te); podrum (Shk);*

4.4. Zhargonet mbi toponime ose institucione

Me anë të përdorimit të prapashtesave dhe formave të ndryshme qytetarët tregojnë qëndrimin e tyre psikologjik dhe lidhjen emotive me lokalitetin e caktuar që ka rëndësi për ta, më shpesh në aspektin pozitiv e më rrallë atë negativ.

Ky raport shprehet edhe me anë të shkurtesave: **Skënderbe (Busti i Skënderbeut – Shkup), Nënë Tereza (busti i Nënë Terezës – Shkup), Mavrovk (Qendra tregtare Mavrovasja - Shkup), Cairçank (Qendra tregtare Cairçanka-Shkup), Kodër (Kodra e Diellit – Tetovë,**

4.5. Lloje tjera të zhargoneve

Midis sendeve më të preferuara të zhargoneve janë pjesët e trupit e njeriut. Pastaj vijnë fjalët që lidhen me *zënka, rrahje, vjedhje, vrapim, ushqim dhe pije, para* dhe të gjitha llojet e *përçmimit*, ndoshta më tepër për të humburit dhe meritë e tyre, sepse ata të mençurit kanë dëshirë të tregojnë se si janë më të përparuar, andaj mendojnë shumë fjalë për ata më të humburit.

Plehu kimik: *uzina e breshërit të bardhë (Ylli, 1976, nr.8)*

Fëmijët: *lulet e jetës*

5. Prapashtesat si bazë për zhargonizmin e fjalëve

Një numër të madh zhargonesh dhe blende formohen edhe me anë të prapashtesave. Ja disa prej tyre:

-çe:

zyrtarçe: Siç thonë në anët e veriperëndimit , “*nisin me fol zyrtarçe*”;

katundarçe në gjuhën joletrare;

malsorçe: që përbën një një kundruellësi ndaj të folurit të zakonshëm të gjithë fshatit “*malsorçe*”. (Shkurtaj 2003:211);

majmunçe = @ - adresa e postës elektronike: ‘emri, majmunçe, hotmail.com’;

tamçe: kamion i markës TAM;

gjalçe: djalë në formë përkëdhelëse;

mallçe: për fëmijën që e ka për mallë;

skukallçe: lloj xhamlie që luajnë fëmijët;

kaurçe: emër ofendues për maqedonasit;

gomarçe: ai që pretendon t’i emitoj të tjerët, por në fakt nuk është i tillë. (Gazeta e Athinës nr.484, 18.07.2008).

çamçe (çamërisht);

- ka:

kullerka,

rolerka,

-da:

bakalliada;

fadiliada;

golliada (emision sportiv në ALSATm);

ballkaniada

B. PËRZIERJA E FJALËVE (BLENDET)

1. Rreth termit Blend

Ndër dukuritë tjera sociolinguistike, vëmendjen tërheq edhe një proces i ri, i motivuar për të ndërtuar fjalë të reja në gjuhë. Ky proces ndonjëherë quhet si kontaminim, ndërsa në aspektin terminologjik ndërkombëtar rëndomë përdoret termi **blende**.

Bëhet fjalë për përngjitjen e dy fjalëve ose pjesëve të tyre në tërësi të re, duke u përputhur me segmentet e tyre formale që paraqet kombinim të pjesëve që kanë hyrë në atë përbërje. Ky proces është i inspiruar nga tipi i përngjitjeve angleze: **motel** (**motor** + **hotel** “hotel për motoristët”); **smog** (**smoke** + **fog** “përzierje e tymit me mjegullën”); **najlon** (**New York** + **London** “lloj çorapeje”); **fanzin** (**fan**+**magazin** “revistë e përkrahësve të ndonjë drejtimi në pop kulturën”). Në të gjitha këto raste, kemi përngjitjen e një pjese me pjesën e dytë të fjalës së dytë, duke fituar fjalë e tretë. Edhe më karakteristike janë përngjitja e tre e më tepër shkronjave të para, duke fituar një akronim, që sot ka marrë tiparin e një emri: **news** (**n**orth, **e**ast, **w**est and **s**outh); **golf** (**G**entlemen, **O**nly, **L**adies **F**orbidden); **fuck** (**F**or **U**nlawful **C**arnal **K**nowledge); **tip** (**T**o **I**nsure **P**romptness);

Nën ndikimin e anglishtes, edhe në gjuhët tjera të ndryshme u paraqitën modifikime të tilla. Qëllimi i vetëm i këtij lloj krijimi është lidhja e dy veçorive kryesore : karakteri tallës dhe mjeshtëritë kalamburike që është më i pranishëm tek mediet, sidomos tek reklamat. Në gjuhën angleze kjo lojë e fjalëve (puns) ka një traditë të gjatë që përfshinë edhe autorë gjigantë si Shekspirin dhe Xhojsin dhe sidomos mjeshterin e përngjitjeve Luis Karolin. (Bugarski 2006 :190).

Krahas kësaj, në gjuhën tonë efektet e tilla të përmendura më lartë, janë rëndë të arrihen nga ana formale, megjithatë edhe në kulturën tonë nuk mungojnë këto karakteristika, edhe pse mund të numërohen me gishta. Ndoshta mund të gjendet ndonjë “përzierje të fjalëve” në nivel krahnor të krijuar nga populli, por ata ose janë vjetruar ose janë zhdukur. Gjithashtu ky model i popullit nuk mund të paraqes model për procesin krijues të modernes urbane për të cilën bisedojmë.

Në fillim leksemat si : **motel**, **smog**, **najlon**, **fanzin** janë importuar si tërësi dhe ashtu janë kuptuar, sepse nuk është bërë

ndonjë analizë rreth prejardhjes së tyre. Por me kyçjen e shoqërisë sonë në rrjedhat shoqërore ndërkombëtare dhe me qëllim të tërheqjes së vëmendjes për shkaqe të ndryshme reklamuese, edhe tek ne kanë filluar këto eksperimentime të “përzierjes së fjalëve”.

Në vazhdim do të përmendim dhe analizojmë disa blende që i kemi vërejtur nëpër media dhe tek të rinjtë.

2. Ndarja sipas fushave

1. Zhargonet e të rinjve janë një nga burimet kryesore për pasurimin e gjuhëve me blende, të cilët nga imagjinata dhe aftësia e tyre të lojës me fjalë na çojnë të njihemi me karakteristikat psikologjike dhe morale të njerëzve dhe profesionet e tyre, ambientin shkollor, vendtakimet më të preferuara, preokupimet e të rinjve, sendet dhe prodhimet e ndryshme etj.

Këtu mund t'i veçojmë: **profaraon** (profesor), **horongop** (idiot), **toçkuklle (idiot)**; **franglish** a **franglais** (frëngjisht + anglisht), **denglish** a **germish** (gjermanisht + anglisht), **spanGLISH**, **chinglish** e të tjerave në Evropë e në Azi, mund të themi që po i shtohet edhe “**alGLISH**” apo “**shqipGLISH**”, **Albangle** si **frangle** (Murati 2004:111); Llojet e automobilave: **shkodilak** (shkoda), **varborxhini** (Vartburg), **figuar** (Fiat 750); slogane politike: **Jungatjeta** (përshëndetje si parullë e PDSH-së në zgjedhjet e fundit parlamentare në Maqedoni); **Sperminator** (burrë mjaft potent), **shahobus** (autobus me shahistë), **goleador** (golashënues në Spanjë)

2. Mjetet publike: **Infomania**, **Kvizovizor**, **Festovizia**, **Kablovizor**, **sportoskop**, **Ekoskop**

3. Diskursi politik është një nga domenet mjaft populharizues për krijimin e fjalëve të përziera. Në fillim do t'i cekim zhargonet e importuara si: **Drakulesku**, **Çaushvic**, **demokratura**, **katastrojka**, **komunjarët**, **Titonik**, **Titosllavija**, **sllavomaqedonas**, **globalitarizam**, **mafijavelizëm**, **bleferendum**, **reFERendum**, **Horoskok**. Krijime paralele me ta përbën edhe **opingambath** - njeri që ikën nga frika e i fshihesh një detyrimi ligjor (është përdor për herë të parë kur Fatos Nano ia mbathi për Maqedoni), pastaj **robshtesë** - njeri kot, denigrim.

4. Përveç kategorive të mësipërme, për të cilët mund të thuhet se janë më tradicionale, paraqiten edhe të reja në 10 vitet e fundit në titujt e revistave dhe librave: **Anarheologija** (revistë

arkeologjike në Serbi), **Projeka(r)t** (revistë për artin vizuel), **Vizanteme** (ekspozitë pikturash me temë vizantike); **Fobjekat** (ekspozitë fotografish)

Një film i Milko Mançevskit mban titullin **Ballkankan** (me kuptimin kan-kan ballkanik). Një shkollë kompjuterash quhet **Enternet**.


Në gazetën “**Koha**” të ditës së hënë, 10.11.2008, f.8, me titull: “*EULEX-i, sërish pranë dështimit*” paraqitet blendi: **EU(lex) – EU(mik)**, me një X në mes.



Në gazetën “**Nova Makedonija**” të ditës së mërkurë, 22.10.2008 në ballinë botohet artikulli me titull: “*Qeveria nuk është e befasuar që Brukseli luajti sirtaki*” dhe blendi: (E)U(R)TOPIA = UTOPIA



Në gazetën “**Dnevnik**” të ditës së premte, 31.10.2008, botohet artikulli “*Demarsh për marshin-nacist grek*” dhe blendi me kryqin nacist dhe emri Greqi.



3. Modele krijuese

3.1. – Modeli i parë (klasik) : pjesa e parë të njërës dhe pjesa e dytë të fjalës së dytë shkrihet në një tërësi:

Albglish (albanian + english);
Angloolizëm (anglomania+alkoolizëm)
Beovizija (Beograd + televizija),
Bombëkracia (bombë + demokracia)
Chinglish (china + english),
Demokratura (demokracia + diktatura)
Demonokrate (demon + demokrate)
Denglish (denmark + english),,
Drakullesku (Drakulla + Caushesku),
Ekoskop (ekonomski + horoskop)
Figuar (fiço+jaguar)
Français (franc+ anglais),
Franglish(franc+ english),
Germglish (germani + english),
Globalitarizëm (globalizëm + totalitarizëm)
Hashoman (hashish+narkoman)
Infotekist (informatist+bibliotekist)
Kandillak (kanditi+kadillak)
Katastrojka (katastrofa + perestrojka)
Kafuçino (kafe + kapuçino)
Krebil (kreten+debil)
Nekrospektivë
Montevizija (Montenegro + televizija)
Milboro (Milo + Marlboro)
Raconalist (racë + nacionalist)
Restoteka (restorant+diskoteka)
Rurbane (rurale + urbane)
Roltika (rolera + patika)
Serbisllavia (Serbia + Jugosllavia)
Sociozofik (sociologjik + filozofik)
Spanglish (spanjolisht + english),
Sperminator (sperma+terminator)
Shkodillak (shkoda+kadillak)
Telegjenik (televizor+fotogjenik)
Trambus (tramvaj+autobus)
Trifilis (triper+sifilis)
Varborxhini (wartburg+llamborxhini)

3.2. – Modeli i dytë : pjesa e parë të njërës dhe pjesa e parë të fjalës së dytë shkrihet në një tërësi:

Alsat (Albanian+satelit),
Albsig (albanian+sigurimi);
Albakos (Albania + Kosova);
AlbUSA (Albania + USA);
Boxalb (boxing + albanian);
Digitsat (digital + satelit),
Digitalb (digital + albanian);
Kosmak (Kosova + Makedonija);
€urosig (€uro + sigurimi)
Ecolog (ekolog + logos)
Albaglobal (Albania + globalizëm)
StudEu (Student + Europe)



3.3. – Modeli i tretë:

a) Përngjitja e tërësishme e fjalës së parë dhe pjesës së dytë të fjalës së dytë.

Bleferendum (blef + referendum)
Danteon (dante + panteon),
Debiltant (debil + debitant),
Fantamorgana (fanta + fatamorgana),
Fenolmenale (fenol + fenomenale)
Goleador (gol + toreador)
€urospa (euro + spanja)
Natokratia (nato + demokratia),
Pankcert (pank + koncert),
Radiovizor (radio + televizor),
Rodmansa (rodman + romansa),
Rokopedia (rok + enciklopedia),
Shahobus (shah + autobus),

Shahoreska (**shah** + **humoreska**),
Shahorizma (**shah** + **aforizma**),
Shqipglis (**shqip** + **english**);
Sportoskop (**sport** + **horoskop**)
Studentobil (**student** + **automobil**)
Titosllavia (**tito** + **jugosllavia**),
Titonik (**tito** + **titanik**),

b) përngjitja e tërësishme e fjalës së parë dhe pjesës së parë të fjalës së dytë.

showbiz (**show** + **biznes**)
Albaniasat (**Albania** + **satelit**)



3.4. – Modeli i katërt: e kundërta me modelin e tretë, përngjitja e pjesës së parë të fjalës së parë dhe përngjitja e tërësishme e pjesës së dytë.

Albadigital (**Albanian** + **digital**)
Albaglobal (**Albanian**+ **global**)
Albakopie (**Albanian** + **kopie**)
Albashare (**Albanian** + **share**)
Albatrans (**Albanian**+**trans**)
Albauto (**Albanian**+**Auto**)
Albducros (**Albanian** +**Ducros**)
Albemigrant (**Albanian**+ **emigrant**)
Albevangelist (**Albanian** + **evangelist**)
Albfriend (**Albanian** + **friend**)
AlbIslam (**Albanian** + **Islam**)
Albqeramikë (**Albania** + **qeramikë**);
Albshkenca (**Albanian** + **shkenca**);
Albstation (**Albanian** + **station**)
Albstudent (**Albanian** + **student**)
Anarkeologji (**anarki** + **arkeologji**),
Apartvila (**apartman** + **villa**),
Arkitekturist (**arkitektura** + **turist**)
Arkitortura (**arkitektura** + **tortura**);
Çaushvic (**Çaushesku** + **Aushvic**)
Cicigan (**ciciban** + **cigan**),
Ekologjike (**ekologjike** + **logjike**)
Ekonomiks (**ekonomia** + **miks**),
Fenofantastike (**fenomenal** + **fantastike**);

ALBA  TRANS

alBISLAM

ALBEMIGRANT.COM


AlbAuto
 SHITBLERJE AUTOMJETESH

Portali Dashurise
AlbFriend

albStudent
 Rrethet Internacionale te Shoqatave Studentore Shqiptare

ALB
 evangelist

Albashare.net

ALB DUCROS

Fobjekt (foto + objekt)

Informania (informacion = mania),

Kantena (kantë + antena)

Kopakafana (Kopakabana + kafana),

Profesmor (profesor + smor),

Palmpedia (Palma + pedia)

Senegol (Senegal + gol),

Telenovelë (televizor + novelë);

Vizantema (vizantike + tema),

Hamburekxhillnica (hamburger + burekxhillnica),



3.5. – Modeli i pestë: përngjitja e tërësishme e dy fjalëve , ashtu që secila mund të pastrohet në mënyrë integrale:

Albangle (alban – angle)

Apartmania (apartman + mania)

Fotografia (fotograf + grafia)

Kakademik (kaka + akademik)

Kameleopard (kameleon + leopard)

Profaraon (profa + faraon),

Pajkanalizim (Pajkan + kanalizim)

Skandaluzia (skandal + Andaluzia),

3.6. – Modeli i gjashtë: njëra fjalë është brenda tjetrës, duke e nënvizuar.

Alb4ever

Balkankan (Ballkan + Kan)

Fantastik (fanta + fantastik)

Freem@il,

@cafe,

Postfest-um,

Referendum,

Xpert (eks+pert)



3.7. Kategori të veçanta, pa ndonjë analizë gjuhësore

Një krijim të tillë ka përdorur edhe televizioni **IN** nga Mali i Zi: *Adm**IN**istracija*, *Tren**ING***, *Ist**IN**a*, *Dom**IN**e*, *S**IN**optika* etj.; duke parë çfarë është në trend një pronar i petullave me sheqer e mbushur me marmelatë ose pekmez (ser. *pallaçinka*) harxhuesve

të vet u ofron 16 lloje të petullave varësisht me çfarë janë të mbushura.

Shmangiet nga tipat e fjalëformimit ndjehen jo vetëm në letërsi e publicistikë, por edhe në jetën e përditshme. Në një ndërmarrje vjen një përgjegjës i ri i brigadës dhe ata i thonë mbiemrat e tyre sapo njihen duke dalë një përkim i rastit: *Çelsula, Çelmeta, Çelaga*. Përgjegjësi atëherë tha: *U pa puna, edhe unë nga Adhami do ta bëj Çeladhami!* (Lloshi 2001:124); Tekst me humor ose me parodizim kemi edhe në rastin: *llafe ndërkombëtare* (për ndërkombëtarizma), *ekspeditë për mbledhjen e llafeve* (Lloshi 2001:46);

Te “Çipi i palaçove”(1922), Faik Konica luan me tri trajta të emrit të kontinentit **Auropa, Evropi, Evropa** për ata që shtiren se janë evropianizuar. (Lloshi 2001:56);

Shkrime në gazetë lidhur me politikën: **Mmmmmmf...** (titulli i artikullit në lidhje me MMF, (Vreme 15.09.2005)

Me shenjën e euros €, kemi këto emërtime: **€kon:ference** (Konference e organizuar na magazini Ekonomist 2005 në 3 ngjyra). Po me këtë shenjë në gazetën tiranase “Koha jonë” e datës 21 korrik 2008 takojmë reklamën: **€urosig** dhe **€uroSpa** etj.

Takohen reklama me shenjën @: **freem@il, @cafe**.

Në një reklamë mbi shkollën shqiptare të Athinës “Gazeta e Athinës 18-24.07.2008” vërejtëm formën: **xpert – ekspert**, ku motoja është: *Qendër ekskluzive trajnimi dhe testimi i certifikatës europiane për kompjuter xpert për Greqinë.*

“Kuçedra e ujit” përsëri në Tiranë (artikull lidhur me ndërrmarjet e ujësjellësit në Tiranë shpërdorimin e ujit të pijshëm në “Gazeta e Athinës 18-24.07.2008).

“Topi bamb e Muçoja tutje” (artikull mbi veprimtarinë e -ish spiunëve në shoqërinë shqiptare në “Gazeta e Athinës 18-24.07.2008).

Dialogu me Shqipërinë - (artikull ku përmendet *nënkryetari* i Bashkisë së Tiranës i cili nuk merret me plehrat e zjarret por vetëm shkon e harron, në “Gazeta e Athinës 18-24.07.2008).

“Demokracia e kulluar” dhe “pastërtia e figurave”, (artikull mbi veprimtarinë e -ish spiunëve në shoqërinë shqiptare, në “Gazeta e Athinës{ 18-24.07.2008).

Përdoren edhe **“infeksion komunist”; recidiv enverist”**

Pjesa më e mirë e diçkaje: *“si kokla n’viam”*; **llokma e luanit** (e përdorur në një artikull lidhur me përdorimin e naftës *“Rusia zotëron llokmën e luanit në Arktik”* në “Gazeta e Athinës 18-24.07.2008).

5. Eksperimente tjera verbale

Këtë hulumtim do ta mbarojmë me vërejtjen se këto dukuri nga aspekti sociolinguistik nuk janë të vetme. Jashtë objektivit tonë ngelën edhe disa eksperimente tjera verbale, pak a shumë të njëjta me të parët. Edhe këtu kemi të bëjmë me fshehjen e mundësive gjuhësore, në njëfarë mënyrë një **“lojë fjalësh”** ku me anë të heqjes, ndryshimit ose futjen e vetëm një shkronje, rrokje, fjale, shenje ose me ndonjë intervenim shumë të vogël fitojmë një kuptim të ri në prapavijën e diçka që ka ekzistuar dhe që ka qenë e njohur më parë.

Te novela *Krushqit janë të ngrirë* të Ismail Kadaresë ndeshim këtë fjalë **“Erdhi dita e Kosovës”** (marrë nga vargu *Kënga V* te Milosaoja të De Radës **“Erdhi dita e Arbërit”**).

Me rastin e ndërtimit të sallës sportive në Novi Sad ndeshim fjalën **“Dom za ceshanje”** (shtëpi për kryerje) nga filmi i njohur i Emir Kosturicës **“Dom za veshanje”** (shtëpi për varje).

Titull drejtuar ish-kryeministrit serb Vojisllav Koshtunica **“Ko to tamo zeva”** (*Kush hap gojën atje*) – nga filmi **“Ko to tamo peva”** (kush këndon atje).

“A ke ta ndezim njëherë nga duhani i Remes” (A ke një cigare, mare nga filmi.....me luftën e Pezës)

6. Përfundime mbi blendet

1. Edhe pse blendet kanë jetë të shkurtë, vetë paraqitja e tyre nuk është pa rëndësi në gjendjen e sotme aktuale të shoqërisë dhe zhvillimit të gjuhës. Me anë të regjistrimit të këtyre fjalëve dëshmojnë për adaptimin e përgjithshëm të gjuhës me ndryshimet e kohës së re. Sipas hulumtimeve tona, prodhuesit e këtyre blendeve mund të dallohen 3 grupe krijuesish: **adoleshentët** (nga zbavitja), **gazetarët** dhe **ekspertët e marketingut** (për ta tërhequr auditoriumin dhe klientët për prodhimet ose shërbimet e tyre).

2. Kjo dukuri, në një mënyrë paraqet indikator jo vetëm të natyrës por edhe shpejtësisë së ndryshimeve shoqërore. Paraqitja e blendeve nuk është njësoj intensiv në të gjitha fushat. Blendet e para u afirmuan në skenën politike gjatë ndryshimeve të mëdha që e përshkuan jo vetëm vendin tonë por edhe tërë Ballkanin. Por tani zhvillim më të shpejtë blendet gjejnë në botën e reklamave, që në një mënyrë e plotëson me të madhe listën.

3. Duhet të përmendim se edhe pse përmendëm shumë blende me prejardhje ndërkombëtare, qëllimi nuk është ata t'i

huazojmë, por të hapim një proces që deri pak para i panjohur, por sot ka marr një hov shumë të madh në tërë botën dhe paraqet mënyrën më të gjallë të krijimit të fjalëve të reja. Me shembujt ndërkombëtarë kemi marrë vetëm inspirimin si një lloj modeli gramatikor e deri diku edhe si një qëndrim psikologjik që mund të zgjerohet me blende nga brumi gjuhësor yni dhe rrethit tonë shoqëror. Të përmendim disa blende që janë marrë nga gjuhët e huaja, si p.sh. : **Drakulesku**, **Caushvic** (nga Rumanishtja), **demokracia** (Polonishtja), **katastrojka** (nga Rusishtja), **rurbane**, **automat**, **bankomat**, **kafemat**, **kartomat**, **parkomat** (nga anglishtja), **Teuro** (gjerm. *Teuer* ‘shtrenjtë“ + *Euro*) që paraqet koment ironik për shtrenjtimin e përgjithshëm që ndodhi me kalimin e markës në euro. Kjo fjalë më 2002 u zgjodh si fjalë e vitit në Gjermani.

4. Procesi i blendeve në gjuhën shqipe ende nuk ka gjetur mbështetjen e duhur, megjithatë me të madhe funksionon nëpër reklama, emërtimet e kanaleve televizive dhe institucioneve të caktuara private, si p.sh. **albsat**, **albsig**, **albshkenca**, **albglis**, **shqipglis** etj., mirëpo për mbledhjen dhe analizimin e tyre është bërë shumë pak. Do të duhen vite për t’u mbledhur, por është fakt se çdo ditë lindin një numër të madh të blendeve si proces që i përgjigjet kohës dhe nevojave të caktuara.

C. EUFEMIZMAT DHE TABUTË

Edhe në jetën private edhe në atë publike, gjuha pa eufemizma paraqet një mjet të dobët komunikimi. Prandaj eufemizmat duhet të shikohen si një nga strategjitë e rëndësishme të ligjërimit, ose siç e kemi konsideruar në mënyrë tradicionale, si një figurë retorike. Por meqë eufemizmat paraqiten edhe te fjalorët, ato mund t'i shqyrtojmë edhe nga aspekti leksikografik.

Eufemizmat për shkak të kuptimit të zgjeruar nuk definohet vetëm në një mënyrë, por ekzistojnë definicione të shumta. Nga definicionet e shumta veçuan: *“Eufemizmat përdoren si zëvendësim për shprehjet e papërshtatshme, me qëllim që t'i iket “zverdhjes së fytyrës”: goftë të fytyrës së vet ose të tjetrit, ose ikjes nga ofendimi ndaj dëgjuesit ose anës së tretë”* (Allan dhe Burridge 1991:11).

Mjaft interesant është edhe definicioni që e gjejmë në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, ku fjala **eufemizëm** është përkufizuar në këtë mënyrë: *Fjalë ose shprehje që përdoret në vend të një fjale a shprehjeje tjetër, të cilën nuk duam ose nuk duhet ta zëmë në gojë, fjalë a shprehje e butë a e zbutur* (p.sh. të bukurat për "grykët", e paemra për "sëmundjen e shpretkës", buzëlidhuri për "i vdekuri", gojëlidhuri për "ujkun", nuk thotë të vërtetën në vend të "gënjen", u nda prej nesh në vend të "vdiq" (FGJSSH 1981: 438).

Eufemizmat krijohen me anë të procesit të eufemizmit të leksikut (që është e kundërta e pejorizimit të leksikut). Me anë të eufemizmave, shumë fjalëve të papërshtatshme për komunikim, u krijohen shprehje sinonimike. Ndërrimi eufemistik ose shprehje me konotim pozitiv krijohet me qëllim të ikjes së ndonjë moskuptimi eventual gjatë komunikimit. Ikja nga termi i papërshtatshëm, eufemizmi në realitet e lehtëson diskursin social” (Rawson 1981:3).

Gjuha në disa segmente të saj (sidomos kur bëhet fjalë për leksikologjinë dhe leksikografinë) nuk mund të shikohet si përbërje të mbyllur dhe abstrakte, por si mënyrë interdisiplinare, nga dy e më shumë disiplina shoqërore. Prej këtu, eufemizmat paraqiten si temë sociolinguistike, që nuk varen nga standardi por nga roli që luajnë në shoqëri, si në: kulturë, letërsi, civilizim, politikë, fe, komb etj. Prej këtu në linguistikën moderne interesimi për hulumtimin e eufemizmave është në rritje e sipër, duke u bazuar edhe në studimet teorike. Por për fat të keq në fjalorin e gjuhës shqipe nuk është treguar interesim të duhur për këtë lloj shprehjeje.

Megjithatë, nga ato pak fjalë dhe shprehje eufemistike që janë përfshirë në fjalorin e gjuhës shqipe, sidomos nga materiali shumë i pasur në ligjërimin popullor, eufemizmat në shtresat e saja leksikore përfshinë të gjitha stilet funksionale të gjuhës shqipe. Pikërisht, kjo e vështirëson pak përpunimin leksikografik.

1. Vdekja

Shumë ndjenja njerëzore nuk mund t'i shprehim ashtu siç duam dhe shpesh herë mundohemi t'i paraqesim me eufemizëm, duke përdorur fjalë më të bukura apo më pak të tensionuara. Një nga tabu-të më të mëdha të njerëzimit është vdekja. Sa herë kemi dëgjuar që të thonë: '*nuk është me midis nesh*', apo në anglisht '*passed away*', apo '*na la*', apo '*është midis engjëjve*' etj? Te gjitha këto sepse kemi frikë të themi se vdiq.

E vejë:

burrëvdekur (Xhuvani 1986:87,208);
drugushtore (Pp);
leshkorre (Kurvelesh) (Totoni 1971:97);

E vrau:

i dha gjysmën e lekut (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:121);
ia gatuj kulaqin (Devoll) (Jashari 1975:138)

Mëkatar i porsavdekur:

qafëthyeri (Osmani & Pepa 2000:135);

Ngordhi:

keqet (Tase 1941:196)

Njeri që vdes:

mjerë kujt i han shpina dhe (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:129);

Njeriu që është afër vdekjes:

e ka korr elbin (Pp)

e ka njëren këmbë në varr (Jugu) (Tase 1941:16);

është me shpirt ndër dhambë (Jugu) (Tase 1941:16);

është në buzë të varrit (Jugu) (Tase 1941:16);

i ka të pakta bukët (Jugu) (Tase 1941:16);

të shatat n'brez i ka (Jugu) (Tase 1941:16);

Shpirtrat e të vdekurve:

të mirët (Osmani & Pepa 2000:128);

Varri:

ara e Zotit (Osmani & Pepa 2000:104);

banesa e fundit (Lezhë) (Osmani & Pepa 2000:106);

fundit (Banesa e fundit);

gropa (Osmani & Pepa 2000:118);

mbyll, çel (Çel e s'mbyll) (FGJSSH 1981)
vasilikua – vasilikoi (Gjirokastër) (Haxhihasani 1974:107);

Dita e të vdekurve:

dita e shueme. (Shkodër). (Osmani & Pepa 2000:113);

Vdekja:

bie në gjumë të përjetshëm(FGJSSH 1981);
buzëlidhuri(FGJSSH 1981);
e të madhin (FGJSSH 1981);
emërshuari (Osmani & Pepa 2000:114);
fle gjumin e madh (FGJSSH 1981);
fthohem (FGJSSH 1981);
fthohur (e gjeti të fthohur) (FGJSSH 1981);
gjumi i madh (i përjetshëm) (FGJSSH 1981);
gjumi i madh (M Madhe) (Osmani & Pepa 2000:119);
gojëhapuri (Osmani & Pepa 2000:117);
i mjeri (Çabej 1977:1-22);
i mjeri (FGJSSH 1981);
i nxiri (FGJSSH 1981);
i shkreti (FGJSSH 1981);
i shkreti (Jakova 1955:13);
i ziu (Çabej 1977:1-22);
i ziu (FGJSSH 1981);
ishte fjetur (FGJSSH 1981);
kaltëruari (FGJSSH 1981);
krahëthati (FGJSSH 1981);
merhumi(FGJSSH 1981);
pa jetë(FGJSSH 1981);
pasqafe. (I erdhi pasqafja) (FGJSSH 1981);
pasqafja (Osmani & Pepa 2000:133);
prehet (FGJSSH 1981);
qoftë larg nesh (Myzeqe) (Nushi 1974:318);
qyqari (Shkodër) (Çabej 1977:1-22);
shuari (FGJSSH 1981);
të madhin (Osmani & Pepa 2000:127);
vdekje e bardhë (Osmani & Pepa 2000:142)

Vdiq:

dorëzoi tallon ('80); (Shkurtaj 2003:247);
dorëzoi triskën ('50) (Shkurtaj 2003:247);
drita e syve iu ka errë. (Osmani & Pepa 2000:113);
dritën e diellit kurr s'ka me e pa ma (Osmani & Pepa 2000:113);
e bëri bishtin kopan (Shkurtaj 2003:251)
e dërguan në shtëpinë e re (Shkurtaj 2003:251)
e la zemra (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:114);
e përcollën në botën tjetër (Osmani & Pepa 2000:121);

e piu shëndetin (Osmani & Pepa 2000:134);
harroi me marrë frymë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:120);
harroi me marrë frymë (Shkurtaj 2003:247);
i bëri këmbët big (Shkurtaj 2003:251)
i ka mbirë bari mbi krye(Shkurtaj 2003:247);
i ktheu sytë nga dielli (Shkurtaj 2003:251)
i lau teshat (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:121);
iu mbarua vaji kandilit (Fier) (Shkurtaj 2003:251)
iu ndal zemra (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:121);
ju marrun ditët (Shkodër) (Tase 1941:16);
kaq e pat (Shkodër) (Tase 1941:16);
kërceti (anegdotë: një grua shqiptare duke dashur t'ia tregojë
lajmin një maqedonasje për vdekjen e një personi i drejtohet me
fjalët: “Petrejce moj Petrejce, ripna Zharko ” (Petrejce moj
Petrejce, “kërceu”Zharku, në kuptimin vdiq);
ktheu krahët (Berat) (Krimçe 1988:71);
ktheu sytë nga dielli (Osmani & Pepa 2000:123); (Shkurtaj
2003:247);
mbaroi (Shkodër) (Tase 1941:16);
mbylli sytë(Shkurtaj 2003:247);
mylli sytë (Shkodër) (Tase 1941:16);
na la (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:129); (Pp); (Shkurtaj
2003:247);
na la shëndetit (Shkodër) (Tase 1941:16);
na lë shëndenë (Shkurtaj 2003:251)
na paska lanë jetë (Vreto 1973:328) ;
ndërroi jetë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:130);
shkoi (Shkurtaj 2003:247);
shkoi matjet (Shkurtaj 2003:247);
shkoi për fito pare(Pp);
shkoi për thana (Spiten – Lezhë) (Osmani & Pepa 2000:138);
shkoi te depo e Duhanit (sepse në Lushnjë varrezat janë afër Depos
së Duhanit). (Shkurtaj 2003:251)
shkoj ke ajo dunja (Pp);
shkoj me t'shumtit (Shkodër) (Tase 1941:16);
shkoj n'jetë t'vërtetë (Shkodër) (Tase 1941:16);
shkoj si qeni në rrush (Shkodër) (Tase 1941:16);
u ba për vig (Fishta 1982:126);
u bo për rafmet (Pp);
u ftof (Shkodër) (Tase 1941:16);
u ftof këmbësh (Mirditë) (Osmani & Pepa 2000:117);
u martue me gurë e dhe (Osmani & Pepa 2000:127);
u marue me dheun e zi (Osmani & Pepa 2000:127);
u punësua në minierë (Shkurtaj 2003:251)

2. Sëmundjet

Kemi frikë të themi se 'mund të vdes' dhe themi 'mund të më ndodhi diçka' ose 'nëse më ndodh diçka...'Ajo që bëhet nami është me kancerin. Të gjithë kemi dëgjuar të flasim për të si 'sëmundja e keqe' sepse kemi frikë të themi 'kishte kancer'

Ankthi:

rëndë (Të rëndët e dheut)

Epilepsia:

ajo (ajo e fëmijëve (e tokës) sëmundja e tokës (FGJSSH 1981);

ajo (Pukë) (Osmani & Pepa 2000:103);

ajo e caullve (Ibrahimi 2007:41);

ajo e hënës (Jug) (Osmani & Pepa 2000:103); (Shkurtaç 2003:248);

ajo e keqja (Osmani & Pepa 2000:103);

ajo e ligë (Xhuvani 1986:152);

ajo e mxhovive (Ibrahimi 2007:41);

ajo e tokës (Shkodër, Muzeqe) (Osmani & Pepa 2000:103);

ajo e tokës (Shkurtaç 2003:248);

ajo e truallit (Himarë) (Xhuvani 1986:152);

ajo paun (Ibrahimi 2007:41);

ajo punë (Dibër) (Plaku 1970:109); (FGJSSH 1981);

bëtajë (e nget bëtaja) (FGJSSH 1981); (Xhuvani 1987: 152);

bëtal (Çamëri) (Xhuvani 1987: 152);

bota (Osmani & Pepa 2000:108); (FGJSSH 1981);

dongxhe (Mazrrek – Çamëri) (Haxhihasani 1974:41);

e lashta (Xhuvani 1986:152);

e tokës (Shkodër, Hot) (Shkurtaç 1974:401);

egjertai (Luzni të Dibrës) (Beci 1974:261);

er' e tij (Kotes – Çamëri) (Haxhihasani 1987:43);

havale (e ka zënë havaleja) (FGJSSH 1981);

i betuemi (Gazulli 1941:67)

leshtë (i ra e leshta) (FGJSSH 1981);

lgata e hënës (Osmani & Pepa 2000:125);

lgata e tokës (Ljarje) (Zymberi 1981:92);

liga e keqe (Zymberi 1981:189,163);

lodërz (i ra (e zuri) lodërza) (FGJSSH 1981);

lodërz (Çabej 1982:53);

mirë (e zuri e mira) (FGJSSH 1981);

puna e hënës (Osmani & Pepa 2000:135); (FGJSSH 1981);

(Shkurtaç 2003:248);

puna e herës (FGJSSH 1981);

puna e truallit (FGJSSH 1981);
punë e trollit (Radostë e Rahovecit) (Zymberi 1981:163);
punëhera (Shkurtaç 2003:248); (Xhuvani 1986:86, 152); (FGJSSH 1981);

rëndë (e zu e rënda) (FGJSSH 1981);
shkuma (Osmani & Pepa 2000:139); (Shkurtaç 2003:248);
e shkelura (Shkurtaç 2003:248);

smunja e keqe (Pejë e Istok) (Zymberi 1981:164);
terezi (është në terezi tjetër) (FGJSSH 1981);
tokë:si (Çefa 1988:82);

ujku raft ksajde (Martiq – Krajë) (Zymberi 1996:168);

Gjendje shumë e rëndë shëndetësore:

fatalumas (Tiranë) (Tafaj – Haxhillazi 1989:231)

Gjëndra tuberkulare:

buheckë (Elbasan); *bujeckë* (Tiranë) (Elezi 1982:365)

Gripi:

përshkumje (Pejë) (Zymberi 1981:164)

I sëmurë:

o zaeftledis (Pp)

i paqef (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:133);

i pamujtun (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:133);

i pakuvet (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:133);

i paterezi (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:133);

i papimë (Mazrrek të Hasit – Prizren) (Zymberi 1981:164);

e zaifme. (Beci 1974:269)

I thati:

e mira e gjasë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:128);

koqe e mirë i thatë (lëmsh i vogël në ngjyrë të errët, që formohet zakonisht në mollëzat e gishtërinjve e më rrallë në pjesë të tjera të krahut dhe që të jep dhembje të forta);

Kanceri:

ajo q'i spërmendet (Osmani & Pepa 2000:103)

Kolera:

praponazot (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:134);

të pshtin (Bregu i Matës) (Osmani & Pepa 2000:134);

Kolla:

difteria (FGJSSH 1981);

fruthi i mirë (Kosovë) (Osmani & Pepa 2000:123);

grykët e bardha (FGJSSH 1981);

koll' e bardhë (Burrel, german, Bregu i Matës);

kolla e ëmbël (FGJSSH 1981);

kolla e keqe (FGJSSH 1981);

kolla e bardhë (FGJSSH 1981);

kolla e mirë (FGJSSH 1981);

kolla e zezë(FGJSSH 1981);
kolli i mirë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:123);
Murtaja e bardhë (FGJSSH 1981);
qoftë e bardhë (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:135);

Larg nesh:

maleve t'shkreta (Pp)

Li e pavaksinuar:

lija e pableme (Hot) (Osmani & Pepa 2000:126);

Lia:

lum (I doli e lumja. E preu e lumja);
Lia e miri; bekuar (FGJSSH 1981);
lume (lia e zezë-Veri, Arëreshët e Greqisës);
lia e bardhë (German, Mat, Shkodër); (FGJSSH 1981);
zonja e mirë (Jug) (Osmani & Pepa 2000:144);
lija e derrave (Ibrahimi 2007:110)
lija madhe (Ibrahimi 2007:110)

Lloj sëmundjeje:

ardhjemadhet (Tase 1941:7);
ardhjet; (Osmani & Pepa 2000:104);
allanjus (Ibrahimi 2007:42)
astalluok (Ibrahimi 2007:45)
breshkëz (Çabej 1987:53);
burthi (Çabej 1982:53);
butë (Shpat – Elbasan) (Elezi 1982:124);
dora e Asllanit (Disdari – Ndoja 1975:52);
çuma (Ibrahimi 2007:63)
çymza (Ibrahimi 2007:64)
kryqt (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:124);
kryqzat (M. Madhe),
neolla (Ibrahimi 2007:128)
sili (Ibrahimi 2007:156)
të britit (Elezi 1982:364);
të kuqt e madh (Shpat – Elbasan) (Elezi 1982:124);
urthi (Çabej) (Osmani & Pepa 2000:124);
verdhëz (Çabej) (Osmani & Pepa 2000:124);
zhushka (Ibrahimi 2007:184)

Paraliza:

ajo punë (Pejë)(Zymeri 1981:160);
ajo që i raftë tokës (M.Madhe, Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:103)
ilieti (Ibrahimi 2007:88)
pikë (FGJSSH 1981) ;
send (I ra një send) (FGJSSH 1981);
damlla (Ibrahimi 2007:65)
ollosajtet (Ibrahimi 2007:131)

Reumatizmi:

erë. (Kostallari 1989:85);

ngutë (Polis – Elabsan) (Haxhihasani 1987:135)

Ritual për sëmundjet:

kripja me sheqer. (Myzeqe) (Nushi 1974:331)

Sëmundja e plasjes:

padukur (I ra lopës e padukura).

Sëmundja e shpretkës:

e paemra. (Skurraj – Krujë) (Haxhihasani 1974:80)

Sëmundja e veshkëve:

amëltuemet (të) (Mirëditë);

t'ambëlutem (Dibër) (Shehu 1991:182)

Sëmundja mëllëri (i thatë):

i meiri (Murati 1994:102-103).

Sëmundja pleuriti:

tameltumit (Veri) (Çabej 1977:22)

Sëmundja polmoniti:

tameltumit (Mirëditë)(Çabej 1977:22)

Sëmundje e gishtit:

fshikë e ligë (Polis – Elbasan) (Haxhihasani 1987:262)

Sëmundje e keqe:

e rënda (Haxhihasani 1974:91)

Sëmundje e shpretkës, që shfaqet me ënjtje të saj:

paemër (I ra e paemra)

Sëmundje infektive e syve:

mirzë (Brezni e Opojës) (Zymberi 1981:16)

fshehtë (FGJSSH 1981);

Sëmundje lëkure:

urëz (Strelë, Korçë) (Petruti 1987:269)

brithi (Ibrahimi 2007:45)

giboni (Ibrahimi 2007:45)

bythëpule (Ibrahimi 2007:58)

Sëmundje ngjitëse:

dhimbë (Lafe 1964:145); *i kuqi i madh* (Dizdari – Ndoja 1975:185)

Të therme nervore:

tamëlto (Kërçovë);

tameltum (Strugë) (Osmani & Pepa 2000:103);

tameltumit (Pukë) (Çabej 1977:22);

thikët (Pedersen 1895:315)

Tifoja:

ftohtë (E pafsha të ftohtë!);

smundja e ftohtë (Krujë) (Osmani & Pepa 2000:137);

shurdhi (Polis – Elbasan) (Haxhihasani 1987:140);

shutërza (Beci 1982:123);

Turbekulozi:

dergjë thatë (Dukaxhin);
kolla e keqe (Osmani & Pepa 2000:123);
kolla e thatë (Zymberi 1981:71);
kulufickë (M. Madhe, Shkodër)
Ingata e thatë (Velipojë) (Osmani & Pepa 2000:126);
oftikë (M. Madhe, Shkodër)
preka (M. Madhe, Shkodër)
verem (M. Madhe, Shkodër)

3. Seksualiteti

Seksualiteti është qe nga lashtësia deri me sot një tabu i pakapërcyeshëm. Sidomos fjalët e organeve i zëvendësojmë me fjalë që na duken më të mira. Edhe pse janë tabu (por të gjithë i dimë).

3.1. Emërtimi i organeve seksuale**3.1.1. Emërtimi i organeve seksuale te njerëzit**

Emrat e organit seksual të mashkullit: *bishtak, buçurruc, currak, çukallkë, fishek, gozhdar, hajdar, hallat, herroj, kacagjel, kalem, karklluk, karushë, koçan, llullak, llullë, maçarungë, manillë, matarak, matarosh, matrafell, matrakullë, mazhgull, meskambësh, mëzhell, mullar, ndërmjekambësh, ngordhash, ngordhe, ngordhë, pallë, pashë, pllambanik, qushk, rrepan, rrip, rropell, rrotak, rrotoman, rrush, shaputan, shkërdhyes, shubak, shul, teshë, zdërvek, rockë, trap, bile, kollodok, handar, vidhbili, bibilush, kartjush; kabile; ka; matramish; c'birus, 2 pllomsh, qor, zari, kar-rocke, bile-bibilush, penis-zorre, rrush-bibilush, mazllum, matrapik, hapes bir(r)ash, lloz, zhbirues, sallom, ulluk, ushkur, bili, bibilush, kartjush. kabile, matramish, birus, pllomsh, qorr, zari, rroçko, zorre; hallatet, trobet, ai sendi, ai miku, vete-vetja, zogu, rrushi, luci, bylbyli/bilbili, bilebilja; hajdari, damari, delli, cari (Shkurtaç 2003:251); ropelli, roçko, ç'kallka, çupërluça (Ibrahimi 2007:63, 64, 152); vetja, vetëheja. (Osmani & Pepa 2000:143)*

Emrat e organit seksual të femrës: *baqth, birë, birbiraçë, bubblesh, buç, buçuk, çapellë, çok, duc, dyfel, dygishte, feladug, fellë, gojëkali, gop, gjollë, kacagjele, klemëz, lemcë, lemcë, lorek, të leth, lug, llapatan, maknaq, matrafellë, meskambësh, ndërmjekambsh, papalak, papulan, papuli, piç, pupulak, quk,*

quklinë, rumbullak, shyt, taknaq, teshë, varrë, vete, zuzalak, zuzë, zymilek. vrime, vagon; vete, lule-lulja, ai vendi, vendi i lig, vendi i keq, vendi që s'kallzohet; gop, vërr, buzë kuqmustaqezi, llokumi, mele, daflaku, vulva, lepuri, zogu; bithalesh (Xhuvani 1987:178)

Organi gjenital i fëmijëve (meshkujve):

culaq (Sarandë) (Nathanaili – Samara 1990:12);

rrush (Shkodër);

bilbil (Jug) (Osmani & Pepa 2000:136);

bilbil, kure (Ibrahimi 2007:52,107)

rrushi, bile-bilja, bylbyli, zogu; hallatet, trobet, ai sendi, ai miku, vete-vetja, zogu, rrushi, luci, bylbyli/bilbili, bilbilja (nga interneti)

Organi gjenital i fëmijëve (femrave): *çuk-u, fiku, kukunare,*

kukunë, zogu (Shkurtaj 2003:249); vete, lule-lulja, ai vendi,

vendi i lig, vendi i keq, vendi që s'kallzohet;

Testikulet:

loqet (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:126);

lulet (Osmani & Pepa 2000:126);

tamlat (Elbasan sipas Kristoforidhit) (Çabej 1976:323);

vendi i keq (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:142);

koqe, bole, llaushka (Ibrahimi 2007:57);

herdhet, uj, loqe, tope, testik (FGJSSH 1981)

lule (Lulet e dashit) (FGJSSH 1981)

3.1.2. Emërtimi i organeve seksuale te kafshët

- për derrin, cjapin, dashin:

pethi (Shkurtaj 2003:249);

- për demin e mëzatin:

karushka, krushka (Shkurtaj 2003:249);

caurdha (Pp)

- për organin gjenital të lopës, deles, dhisë:

t lem-it (Shkurtaj 2003:249)

3. 2. Procese seksuale

3.2.1. Procese seksuale te njerëzit

Akti seksual

Nga gratë: puth, mbaron punë, bën atë punë, fle me burrin, shkon me x, e shau me nan, më tha kshtu t'ia bafsha nans, ta bafsha e ta kthefsha (Shkurtaj 2003:249); ajo punë, shkëmbim përvoje (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:103)

Nga burrat: *me da dyshekun* (Osmani & Pepa 2000:112); *u solla mbarë me të* (Osmani & Pepa 2000:142); *gratë*:

Masturbimi:

bie me dore; vetëpërkedhelje; e tosh, rrjep majmunin, qëroj bananen,

Bota e seksit:

kastravec, zog kopshti, veci, trangulli, sallatori, sallata

Film me pornografi:

“film me luft” (Shkurta 2003:250),

film me d'zanme (Pp)

Eufemizmat për grua prostitute:

kurvë, zuskë, buçe, baxhellë, lavire, rruspi, prostitut, e lëmenjve, putan, kuçkë, shkaperllate baxhelle; lavire, bushtër., shkerdhate, karakurve; të nëntëdhjetë e nëntave=e hurit dhe e litarit; doubleclick the mouse, baxhi, baxhelle, kurve, karakurve, putane, karaputane, superkaraputane, ekstrakarkurve, rruspi, kabire, kartore, karthyese, kurve kardinale, ledi putane; lavire, kucke, buçe, lufke,

Homoseksual:

pederast, bythar, anëtar i shoqatës (shkurtesë anëtar i shoqatës së gej-ve; *bythqir, gay, pederast, pede, homo, verdacke.*

Menstruacionet:

adetet (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:110);

ato (FGJSSH 1981)

gjetura (i erdhën të gjeturat) (FGJSSH 1981)

bukuroshet (Osmani & Pepa 2000:120);

hanet e grave (Osmani & Pepa 2000:120);

lule (ishte me lulet) (FGJSSH 1981)

lulëkuqe (FGJSSH 1981)

lulet (Osmani & Pepa 2000:126);

ndërresë (FGJSSH 1981)

shpëlara (i erdhën të shpëlarat) (FGJSSH 1981)

të bardha (Osmani & Pepa 2000:106);

të larat (Osmani & Pepa 2000:125);

tezja (Osmani & Pepa 2000:120);

zakonet (Osmani & Pepa 2000:143);

Vajzë që shkon me shumë djem:

dorë, dorë e butë, minorene

Tradhti bashkëshortore:

e kishte pas gjte të keq (Osmani & Pepa 2000:114);

Shtatzëne:

me bark (Begracë – Kosovë) (Simja 1981:210);

e rëndë (Shkodër) (Haxhihasani 1974:91)

e ngarkueme (Shkodër) (Haxhihasani 1974:91)

e rand (Ibrahimi 2007:148)

Grua amorale:

bishtdredhur (Gjirokastër);

bishtdredhun (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:107);

bishtlujtme (Pp).

Grua me barrë:

i ka rënë miu në qypt (Fier) (Shkurtaç 2003:251);

ka hangër shumë karabusha (Malësi e Madhe) (Shkurtaç 2003:251);

ju ajn barku, e kan pumpajt (Pp); *e rant* (Ibrahimi 2007:148)

I riu në pubertet:

xhielbander,~i (Ibrahimi 2007:181)

Nuk u martova:

s'i qita fat vendit (Osmani & Pepa 2000:137);

U martua:

u ba me radio (Rilë – Bregu i Matës) (Osmani & Pepa 2000:141)

Prapanica:

dega e Krasniqes (Osmani & Pepa 2000:112);

zuzë (Dedi 1974:193)

Prapanikja, të ndenjurit:

banike (I ra në banike) (FGJSSH 1981)

Që ka të bëjë me organet gjinore:

fshehtë (FGJSSH 1981)

3.2.2. Procese seksuale te kafshët**- për lopën:**

ethet (Shkurtaç 2003:249);

çoet (Ibrahimi 2007:62);

ëthen (Polis – Elbasan) (Haxhihasani 1987:129)

- për delen: *ndërzheth* (Shkurtaç 2003:249);

bohët, bonët (Arëreshët e Italisë) (Çabej 1969:114);

me u dëbue (Cërnice të Moravës) (Shkurtaç 1979:70);

hidhet (Osmani & Pepa 2000:121);

- për dhinë: *thërpehet* (Shkurtaç 2003:249)

- për bushtrën e macen: *bohët / bonët* (Shkurtaç 2003 :249)

- për pelën dhe gomarin: *ndiqet* (Shkurtaç 2003:249)

- për pulën: *shkelet* (Shkurtaç 2003:249)

- për shpendët tjerë:

përfendet, (Shkurtaç 2003:249)

shkarrafendet (Shkurtaç 2003:249)

- mbarset:

bërzen (Shkurtaç 2003:249);

ngarkohet (Totoni 1971:98)

- organet e fshehta: *fshehtë* (FGJSSH 1981)

- plasja e bagëtive: *fshikëz* (FGJSSH 1981)

4. Ndjenjat (mashkull - femër).

Askaridet:

bubci. (Shkodër) (Elezi 1982:364)

Çiban:

i paemër (Margëlliç) (Haxhihasani 1974:80);

i thatë (Shkodër) (Lafe 1964:147)

Djajtë: *asi qi kjoshin djegë* (M. Madhe) (Kurti 1942:21);

Gënjen:

ka gabue. (Veri) (Çabej 1947:58);

ver takatë (Beci 1971:32)

Gënjeshtar i madh:

baba i rrenës. (Osmani & Pepa 2000:106);

Gjë e ndaluar:

mollë e ndalueme (Osmani & Pepa 2000:129);

Gojëvalë:

fjalaman (Dibër) (Zeneli 1987:81)

Hile:

pikël (Blinisht – Mirditë) (Osmani & Pepa 2000:134);

I ka hëngër të mirat e jetës:

e ka kullotë livadhin (Osmani & Pepa 2000:122);

I mjerë:

kokomir (Margëlliç – Çamëri) (Haxhihasani 1974:56)

I plagosur:

i shituem (Beci 1965:89)

I tretur nga mend:

humbamend (Osmani & Pepa 2000:121);

ka një drrasë mangut (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:122);

Jomuhabetçar:

i pagojë (Kurvelesh) (Totoni 1971:99)

Kafshon:

zë (Çeliku 1974:205)

Lypës:

kërkojsë (Çabej 1977:24); *përderak* (Gjeçovi 1943:357)

Lypësja:

zonja e madhe (Gjirokastër) (Çabej 1982:53)

Mallkoj:

dëvrej (Polis – Elbasan) (Haxhihasan 1987:928);

të foltë prifti (Shqipëria e Mesme) (Osmani & Pepa 2000:116);

t'preksha t'ftoftë

Njeri i çmendur:

i cikatur. (Lumë, Shkodër) (Xhuvani 1987:148)

Njeri i lig:

ruejnazot (Shkodër, M. Madhe) (Kostallari 1972:176)

Njeri i pashoqërueshëm:

çmendarak, (Shkurtaç 2003:251) *i lujtmi* (Pp)

Njeri i pasjellshëm por që ka dëshirë të ndryshoj:

i bekuari (Osmani & Pepa 2000:107);

Perëndeshat e fatit:

mëshirueset (Kostallari 1972:185)

Piklaxhi:

hileqar (Blinisht – Mirditë) (Osmani & Pepa 2000:134);

Plaku:

qaku (Katund i Ri) (Beci 1974: 266)

Prishem mendsh:

harrohem (Tototni 1964:130);

shushmëndem (Skopjonë) (Haxhihasani 1974:102)

Punoj keq:

me stërvit (Beci 1971:319);

më ra në tjetër punë (Vraniç të Suharekës) (Beci 1971:319);

Qetë:

krah punë (Pult – Dukagjin) (Osmani & Pepa 2000:123);

Rrëshqanës:

kokëzogëz. (Myzeqe) (Nushi 1974:28)

Shamatë:

hjek (Shkrel Shkodër) (Beci 1971:314)

Shëndetlig:

i qimosur (Korçë – Strellcë) (Osmani & Pepa 2000:135);

Shërbëtor:

rrëitar (Beci 1987:118)

Shpirtzi:

shpirtthatë (Palushi 1988:93)

Shprehje kur dikush preket me dorë duke biseduar:

mos të preksha për të keq – t'preksha për t'mirë (Osmani & Pepa 2000:140)

Shprehje për një njeri i keq që duan ta dënojnë:

i kanë këndue kangën (Lezhë) (Osmani & Pepa 2000:122);

Spiuni: ai (Osmani & Pepa 2000:102)**U mërzit pa të drejtë: buzuku** (Davidi 1983:9).**Vjedhës:**

fucaku (Pukë) (Curraj 1983:89);

i pahajri (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:132); *t*

honi i keq (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:141)

e ka dorën e gjatë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:114);

me picatë (Gjinari 1971:361)

E ka msau dorën (Ibrahimi 2007:212)

5. Bota shtazore

Ariu:

gojëmbërthyeri (Jug) (Tase 1941:55);
gjëja (Ruhot të Pejës) (Zymberi 1981:162);
teza (Korishë) (Osmani & Pepa 2000:140)
mjaltëngrënësi (Kostallari 1972:185);

Arrçi:

klysh dheu. (M. Madhe) (Gazulli 1941:197);
gojëkçuri (FGJSSH 1981);
gojëlidhuri (FGJSSH 1981);

Bleta:

ama e bletës - mbretëresha e bletës: (Osmani & Pepa 2000:103)
asi bletet - Mjalti (Postribë) (Gazulli 1941:241)
buqi me krayma (Lojë fëmijësh “Cërrën e don: Kulaqin n’diell, a buqin me krayma” (Ibrahimi 2007:56)
e bekuemja. (Osmani & Pepa 2000:107);
fryma e shenjtë (Lekbibaj – Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:117);
lëshoj bleta - Kur bleta e re del prej zgjonit: (Shkodër, Pukë) (Osmani & Pepa 2000 :125);
me shu - bleta e re del prej zgjonit: (Katund i Ri) (Beci 1974:267)
mizare (Çabej 1949:173);
mizë mjalti (Çabej 1977:173);
mjalcë (Janjar – Çamëri) (Haxhihasani 1974:75);
pres bjetën - marr mjaltin nga zgjoi (Topalli 1974:332);
pres bletën - marr mjaltin nga zgjoi (Çabej 1982:53)
punëtoret. (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:135);
qeth bletën (Çabej 1982:53)
vdinq bleta. (Malësitë Veriore) (Osmani & Pepa 2000:142)

Bolla:

orë (Ora e shtëpisë) (FGJSSH 1981);
vitore (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:143)

Bukla :

mirë (FGJSSH 1981);
nusja e lalës (FGJSSH 1981);
bishtfurka (Tiranë) (Kristoforidhi 1961:52);
bishtfurkabukur (Tiranë) (Elezi 1982:358);
bugër (Elezi 1982:366);
bukël dheu (Picar); (Haxhihasani 1974:34);
bukëlza (Kurtës) (Haxhihasani 1974:34);
bukëlza, (Elezi 1982:366);
bukëra (Variante fonetike në Veri) (Elezi 1982:366);
bukëra (Shpat – Elbasan); (Elezi 1982:366);
bukërza, (Elezi 1982:366);

bukrëza (Shpat – Elbasan) (Elezi 1982:366);
bukurija e mive (Zonat Veriore) (Osmani & Pepa 2000:110);
bulgeza (Kavajë) (Çeliku 1974:190);
bungë – bungla, (Elezi 1982:366);
bungëlza, (Elezi 1982:366);
buqeza (Polis – Elbasan) (Haxhihasani 1987:128);
burbuqe (Verilindje) (Shehu 1987:41);
e bukura (Verilindje) (Osmani & Pepa 2000:110);
e bukura e mive, (Osmani & Pepa 2000:110);
e bukura e zogjve (Pukë); (Osmani & Pepa 2000:110);
e mira e të mirave (Osmani & Pepa 2000:128);
kulkuqe (Verilindje) (Shehu 1987:124);
nusebukur (verilindje) (Shehu 1987:44);
nusël (Osmani & Pepa 2000:130);
nusëza (Çabej 1977:18);
nusja (Fushë – Arrës) (Osmani & Pepa 2000:130);
nusja e djemve, (Osmani & Pepa 2000:130);
nusja e mive (Fushë – Arrës) (Osmani & Pepa 2000:131);
nusjela, nuse lale (Picar) (Haxhihasani 1974:79),
nuskës lale (Çeliku 1974:199);
nuslala (Osmani & Pepa 2000:130);
nuslala, (Çeliku 1974:199)
nusmira (Lezhë) (Shkurtaç 1998:89,90);
pikaloshe (Verilindje) (Shehu 1987:50);
shtatpikaloshe (Verilindje) (Shehu 1987:50)

Derri:

tërnakopahije. (Gollak – Kosovë) (Dedi 1974:191)

Dhelpra:

bishtgjata (Myzeqe) (Nushi 1970:188);
bishtgjatë (FGJSSH 1981)
e paudha (Osmani & Pepa 2000:133);
këmbëkuq (FGJSSH 1981)
kumalindra (Pp);
kumaresha. (Ana e Malit) (Osmani & Pepa 2000:124);
kumareshë (Anë të Malit) (Shkurtaç 1998);
ndrikulla (Anë të Malit) (Shkurtaç 1998);
nrikull-a (*ndrikull-a*) (Anë të Malit) (Shkurtaç 1998);

Dosa:

ai i hekrave (Osmani & Pepa 2000:101);
ai i lugit të kuq (Zymberi 1981:163);
ai i lumit (Osmani & Pepa 2000:101);
ai i rripave (Osmani & Pepa 2000:101);
ai i shkorretit (Fishta 1921:18);
ai koftë larg ktuhit (Zymberi 1981:163);

- ai qi kokotë në shpellë* (Osmani & Pepa 2000:101);
ai qi pastë thye qafën (Dukagjin) (Osmani & Pepa 2000:101);
ai qi prapona zot (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:101);
ai qi qoftë tretë (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:101);
aqfarëgjeja (Muzeqe) (Nushi 1970:179).
gjofterrfeja (=ia që e gjoftë rrufeja-Malësi e Madhe) (Zymberi 1981:163);
punëtori i tokës (Totoni 1964:64,133)
- Gjarpëri:**
- ai i dheu* (Brajshë-Anamal); (Malësi e Madhe) (Zymberi 1996:20 dhe 48);
ai i ferrës (Mirëditë) (Osmani & Pepa 2000:102);
ai i gardhit, (Kodër e Budanit, Grudë) (Zymberi 1996:20);
ai i lleut (Kodër e Budanit, Grudë) (Malësi e Madhe) (Zymberi 1996:20);
ai i nurgurit (Kodër e Budanit, Grudë) (Zymberi 1996:20);
ai i paemni (Zymberi 1996:20);
ai i shkamt (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:102); (Zymberi 1996:20);
ai i shullanit (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:102);
ai i tokë (Pejë-Potog) (Osmani & Pepa 2000:102); (FJSSH 1984:376),
ai me briena (Kodër e Budanit, Grudë) (Zymberi 1996:20);
ai qi shkon zhag (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:102);
buba (Krajë) (Zymberi 1996:31);
buçi (Malësi e Madhe) (Zymberi 1996:20); (Ulçin) (Zymberi 1996:31);
çfurkuth (Gjinar – Shpat) (Çeliku 1971:253);
dhe (i zuri dheu lopën) (FGJSSH 1981);
dhetokësi (FGJSSH 1981);
dheu (Brajshë-Anamal) (Zymberi 1996:20 dhe 48);
dheu (Lezhë, Pukë, Burrel) (Cordignano 1934:31);
djegsh ai (ajo) që u djegtë (Shehu 1991:176);
farkaçi (Vërmicë – Prizren – Kosovë) (Zymberi 1981:163);
farkalofshi (Shehu 1987:141);
farofsh ai (ajo) që u faroftë (Shehu 1991:176);
ferrës (Mirditë) (Osmani & Pepa 2000:116);
gardhit / ai i garllit (Malësi e Madhe) (Zymberi 1996:20);
gjarpëri (Romaq – Gjakovë) (Zymberi 1981:185);
gjarpri me kurorë (Myzeqe) (Nushi 1974:36), (Mal të Zi, Tirol, Zvicër, Gjermani) (Nopça 1921:1-5);
gojëkyçuri (FGJSSH 1981);
gojëlidhuri (e kafshoi gojëlidhuri) (FGJSSH 1981);
gojëmbërthyeri (Jug) (Tase 1941:55);

gojëqepuri (FGJSSH 1981);
gojëthati (Anë të Malit, Shkodër);
gojngrimi, (Kojë) (Zymberi 1981:64);
gojngurti, (Kojë) (Zymberi 1981:64);
gojthati (Pp);
i bekuomi (Kalis, Kukë) (Osmani & Pepa 2000:107);
i ftohti (Kryezi, Pukë) (Tase 1941:55);
i gjati (FJSSH 1984:376),
i helmuemi (Kojë) (Zymberi 1981:64);
i përdredhuni (Osmani & Pepa 2000:133);
i tok:ës (Pukë, M. Madhe) (Gazulli 1941:408);
i tokës (Dukaxhin) (Osmani & Pepa 2000:121);
këmbëfshehuni (Dibër)) (Osmani & Pepa 2000:122);
kulaçi (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:124);
laramanlivadhi (Kosovë) (Dedi 1973:192);
lizganjoci (Mat) (Osmani & Pepa 2000:125);
mbërshelëgojë, *gojëmylluni* (Budi 1998:235);
nxifsh ai (ajo) që iu nxeftë koka (Shehu 1991:176);
ora e shtëpisë (Veri);
padheu (Osmani & Pepa 2000:133);
përdheci (Zymberi 1981:105);
përdhesi (FGJSSH 1981);
përdhesi (FJSSH 1984:891);
përtokësi (Zymberi 1981:162);
përtrodhësi (FJSSH 1984:915),
përtrollësi (FGJSSH 1981);
përtrollësi (Jug) (Osmani & Pepa 2000:134);
përzhagësi (Has – Prizren) (Zymberi 1981:162);
plasç bagëti që u fryftë e plastë (Shehu 1991:176);
roja e shpisë (Osmani & Pepa 2000:131);
rrëshqanës (FGJSSH 1981);
rrëshqanësi (FJSSH 1984:1052);
shpërdheci (Zymberi 1981:154);
shqansi, *rrëshqanësi* (Osmani & Pepa 2000:139);
shqigjetë (Strelcë – Korçë) (Osmani & Pepa 2000:137);
skrapth (Bregu i Matës) (Osmani & Pepa 2000:137);
tokësi (FJSSH 1984:1244),
zhagës (Opojë – Kosovë) (Zymber 1981:173);
zuri toksi (Tropojë) (Çefa 1988:82);
Gomari:
veshgjati (Pp);
veshlivarmi (Pp);
veshgjati (FGJSSH 1981);
gazheli (nga gratë) (Osmani & Pepa 2000)

Hardhuca:

tamluc (M. Madhe) (Gazulli 1941:420)

Iriqëza:

bezhël (Shpat – Elbasan) (Elezi 1982:364)

Kafshë e egër:

e bukura e shqerrave (M. Madhe) (Gazulli 1941:40)

Kafshimi i gjarprit:

të zëntë e gjarprit (Osmani & Pepa 2000:143)

Këlysh lepur:

makthi (Osmani & Pepa 2000:127);

Kukuvajka:

shpendkeqja (Kosovë) (Osmani & Pepa 2000:139);

Lloj insekti:

mollëkuqe (Osmani & Pepa 2000:129);

mallakuqe (Ibrahimi 2007:117)

Lloj zhapini:

hardhiçkë (Çeliku 1974:194)

Lloj zvarraniku:

arrsh (Shkurtaj 1974:234)

Milingona:

gojëmbërthyera (Qeparo – Himarë) (Kotallari 1972:15)

Mizë përdhese:

bërdhec (Beci 1982:91)

Morri:

asi shokësh (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:105);

bardheci (Zym i Hasit) (Zymberi 1981:162);

bërdhaci (Gazulli 1941:59); (FGJSSH 1981)

gjahtari (Gjirokastër) (Çabej 1977:19, 24);

Ujk,~u:

ai i malit (Mirëditë); (Osmani & Pepa 2000:101);

ai i natës (Breg i Matës – Lezhë); (Osmani & Pepa 2000:101);

ai ju gurt goja (Drume e sipërme – Hot); (Zymberi 1996:20,28);

ai që iu trash hallka e zinxhirit, (FGJSSH 1984:768);

ai qi ta thanë vathën (Bllacë e krajës) (Zymberi 1996:20,28);

bisha – bisha. (Xhuvani 1987:176);

bisha e pagojë; (Malësi të Madhe); (Osmani & Pepa 2000:117);

bisha, ai malit, (FGJSSH 1984:347),

bishë e pagojë (Mat – Pukë) (Tase 1941:55);

bishtgati (Koliçan i Istogut) (Zymberi 1981:161);

egërcina (FGJSSH 1984:870);

egërti (Buçe të Opojës) (Zymberi 1981:162);

gjëja (Ruhot të Pejës) (Zymberi 1981:162);

gojëfarkuti (Brodosani i Opojës – Kosovë) (Zymberi 1979:162);

gojëferkuemi (Podgorica 1989:195);

gojëkyçur, (FGJSSH 1981)
gojëkyçuri (=ai që iu kyçtë goja), (FGJSSH 1984:347);
gojëlidhun (Zymberi 1996:58);
gojëlidhuni (Mat, Pukë, Shkodër);
gojëlidhur (ra gojëlidhuri në dhen); (FGJSSH 1981)
gojëlidhuri, (Malësi të Madhe); (Osmani & Pepa 2000:117);
gojëlithti (Anë e Malit) (Osmani & Pepa 2000:117);
gojëmbërthyer (çau dy dele gojëmbërthyeri); (FGJSSH 1981)
gojëmbërthyeri (FGJSSH 1984:347),
gojëmbërthyeri (Jug) (Tase 1941:55);
gojëmbërthyeri, (FGJSSH 1984:347);
gojëmyllëti (Kosovë) (Thomaj 1987:58);
gojëmylluni (Ternovë – Peshkopi) (Osmani & Pepa 2000:117);
gojëmyllur (FGJSSH 1984:347),
gojëmshelni, (Osmani & Pepa 2000:118);
gojëmshelti (Veri) (Osmani & Pepa 2000:118);
gojëmyllm (Voaniç, Karvesori); (Tase 1941:55);
gojëngrimi (Shestan) (Osmani & Pepa 2000:118);
gojëqepuri (Dardhë – Korçë) (Osmani & Pepa 2000:118);
gojëqepuri (FGJSSH 1984:347),
gojëthati (Mat, Pukë, Tërnovë të Peshkopisë) (Zymberi 1981:64);
gojëzëni (Tase 1941:55);
gurojazogojën (=ai që ti o zot guroja gojën) (FGJSSH 1984:347);
gurojazogojen (Osmani & Pepa 2000:119);
hajujku (ai që ta hajë ujku) (FGJSSH 1984:768); ,
i gati (Zymberi 1979:40);
i padukur (ai që qoftë i padukur) (FGJSSH 1984:768);
i paemri (FGJSSH 1984:833),
i pagojë (Verilindje, Kosovë, Jugu) (Tase 1941:55);
i pagoji (FGJSSH 1984:835),
i pagoji, (Malësi të Madhe); (Osmani & Pepa 2000:117);
i papjesi (FGJSSH 1984:850),
i paqeni (FGJSSH 1984:851),
i paudhi (FGJSSH 1984:870),
këmbëlehti (Reks – Kukës)) (Osmani & Pepa 2000:122);
kumara (Malësi të Madhe); (Osmani & Pepa 2000:117);
kumbara i natës (Kosovë) (Kurti 1942:30);
largneshi (FGJSSH 1984:591);
mbyllzogojën (Veri) (Kostallari)
pagojë; (FGJSSH 1981)
qafërthyeri (Gramsh) (Osmani & Pepa 2000:135);
qaftrash (Ibrahimi 2007:145);
qoftëlargu (FGJSSH 1984:998),
seni i malit (Kosovë) (Osmani & Pepa 2000:137);

shkoftëlargu (FGJSSH 1984:1156),
shpata e zotit (Kosovë) (Osmani & Pepa 2000:139);
shpend (ia hëngri shpendi dhinë; (FGJSSH 1981)
shpirtndrituni (Klos – Burrel) (Osmani & Pepa 2000:139);
uluritsi (Pukë) (Osmani & Pepa 2000:141);
veshcurri (Mazrrek, Has) (Zymberi 1981:160); (Osmani & Pepa
 2000:117);

Urithi:

ai qi çon dhe (Tropojë-Mirëditë);
zuri (Osmani & Pepa 2000:144);

Xixëllonjë:

buk e re (Vilë – Kukës) (Tase 1941:196);
bukre (Kukës) (Hoxha 178);
bukure (Xhuvani 1987:240)

Zekthi:

dheçkë (M. Madhe) (Gazulli 1941:485)

a) Shprehje lidhur me kafshët**Plasja e bagëtive:**

lulja e mirë (Mat);
lulja e merr (Lurë) (Haxhihasani 1963:152)

Shprehje për pelën e bukur, që të mos e marrim mësysh:

bishtkorre. (Çabej 1947:159)

Shprehje për t'i zbutur gjarpërinjtë:

shko kumbarë (Malësi e Gjakovë) (Osmani & Pepa 2000:137);

Shtazë e egër:

bisha – bisha (Xhuvani 1987:176);

Sisa:

shytë (Gollak – Kosovë) (Dedi 1974:190)

Sisët e lopës:

cikat (Shkrel) (Beci 1971:311)

Tërësia e kafshëve të egra:

gjëja (Valbonë) (Osmani & Pepa 2000:119);

Tredh derrin:

dllir (Larje Krajë) (Zymberi 1996:45);

Tredh:

çjerr (Çjerr çjapin, dashin, mëzatin; Kalë i çjerrë) (FGJSSH 1981);
dëlir (E dëliri thiun) (FGJSSH 1981);
rrah (Tredh. Rrahën demin, dashin, çjapin) (FGJSSH 1981);
rrahur (Dash (çjap, dem) i rrahur) (FGJSSH 1981);

I patredhur:

paçjerrë (Kalë i paçjerrë) (FGJSSH 1981);
dukaum (Ibrahimi 2007:71)

b) Sëmundje që shfaqet te bagëtia:*gojëza* (Totoni 1964:130)*qymexhall* (Ibrahimi 2007:147)*rosniçarka* (Ibrahimi 2007:150)*zarzabica* (Ibrahimi 2007:184)**Sëmundje delesh:***hirrëzë* (Çeliku 1974:194)**Sëmundje e dhenve dhe e dhive:***shqopth* (Katund i Ri) (Beci 1974:267)**Sëmundje kuajsh:***burci* (Valbonë) (Gosturani 1982:329)**Sëmundja e pulave:***Pipka* (Ibrahimi 2007:139)**6. Bota bimore****Ai që pret dru:***dushmani i drunit* (Pp)**Lloj bime aromatike:***suka e makthit* (Vorfe) (Osmani & Pepa 2000:127);**Lloj peme tabu:***arrë* (Kastrat, M. Madhe). (Nushaj1974:321).**Mbretëresha e luleve:***kallauze* (Lishec, Luzni, Dibër) (Beci 1974:274)**Pemzë:***urthi*. (Çabej 1982:53)

Lloj sëmundje të kulturave bimore:

allaxha – sëmundje e duhanit (Ibrahimi 2007:42)**7. Qenie Mitologjike dhe fetare****Djalli:***ai i hekrave* (Osmani & Pepa 2000:101);*ai i lugit të kuq* (Osmani & Pepa 2000:101);*ai i lumit* (Osmani & Pepa 2000:101);*ai i rripave* (Osmani & Pepa 2000:101);*ai i shkorretit* (Fishta 1921:18);*ai koftë larg ktuhit* (Zymberi 1981:163);*ai qi kokotë në shpellë* (Osmani & Pepa 2000:101);*ai qi pastë thye qafën* (Dukagjin) (Osmani & Pepa 2000:101);*ai qi prapona zot* (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:101);*ai qi qoftë tretë* (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:101);

ana e keqe (nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq) (FGJSSH 2001)
aqfarëgjeja (Muzeqe) (Nushi 1970:179);
brienoçi (Bris – Krajë) (Zymberi 1996:30);
brimadh (Hora e Arbëreshëve) (Osmani & Pepa 2000:109);
denum (Kavajë) (Çeliku 1974:192);
djalli (Fan – Mirditë) (Osmani & Pepa 2000:122); (Çabej 1947:56);
gjoftrrëfeja (Malësi e madhe) (Osmani & Pepa 2000:119);
gojëqepuri (Dardhë – Korçë) (Osmani & Pepa 2000:118);
hajeuk (Nushi 1974:336);
hajujk (Nushi 1974:336);
hajujk(FGJSSH 2001)
hajujku (Nushi 1974:336);
hajuk (Nushi 1974:336);
hëujk (Nushi 1974:336);
i mallkuari (Kostallari 1972:176);
i padukuri (Osmani & Pepa 2000:132);
i paemër (Veri) (Haxhihasani 1974:80);
i pafe (Tropojë), (Osmani & Pepa 2000:132);
i pagoji (Vlorë) (Gjidede 1970:114);
i panafaku (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:121);
i papjesë (Margëllic) (Haxhihasani 1974:81);
i paqeni (Osmani & Pepa 2000:132);
i paudhi (Kostallari 1972:189);
i prroit (Drisht – Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:134);
i ziu (Pukë- Fushë Arrës) (Çabej 1977:1-22);
jashtë këndej (Çabej 1947:156);
kafsha e keqe (Gollak – Kosovë) (Osmani & Pepa 2000:122);
kafsha e ligë (Gollak – Kosovë) (Osmani & Pepa 2000:122);
kambëmbarshti (Kosovë),
kastigimi (Vishnjëvë – Kosovë) (Zymberi 1996:72);
këmbëprapi (Shqipëria e Jugut) (Kostallari 1984:93);
këmbëshkurti (Osmani & Pepa 2000:122);
kjoftëlargu (Kosovë, Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:135);
koftëlargu, (Halimi 1979:127);
kukulli (Lushnjë) (Osmani & Pepa 2000:124);
largkëtej (FGJSSH 2001)
largkëtej (Osmani & Pepa 2000:125);
largnesh (FGJSSH 2001)
largneshi (Kostallari 1972:155)
largqoftë (FGJSSH 2001)
largqofti (Osmani & Pepa 2000:125);
mëkati (Borgo Erizo) (Tagliavini 1937:186);
mospastpjesi (Vranishtë – Vlorë) (Haxhihasani 1974:76);

naleti (Dedi 1972:200) (Osmani & Pepa 2000:129); (*Pp*)
ndjesëpasti (Kostallari 1972:185);
njohës (Shqiptarët e Greqisë) (Çabej 1947:56);
padukur (FGJSSH 2001)
paemër (FGJSSH 2001)
pagojë (FGJSSH 2001)
papjesi (FGJSSH 2001)
paqenë (FGJSSH 2001)
paudhë (ka të paudhin në bark);
platgoja (Osmani & Pepa 2000:134);
praqona zot (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:134);
preftigja rrugën (Shkurtaç 1998:90);
punëkeq (FGJSSH 2001)
qoftëlarg (FGJSSH 2001)
qoftëlargu (Osmani & Pepa 2000:135);
qyqari (Pukë- Fushë Arrës) (Çabej 1977:1-22);
rrashtëbitisun (Bariçi 1950:169);
rripë (ai i rripave). (FGJSSH 2001)
ruajnazoti (Dangëlli, Përmet, Këlcyrë) (Kostallari:1972176);
rujnazoti (Dukagjin) (Osmani & Pepa 2000:132);
shkoftëlargu (Halimi 1979:127);
shkoftëlargu (M. Madhe, Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:135);
shkoftreti (Luzhnicë e Suarekës) (
tunduesi (Osmani & Pepa 2000:141);
ujku u hagërt (Dol – Guci) (Zymberi 1996:166);
 Zymberi 1981:163);

Dragoi:

në punët e tij,
në punës e saj
është njeri me punë (në kuptimin është Dragua); burrit dhe djalit
 nuk duhet thënë “*T’u thafshin krahët!*” se ndoshta është
 Dragua, ka fletë, e dëmton e vdes. (Tirta 1991:104).

Qenie mitologjike:

bardhë (FGJSSH 2001)
e bukura e pyllit (Agolli 1980:198);
e bukurza e dheut (Osmani & Pepa 2000:110);
e mira (Nushi 1974:);
e mira e vogël (Osmani & Pepa 2000:128);
fatitë (Çabej 1977:21);
fatmirat (Hahn 1853:161);
flamë (Janjar, M. Likun) (Haxhihasani 1974:46);
hyrija (Osmani & Pepa 2000:121);
jashtësme (FGJSSH 2001)
lubia (Çabej 1961:89);

- mëmëloshe* (Spatar, Filat) (Haxhihasani 1974:74)
mëmëstih (Kurtes) (Haxhihasani 1974:74)
mëmëstihia (Jug) (Haxhihasani 1974:74);
memoja (Margëllic) (Haxhihasani 1974:74);
nëna e votrës (Elbasan) (Haxhihasani 1974:74);
nji send e gja (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:131);
ora e ligë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:131);
orët e bardha, ora e malit (Osmani & Pepa 2000:132);
qyqja e votrës (Prilep);
shtoft zotynë (Osmani & Pepa 2000:139);
shtozot (M. Madhe, Postribë) (Osmani & Pepa 2000:139);
shtozorreshtat (Osmani & Pepa 2000:139);
shtozovallet (Osmani & Pepa 2000:139);
shtozovargun (Osmani & Pepa 2000:139);
stihia (Janjar) (Giordano1963:448, Haxhihasani 1974:97);
stihji (Jugu, Arbëreshët e Italisë) (Giordano1963:448, Haxhihasani 1974:97);
të bardhat (Hahn) (Osmani & Pepa 2000:106);
të jashtmet (Hahn 1853:16);
të lumet e natës (Bregu i Matës – Mat) (Osmani & Pepa 2000:126);
tri gratë (Çamëri) (Çamëri 1977:21);
vitore (Jug) (Osmani & Pepa 2000:143);
zana e mirë (Osmani & Pepa 2000:143);
zanat e bardha (Osmani & Pepa 2000:143);
zanat e malit (Osmani & Pepa 2000:143);
zonja murtajë (Osmani & Pepa 2000:144);
zoti shtoftu vargun (Osmani & Pepa 2000:144);
- Zanat:**
lume (Të lumet e natës).
- Kukumjaçka:**
mbreti i shtëpisë (Nushi 1974:325)
- Lloj amfibi:**
e bukura e dheut (Visaret e Kombit) (Osmani & Pepa 2000:110);
salamandra (Osmani & Pepa 2000:137);
- Lungë nën sqetull:**
nusëzë (Shqiptarët e Greqisë) (Çabej 1977:22)
- Shtriga:**
ajo qi han gur e gërshanë (Veri) (Osmani & Pepa 2000:103)
- Xhindët:** *gurët e sendit* (Podgorica 1989:200); *t'miraz* (Çeliku 1971:255)
- Zanat:**
t'lumet (Krajë) (Osmani & Pepa 2000:126);
e bukura e jetës (Osmani & Pepa 2000:110);
t'lumet, t'lumet e natës (FJSSH 1984:643),

t'mirat (FJSSH 1984:720);
shtozovallet, (Shkurtaaj 2003:245)
shtojuzorreshtat (Shkurtaaj 2003:245)

Hoxha:

ai me qallmën (Pp)

Prifti:

mjekërcapi (Shkurtaaj 2003:251);
makariozi, (Pp)
mjekërgjati (Pp)

Shejtani:

hurdhë (ai i hurdhës) (FGJSSH 2001)
lumë (ai i lumit) (FGJSSH 2001)
i paudhi (FGJSSH 2001)
mallkuar (FGJSSH 2001)
plotgojë (FGJSSH 2001)
shejtani i aurdhës (Ibrahimi 2007:255)
xhydam, lanet, dreq, laco, mizerje, pjellë dreqi, shejtan mulliri,
shejtan përroi, i paudhe, qoftëlarg, djalli (nga veb faqe interneti)

8. Nevojat biologjike të njeriut**Fekalet e njeriut:**

baltëthekën (Bllacë e Suharekës),
dale (Shehu 1991:176);
kulaqi n'diell (Lojë fëmijësh “Cërrën e don: Kulaqin n'diell, a buqin
me krayma” (Pp)
t'fliqtë (Pejë, Istog) (Zymberi 1981:164);
t'ndyt (Shkodër) (Zymberi 1981:164);
t'zhyt (Pejë, Istog) (Zymberi 1981:164);

Jashtëqitja:

barkqitje (FGJSSH 2001);
barku e qon (Pp);
trashë (Ujë e trashë (e madh), nevoja e madhe);
shkulem (FGJSSH 2001);

Kryerja e nevojës personale:

dalim jashtë e kqyrim motin (Malësi e Gjakovë), (Osmani & Pepa
 2000:112);
dal për vendi (Osmani & Pepa 2000:112);
vete tej (Osmani & Pepa 2000:143);
um shkojet përjashta (Pp);
jashtë (dal jashtë);
lirohem (shko lirohu!);
ujët (ujët e madh (e trashë);

ndot, ndotem (është ndotur foshnja);
ndyhem (u ndy foshnja);
nevoja e madhe, (FGJSSH 2001);
ujët e trashë, (FGJSSH 2001);
nevoja e vogël (FGJSSH 2001);
ujët e hollë(FGJSSH 2001);
nevoja e qenit (e maces) (FGJSSH 2001);

Kryerja e nevojës së madhe:

ku shkon mbreti në kambë (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:124);
ku shkon mreti n'kam; (Pp);
t'ja paguj popit; (Pp);
ke dera e vuogël, (Pp);
përrjashta (Pp);
ia paguj borxhin popit, (Shk).
shkoj ne kancelari (Shk).

Kryerja e nevojës së vogël:

t'qies ni uj (Pp);
i jap kalit uj (Shk)
Lahem: *bëj banjë* (Osmani & Pepa 2000:107);

Lindje:

dëlirem (U dëlir gruaja.U dëlir lopa);
lirohëm (Bëj fëmijë; lind (për gratë). U lirua gruaja (nusja). (FGJSSH 2001);

Nevojto: *banjë* (Dera e banjës); *dera e vogël* (Pp)

Sharje:

Në Kastrat e gjetkë në Malësi të madhe kur zihen djemtë e vegjël me njëri-tjetrin shahen me distikë që rimojnë: “*un e lam e ti n lam, t q... p... e sat' a:më*”

Urinon me vështirësi:

i lidhet ujt (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:121);

Shprehje për ushqimin e keq:

fale zot (Osmani & Pepa 2000:115);
zot fale (Osmani & Pepa 2000:144);

Pordha: *kopçe* (Rushat – Pejë) (Zymberi 1981:171);

Jashtëqitja e hollë:

shkulë (Dedi 1974:189);
shkulan (Dedi 1974:13);
e qon barku, e pkauti barku (Pp).

Urinoj:

baj ujt e holl,
derdh uj (Zymberi 1981:164);
derdh ujët (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:112);
derdh uj (Pp)

9. Pjesët e trupit të njeriut

Dhëmbët:

puntoret. (Tropojë) (Osmani & Pepa 2000:135);

Flokë të thinjur:

flokë gri. (Osmani & Pepa 2000:116);

Gryka:

gryka e bardhë (FGJSSH 1980:583);

të bukurat. (Osmani & Pepa 2000:110);

Thinjat:

bora e pleqërisë (Osmani & Pepa 2000:108);

Tullac:

kokëzbardhur (Skrapar) (Metani 1990:80)

Tumri:

mish i huaj (Osmani & Pepa 2000:128);

Njerëzit që mbajnë syze:

qorre, qorri, saymizhitmi (Pp)

Grykët:

bukur (FGJSSH 2001)

10. Fenomene natyrore

Erë e Jugut:

juga e bardhë (Osmani & Pepa 2000:121);

Vetëtima:

dora e zotit. (Hot) (Osmani & Pepa 2000:113);

Ylberi:

brezi i Zojës (Mirditë e Shkodër) (Beci 1987:195)

Perëndon dielli:

bën dhëmbëz dielli (Polis, Shpat – Elbasan) (Osmani & Pepa 2000:107);

falet dielli (Osmani & Pepa 2000:115);

Shuaje dritën:

fale dritën (Osmani & Pepa 2000:115);

Zoti:

farëmiri (Reinhold 1855:10, Kostallari 1972:185)

Fshikëza e ujit:

vendi i ujit. (Osmani & Pepa 2000:142)

Shakullinë:

hajeuk (Kavajë e Kryezi) (Çeliku 1974:194)

Orë pa fat:

orë cubake. (Pukë); *orë cubele* (M. Madhe) (Gazulli 1941:86)

11. Mjete teknologjike

Aeroplani:

krayeshkraum (Ibrahimi 2007:104) P.sh. *Or ballaum more krayeshkraum/ ku e nais more me na qau...* (Ibrahimi 2003:72).

Pushka:

e shkreta (Osmani & Pepa 2000:138);
grykëhollë; grykëngushtë (I shkëlqente grykë ngushta) (FGJSSH 2001)

Shkrepi i pushkës:

ngaskeq (M. Madhe, Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:123);

12. Eufemizma që lidhen me jetën familjare

Beqare:

s'i ka dalë fati. (Osmani & Pepa 2000:137);
vajzë e ndejme (Shkodër, M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:142);
nauk i ka dal kismetit (Pp)

Burri:

ai (Beci 1974:259);
fati (Budi 1621:185);
ky (Shkodër) (Osmani & Pepa 2000:124);
neri (Osmani & Pepa 2000:130);
njeriu (Katund i Ri), (Beci 1974:264);
baba i Shatit (baba i Reshatit)

Dy gratë e një burri: *shoqe.* (Beci 1965:90)

Fëmijë i vogël: *njomja* (Osmani & Pepa 2000:131);

Grua e keqe: *virane* (Osmani & Pepa 2000:143)

Gruaja: *ajo* (M. Madhe) (Osmani & Pepa 2000:103)

Kunati: *lalbukur* (Arbëreshët e Italisës) (Domi 1986:108)

Nata e tretë pas lindjes së foshnjës:

të tretat e natës (Nushi 1974:294)
tretanet (Ibrahimi 2007:171)

Vjehri :

babaxhýpi (Ibrahimi 2007:48“...Bon konak baba xhýpi, bon konak/se do t'vije Jago baba, bon konak” (Ibrahimi 2003: 80)

Vjehrra:

nanaxhypka (Ibrahimi 2007:127); “*Amanat nanaxhypka / bon gati ajne drekën..*”) (Ibrahimi 2003:94)

Muaji i parë i jetës bashkëshortore:

Muaji i mjaltit (FGJSSH 2001)

Kripa: *ajo e gjellës* (Gjirokastër) (Osmani & Pepa 2000:103)

Ç. PARAGJYKIMET MIDIS POPUJVE, GJUHËVE DHE KULTURAVE TË NDRYSHME

Kjo urrejtje ndaj gjuhës së tjetrit, është si pasojë e mosnjohjes dhe moskuptimit i të huajt, as që është bërë përpjekje që të kuptohet. Pra dallimet e gjuhës i kuptojnë si shenjë të pabarazisë dhe ndaj gjuhës së tjetrit është parë si gjuhë e parëndësishme, njëkohësisht është rritur edhe urrejtja ndaj atij populli. Një konsultim i thjeshtë me fjalorin, për termin "i huaj" tregon sa është i larmishëm, kompleks dhe shumëformësh perceptimi i "tjetrit". Ky term mund t'i emërojë kombet ndërmjet tyre ose ato që nuk i përkasin grupit të cilit i referohet, njëkohësisht i huaji mund të emërojë një altar të njohur apo përkundrazi të panjohur. Pasi për të ekzistuar secili identifikohet në raport me tjetrin, fqinjët janë shënjestra e parë, të cilën kombet mundohen ta karakterizojnë sipas nevojës së tyre vetanake për ta treguar veten.

Dallojmë tri mënyra të paragjykimeve mbi gjuhën: *estetike, pragmatike dhe moralo-shoqëror*. (Bugarski 1975:193). Më tepër dominojnë paragjykimet pragmatike, por të pranishëm janë edhe ato estetike.

1. Paragjykime estetike

Në çdo hap dëgjojmë se si gjuhët romane janë të butë, të lehtë e deri "muzikal", kurse gjermanishtja e fortë, që flitet me fytnin; se si spanjishtja dhe italishtja janë më të bukurit, kurse danishtja dhe holandishtja gjuhët më të shëmtuara në Evropë. Shpeshherë paragjykimet për bukurinë e një gjuhe marrin elemente nga përjetimet personale apo kolektive me shtetin ku flitet ajo gjuhë. Ata që e duan Italinë dhe italianët e duan edhe gjuhën e tyre dhe janë të përgatitur të vërtetojnë se vetëm me atë gjuhë mund të këndohet opera. Shembull tjetër mund të merren shtetet e ish-Jugosllavisë dhe shtete tjera evropiane, nga shkaqe tashmë të njohura gjermanishtja është kryesisht gjuhë komanduese: *i ashpër, i vrazhdë, ndërprerës dhe joikëndshëm*. (Bugarski 1975:194).

Fjalë të reja formohen duke i përdorur emrat e një shteti, dhe duke treguar një karakteristikë të tyre. P.sh. anglezët thuan "*Italian blue*" (bukuroshe italiane); "*french red*"; "*Chinese white*"; *rusko zelen*; *bleu indien*; *blanc de Chine*; *malaingelb*; *prussische blau*; *sudan cernji*; (Aleksandrovna 1990)

Kështu, historianët romakë kanë lavdëruar vlerën e disa armiqve të tyre për ta forcuar më mirë imazhin e tyre si ngadhënjimtarë.

2. Paragjykime pragmatike

Pasojat më të mëdha të një absolutizmi të tillë nuk është në atë se sa i bukur ose sa i rëndë është një gjuhë e caktuar, por aftësia e tij për të kryer një funksion. Këto paragjykime mund t'i quajmë si pragmatike. Këtu kemi të bëjmë në besimin e popujve të caktuar se eksitojnë gjuhë primitive dhe gjuhë të zhvilluara.

Në shek. 18-19 ende vazhdonte periudha e romantizmit, ku në fakt kjo është periudha e ndryshimeve të mëdha shoqërore, lëvizjeve nacionale, ku rëndësi i jepej gjuhëve nacionale dhe folklorit. Kjo është periudha e zhvillimit të ndërgjegjes kombëtare dhe realizimit të ideve për shtete nacionale. Me anë të këtyre konceptioneve romantike, ata e kanë matur fuqinë e tyre, pikërisht duke e lartësuar gjuhën e tyre, dhe duke zvogëluar dhe nënçmuar gjuhën e popujve tjerë. I huaj, i cili nuk flet greqisht, për qytetarët e Athinës do të cilësohet si **“barbar”**. Pak më vonë, historia do të vlij nga shprehjet të cilët do të tregojnë se gjuha e tjetrit nuk pranohet dhe respektohet. Disa popuj evropian, po ashtu filluan ta lartësojnë pozicionin e gjuhës së tyre, kryesisht duke u mbështetur në paragjykimet romantike parababilonase. Kështu gjermanët gjuhën e tyre e konsideronin si **“gjuhë që ka mbifuqi natyrore”** (paragjykim nga i cili edhe lindi racizmi hitlerian), frënget kryesisht mbështeteshin në atë se, **“gjuha e tyre është aq e qartë dhe e logjikshme, sa që çdo mendim në gjuhën frenge del logjikisht”**. Në këto gara nuk ngelën mbas, as anglezët, të cilët për gjuhën e tyre pohonin se **“zoti mund të flet vetëm anglisht”**. (Bugarski 1975:200-201).

Shumë zhargone tregojnë kundërshtim dhe mosbesim ndaj pjesëtarëve të ndonjë nacionaliteti tjetër, andaj nuk janë të rralla fjalët pejorative dhe nënçmuese që theksojnë dallimet. Prej këtu në fushën e etnonimeve zhargonet përdoren në mënyrë selektive, duke treguar interes ndaj një numri më të vogël të grupeve etnike të cilët më shpesh janë në cak të stereotipeve dhe botëkuptimeve të ndryshme.

Një numër i konsiderueshëm të fjalëve flasin për mostolerancë fetare, ndërnacionale, racore, klasore, fisnore etj. Ndoshta jo përherë kemi të bëjmë për jotolerancë, por ndonjëherë ata përdoren nga dëshira që të dallohet nga tjerët dhe mos t'i takojë asnjë grupi tjetër, përveç asaj që i takon. Qëllimi i tyre i vërtetë ka qenë se e kanë favorizuar gjuhën dhe kulturën e vet, kurse gjuhët e huaja i anatemojnë ose i përqeshin. P.sh. grekët por

më vonë edhe romakët, barbaros i quajnë njerëzit që flasin ndryshe nga ta. Sllavët i emërtojnë gjermanët me fjalën *njemci* “*memeç*”, me të vetmin qëllim që ta nënçmojnë dhe zhvleftësojnë së pari gjuhën e pastaj edhe popullin gjerman në përgjithësi. Gjermanët nga ana tjetër fqinjët e tyre sllav i kanë qerosur me emërtimet: ***pelltek, i huaj, varvar, dushman, farrë qeni*** etj. (Bugarski 2001a:21). Në Mali populli ***bobo*** mban emrin që në gjuhën *bombare* do të thotë “*memeç*”. Në shek VI, ***uellshanët***, vetin e quajnë “*cymry*”, që në gjuhën e tyre do të thotë “*atdhetarë*”, nga ana tjetër anglosaksonët do t’ua japin emrin ***Welsh***, që do të thotë “*të huaj*”. Arabët popullit që gjendet në Afrikën perëndimore në jug të Saharës do t’i japin emrin ***Sudan***, që burimisht do të thotë “*i zi*”. Detarët portugez të cilët të parit arritën në lumin Vuri e emërtuan ***rio dos cameroes (lumi i guacave)***, shumë shpejt kështu u emërua edhe tërë rajoni, kështu në spanjisht kemi *camerones*, anglisht *cameroons*, gjermanisht *kamerun* dhe frëngjisht për *cameroun*. Në vitin 1914 kur çetat afrikane dhe verioafrikane morën pjesë në hterrjet francezo-gjermane, ***arabët*** bëhen ***arbicots*** (fjalë që më vonë do të krijohet emërtimi racist ***bicots***), kurse ***zezakët bamboulas***. Shembulli më i mirë i astrologjisë koloniale dhe raciste lidhet me historikun e fjalës ***kanibal***, që sot ka kuptimin e njerëngrënës. Fjala kanibal është huazim nga spanjishtja, por e ndryshuar nga caribal që rrjedh nga ***caribe***, fjalë nga Karaibet Antile që do të thotë “mendjemadh”. Për herë të parë e përdor në ditarin e tij Kristofor Kolumbo, që gabimisht e shkruan ***caniba*** me të dhënata se hanë mish njeriu. (Kalve 1981:70-74). Francezët një fis indian që mban unaza në hundë e quajnë “*të shpuarit me unaza*” (Jackson 1972: 37).

3. Paragjykime në lidhje me vlerësimet shoqërore-morale

Në kohët tona, një pjesë e madhe e barsoletave popullore thuren kinse mbi "karakteristikat" e kombit fqinj, barsoleta që shpesh nuk janë në favor të tyre. Për shembull, për të treguar individë jo të shkathtë dhe pak inteligjentë, francezët tregojnë barsoleta mbi belgët, kroatët mbi boshnjakët, serbët e maqedonasit mbi shqiptarët, dhe reciprokisht korsët e malazezët, dy kombe malore në breg të detit, tregohen si përtacë. Grekët thuhet se janë homofilë dhe skocezët njihen për koprracinë e tyre. Përveç barsoletave të buta mbi këta të huaj-fqinjë, raportet me fjalë me tendencë përçmuese pa të keqe, linden, për shembull, sipas zakoneve të kuzhinës, kështu që anglezët i thërrasin francezët "frogs" dhe reciprokisht francezët i quajnë anglezët "rosbeef".

Edhe ndaj shqiptarëve kanë lindur shumë paragjykime, sepse i huaji shpesh supozohet të jetë një shkaktar i problemeve dhe

burimi i të gjitha të këqijave - asgjë nuk ka ndryshuar nga këto mendime, as në kohët tona - gjë që i mundëson kronistit Monaldo Leopardi të mendojë në Annali di Recanati- se shqiptarët "*janë një popull që i tejkalon të gjithë popujt e njohur deri më tani për vrasjet, vdekjet dhe infeksionet, i cili gjithmonë ka sjellë murtajën në qytetin e Recanatit*". Por, kontributi pozitiv i këtyre po të njëjtëve imigrantë është evident dhe kronisti i cituar më herët detyrohet të pranojë se shqiptarët "*kanë kontribuar shumë për përmirësimin e kulturave në fshatrat tona, të cilat, përpara ishin gati të paditura*".

Në një satirë bizantine e shekullit XV, e quajtur Mazarine, "*shqiptarët i quan si hajna dhe qenie të dhunshme*". Julian Amery në poemën e tij, "Songs of the Eagle" në shekullin XX, shqiptarët dalin "*si të pamposhtshëm dhe krenarë, xhentëlmenë të mëdhenj, po edhe si hajdutë të mëdhenj, që vënë nderin para burrërisë*". Kronisti Dukas gjithashtu i shekullit XV, në Historia Turco-Byzantina i cilëson "*shqiptarët si një racë barbare, duke i vënë në një pozitë si kombet e tjera të Ballkanit, të konsideruar si derra apo qen*". Përkundrazi, murgu dominikan, Gulielm Ade, apo i quajtur ndryshe edhe Pseudo-Brokardus, provon të tregojë dominim të tepruar të ortodoksëve serbë në shekullin XIV dhe *mbron shqiptarët, që dalin kësaj radhe trima e heronj të mirë*. Ata, sipas një anonimi të vitit 1571, pra shqiptarët e veçanërisht ata të Ulqinit, nuk i donin të huajt, për shkak të disa emocioneve që ishin të inspiruar nga të hequrit dorë të Medesë nga Zhazoni dhe gjejmë këtu një përzjerje në mes të mitologjisë dhe arsyes politike.

Vetizolimi, çoi nga njëra anë në ruajtjen e gjuhës dhe të identitetit arbëresh, siç parapëlqejnë vetë shqiptaro-italianë e këtyre kolonive. Nga ana tjetër, kjo pati pasoja negative, sepse ata mbeten të huaj për italianët dhe të trajtoheshin edhe në vazhdimësi me një farë mosbesimi. Në fshatin Falkunara, kryetari Erkole Konti përmendi shprehjen italiane ndaj arbëreshëve "*vrit arbëreshin e lë ujkun*". (Ibrahimi 2008:138). Një fjalë e urtë siciliane thoshte atëherë: "*Si vidhi llu gjegju e vidhi llu llupu, spara allu gjegju e llasa llu llupu*" **Ndë sheh një arbëresh e një ulk, shkrehu arbëreshit e le ulkun** (nëse ti ndesh në rrugë një ujk dhe një shqiptar atëherë qëllon në fillim shqiptarin). Por edhe arbëreshët kanë patur shprehje të ngjashme si: "**Derk e lti mos e klit ndë shpi se të mblon me bri**" ose "**L'tiri t'ha, t'pi e t'lidhen**". Një prift arbëresh, për ta shprehur urrejtjen e trashëguar, emrin lti ua shkruante fëmijëve të fshatit në thembrën e këpucës: "*shkileni, shkileni ltirin tërë ditën, nesër prapë do t'jua shkruaj*". (Zllatku1996:52).

Këto paragjykime vazhduan edhe në historinë e më vonshme të shqiptarëve. Stereotipa të tilla shprehëse ndaj shqiptarëve

përdori edhe propaganda italiane në luftën e Vlorës më 1920 që e ndoqi shtypi italian. Shqiptarët ishin: *cuba, rebelë, që duhen dënuar rreptë*. (Lloshi 2001:227); Mjaft karakteristike për hapësirat ballkanike ishin emërtimet e popujve ish-jugosllav për shqiptarët Në Kosovë, Maqedoni e mal të Zi .

Shqiptarët nga serbët dhe maqedonasit emërohen me fjalët: *shipac, shipus, shipos, shiptar, shiptarishka, shiça, shica* (Bugarski 2006:182). Për shqiptarët përdoren edhe zhargone tjera si: *albanska svječica – furati albanska svječica* (d.m.th. si ata që rëndë dhe ngadalë kuptojnë) (Sabljak :27); shqiptarët u emërtuan edhe si: *shipa, vaterpolist* (Bugarski 2006:185). Përveç këtyre fjalëve ofenduese shqiptarët vazhdimisht nga propaganda serbe dhe maqedonase në ish-Jugosllavi u etikun si: *nacionalist, separatist, irredentist, dhunues, të egër, etj.*

Edhe shqiptarët kishin emërtime ofenduese për sllavët si: *shka, kaur, kaurçe, gjaur, thi, derr;*

Ndaj **romëve** nga ana e shqiptarëve përdoren zhargonet: *maxhup, gjyp, çergar, cigo, romale (në Maqedoni); jevg, gipsi, maxhup, gabel, cigan, arixhinj (në Shqipëri);* Përveç zhargoneve të nxjerra nga emërtimi i grupit, ekzistojnë edhe zhargone të motivuar nga perceptimet e popullarizuara, karakteristikave të tyre tipike, ose si lojë fjalësh. Kështu **romët** në mënyrë plotësuese quhen edhe *akate-soske, ato me çadrët (në rrethin e Prilepit); rrac kamxhiku, bythzi, harixhi, maloket e mutit, zift dhe qymyr (në Shqipëri); ganac, gancara, garagan, shtroks, ugljesha, ciguligu (në Serbi)* (Bugarski 2006:182);

Interesant janë edhe dallimet sipas dy dialekteve, në dialektin gegë përdoren: **magjyp, gabel** kurse në dialektin tosk: **jev gj, arixhinj**. Ndaj **vllahëve**: *cincar, karakaçun, mijak, vllah.*

Ekziston edhe **mostolerancë fetare**, zakonisht serbët përdorin këto fjalë ndaj myslimanëve: *muslić, musloš, muslima, muslidža*. Por edhe *mudžos, mudža, mudžara* duke aluduar se ata përfaqësojnë muxhahedinët. Myslimani për serbët është edhe *obreznjak* (i prerë duke aluduar për synetin) dhe *zelenko, zeleni* (i gjelbër – i papjekur) (Bugarski 2006:182)

Shpeshherë gjatë emërtimit të aziatikëve paraqitet edhe **mostoleranca racore**, kështu për kinezët kemi **kinxha, zhutaç, zhuça, zubonja dhe sarsiç** (Bugarski 2006:182), italianët janë vetëm **makaronxhi** dhe **zhabar**.

4. Stereotipat midis qyteteve dhe fshatrave

Përveç mostolerancës nacionale dhe fetare, në hapësirat shqiptare paragjykimet lindin edhe nga dallimet dialektore të krahinave dhe stileve të gjuhës. Në këtë ndikojnë edhe ndryshimet radikale demografike të qyteteve dhe krahinave, andaj lindin distikcionet gjuhësore midis asaj “*më e mirës*”, “*më burimore*” dhe “*folmja e pastër e fshatit tonë*”, *gjuha e shkujdesur të qytetit*”. P.sh. Duke i pyetur banorët disa fshatrave në fushëgropën Gordola afër Nicës të Francës, se çfarë mendojnë për gjuhët e të tjerëve, pothuaj çdo fshat kishte nga një emërtim i tillë. Ata shpjegonin se banorët e Lantosit janë **cougourdias** (“*kungullaxhi*” sepse është folur se hanë shumë kunguj); banorët e La Bolena emërtohen **amouyans** (“*qershia të thata*”), banorët e San Marten de Vezubija kanë marrë emrin **totchis** (“*të vegjlit*”); ata të fshatit Belvedera si **banes** (“*bri kaprolli, brinaxhinj*”) et. Të gjithë këto vende janë në një radius prej 30 km rreth. Por pa marrë parasysh se këta banorë midis veti quhen **cougourdias, amouyans, totchis** apo **banes**, qytetarët e Nicës me një emër i quajnë **gaouatchs** “*malësor*”. Por provincat tjera japin edhe forma tjera në Provancë quhen **gavot**, në Gaskonj **gavach**, kurse në Katalonj **gabach** (Kalve 1995:92-93). Emërtime të tilla kemi edhe midis fshatrave shqiptare. P.sh. banorët e viseve malore quhen **malësor**, por edhe variante tjera *malok, lok, cecen*.

Pothuaj të gjitha fshatrat shqiptare në rrethin e Prilepit dhe Krushevës kanë emërtime midis veti. P.sh. banorët e fshatit Alldançe emërohen si **laknaxhi**; banorë e fshatit Debresh “*pomak*” dhe **torbesh**; ata të Nerovës “*babajkovci*”. Banorët e fshatit Cërnilishtë nga desovarët quhen “**d’buçallës**” (nga toponimi Buçallë në Cërnilishtë), kurse cërnilishtasit ua kthejnë “**d’gollanës**” (nga toponimi Gollanë në Desovë); Banorët e Cërnilishtës nga debreshtasit quhen **gërk** (sepse nuk i kuptojnë shqip), kurse cërnilishtasit ua kthejnë **bugar** (sepse flasin maqedonisht).

Emërtime të tilla kemi edhe për qytetet e ndryshme shqiptare, si p.sh.: **Tiranasi** – *tirans, jevg, gipsi, ije tarane, katnort e Tirons, tiransit puro*; **Shkodran**- *shkordhran, mendje sheqer*; **Elbasanli** - *gabel, jevg elbasani*; **Korçar** - *lekur zi, rom*; **Gjirokastrit**- *enver gjirokastre*; **Burrels** - *rraksionar, delenxhi*; **Dibran**- *lumjan hesapi*; **Mirditor** - *kaurr, lekur derr*; **Krutan** – *qifut*; **Pogradecar** - *pordhi dhija pordhi keci*; **Durrsak** - *gjypk durrsi*; **Tropojan** - *shllunge Tropoje*; **Kavajs**- *homo*; **lezha** - *leshi i qullit*; **Lac** - *pordha e Matit* . **Kosovar** - *koqevan, koke trash, emocional, malok, i pagdhundur*; **Lali** – *galuc, lepur, zhabe myzeqeje*; **Lab** - *labuc, opinga, zhabe kanali*;

5. Barsoleta të përdorura si rezultat i paragjytimeve

Banorët e një qyteti apo fshati gjejnë kënaqësi kur tregojnë barsoleta për qytetin apo fshatin fqinj. Që kjo barsoletë të jetë sa më e mirë, duhet të tregohet dhe imitohet në atë të folme ose dialekt. Karakteristike janë edhe barsoletat krahinore, sidomos ato brenda shqiptare. Ja disa të tilla midis shqiptarëve nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria.

Çikë të nxehtë

Shqiptari i Shqipërisë viziton Kosovën, pasi hynë në restorant njëri prej tyre porositi pica dhe i thotë kamerierit “Çuni, ma bëj ‘i çikë të nxehtë!’” Meqë kosovari e kupton fjalën çikë si vajzë, kamerieri i gJORë duke menduar se tipi po kërkon prostitute, ia kthen: “më fal zotëri, ne nuk jemi lokal që ofron shërbime të tilla!”

Minibus-kombi

Në ditët e para kur u çel kufiri Shqipëri - Maqedoni një familje tetovare nisete për Shqipëri me minibus. Siç dihet në atë kohë Shqipëria për maqedonasit merrte vizë hyrëse, ndërsa për shqiptarët e Maqedonisë jo. Kur kjo familje tetovare arrin në kufi, polici e pyet tetovarin se çfarë kombi je, tetovari ia kthen ford tranzit, duke menduar se e pyet për kombin, pasi në Maqedoni minibusit i thonë kombi.

“Albanski konjak”

Në një rast tjetër tregohet kur tetovari shkon në Tiranë për të blerë konjak, hyn në shitore dhe i thotë: a kini ‘Albanski konjak’ shitësi i tërë i habitur assesi ta kuptoj. Më në fund merren vesh kur i thotë se kërkon konjakun me emrin Skënderbe.

Pavarësisht nga mendimet e shprehura ndaj të tjerëve, ndonjëherë arbitrare apo të bazuara dhe jashtë kontekstit mental të mbushur me besim fetar, ajo që prek më shumë mendjen moderne është mënyra direkte, madje emocionale dhe pa ngurrim etik, me të cilën të diturit e Mesjetës gryojnë pjesëtarët e një bashkësie tjetër. Prej atëherë, prej Renesancës në Shekullin e Lumjerëve, Perëndimi është prekur nga era nacionaliste dhe fjalimet mbi tolerancën, mbi argumentimin shkencor dhe nga motorë të tjerë për arritjen e një mendimi të quajtur "objektiv." Tashmë duket e paparamendueshme të quhet cilido komb me emra: "shtazë të egra", "primitivë" dhe ajo "politikisht korrekte" kërkon përdorim të formave shumë më të buta të cilësorëve të vlerësuar si degradues ndaj cilësdo bashkësie qoftë. Nuk thuhet më "zezak", por "njeriu me ngjyrë", "i verbër", por "që nuk sheh," "Bota e Tretë" për "Vend në zhvillim" etj.

PËRFUNDIM

POROSIA UNIVERSALE E DUKURIVE SOCIOLINGUISTIKE

Në tërë botën dukuritë sociolinguistike (*zhargonet, blendet, eufemizmat*) kanë vija të përbashkëta që paraqiten gjithkund. Tek të gjithë popujt paraqitet diçka që është e përbashkët dhe që ka të bëjë me natyrën e njeriut. Nëse analizohen këto dukuri nëpër shtete të ndryshme mund të vërejmë shumë ngjashmëri, por edhe dukuri që janë karakteristike vetëm për një popull.

Sot në botë ka shumë botime dhe vebsajte me zhargone të tilla sinonimesh. P.sh. në Amerikë ka një website për prindërit me një liste të madhe "slangu" ose gjuhe e krijuar nga rinia. Edhe në Itali, adoleshentët dhe të rinjtë kanë publikuar në internet fjalorët me zhargonet e tyre. Mund të gjejmë me disa përjashtime shumë fjalë të ngjashme që në mënyrë metaforike paraqiten gjithkund.

Ndoshta disa nga këto "lojëra fjalësh" nuk janë inventive, por nga ana teknike ata ilustrojnë mundësinë që më parë nuk janë shfrytëzuar, pra këto janë shenjat e kohës së re.

Qëllimi ynë nuk ishte që këto inovacione t'i lavdërojmë ose t'i sulmojmë, por t'i regjistrojmë dhe t'i përshkruajmë sa më mirë të gjitha këto krijime jo të rëndomta, ndërsa vetë lexuesi do të mund të vlerësojë cilat prej tyre janë banale e cilat inovacione të rëndësishme. Medoemos në fund të pajtohemi se me anë të eksperimentimit të fjalëve ne zbulojmë një mënyrë tjetër të këndshme të komunikimit dhe zbulimit të botës.

Megjithatë, shumë prej këtyre fjalëve janë të njohura dhe të kuptueshme për shqipfolësit. E mira është që disa nga ta duhet të propozohen që këto fjalë të futen në fjalorin e gjuhës shqipe. Aq më mirë që këto fjalë nuk kanë ndikim të huaj por janë fjalë të mirëfillta shqiptare. Në këto fjalë pasqyrohet në mënyrë të theksuar edhe humori i kulturës sonë.

Përdorimi i një fjalori të tillë simbolizon lirinë dhe afirmimetin e moshës. Në atë moshë, të gjithë kërkojnë të bëjnë diçka të veçantë dhe ndoshta një fjalor i tillë i lehtësuar.

SHKURTESAT, QYTETET DHE MBLEDHËSIT

Shqipëri (Alb): Material nga burime të ndryshme

Tetovë (Te):

Fatmire Elmazi (studente në UEJL)
Elmira Qufliu (studente në UEJL)
Feride Muaremi (studente në UEJL)
Jetmir Adili (studente në UEJL)
Jeton Bexheti (student në UEJL)
Mimoza Arifi, (studente në UEJL)
Ramije Bislimi, (studente në UEJL)
Ramije Muaremi, (studente në UEJL)
Sadete Luma, (studente në UEJL)
Shpresa Demiri, (studente në UEJL)
Sihana Jashari, (studente në UEJL)
Xhemile Misimi, (studente në UEJL)
Zujeta Rushiti (studente në UEJL)
Havije Murati (studente në UEJL)

Gostivar (Go):

Valdeta Kadriu, (studente në UEJL)
Jusra Abduraimi, (studente në UEJL)
Ilinka Mateska (studente në UEJL),

Shkup (Shk):

Orhan Kadriu (student në Shën Qiril dhe Metodi)

Strugë (St):

Lindita Kaliqi (studente në UEJL)

Kumanovë (Ku):

Jehona Salihi (studente në UEJL)

Kërçovë (Kç):

Afërdita Ramadani, (studente në UEJL)
Çeflije Seferi (studente në UEJL)

Dibër (Di):

Jehona Ramku (studente në USHT)

Prilep (Pp):

Samedin Imeri (profesor)

Krushevë (Kr):

Blerije Bajrami (studente në USHT)

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Literatura për zhargonet, blendet dhe paragjykimet

- Bugarski, R. (1975). *Lingvistika o čoveku*. Biblioteka XX. Beograd
- Bugarski, R. (2001). *Jazici*. Ein-Sof. Skopje.
- Bugarski, R. (2006). *Žargon*. Biblioteka XX. Beograd.
- Bugarski, R. (2005). *Jezik i kultura*. Biblioteka XX. Beograd.
- Çepani, Anila. (2006). *Probleme të kulturës së gjuhës në përdorimin e shqipes në internet*. Në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. 25/1. Prishtinë.
- Haxhihasani, Qemal (1964), “ *Të folmet shoqnore. Dogançja, e folmja shoqnore e zejtarëve shëtitës të Permetit dhe të Leskovikut*”. Në revistën “*Studime filologjike, Tiranë, nr. 1,2,3*.”
- Ibrahimi, Mustafa (2008). *Shënime udhëtimi mes arbëreshëve të Italisë*. Shkup: Interlingua.
- Imami, P. (2000). *Beogradski frajerski rečnik*. Beograd: NNK International.
- Jespersen, Otto (1970). *Čovječanstvo, narod i pojedinac sa lingvističkog stanovišta*. Sarajevo.
- Kalve, Žan Luj. (1981). *Lingvistika i kolonijalizam*. Beograd.
- Kalve, Žan Luj. (1995). *Rat među jezicima*. Beograd.
- Lloshi, Xhevat. (2001). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë.
- Ogden C.K.&Richards I.A.(1923). "*The meaning of meaning*" London. RSANU. *Rečnik Srpske Akademije Nauke i Umetnosti*. Beograd.
- Stefi, Jani. (1970). *Leksikologjia shqipe*. Prishtinë.
- Sabljak, T. (1981). *Rječnik šatrovačkog govora*. Zagreb: Globus.
- Tagliavini C., (1943). "*Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*", *Le terre albanesi redente I Kosovo*. Roma 1943, f.73-82.
- Thomai .J.(2003) *Leksikologjia*. Tiranë.
- Ymeri, Mariana (2002). *Zhargonet dhe dëshmitë e tij në gjuhën shqipe*. Në Revistën Gjuha jonë. Tiranë, nr.1-2.
- Zllatku, Rexhep. (1996). *Me arbëreshët*. Shkup

2. Literatura për eufemizmat

- Abdullah Zymberi, *Leksiku bujqësor dhe blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*. Prishtinë 1996.
- Agolli, D. (1980). *Trëndafil në gotë*. Tiranë.
- Allan, K. & Burridge, K. (1991), *Euphemism & Dysphemism: Language Used as Shield and Weapon*, Oxford University Press, Oxford.
- Bariçi, H. (1950). *Fjalor i gjuhës serbishte ose kroatishte dhe shqipe*. Zagreb.
- Beci, B. (1965). *E folmja e Reç – e – Dardhës së Dibrës*. SF, nr 1.
- Beci, B. (1971). *E folmja e Shkrelit*. DSH, nr I.
- Beci, B. (1982). *E folmja e Mirditës*. DSH, nr IV. Tiranë.
- Beci, B. (1987). *E folmja e Mirditës*. DSH, nr V. Tiranë.
- Beci, Bahri. (1974). *E folmja e Luznisë së Dibrës*. Në *Dialektologjia shiptare*, II. Tiranë.
- Budi, K, Ashta. (1998). *Leksikku historik i gjuhës shqipe*. nr II. Tiranë
- Budi, P. (1621). *Rituali roman*. Romë.
- Çabej, E. (1947). *Linguistika*. Tiranë.
- Çabej, E. (1949). *Disa eufemizma të shqipes*. BISH, nr I. Tiranë.
- Çabej, E. (1961). *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*. nr I. Tiranë.
- Çabej, E. (1969). *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike*. nr III. Tiranë
- Çabej, E. (1977). *Disa eufemizma të shqipes*. SGJ, nr IV. Prishtinë.
- Çabej, E. (1982, 1976, 1987). *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. SGJ, nr I, nr II, nr III. Tiranë.
- Çefa, A. (1988). *Fjalë nga rrethi i Shkodrës*. GJJ, nr 4.
- Çeliku, M. (1971). *E folmja kalimtare e Shpatit*. DSH, nr I. Tiranë.
- Çeliku. (1974). *Të folmet e Kavajës*. DSH, nr II. Tiranë.
- Cordignano, F. (1934). *Dizionario albanese – italiano (Fjalori shqip – italisht)*. Milano.
- Curraj, M. (1983). *Fjalë të mbledhura në rrethin e Pukës*. GJJ, nr 2.
- Davidi, P. (1983). *Frazeologji dhe shprehje nga goja e popullit mbledhur në Myzeqe të Vlorës*. GJJ, nr 2.
- Dedi, V. (1973). *Material leksikor nga krahinat*. SF, nr 4.
- Dedi, V. (1974). *Materrial leksikor nga krahinat*. SF, nr 1.
- Disdari, R – Ndoja, H. (1975). *Të dhëna nga mjekësia popullore e Shqipërisë së Veriut*. Tiranë.
- Domi, M. (1986). *Të dhëna nga jeta e vepra e A. Xhuvani*. SF, nr 4.
- Elezi, P. (1982). *Kontribut për fjalorin dialektor*. DSH, nr IV. Tiranë.
- Eqrem Çabej, *Disa eufemizma të shqipes*, në “Studime Gjuhësore”, Prishtinë 1976, vëll.IV, f.17.

- FGJSSH. (1981). *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Prishtinë.
- FGJSSH. (1980). *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë.
- Fishta, GJ. (1982). *Anzat e parnasit*. Shkodër.
- Fishta, Gjergj. (1921). "*Gomari i Babatasit*". Tiranë.
- Gazulli, N. (1941). *Fjalorth i ri, fjalë të rralla të përdorura në veri të Shqipërisë*. Tiranë.
- Giordano, E. (1963). *Fjalor i arbëreshëve t'italisë*. Bari.
- Gj.Shkurtaç, *Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes sipas ideve të Eqrem Çabej*. Studime shqiptare 9. Çabej, 1998, f.86-97. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. 1984. Tiranë/
- Gjeçovi, Sh. (1943). *Bota shqiptare*. Tiranë.
- Gjigede, P. (1970). *Material nga krahinat*. SF, nr 4.
- Gjinari, J. (1971). *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*. DSH, nr I. Tiranë.
- Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*. Tiranë 2003. f. 241
- Gosturani, XH. (1982). *E folmja e Çeremit dhe e Valbonës*. DSH, nr 4. Tiranë.
- Hahni, G. (1853). *Albanischen Studien*. Jena.
- Halimi, M. (1979). *Mbi disa toponime të tipit perifrastik*. Onomastika e Kosovës. Prishtinë.
- Haxhihasani, Q. (1974). *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*. DSH, nr II. Tiranë.
- Haxhihasani, Q. (1987). *Vëzhgim rreth të folmes së Polisit*. DSH, nr V. Tiranë.
- Haxhihasani, Q.(1963). *Vëzhgime gjuhësore mbi krahinën e Lurës*. BSHSH, nr 4.
- Ibrahimi, Mustafa (2003). *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë*. "Flaka", Shkup.
- Ibrahimi, Mustafa (2007). *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*. "Interlingua", Shkup.
- Jakova, K. (1955). *Toka jonë*. Tiranë.
- Jashar, A. (1975). *Materiali frazeologjik nga krahina e Devollit*. SF, nr 4.
- Kostallari, A. (1984). *Tribunë e gjuhës shqipe*. GJJ, nr 3.
- Kostallari, A. (1989). *Vëzhgime mbi disa grupe fjalësh popullore të trojeve verilindore*. SL, nr III. Tiranë.
- Kostllari, A. (1972). *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*. Sl, nr I. Tiranë.
- Krimçë, M. (1988). *Fjalë e shprehje nga rrethi i Beratit*. GJJ, nr 3.
- Kristoforidhi, K. (1961). *Fjalori shqip – greqisht*. Tiranë.
- Kurti, D (1942). *Përralla kombëtare*. nr.I. Tiranë.
- Lafe, E. (1964). *E folma e Nikaj – Mërturit*. SF, nr 3.
- M.Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*, Prishtinë 1996.

- Metani, H.(1990). Fjalë e shprehje nga rrethi i Skraparit.GHJ, nr 3.
- Murati, Q. (1994). *Probleme të gjuhës së sotme dhe historike të shqipes*. Shkup.
- Nathanaili, N – Samara, M. (1990). *Fjalë e shprehje nga rrethi i Sarandës*. SF, nr 4.
- Nopça, F. (1921). *Zakone e besime në Shqipëri*. “Djalëria” nr 11.
- Nushi , Jani. (1970). *Material leksikor nga krahina (Muzeqe)*. Në SF nr.3 Tiranë.
- Nushi , Jani. (1970). *Material leksikor nga krahina (Muzeqe)*. Në SF nr.3 Tiranë.
- Nushi, J (1974). *Mitologji e besime në Muzeqe*. ESH, nr V. Tiranë.
- Osmani, T – S.Pepa, *Vëzhgime për disa eufemizma të shqipes*, në “Gjuha jonë“, Tiranë, 1-2, 1992, f.25-32.
- Osmani, T & Pepa, S. (2000). *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*. Shkodër.
- Pasini, Dinka. (2005).*Eufemizmi u Aniçevu rijeçniku*. “Fluminensia”, viti 17, nr.2.
- Palushi – F, Gj. (1988). *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Kukësit*. GJJ, nr 2.
- Pedersen, H. (1895). *Albanesische Texte mit Glosar*. Leipsig.
- Petriti, Ç. (1987). *Vëzhgim mbi të folmen e Strlcës*. DSH, nr V. Tiranë.
- Plaku, N. (1970). *Material leksikor nga krahinat*. Në SF, nr.4. Tiranë.
- Podgorica, F. (1989). *Fjalori etnofolklorik*. BSH, nr 2.
- Rawson,H. (1981). *A Dictionary of Euphemisms & Other Doubletalk*. New York:Crown Publishers.
- Reinhold, K.H. Teodor. (1855). *Noctes pelasgiges*. Athines.
- Shehu, H. (1987). *Vlerat potencilale të leksikut popullor në gjuhën e sotme letrare shqipe*. SF, nr 2.
- Shehu, H. (1991). *Fjalë e shprehje nga e folmja e Dibrës*. SF ,nr.2, Tiranë.
- Shehu, H. (1991). *Fjalë e shprehje nga e folmja e Dibrës*. SF ,nr.2, Tiranë.
- Shkurtaj, Gj. (1967). *E folmja e Kastratit*. SF, nr.3. Tiranë.
- Shkurtaj, GJ. (1974). *E folmja e Hotit*. DSH. nr. II. Tiranë.
- Shkurtaj, GJ. (1979). *E folmja e Kelmendit*. DSH, nr III.
- Shkurtaj, GJ. (1982.). *E folmja e Ranzave të Mbishkodrës*. DSH, nr IV. Tiranë.
- Shkurtaj, Gj. (1998). *Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes sipas ideve të Ekrem Çabejt*, në përmbledhjen “ *Eqrem Çabej – personaliteti i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare*.”
- Simja, K. (1981). *Fjalë dhe shprehje popullore nga Kosova*. SF, nr 3.

- Tafaj, S – Haxhillazi, P. (1989). *Fjalë dhe shprehje nga rrethi i Tiranës*. SF, nr 4. Tiranë.
- Tagliavini, K. (1937). *L'albanese di Dalmazia. Contributo alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara. Testi con traduzione interlineare. - Lesico etimologico*. Firenze.
- Tase, P. (1941). *Fjalorth i ri. Fjalë të rralla të përdorura në Jug të Shqipërisë*. Tiranë
- Tase, Pano (1941). *Fjalorth i ri. Fjalë të rralla të përdorura në jug të Shqipërisë*. Tiranë.
- Thomaj, J. (1987). *Rreth leksikut popullor në të folmet Verilindore*. SF, nr 2.
- Topalli, Xh. (1974). *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*. DSH, nr II. Tiranë.
- Totoni, M. (1964). *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*. SF, nr II.
- Totoni, M. (1971). *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*. DSH, 1.
- Tirta, Mark (1991). *Figura të mitologjisë shqiptare dhe përkime ballkanike*. Në "Makedonski Folklor" Viti XXIV, nr.48.
- Vreto, J. (1973). *Vepra*. Tiranë.
- Xhuvani, A. (1986). *Fjalë dhe shprehje të gjuhës shqipe*. SF, nr.2. Tiranë.
- Xhuvani, A. (1986). *Fjalë dhe shprehje të gjuhës shqipe*. SF, nr.2. Tiranë.
- Xhuvani, A. (1987). *Fjalë dhe shprehje të gjuhës shqipe*. SF, nr 1, 2, 3. Tiranë.
- Zeneli, E. (1987).
- Zymberi, A. (1979). *Fjalorth i fjalëve të rralla*. Prishtinë.
- Zymberi, Abdullah (1981). *Disa eufemizma dhe shprehje eufemike popullore shqipe*. Në "GjASSHF" IX, Prishtinë.
- Zymberi, Abdullah (1996). *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*. Prishtinë.
- Zymberi, Abdullah (1996). *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi*. Prishtinë.